

Valbona Berisha • Adelina Çitaku • Suzana Bajrami • Leutrim Klinaku

# MATEMATIKA

# 2

UDHËZUESI PËR MËSIMDHËNËS



LUARASI

**MATEMATIKA 2**  
**UDHËZUESI PËR MËSIMDHËNËS**



## **Përmbajtja**

<b>Parathënie .....</b>	<b>1</b>
<b>1. Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore për shkallën 1 (RNK) .....</b>	<b>3</b>
<b>2. Rezultatet e të nxënit për fushën e matematikës për shkallën 1 (RNF) .....</b>	<b>8</b>
<b>3. Rezultatet e të nxënit për lëndën e matematikës, klasa 2 (RNL) .....</b>	<b>12</b>
<b>4. Planet mësimore .....</b>	<b>16</b>

## Parathënie

Të nderuar mësimdhënës,

Udhëzuesi që keni në dorë është përgatitur në pajtim me kompletin e teksteve Matematika 2A dhe Matematika 2B, për klasën e dytë. Hartimi i kompletit të teksteve Matematika 2 është bërë në përputhje të plotë me rezultatet e nxënies për lëndën e matematikës, klasa 2, të cilat janë marrë nga kurrikulat lëndore/programet mësimore, për klasën e dytë (botuar nga MASHT, 2018). E tërë lënda është shtrirë përgjatë 185 orëve të planifikuara mësimore nga kjo lëndë. Qasja në mësimdhënien e matematikës, të cilën e sugjeron kompleti i teksteve së bashku me udhëzuesin, përmban tre hapa: Aktivitetet konkrete – Paraqitjet vizuale – Paraqitjet simbolike. Kjo qasje bashkëkohore tashmë është dëshmuar si praktikë shumë funksionale e mësimdhënies dhe nxënies së përmbajtjeve matematike në shkollën fillore. Përmes këtyre hapave, nxënësit:

1. Njoftohen me konceptet matematike përmes aktiviteteve konkrete, mjeteve konkretizuese, modeleve dhe manipulativëve.
2. Udhëheqen drejt paraqitjeve vizuale të koncepteve të mësuara matematike që shërbejnë për modelimin e problemeve matematike
3. Pas familjarizimit me idetë e zhvilluara matematike, vazhdojnë drejt fazave abstrakte të të nxënies të matematikës, ku përdorin numrat, simbolet, shprehjet dhe formulat.

Vendi qendror në kompletin e teksteve është rezervuar për zgjidhjen dhe modelimin e problemeve me fjalë. Zgjidhja e problemeve me fjalë, sot, paraqet qendrën e shumicës së kurrikulave bashkëkohore matematike, sepse është një mjet shumë efikas drejt zhvillimit të të menduarit të niveleve të larta kognitive. Baza kryesore mbi të cilën është hartuar kompleti i teksteve Matematika 2, është ndërlidhja direkte e përmbajtjeve matematike me objekte reale dhe me përvoja reale të nxënësve, gjë që siguron çasjen pozitive dhe motivimin e nxënësve për nxënien e lëndës së matematikës, e poashtu kontribon shumë për një komunikim të mirëfilltë në matematikë.

Udhëzuesi për Mësimdhënës është përgatitur për të ofruar ndihmë gjatë planifikimit dhe zhvillimit të mësimdhënies të matematikës në klasën e dytë. Sa i përket strukturimit të udhëzuesit, në pjesën e parë të tij janë paraqitur RNK-të (rezultatet e të nxënies për kompetenca kryesore për shkallën 1), në pjesën e dytë janë paraqitur RNF-të (rezultatet e të nxënies për fushën e matematikës për shkallën 1), të cilat janë marrë drejtpërdrejt nga Kurrikula bërthamë I (botuar nga MASHT, 2017). Në pjesën e tretë janë paraqitur RNL-të (rezultatet e të nxënies të

lëndës të matematikës për klasën 2), të cilat janë marrë nga Kurrikulat lëndore/programet mësimore, për klasën e dytë (botuar nga MASHT, 2018). Ky varg i tërë i rezultateve të nxënies është paraqitur vetëm për lehtësim gjatë punës së mësimdhënësve në planifikim dhe vlerësim. Në pjesën e katërt janë paraqitur planet mësimore. Me ndihmën e tabelave janë paraqitur shpërndarja e orëve mësimore për tema; shpërndarja e materialeve të teksteve për orë mësimore; plani vjetor, planet dymujore. Poashtu, në këtë pjesë janë paraqitur edhe të gjitha planet e orëve mësimore për njësitë që duhet të zhvillohen në lëndën e matematikës në klasën e dytë. Përveç kompletit të teksteve, mësimdhënësit/et kanë në dispozicion edhe faqen e internetit të ShB Luarasi. Aty mund të gjeni materiale shpesh për zhvillimin e punës në klasë dhe në shtëpi, si dhe modele të testeve vlerësuese.

Të shtojmë në fund se pyetjet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëpritura.

Autorët

# 1. Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore për shkallën 1 (RNK)

## 1.1. Kompetencat kryesore të të nxënit

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të njohurive, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura. Kompetencat e parapara me kornizën kurrikulare rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar. Këto kompetenca janë:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca e të menduarit
3. Kompetenca e të mësuarit
4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
5. Kompetenca personale
6. Kompetenca qytetare

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, të cilat janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të mesëm të lartë.

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Komunikues efektiv).** Me qëllim që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësit përkrahen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

**Kompetenca e të menduarit (Mendimtar kreativ (krijues dhe kritik).** Marrja dhe përpunimi i njohurive në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, por edhe për të marrë vendime dhe për të zgjidhur probleme. Duke mbajtur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë thelbësore për shekullin XXI. Nxënësit kanë nevojë jo vetëm të marrin informacion, por edhe të zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.

**Kompetenca e të mësuarit (Nxënës i suksesshëm).** Në zhvillimet bashkëkohore në shoqëri, në shkencë, në teknologji e në ekonomi nuk mund të kërkohet që të gjitha njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme të arrihen nëpërmjet shkollimit. Prandaj, shkolla u krijon nxënësve të gjitha kushtet dhe mundësitë për t'u arsimuar dhe përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës. Në funksion të

kësaj kompetence duhet të promovohet mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në stilet dhe strategjitë efektive mësimore.

**Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Kontribuues produktiv).** Shkolla angazhohet që nxënësi/ja të përgatitet të punojë në mënyrë të pavarur dhe të vetëdijesohet për rolin dhe përgjegjësinë e tij në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Për të zhvilluar këtë kompetencë nxënësi/ja përkrahen që të kuptojë në mënyrë të plotë ndërvarësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore. Njëkohësisht, duke e pasur parasysh arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, ai/ajo përgatitet që të ballafaqohet me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale.

**Kompetenca personale (Individ i shëndetshëm).** Për të zhvilluar kompetencën personale, shkolla përgatit nxënësin, që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare, shoqërore dhe të punës. Në këtë kontekst, nxënësi përkrahet që të vetëdijesohet për veten dhe të ketë vetëbesim, por njëkohësisht të jetë i hapur dhe të ketë besim për të tjerët dhe te të tjerët.

**Kompetenca qytetare (Qytetar i përgjegjshëm).** Shkolla përgatit nxënësin/en për të jetuar së bashku me të tjerët dhe për të tejkaluar sfida kryesore me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Kjo kompetencë siguron që nxënësi të jetë në gjendje të veprojnë si qytetar i përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë të zhvillimeve në shoqëri.

## **1.2. Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore për shkallë**

Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënit për shkallë. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga të gjithë nxënësit me rastin e përfundimit të një shkalle të kurrikulës. Rezultatet nuk mbulojnë gjithçka që nxënësit kanë mësuar apo është dashur të mësojnë gjatë një shkalle të caktuar. Ato shprehin kërkesat esenciale të arritjes drejt zotërimit të kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të një shkalle të caktuar si dhe promovojnë integrim të mëtejshëm të fushave të kurrikulës, në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me kornizën e kurrikulës.

Rezultatet e të nxënit përkufizohen si: “Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës/se në fund të një shkalle apo niveli”. Ato shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat.

Rezultatet e të nxënit për kompetenca shprehin pritjet e mësimdhënësve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë në raport me arritjet konkrete, të matshme, të nxënësve në fund të çdo shkalle të kurrikulës. Ato duhet të përdoren gjatë hartimit të programeve mësimore, organizimit mësimor në shkollë, hartimit të teksteve shkollore dhe materialeve mësimore.

Për nxënësit që i arrijnë ose nuk i arrijnë rezultatet e të nxënit për kompetenca në nivel shkalle kurrikulare, shkolla duhet të organizojë mësim mbështetës si shtues, plotësues dhe forma të tjera të përkrahje

### **Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës 1**

<b>I</b>	<b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv</b>
1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë f.je, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
2	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë f.je - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një f. tekst të shtypur.
5	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njëres nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit.
6	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve
8	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimi të një tregimi, shikimi apo performimi të një vallëzimi, dëgjimi apo performimi të një kënge apo melodie, në njërin nga format shprehëse.
9	Emërton në gjuhën e huaj objekte, veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë.
<b>II</b>	<b>Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ</b>
1	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
5	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njëres prej tyre në njërin nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të silllet në rast rreziku.
6	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën në një gjysmë f.je të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërin nga format shprehëse.
7	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna
8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta.



<b>III</b>	<b>Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm</b>
1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë.
6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.
<b>IV</b>	<b>Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv</b>
1	Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dytri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre.
2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
3	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
4	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njëres nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
5	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
6	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta (të shëndetshme) dhe anashjelltas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.
<b>V</b>	<b>Kompetenca personale – Individ i shëndoshë</b>
1	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit të vet në të cilin jeton dhe vepron.
2	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).

3	Bën një listë (me njërën nga format shprehëse, si, shkrim vizatim etj.) me ushqimet të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.
4	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitete në klasë/shkollë apo jashtë saj.
6	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.)
<b>VI</b>	<b>Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm</b>
1	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë.
2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
3	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
4	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
5	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.
6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
7	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilët kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

## 2. Rezultatet e të nxënit për fushën e matematikës, për shkallën 1 (RNF)

Në klasën përgatitore dhe arsimin fillor fusha e matematikës promovon përvetësimin themelor të nocioneve dhe koncepteve matematike, përforsim dhe zhvillim, në identifikimin e simboleve, kryerjen e veprimeve themelore matematikore, matje me instrumente jo standarde dhe standarde, formën e figurave dhe trupave gjeometrik, grumbullimin e të dhënave, leximin dhe paraqitjen e grafikëve të thjeshtë, si dhe vendosjen e një baze të njohjes dhe qëndrimeve pozitive ndaj matematikës.

Fusha e matematikës si qëllim ka zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, zhvillimin e personalitetit të tyre, zhvillimin e shkathtësive për të punuar në mënyrë të pavarur dhe sistematike, nxitjen dhe inkurajimin e ndërtimit të njohurive të reja me qëllim të zbatimit dhe integritit të tyre në fushat e tjera dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Po ashtu edhe njëri nga qëllimet e fushës së matematikës është funksionalizimi i dijeve përmes integritit të saj me të gjitha fushat, lidhjen ndërkurrikulare dhe arsimimit të qëndrueshëm përmes të cilave zotërohen kompetencat kryesore.

Rezultatet e të nxënit për fushën e matematikës përcaktohen si njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që nxënës duhet t'i fitojë gjatë një procesi të mësimdhënies dhe të nxënit. Përvetësimi i përmbajtjeve programore nga nxënësi demonstrohen si njohuri relevante që atij i parashtrihen. Shkathtësitë që i demonstron nxënësi përfshijnë aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive në arrijten e rezultateve të planifikuara. Qëndrimet e nxënësve ndaj matematikës i vendosin ata drejt angazhimit produktiv të tyre në matematikë.

### Rezultatet e të nxënit për fushën e matematikës për shkallën 1

#### I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE QË ZHVILLOHEN TE NXËNËSI/JA PËRMES PËRVOJAVE MËSIMORE QË NDËRLIDHEN ME:

1. Zgjidhjen e problemeve,
2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike,
3. Komunikimin në/përmes matematikë/s,
4. Lidhjet matematike,
5. Përfaqësimin matematik,
6. Promovimin e modelimit matematik,
7. Strukturimin e të menduarit matematik,
8. Përdorimin e TIK-ut në/për matematikë.

#### 1. Zgjidhja e problemeve:

Zgjidhja e problemeve është një proces që zhvillon njohuritë e nxënësve në matematikë përmes detyrave ku rezultati dhe procedura e zgjidhjes nuk është e njohur më parë. Nxënësi ndërton njohuri, përshkruan dhe zgjidhë situata problemore që krijohen brenda matematikës dhe në kontekste nga fushat e tjera si dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme. Nxënësit i mundësohet që të zbatojë dhe të përshtatë një shumëllojshmëri të strategjive për të zgjidhur problemet.

Nxënësi/ja:
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</li> <li>2. Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;</li> <li>3. Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;</li> <li>4. Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;</li> <li>5. Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.</li> </ol>
<p>2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike:</p> <p>Arsyetimi është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësve në matematikë përmes konjunkturave matematike, nxjerrje e konkluzioneve logjike, hipoteza dhe të menduarit të tyre kritik, justifikim idesh, analizim të provave dhe ndërtim argumentesh. Nxënësve iu mundësohet përdorimi për arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës.</p> <p>Nxënësi/ja:</p>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. demonstroi të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve;</li> <li>2. Zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësime;</li> <li>3. dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.</li> </ol>
<p>3. Komunikimi në/përmes matematikës/s</p> <p>Komunikimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t'i shprehur idetë matematike me rrjedhje logjike që i justifikon ato në audiencë dhe në shoqëri përmes të folurit dhe shkruarit për atë që e bëjnë me simbole, terme, grafike, modeleve dhe shprehje matematikore.</p> <p>Nxënësve iu mundësohet përdorimi i komunikimit nëpërmjet shenjave, të folurit të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik.</p> <p>Nxënësi/ja:</p>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore;</li> <li>2. Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor;</li> <li>3. Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme;</li> <li>4. Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;</li> <li>5. Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;</li> <li>6. Demonstroi të menduar të pavarur dhe shprehje pune.</li> </ol>
<p>4. Lidhjet në matematikë:</p> <p>Lidhja matematike është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t'i lidhë idetë dhe njohuritë matematike, brenda fushës së matematikës dhe jashtë saj. Nxënësve iu mundësohet për të njohur dhe të përdorur lidhjet e ideve matematikore, për të kuptuar se si idetë matematikore ndërtohen njëra mbi tjetrën dhe për të prodhuar një tërësi koherente si dhe zbatimi i matematikës në kontekste brenda dhe jashtë fushës së matematikës.</p> <p>Nxënësi/ja:</p>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve.</li> <li>2. Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</li> </ol>

<p>5. Përfaqësimet matematike:</p> <p>Përfaqësimi matematike është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të përfaqësuar objektet matematikore dhe veprimeve duke përfshirë numra, forma dhe marrëdhëniet. Përfaqëson dhe analizon situata dhe strukturat matematikore. Nxënësve iu mundësohet për të krijuar dhe të përdorur përfaqësitë për të organizuar, regjistruar dhe komunikuar idetë matematikore, zgjidh, përkthye dhe zbatuar përfaqësimet që kanë të bëjnë me zgjidhje probleme matematikore, përdorur përfaqësimet për modele dhe interpretime të fenomene, sociale natyrore dhe matematikore. Nxënësi/ja:</p>
<p>1. Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>
<p>6. Modelimi matematik</p> <p>Modelimi matematike është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të kuptuar format, modelet në kontekste të ndryshme, marrëdhëniet dhe funksionet, paraqitjen dhe analizimin e strukturave matematikore. Nxënësve iu mundësohet për të krijuar dhe të përdorur modelet të ndryshme, paraqit modelet dhe roli i tyre në kontekst, përdor modelet për të përfaqësuar dhe për të kuptuar marrëdhëniet sasiore, interpretuar me modele fenomenet, sociale natyrore dhe matematikore. Nxënësi/ja:</p>
<p>1. Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme;</p> <p>2. Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive;</p> <p>3. Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme;</p> <p>4. Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete</p>
<p>7. Strukturimi i të menduarit matematik</p> <p>Të menduarit matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të parashtruar pyetje dhe pritjet nga përgjigjet e mundshme. Nxënësve iu mundësohet për të ndërgjegjësuar për mënyrën, formën, qasjen dhe për llojet e pyetjeve që e karakterizojnë matematikën si dhe llojet e përgjigjeve të pritshme.</p> <p>Nxënësi/ja:</p>
<p>1. Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtë shkollor.</p>
<p>8 Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë:</p> <p>Përdorimi i teknologjisë është një proces që zhvillon njohuritë dhe aftësitë e nxënësve për të përmbush rigoroz rezultatet e të nxënët të fushës së matematikës dhe ta bëjë të suksesshëm edhe përtej shkollës. Nxënësve iu mundësohet për të përdorë teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione.</p> <p>Nxënësi/ja:</p>
<p>1. Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore;</p> <p>2. Përdor kalkulatorin për të verifikuar saktësinë e zgjidhjes së problemit.</p>
<p><b>II. VLERAT DHE QËNDRIMET</b> që zhvillohen te nxënësi/ja:</p>
<p>Qëndrimet e individit, bindjet dhe emocionet luajnë një rol të rëndësishëm në interesimin etij, përgjigjen ndaj matematikës dhe përdorimin e saj në jetën e tij. Qëndrimet e nxënësve ndaj matematikës i vendosin ata drejt angazhimit produktiv të tyre në matematikë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interesimi për matematikën - nëse ata e shohin atë si të dobishme në jetën reale;</li> <li>• Gatishmëria për të angazhuar në matematikë - ka të bëjë me qëndrimet emocionale dhe besimit personal që e shpie nxënësin drejt përfitimit.</li> </ul>

formimet relevante në këtë fushë janë përfshirë te:

- Kurioziteti;
- Motivimi për mësim;
- Imagjinata në kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;
- Insistimi, këmbëngulja dhe fuqia në fokusimin e problemeve;
- Pavarësia në mendime dhe veprime;
- Iniciativa dhe interesi për qasje të ndryshme;
- Organizimi i të menduarit;
- Besimi në forcat vetjake;
- Besimi në përdorimin e teknologjisë;
- dëshira për njohuri matematike;
- formimi human dhe zhvillimi i personalitetit;
- Kritikë konstruktive;
- Pavarësia në mendime;
- Gatishmëria për bashkëpunim;
- Prania e kritikave dhe gatishmëria për kritikë konstruktive;
- Gatishmëria për gara fer;
- Kuraja për të kërkuar përkrahje/ndihmë;
- Qëndrimi i hapur ndaj përkrahjes së të tjerëve;
- Qëndrimi ndaj pyetjeve dhe kërkesave;
- Vullneti;
- Toleranca;
- respekti për saktësinë, përpjekjet personale dhe ato në grup;

### III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja:

- Identifikim,
- Përshkrim,
- Zbatim,
- Njehsim,
- Matje,
- Vlerësim,
- Skicim,
- Krijim modelesh,
- Qasje problemeve nga perspektiva të ndryshme.

### IV. KONCEPTET SPECIFIKE DHE NJOHURITË Numrat, algjebra dhe funksioni, forma, hapësira, matja dhe gjeometria, përpunimi i shënimeve dhe probabiliteti

- Numrat natyrorë dhe të plotë,
- Veprimet themelore me numra,
- Ekuacionet, inekuacionet dhe funksionet,
- forma e figurave të rregullta ( trekëndëshi, katrori, drejkëndëshi dhe rrethi),
- Hapësira – objektet gjeometrike dhe trupat e rregullt gjeometrik (kubi, kuboidi, piramida, pirzma dhe sfera)
- Matjet (e gjatësisë, perimetri dhe syprina) e figurave të rrafshta,
- Të dhënat (elemente themelore të statistikës) grumbullim të shënimeve, mostra, prova, mesi aritmetik.

### 3. Rezultatet e të nxënit për lëndën e matematikës, klasa 2

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
<p style="text-align: center;"><b>Numri</b></p>	<p style="text-align: center;">Numrat natyrorë</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;</li> <li>▪ Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (<i>me njëshe dhe dhjetëshe</i>) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri.</li> <li>▪ Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100;</li> <li>▪ Përdorë strategji të ndryshme (<i>mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj</i>) për ta gjetur prodhimin e numrave (prodhimi <math>\leq 50</math>);</li> <li>▪ Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave si dhe shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri 100;</li> <li>▪ Shumëfishon numrat njëshifrorë dhe krijon vargje numerike (<math>\leq 50</math>);</li> <li>▪ Identifikon në shprehje; faktorët, prodhimin, të pjesëtueshmin, pjesëtuesin dhe herësin e numrave natyror deri 100;</li> <li>▪ Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>);</li> <li>▪ Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>▪ Gjen vlerën (<i>shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin</i>) e shprehjeve numerike të përbëra (<i>dy veprime</i>);</li> <li>▪ Përdorë vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave;</li> <li>▪ Zbaton rregulla për të identifikuar numrat çift dhe tek;</li> <li>▪ Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura</li> <li>▪ Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave;</li> <li>▪ Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme;</li> <li>▪ Mbledh dhe zbret paratë (euro,);</li> <li>▪ Përcakton radhën (numri rendor);</li> <li>▪ Dallon gjysmën e numrave çift;</li> <li>▪ Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë;</li> <li>▪ Tregon shembuj nga jeta për gjysmën dhe çerekun dhe bën lidhjen me pjesëtimin;</li> <li>▪ Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.</li> </ul>

<b>Algjebra dhe funksioni</b>	Modelet	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zbaton formula të thjeshta për të plotësuar vargun numerik;</li> <li>▪ Modelon katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshin dhe rrethin;</li> <li>▪ Klasifikon objektet sipas vetive të tyre.</li> </ul>
	Bashkësitë dhe relacionet	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh që mund të jenë afër/larg njëri-tjetrit;</li> <li>▪ Formon bashkësi sipas vetive të elementeve;</li> <li>▪ Identifikon elementet që i takojnë/nuk i takojnë bashkësisë dhe paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit;</li> <li>▪ Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve (më pak, më shumë, aq sa);</li> <li>▪ Gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësive;</li> <li>▪ Shoqëron objektet (elementet) e bashkësisë së dhënë me një objekt (element) të një bashkësie tjetër;</li> <li>▪ Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna;</li> <li>▪ Formon nënbashkësi nga bashkësia e dhënë.</li> </ul>
	Shprehjet shkronjore	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kryen veprimet themelore me shprehje shkronjore;</li> <li>▪ Gjen vlerën (numerike) të shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të ndryshoreve;</li> <li>▪ Shndërron shprehjet me fjalë në shprehje me simbole dhe anasjelltas;</li> <li>▪ Zgjidh problema nga jeta e përditshme duke përdorur shprehjet shkronjore.</li> </ul>
	Ekuacionet dhe inekuacionet lineare	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përcakton mbledhurin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra deri në 100);</li> <li>▪ Përcakton faktorin e panjohur (numra deri në 100);</li> <li>▪ Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri 100;</li> <li>▪ Gjen bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacioneve (numra deri në 100).</li> <li>▪ Përdor algoritmet për zgjidhjen e problemave me fjalë duke përdorur ekuacione \ inekuacione me numra deri 100.</li> </ul>



<p style="text-align: center;"><b>Matjet</b></p>	<p style="text-align: center;">Njësitë matëse</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Matë gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde;</li> <li>▪ Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet; më i gjatë, më i shkurtër, po aq;</li> <li>▪ Bën lidhje ndërmjet numrave dhe matjeve;</li> <li>▪ Vlerëson dhe renditë objektet sipas madhësive;</li> <li>▪ Përdorë metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde;</li> <li>▪ Zgjidh problema me fjalë nga jeta e përditshme;</li> <li>▪ Përcakton peshën e objekteve (kg);</li> <li>▪ Demonstron peshimin me anë të balancës duke përdorur sende të ndryshme;</li> <li>▪ Përdor shenjat : &lt;, &gt;, =, për peshat e objekteve.</li> <li>▪ Krahason vëllimin e enëve të ndryshme, të njohura për ta;</li> </ul>
	<p style="text-align: center;">Orientimi</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi;</li> <li>▪ Zgjidh labirinte të ndryshme;</li> <li>▪ Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme.</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Gjeometria (Hapësira dhe forma)</b></p>	<p style="text-align: center;">Figurat gjeometrike</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përcakton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura;</li> <li>▪ Përkufizon segmentin dhe përdorë vizoren/trekëndëshin për të caktuar gjatësinë e segmentit;</li> <li>▪ Mbledh, zbrit dhe krahason gjatësitë e segmenteve të ndryshme duke përdorur njësitë matëse standarde (cm, m);</li> <li>▪ Emërton figurat gjeometrike siç është katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi dhe rrethi;</li> <li>▪ Përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit;</li> <li>▪ Vizaton figura të ndryshme gjeometrike;</li> <li>▪ Krahason figurat gjeometrike;</li> <li>▪ Gjen shumën e brinjëve të katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit;</li> <li>▪ Dallon objekte që asocojnë me katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshin dhe rrethin;</li> <li>▪ Ngjyrosë figurën simetrike dhe krijon figura simetrie;</li> <li>▪ Vizaton drejtëzën/drejtëzat e simetrisë si dhe përcakton sa drejtëza simetrie ka figura;</li> </ul>

	Trupat gjeometrik	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);</li> <li>▪ Gjen; faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë;</li> <li>▪ Krahason trupat gjeometrik (përmasat e tyre);</li> <li>▪ Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë;</li> <li>▪ Tregon dallimet ndërmjet trupave gjeometrikë (me qoshe dhe të rrumbullak).</li> </ul>
	Sipërfaqja	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njëson syprinën e figurave të paraqitura në sipërfaqe me katror;</li> <li>▪ Dallon sipërfën brenda, jashtë dhe në figurë.</li> </ul>
<b>Të dhënat dhe probabiliteti</b>	Puna me të dhëna	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Grumbullon të dhënat në klasë apo diku tjetër dhe paraqet në tabelë;</li> <li>▪ Analizon të dhënat e grumbulluara nga tabela dhe i paraqet në grafik;</li> <li>▪ Interpretin të dhënat e grumbulluara dhe i krahason ato;</li> <li>▪ Përdor piktogramet.</li> </ul>
	Probabiliteti	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Parashikon mundësinë ( me dallime të mëdha );</li> <li>▪ Bën provën, e mundur, e pamundur;</li> <li>▪ Përdorë probabilitetin në jetën e përditshme;</li> </ul>

## 4. Planet mësimore

Të nderuar mësimdhënës,

Në këtë pjesë i gjeni të gjitha planifikimet e njësive mësimore që duhet të zhvillohen në lëndën e matematikës në klasën e dytë. Poashtu, këtu i gjeni edhe tri tabela përcjellëse. Në tabelën e parë është sistemuar numri i orëve sipas temave të zhvilluara në tekst bazë dhe fletore pune. Gjithsej janë shfrytëzuar 181 orë, duke lënë edhe 4 orë rezervë. Në tabelën e dytë janë sistemuar temat për muaj. Orët rezervë janë vendosur tek muaji i fundit i vitit shkollor, por natyrisht, ju mund ti zhvendosni ato sipas nevojës. Në tabelën e tretë sistemohen dhe ndërliken burimet e ofruara tekstuale (nga teksti bazë dhe nga fletorja e punës) për secilën njësi. Poashtu, materialet shpesh dhe materialet e nevojshme për zhvillimin e ushtrimeve kontrolluese mund të gjeni në f.n e internetit të shtëpisë botuese. Nga këto tabela, duke u shërbyer edhe me planet individuale të orëve mësimore të cilat i gjeni pas tabelave, me lehtësi mund të ndërtoni planet vjetore, planet e periudhave dhe planet dymujore.

**Tabela 1. Numri i orëve mësimore sipas temave**

Tema	Orët mësimore për temë
Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	12
Orientimi	9
Bashkësitë dhe relacionet	8
Numrat natyrorë (Numrat deri në 100)	12
Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	28
Figurat gjeometrike	12
Modelet	5
Numrat natyrorë (Shumëzimi dhe pjesëtimi)	37
Trupat gjeometrikë	9
Njësitë matëse (Gjatësia)	9
Sipërfaqja	3
Njësitë matëse (Masa)	7
Njësitë matëse (Vëllimi)	3
Numrat natyrorë (Paraja)	7
Numrat natyrorë (Tërësia, gjysma, çereku)	3
Ekuacionet dhe inekuacionet lineare (Barazimet dhe jobarazimet)	5
Shprehjet shkronjore (Barazimet dhe jobarazimet)	4
Puna me të dhëna	5
Probabiliteti	3

**Tabela 2. Ndërlidhja e të gjitha orëve të planifikuara për lëndën e matematikësme materialet nga kompleti i teksteve Matematika 2A dhe Matematika 2B.**

Tema	Njësia	Materiali nga tekstet
Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	Numrat deri në 20	Matematika 2A, fq.7, 8
	Numërimi	Matematika 2A, fq.9
	Paraardhësi dhe pasardhësi	Matematika 2A, fq.10
	Dhjetëshet dhe njëshet	Matematika 2A, fq.11
	Krahasimi i numrave	Matematika 2A, fq.12
	Numrat çift dhe tek	Matematika 2A, fq.13
	Numrat rendorë	Matematika 2A, fq.14
	Probleme	Matematika 2A, fq.15
	Mbledhja deri në 20	Matematika 2A, fq.16, 17
	Probleme	Matematika 2A, fq.18
	Zbritja deri në 20	Matematika 2A, fq.19, 20
	Veprimet e përziera	Matematika 2A, fq.21
Orientimi	Pozita	Matematika 2A, fq.22, 23
	Probleme	Matematika 2A, fq.24, 25
	Paraqitja e pozitës me simbole	Matematika 2A, fq.26
	Labirinti	Matematika 2A, fq.27, 28
	Orientimi	Matematika 2A, fq.29
	Përshkruajmë rrugën	Matematika 2A, fq.30
	Paraqitja e rrugës në rrjet	Matematika 2A, fq.31
	Probleme	Matematika 2A, fq.32, 33, 34
	Provojmë veten	Matematika 2A, fq.35
Bashkësitë dhe relacionet	Elementet dhe bashkësitë	Matematika 2A, fq.37, 38
	I takon apo nuk i takon bashkësisë	Matematika 2A, fq.39
	Krahasimi i bashkësive	Matematika 2A, fq.40, 41
	Shoqërimi i elementeve të dy bashkësive	Matematika 2A, fq.42, 43
	Bashkimi i dy bashkësive	Matematika 2A, fq.44
	Elementet e përbashkëta të dy bashkësive	Matematika 2A, fq.45, 46
	Nënbashkësitë	Matematika 2A, fq.47, 48
	Provojmë veten	Matematika 2A, fq.49
Numrat natyrorë (Numrat deri në 100)	Dhjetëshet e plota	Matematika 2A, fq.51, 52
	Numrat deri në 30	Matematika 2A, fq.53, 54
	Numrat deri në 40	Matematika 2A, fq.55, 56
	Numrat deri në 50	Matematika 2A, fq.57
	Numrat deri në 100	Matematika 2A, fq.58, 59
	Njëshet dhe dhjetëshet	Matematika 2A, fq.60, 61
	Numërimi	Matematika 2A, fq.62, 63

	Krahasimi i numrave	Matematika 2A, fq.64, 65	
	Numrat çift dhe tek	Matematika 2A, fq.66	
	Numrat rendorë	Matematika 2A, fq.67	
	Rigrupimi i njësheve dhe dhjetësheve	Matematika 2A, fq.68	
	Provojmë veten	Matematika 2A, fq.69	
Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	Mbledhja e dhjetësheve të plota me mjete	Matematika 2A, fq.70, 71	
	Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve	Matematika 2A, fq.72	
	Mbledhja e dhjetësheve të plota në mënyra të ndryshme	Matematika 2A, fq.73	
	Zbritja e dhjetësheve të plota me mjete	Matematika 2A, fq.74	
	Zbritja e dhjetësheve të plota në bosht dhe në tabelë	Matematika 2A, fq.75	
	Zbritja e dhjetësheve të plota në shtyllë	Matematika 2A, fq.76	
	Mbledhja me mjete	Matematika 2A, fq.77	
	Mbledhja në bosht	Matematika 2A, fq.78	
	Mbledhja në tabelë	Matematika 2A, fq.79	
	Mënyra tjera të mbledhjes	Matematika 2A, fq.80	
	Probleme	Matematika 2A, fq.81	
	Zbritja me mjete	Matematika 2A, fq.82	
	Zbritja në bosht	Matematika 2A, fq.83	
	Zbritja në tabelë	Matematika 2A, fq.84	
	Mënyra tjera të zbritjes	Matematika 2A, fq.85	
	Probleme	Matematika 2A, fq.86	
	Provojmë veten	Matematika 2A, fq.87	
	Mbledhja me rigrupim (njëri mbledhor njëshifror)	Matematika 2A, fq.88, 89	
	Mbledhja me rigrupim	Matematika 2A, fq.90, 91	
	Probleme	Matematika 2A, fq.92, 93	
	Shoqërimi i mbledhorëve	Matematika 2A, fq.94	
	Zbritja me rigrupim (zbritësi njëshifror)	Matematika 2A, fq.95, 96	
	Zbritja me rigrupim	Matematika 2A, fq.97, 98	
	Probleme	Matematika 2A, fq.99	
	Lidhja ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes	Matematika 2A, fq.100	
	Veprimet e përziera me numra	Matematika 2A, fq.101	
	Probleme	Matematika 2A, fq.102, 103, 104	
	Provojmë veten	Matematika 2A, fq.105	
	Figurat gjeometrike	Vijat	Matematika 2A, fq.107, 108
		Segmentet	Matematika 2A, fq.109
Figurat gjeometrike		Matematika 2A, fq.110	
Trekëndëshi dhe katrori		Matematika 2A, fq.111	
Drejtëndëshi dhe rrethi		Matematika 2A, fq.112	
Kompozimi i figurave gjeometrike		Matematika 2A, fq.113	
Tabela gjeometrike		Matematika 2A, fq.114	
Tangrami		Matematika 2A, fq.115	
Elementet e figurave gjeometrike		Matematika 2A, fq.116	
Simetria		Matematika 2A, fq.117, 118	
Drejtëzat e simetrisë		Matematika 2A, fq.119, 120	
Provojmë veten		Matematika 2A, fq.121	

Modelet	Modelet	Matematika 2A, fq.122, 123
	Modele me gjëra reale	Matematika 2A, fq.124
	Modele me figura gjeometrike	Matematika 2A, fq.125
	Modele me numra	Matematika 2A, fq.126
	Modele me blloqe	Matematika 2A, fq.127
Numrat natyrorë (Shumëzimi dhe pjesëtimi)	Kuptimi dhe shenja e shumëzimit	Matematika 2B, fq.7, 8
	Shumëzimi me grupe të barabarta	Matematika 2B, fq.9, 10
	Shumëzimi si mbledhje e përsëritur	Matematika 2B, fq.11, 12
	Shumëzimi në bosht	Matematika 2B, fq.13, 14
	Shumëzimi me rreshtime	Matematika 2B, fq.15, 16
	Faktorët dhe prodhimi	Matematika 2B, fq.17
	Ndërrimi i vendit të faktorëve	Matematika 2B, fq.18, 19
	Shumëzimi me 1 dhe 2	Matematika 2B, fq.20, 21
	Shumëzimi me 3	Matematika 2B, fq.22
	Shumëzimi me 4	Matematika 2B, fq.23
	Shumëzimi me 5	Matematika 2B, fq.24
	Shumëzimi me 6	Matematika 2B, fq.25
	Shumëzimi me 7	Matematika 2B, fq.26
	Shumëzimi me 8	Matematika 2B, fq.27
	Shumëzimi me 9	Matematika 2B, fq.28
	Shumëzimi me 10 dhe 0	Matematika 2B, fq.29, 30
	Probleme me fjalë	Matematika 2B, fq.31, 32
	Ndërtojmë probleme	Matematika 2B, fq.33
	Shoqërimi i faktorëve	Matematika 2B, fq.34
	Provojmë veten	Matematika 2B, fq.35
	Kuptimi dhe shenja e pjesëtimit	Matematika 2B, fq.36
	Pjesëtimi me grupe të barabarta	Matematika 2B, fq.37
	I pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi	Matematika 2B, fq.38
	Pjesëtimi me 2	Matematika 2B, fq.39
	Pjesëtimi me 3	Matematika 2B, fq.40
	Pjesëtimi me 4	Matematika 2B, fq.41
	Pjesëtimi me 5	Matematika 2B, fq.42
	Pjesëtimi me 6	Matematika 2B, fq.43
	Pjesëtimi me 7	Matematika 2B, fq.44
	Pjesëtimi me 8	Matematika 2B, fq.45
	Pjesëtimi me 9	Matematika 2B, fq.46
	Pjesëtimi me 10	Matematika 2B, fq.47
	Ushtrime pjesëtimin	Matematika 2B, fq.48, 49
Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit	Matematika 2B, fq.50, 51	
Probleme me fjalë	Matematika 2B, fq.52, 53	
Veprimet e përziera me numra	Matematika 2B, fq.54, 55	
Vargjete numrave	Matematika 2B, fq.56	
Provojmë veten	Matematika 2B, fq.57	
Trupat gjeometrikë	Kubi	Matematika 2B, fq.58, 59
	Kuboidi	Matematika 2B, fq.60
	Sfera	Matematika 2B, fq.61
	Cilindri	Matematika 2B, fq.62

	Koni	Matematika 2B, fq.63
	Piramida	Matematika 2B, fq.64
	Kompozimi i trupave gjeometrikë	Matematika 2B, fq.65, 66
	Krahasimi i trupave gjeometrikë	Matematika 2B, fq.67, 68
	Provojmë veten	Matematika 2B, fq.69
Njësitë matëse (Gjatësia)	Krahasimi i gjatësisë	Matematika 2B, fq.70, 71
	Matja e gjatësië	Matematika 2B, fq.72
	Metri	Matematika 2B, fq.73
	Centimetri	Matematika 2B, fq.74
	Metri dhe centimetri	Matematika 2B, fq.75, 76
	Probleme me fjalë	Matematika 2B, fq.77
	Matja dhe krahasimi i segmenteve	Matematika 2B, fq.78
	Perimetri i figurave gjeometrike	Matematika 2B, fq.79, 80
	Probleme	Matematika 2B, fq.81
Sipërfaqja	Sipërfaqja	Matematika 2B, fq.82, 83
	Matja e sipërfaqes	Matematika 2B, fq.84
	Probleme	Matematika 2B, fq.85, 86, 87
Njësitë matëse (Masa)	Më i lehtë apo më i rëndë	Matematika 2B, fq.89, 90
	Masa	Matematika 2B, fq.91
	Kilogrami	Matematika 2B, fq.92
	Vlerësojmë kush çfarë mase ka	Matematika 2B, fq.93
	Veprime me kilogram	Matematika 2B, fq.94
	Probleme me fjalë	Matematika 2B, fq.95, 96
	Provojmë veten	Matematika 2B, fq.97
Njësitë matëse (Vëllimi)	Vëllimit	Matematika 2B, fq.98, 99
	Probleme	Matematika 2B, fq.100
	Punojmë me vëllime	Matematika 2B, fq.101
Numrat natyrorë (Paratë)	Paratë	Matematika 2B, fq.102, 103
	Euro	Matematika 2B, fq.104
	Centët	Matematika 2B, fq.105, 106
	Probleme	Matematika 2B, fq.107, 108
	Krahasojmë shumat e parave	Matematika 2B, fq.109
	Probleme me fjalë	Matematika 2B, fq.110
	Provojmë veten	Matematika 2B, fq.111
Numrat natyrorë (Tërësia, gjysma, çereku)	Tërësia, gjysma, çereku	Matematika 2B, fq.113, 114
	Probleme	Matematika 2B, fq.115, 116
	Provojmë veten	Matematika 2B, fq.117
Ekuacionet dhe inekuacionet lineare	Barazimet e mbledhjes	Matematika 2B, fq.119, 120
	Gjejmë mbledhurin duke përdorur boshtin numerik	Matematika 2B, fq.121
	Barazimet e zbritjes	Matematika 2B, fq.122
	Gjejmë zbritësin që mungon	Matematika 2B, fq.123
	Gjejmë të zbritshmin që mungon	Matematika 2B, fq.124, 125
	Shprehjet shkronjore	Barazimet e shumëzimit
Shkronja x		Matematika 2B, fq.128
Probleme me fjalë		Matematika 2B, fq.129, 130
Jobarazimet		Matematika 2B, fq.131, 132
Provojmë veten		Matematika 2B, fq.133

Puna me të dhëna	Grafiku	Matematika 2B, fq.135, 136
	Tabela	Matematika 2B, fq.137, 138
	Piktogrami	Matematika 2B, fq.139
	Piktogrami dhe tabela	Matematika 2B, fq.140
	Sporti i preferuar	Matematika 2B, fq.141
Probabiliteti (Mundësia)	Mundësia	Matematika 2B, fq.142, 143
	E mundur apo e pamundur	Matematika 2B, fq.144
	Provojmë veten	Matematika 2B, fq.145, 146



Plani Vjetor

Plani Vjetor		2022/2023		
Fusha e Kurrikulës		Matematikë		
Klasa		II		
TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				
Periudha I		Periudha II	Periudha III	Kontributi në RNK, Shkalla I, Klasa II
Shtator- Tetor 43 orë	Nëntor- Dhjetor 39 orë	Janar- Shkurt- Mars 59 orë	Prill-Maj-Qershor 43 orë	
Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	Modelet	Njësitë matëse (Gjatësia, Masa, Vëllimi)	Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit I.1, I.2, I.3, I.5, I.7
Orientimi	Figurat gjeometrike	Numrat natyrorë (Shumëzimi dhe pjesëtimi)	Sipërfaqja	Kompetenca e të menduarit II.1, II.2, II.3, II.4, II.5, II.6, II.7, II.8
Bashkësitë dhe relacionet		Trupat gjeometrikë	Numrat natyrorë (Paratë) (Tërësia, gjysma, çereku)	Kompetenca e të nxënit III.1, III.2, III.3, III.4, III.5, III.6, III.7, III.8
Numrat natyrorë (Numrat deri në 100) (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)		Njësitë matëse (Gjatësia)	Ekuacionet dhe inekuacionet lineare  Shprehjet Shkronjore	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis IV.1, IV.2, IV.5.
			Puna me të dhëna	Kompetenca personale V.2, V.3, V.8
			Probabiliteti (Mundësia)	Kompetenca qytetare VI.2, VI.6

Plani dymujor Shtator-Tetor

Plani dymujor		Shtator-Tetor		
Viti shkollor		2022/2023		
Fusha Kurrikulare		Matematikë		
Lënda		Matematikë		
Klasa		II		
Temat		Numrat natyrorë Orientimi Bashkësitë dhe relacionet Numrat natyrorë: (Numrat deri në 100) (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)		
Temat	RNL-të	Njësitë mësimore	Burimet: Matematika 2A Materiale nga faqja e internetit e shtëpisë botuese Luarasi	Numri i orëve  43
Numrat Natyror (Rikujtojmë)	Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 ( <i>me njëshe dhe dhjetëshe</i> ) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri; Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100; Zbaton rregulla për të identifikuar numrat çift dhe tek; Përcakton radhën (numrat rendorë); Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura; Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave si dhe shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri 100; Gjen vlerën ( <i>shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin</i> ) e shprehjeve numerike të përbëra ( <i>dy veprime</i> ).	Numrat deri në 20	M2A, fq 7, 8	1
		Numërimi	M2A, fq 9	1
		Paraardhësi dhe pasardhësi	M2A, fq.10	1
		Dhjetëshet dhe njëshet	M2A, fq.11	1
		Krahasimi i numrave	M2A, fq.12	1
		Numrat çift dhe tek	M2A, fq.13	1
		Numrat rendorë	M2A, fq.14	1
		Probleme	M 2A, fq.15	1
		Mbledhja deri në 20	M2A, fq.16, 17	1
		Probleme	M2A, fq.18	1
Zbritja deri në 20	M2A, fq.19, 20	1		
Veprimet e përziera	M2A, fq.21	1		
Orientimi	Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi; Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi;	Pozita	M2A, fq.22, 23	1
		Probleme	M2A, fq.24, 25	1
		Paraqitja e pozitës me simbole	M2A, fq.26	1

	Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme; Zgjidhë labirinte të ndryshme;	Labirinti	M2A, fq.27, 28	1
		Orientimi	M2A, fq.29	1
		Përshkruajmë rrugën	M2A, fq.30	1
		Paraqitja e rrugës në rrjet	M2A, fq.31	1
		Probleme	M2A, fq.32, 33, 34	1
		Provojmë veten	M2A, fq.35	1
Bashkësitë dhe relacionet	Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh që mund të jenë afër/larg njëri-tjetrit; Formon bashkësi sipas vetive të elementeve; Identifikon elementet që i takojnë/nuk i takojnë bashkësisë dhe paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit; Formon bashkësi bazuar në veti të përbashkëta të elementeve; Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve (më pak, më shumë, aq sa); Shoqëron objektet (elementet) e bashkësisë së dhënë me objekte (elemente) të një bashkësie tjetër; Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna; Gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësisë; Formon nënbashkësi nga bashkësia e dhënë;	Elementet dhe bashkësitë	M2A, fq.37, 38	1
		I takon apo nuk i takon bashkësisë	M2A, fq.39	1
		Krahasimi i bashkësisë	M2A, fq.40, 41	1
		Shoqërimi i elementeve të dy bashkësisë	M2A, fq.42, 43	1
		Bashkimi i dy bashkësisë	M2A, fq.44	1
		Elementet e përbashkëta të dy bashkësisë	M 2A, fq.45, 46	1
		Nënbashkësitë	M2A, fq.47, 48	1
		Provojmë veten	M2A, fq.49	1
Numrat natyrorë (Numrat deri në 100)  (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri; Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100; Zbaton rregulla për të identifikuar numrat çift dhe tek; Përcakton radhën (numri rendor);	Dhjetëshet e plota	M2A, fq.51, 52	1
		Numrat deri në 30	M2A, fq.53, 54	1
		Numrat deri në 40	M2A, fq.55, 56	1
		Numrat deri në 50	M2A, fq.57	1
		Numrat deri në 100	M2A, fq.58, 59	1
		Njëshet dhe dhjetëshet	M2A, fq.60, 61	1
		Numërimi	M2A, fq.62, 63	1
		Krahasimi i numrave	M2A, fq.64, 65	1
		Numrat çift dhe tek	M2A, fq.66	1

	Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në			
	modelet e paraqitura; Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100; Përdorë vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave.	Numrat rendorë	M2A, fq.67	1
		Rigrupimi i njësheve dhe dhjetësheve	M2A, fq.68	1
		Provojmë veten	M2A, fq.69	1
		Mbledhja e dhjetësheve të plota me mjete	M2A, fq.70, 71	1
		Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve	M2A, fq.72	1

#### Plani dymujor Nëntor-Dhjetor

Plani dymujor		Nëntor-Dhjetor		
Viti shkollor		2022/2023		
Fusha Kurrikulare		Matematikë		
Lënda		Matematikë		
Klasa		II		
Temat		Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100) Figurat gjeometrike		
Temat	RNL-të	Njësitë mësimore	Burimet: Matematika 2A Materiale nga faqja e internetit e shtëpisë botuese Luarasi	Numri i orëve 39
Numrat Natyror (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100; Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta; Demonstron shkathhtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave; Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në	Mbledhja e dhjetësheve të plota në mënyra të ndryshme	M2A, fq.73	1
		Zbritja e dhjetësheve të plota me mjete	M2A, fq.74	1
		Zbritja e dhjetësheve të plota në bosht dhe në tabelë	M2A, fq.75	1
		Zbritja e dhjetësheve të plota në shtyllë	M2A, fq.76	1
		Mbledhja me mjete	M2A, fq.77	1

	<p>problema nga jeta e përditshme; Përdorë vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave. Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave si dhe shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri 100; Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).</p>	Mbledhja në bosht	M2A, fq.78	1
		Mbledhja në tabelë	M2A, fq. 79	1
		Mënyra tjera të mbledhjes	M2A, fq.80	1
		Probleme	M2A, fq.81	1
		Zbritja me mjete	M2A, fq.82	1
		Zbritja në bosht	M 2A, fq.83	1
		Zbritja në tabelë	M2A, fq.84	1
		Mënyra tjera të zbritjes	M2A, fq.85	1
		Probleme	M2A, fq.86	1
		Provojmë veten	M2A, fq.87	1
		Mbledhja me rigrupim (njëri mbledhor njëshifror)	M 2A, fq.88, 89	1
		Mbledhja me rigrupim	M2A, fq.90, 91	1
		Probleme	M2A, fq.92, 93	1
		Shoqërimi i mbledhorëve	M2A, fq.94	1
		Zbritja me rigrupim (zbritësi njëshifror)	M2A, fq.95, 96	1
		Zbritja me rigrupim	M2A, fq.97, 98	1
		Probleme	M2A, fq.99	1
		Lidhja ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes	M2A, fq.100	1
		Veprimet e përziera me numra	M 2A, fq.101	1
		Probleme	M2A, fq.102, 103, 104	1
Provojmë veten	M2A, fq.105	1		
Figurat gjeometrike	<p>Përcakton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura; Përkufizon segmentin dhe përdorë vizoren/trekëndëshin për të caktuar gjatësinë e segmentit; Mbledh, zbrit dhe krahason gjatësitë e segmenteve të</p>	Vijat	M2A, fq.107, 108	1
		Segmentet	M2A, fq.109	1
		Figurat gjeometrike	M2A, fq.110	1
		Trekëndëshi dhe katrori	M2A, fq.111	1
		Drejtëndëshi dhe rrethi	M2A, fq.112	1

<p>ndryshme duke përdorur njësitë matëse standarde (<i>cm, m</i>); Emërton figurat gjeometrike siç është katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi dhe rrethi; Përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit; Vizaton figura të ndryshme gjeometrike; Krahason figurat gjeometrike; Gjen shumën e brinjëve të katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit; Dallon objekte që asocojnë me katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshin dhe rrethin; Ngjyrosë figurën simetrike dhe krijon figura simetrie; Vizaton drejtëzën/drejhtëzat e simetrisë si dhe përcakton sa drejtëza simetrie ka figura;</p>	Kompozimi i figurave gjeometrike	M2A, fq.113	1
	Tabela gjeometrike	M2A, fq.114	1
	Tangrami	M2A, fq.115	1
	Elementet e figurave gjeometrike	M2A, fq.116	1
	Simetria	M2A, fq.117, 118	1
	Drejhtëzat e simetrisë	M2A, fq.119, 120	1
	Provojmë veten	M2A, fq.121	1
	Test përmbledhës	Test nga Shtëpia botuese Luarasi	1

#### Plani dymujor Janar-Shkurt-Mars

Plani dymujor		Janar-Shkurt-Mars		
Viti shkollor		2022/2023		
Fusha Kurrikulare		Matematikë		
Lënda		Matematikë		
Klasa		II		
Temat		Modelet Numrat natyrorë (Shumëzimi dhe pjesëtimi) Trupat gjeometrikë Njësitë matëse (Gjatësia)		
Temat	RNL-të	Njësitë mësimore	Burimet: Matematika 2A, 2B Materiale nga faja e internetit e shtëpisë botuese Luarasi	Numri i orëve 59
Modelet		Modelet	M2A, fq. 122, 123	1

	Zbaton formula të thjeshta për të plotësuar vargun numerik; Klasifikon objektet sipas vetive të tyre. Modelon katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshin dhe rrethin; Klasifikon objektet sipas vetive të tyre.	Modele me gjëra reale	M2A, fq. 124	1
		Modele me figura gjeometrike	M2A, fq. 125	1
		Modele me numra	M2A, fq. 126	1
		Modele me blloqe	M2A, fq. 127	1
Numrat natyrorë (Shumëzimi dhe pjesëtimi)	Përdorë strategji të ndryshme ( <i>mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj</i> ) për ta gjetur prodhimin e numrave ( $\text{prodhimi} \leq 50$ ); Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave si dhe shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri 100; Shumëfishon numrat njëshifrorë dhe krijon vargje numerike ( $\leq 50$ ); Identifikon në shprehje; faktorët, prodhimin, të pjesëtueshmën, pjesëtuesin dhe herësin e numrave natyror deri 100; Gjen prodhimin dhe herësin e numrave ( $\leq 50$ ); Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë; Gjen vlerën ( <i>shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin</i> ) e shprehjeve numerike të përbëra ( <i>dy veprime</i> ); Përdorë vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave; Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave; Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme;	Kuptimi dhe shenja e shumëzimit	M2B, fq. 7, 8	1
		Shumëzimi me grupe të barabarta	M2B, fq. 9, 10	1
		Shumëzimi si mbledhje e përsëritur	M2B, fq. 11, 12	1
		Shumëzimi në bosht	M2B, fq. 13, 14	1
		Shumëzimi me rreshtime	M2B, fq. 15, 16	1
		Faktorët dhe prodhimi	M2B, fq. 17	1
		Ndërrimi i vendit të faktorëve	M2B, fq. 18, 19	1
		Shumëzimi me 1 dhe 2	M2B, fq. 20, 21	1
		Shumëzimi me 3	M2B, fq. 22	1
		Shumëzimi me 4	M2B, fq. 23	1
		Shumëzimi me 5	M2B, fq. 24	1
		Shumëzimi me 6	M2B, fq. 25	1
		Shumëzimi me 7	M2B, fq. 26	1
		Shumëzimi me 8	M2B, fq. 27	1
		Shumëzimi me 9	M2B, fq. 28	1
		Shumëzimi me 10 dhe 0	M2B, fq. 29, 30	1
		Probleme me fjalë	M2B, fq. 31, 32	1
Ndërtojme probleme	M2B, fq. 33	1		
Shoqërimi i faktorëve	M2B, fq. 34	1		
Provojmë veten	M2B, fq. 35	1		

		Kuptimi dhe shenja e pjesëtimit	M2B, fq.36	1
		Pjesëtimi me grupe të barabarta	M2B, fq.37	1
		I pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi	M2B, fq.38	
		Pjesëtimi me 2	M2B, fq.39	1
		Pjesëtimi me 3	M2B, fq.40	1
		Pjesëtimi me 4	M2B, fq.41	1
		Pjesëtimi me 5	M2B, fq.42	1
		Pjesëtimi me 6	M2B, fq.43	1
		Pjesëtimi me 7	M2B, fq.44	1
		Pjesëtimi me 8	M2B, fq.45	1
		Pjesëtimi me 9	M2B, fq.46	1
		Pjesëtimi me 10	M2B, fq.47	1
		Ushtrime pjesëtimin	M2B, fq.48, 49	1
		Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit	M2B, fq.50, 51	1
		Probleme me fjalë	M2B, fq. 52, 53	1
		Veprimet e përziera me numra	M2B, fq.54, 55	1
		Vargjet e numrave	M2B, fq.56	1
		Provojmë veten	M2B, fq.57	1
Trupat gjeometrikë	Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida); Gjen; faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë; Krahason trupat gjeometrik (përmasat e tyre); Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë; Tregon dallimet ndërmjet trupave gjeometrikë (me qoshe dhe të rrumbullak).	Kubi	M2B, fq.58, 59	1
		Kuboidi	M2B, fq.60	1
		Sfera	M2B, fq.61	1
		Cilindri	M2B, fq.62	1
		Koni	M2B, fq.63	1
		Piramida	M2B, fq.64	1
		Kompozimi i trupave gjeometrikë	M2B, fq.65, 66	1
		Krahasimi i trupave gjeometrikë	M2B, fq.67, 68	1



		Provojmë veten	M2B, fq.69	1
Njësitë matëse (Gjatësia)	Matë gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde; Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet; më i gjatë, më i shkurtër, po aq; Bën lidhje ndërmjet numrave dhe matjeve; Vlerëson dhe renditë objektet sipas madhësive; Përdorë metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde; Zgjidh problema me fjalë nga jeta e përditshme.	Krahasimi i gjatësisë	M2B, fq.70, 71	1
		Matja e gjatësisë	M2B, fq.72	1
		Metri	M2B, fq.73	1
		Centimetri	M2B, fq.74	1
		Metri dhe centimetri	M2B, fq.75, 76	1
		Probleme me fjalë	M2B, fq.77	1
		Test përmbledhës	Test nga Shtëpia botuese Luarasi	1


#### Plani dymujor Prill-Maj-Qershor

Plani dymujor		Prill-Maj-Qershor		
Viti shkollor		2022/2023		
Fusha Kurrikulare		Matematikë		
Lënda		Matematikë		
Klasa		II		
Temat		Njësitë matëse (Gjatësia, Masa, Vëllimi) Sipërfaqja Numrat natyrorë : (Paratë) (Tërësia, gjysma, çereku) Ekuacionet dhe inekuacionet lineare Shprehjet shkronjore Puna me të dhëna Probabiliteti (Mundësia)		
Temat	RNL-të	Njësitë mësimore	Burimet: Matematika 2B Materiale nga faqja e internetit e shtëpisë botuese Luarasi	Numri i orëve  43
Njësitë matëse (Gjatësia)	Përdorë metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde; Zgjidh problema me fjalë nga jeta e përditshme;	Matja dhe krahasimi i segmenteve	M2B, fq.78	1
		Perimetri i figurave gjeometrike	M2B, fq.79, 80	1
		Probleme	M2B, fq.81	1

Sipërfaqja	Njëson syprinën e figurave të paraqitura në sipërfaqe me katror; Dallon sipërfën brenda, jashtë dhe në figurë.	Sipërfaqja	M2B, fq.82, 83	1
		Matja e sipërfaqes	M2B, fq.84	1
		Probleme	M2B, fq.85, 86, 87	1
Njësitë matëse (Masa) (Vëllimi)	Zgjidh problema me fjalë nga jeta e përditshme; Përcakton peshën e objekteve (kg); Demonstron peshimin me anë të balancës duke përdorur sende të ndryshme; Përdor shenjat : <, >, =, për peshat e objekteve; Krahason vëllimin e enëve të ndryshme, të njohura për ta;	Më i lehtë apo më i rëndë	M2B, fq. 89, 90	1
		Masa	M2B, fq.91	1
		Kilogrami	M2B, fq.92	1
		Vlerësojmë kush çfarë mase ka	M2B, fq.93	1
		Veprime me kilogram	M2B, fq.94	1
		Probleme me fjalë	M2B, fq.95, 96	1
		Provojmë veten	2B, fq.97	1
		Vëllimit	M2B, fq.98, 99	1
		Probleme	M2B, fq.100	1
		Punojmë me vëllime	M2B, fq.101	1
Numrat natyrorë (Paratë) (Tërësia, gjysma, çereku)	Mbledh dhe zbret paratë (euro,); Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura; Dallon gjysmën e numrave çift; Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë; Tregon shembuj nga jeta për gjysmën dhe çerekun dhe bën lidhjen me pjesëtimin;	Paratë	M2B, fq.102, 103	1
		Euro	M2B, fq.104	1
		Centët	M2B, fq.105, 106	1
		Probleme	M2B, fq.107, 108	1
		Krahasojmë shumat e parave	M2B, fq.109	1
		Probleme me fjalë	M2B, fq.110	1
		Provojmë veten	M2B, fq.111	1
		Tërësia, gjysma, çereku	M2B, fq.113, 114	1
		Probleme	M2B, fq.115, 116	1
		Provojmë veten	M2B, fq.117	1
Ekuacionet dhe inekuacionet lineare: (Barazim)	Përcakton mbledhurin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra deri në 100); Përcakton faktorin e panjohur (numra deri në 100); Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri 100;	Barazimet e mbledhjes	M2B, fq.119, 120	1
		Gjejmë mbledhurin duke përdorur boshtin numerik	M2B, fq.121	1
		Barazimet e zbritjes	M2B, fq.122	1

et dhe jobarazimet) (Shprehjet shkronjore)	Gjen bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacioneve (numra deri në 100); Përdor algoritmet për zgjidhjen e problemeve me fjalë duke përdorur ekuacione \inekuacione me numra deri 100; Kryen veprimet themelore me shprehje shkronjore; Gjen vlerën (numerike) të shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të ndryshoreve; Shndërron shprehjet me fjalë në shprehje me simbole dhe anasjelltas: Zgjidh problema nga jeta e përditshme duke përdorur shprehjet shkronjore.	Gjejmë zbritësin që mungon	M2B, fq.123	1
		Gjejmë të zbritshmin që mungon	M2B, fq.124, 125	1
		Barazimet e shumëzimit	M2B, fq.126, 127	1
		Shkronja x	M2B, fq.128	1
		Probleme me fjalë	M2B, fq.129, 130	1
		Jobarazimet	M2B, fq.131, 132	1
		Provojmë veten	M2B, fq.133	1
Puna me të dhëna	Grumbullon të dhënat në klasë apo diku tjetër dhe paraqet në tabelë; Analizon të dhënat e grumbulluara nga tabela dhe i paraqet në grafik; Interpreton të dhënat e grumbulluara dhe i krahason ato; Përdor piktogramet.	Grafiku	M2B, fq.135, 136	1
		Tabela	M2B, fq.137, 138	1
		Piktogrami	M2B, fq.139	1
		Piktogrami dhe tabela	M2B, fq.140	1
		Sporti i preferuar	M2B, fq.141	1
Probabiliteti (Mundësia)	Parashikon mundësinë ( me dallime të mëdha ); Bën provën, e mundur, e pamundur; Përdorë probabilitetin në jetën e përditshme;	Mundësia	M2B, fq.142, 143	1
		E mundur apo e pamundur	M2B, fq.144	1
		Provojmë veten	M2B, fq.145, 146	1

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Numrat deri në 20	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Numër, numërim, vlerë, krahasim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.	
REZULTATET E ORËS: Rendit numrat deri në 20. Numëron objekte në ilustrime. Shkruan numrat 0-20 me shifra dhe me fjalë. Krahason numrat 0-20.	KRITERET E SUKSESIT: Rendit numrat nga 0 deri në 20. Numëro objektet e paraqitura në ilustrime. Shkruaj numrat me shifra dhe me fjalë (0-20). Krahaso numrat duke përdorur fasule.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A dhe fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, fleta A4 me numra 0-20, fasule, lapsi, goma	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta e përditshme	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja u shpërndan nxënësve individualisht nga një fletë A4 në të cilën figuron një numër prej 0 deri në 20. Më tej, mësimdhënësi/ja thërret nxënësit që kanë marrë fletën me numër të dalin para tabelës, dhe të radhiten sipas numrave që kanë në fletë, prej më të voglit deri te më i madhi. Kështu formohet vargu i numrave 0-20. Mësimdhënësi/ja vazhdon me aktivitete tjera duke udhëzuar nxënësit që të formojnë më tej dy vargje numrash. Nxënësit që kanë numra tek të formojnë një varg sipas radhës prej më të voglit deri te më i madhi. Njëjtë veprojnë edhe nxënësit që kanë në duar fleta me numra çift, duke formuar një varg tjetër. Gjithnjë formimi i vargjeve të numrave përcillet edhe me numërim, ku secili nxënës e thotë numrin e tij sapo t'i vijë radha.  Hapi II – Punë me libër Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të hapin librat bazë, faqe 6. Nxënësit bashkë me mësimdhënësin/en analizojnë ilustrimin e faqes 6 duke diskutuar bazuar në pyetjet e paraqitura në detyrën 1, faqe 7. Vazhdon puna në detyrën 2 të faqes 7 ku nxënësit në mënyrë të pavarur	



duhet të numërojnë këmbët e insektit dhe të shkruajnë secilin numër të numëruar. Në detyrën 3, nxënësit identifikojnë numrat duke numëruar objektet e paraqitura në ilustrime dhe shkruajnë në etiketë numrin e duhur.

Puna individuale e nxënësve vazhdon në faqen 8. Në detyrën 1, nxënësit duke numëruar gjejnë dhe shkruajnë me fjalë numrat të cilët janë paraqitur në mënyrë vizuale me anë të vijëzave. Në detyrën 2, nxënësit duhet të numërojnë kubet dhe të shkruajnë numrat me fjalë. Po ashtu, edhe detyrat 3 dhe 4 plotësohen individualisht bazuar në kërkesat e dhëna.




Hapi III – Krahasimi i numrave në dyshe

Nxënësit brenda bankave formojnë secili nga një numër dyshifror duke përdorur fasule. Secila dyshe krahason dy numrat e formuar me fasule dhe tregon në nivel klase rezultatin e krahasimit të dy numrave. Sipas nevojës aktiviteti mund të përsëritet.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke përdorur si teknika vlerësuese vëzhgimin dhe listën e kontrollit. Fokuset e vlerësimit janë arritja e kritereve të suksesit, pra numërimi dhe krahasimi i numrave deri në 20.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Numërimi	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.</p> <p>II.2-Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.</p> <p>V.2-Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).</p> <p>II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 - 5 minuta.</p>	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve;</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.</p> <p>3.5-Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;</p>	
FJALËT KYÇE: Numër, numërim, praptazi, me nga dy, me nga tre.	
<p><b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b></p> <p>Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (<i>me njëshe dhe dhjetëshe</i>) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri.</p>	
<p><b>REZULTATET E ORËS:</b></p> <p>Identifikon numrat deri në 20 në rendin rritës dhe zbritës.</p> <p>Numëron duke zbatuar kërkesat “me nga dy” dhe “me nga tre”.</p> <p>Shkruan numrat deri në 20 bazuar në kërkesën e dhënë.</p> <p>Krahason numrat duke u bazuar në kërkesa.</p>	<p><b>KRITERET E SUKSESIT:</b></p> <p>Veço numrat nga 0 deri në 20 dhe nga 20 deri te 0.</p> <p>Numëro nga me nga dy, me nga tre.</p> <p>Shkruaj numrat deri në 20 bazuar në kërkesën e dhënë.</p> <p>Krahaso numrat duke u bazuar në kërkesa.</p>
<p><b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, lapsi, goma, rrathë gjimnastikor ose shkumës.</p>	
<p><b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Edukata fizike sportet dhe shëndeti; Jeta e përditshme.</p>	
<p><b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b></p> 	

### Hapi I – Aktivitet konkret

Mësimdhënësi/ja i ndanë nxënësit në dy grupe p.sh grupin A dhe grupin B.

Rreshton nxënësit e grupit A në një rënë anë dhe nxënësit e grupit B në anën tjetër. Në mes tyre (dy grupeve) në dysheme vendos 5 rrathë gjimnastikor ose vizaton në dysheme me shkumës 5 rrathë. Nxënësi i parë në rreshtin (grupin) A kërcen me dy këmbët në rrethin e parë duke numëruar “një”, pastaj në të dytin dhe vazhdon duke kërcyer dhe duke numëruar arrin te rrethi i pestë. Tani ia jep radhën nxënësit nga grupi B të vazhdojë numërimin duke kërcyer nëpër rrathë dhe kur ai arrin te rrethi përballë grupit A dhe numëron numrin 10, atëherë ia kalon nxënësit tjetër radhën dhe kështu vazhdohet derisa arrin te numri 20. Tani nxënësi që ka numëruar dhe ka thënë numrin 20, pasuesit të lojës i thotë numëro me nga dy prej njëshit dhe ai që nis lojën fillon 1, 3, 5, 7, 9 kalon radha te tjetri dhe vazhdon 11, 13, 15, 17, 19 tani pasohet loja duke ndryshuar rregullën, për shembull numëro praptazi me nga një - 20, 19, 18, 17, 16 e kështu vazhdohet duke pasuar lojën te tjetri dhe duke ndryshuar rregullat e lojës.

### Hapi II – Punë me libër

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të hapin librat bazë, faqe 9. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të analizojnë kërkesat në detyrën 1, 2, 3, dhe 4. Po ashtu mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të shkruajnë numrat në rrathët e paraqitur në ilustrime duke u bazuar në kërkesat e analizuara.

### Hapi III – Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit në dyshe (brenda bankave) shqyrtojnë bashkërisht zgjidhjet e detyrave nga faqja 9 dhe së bashku diskutojnë ato si dhe vështirësitë e paraqitura gjatë zgjidhjes së detyrave.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke përdorur si teknika vlerësuese vëzhgimin dhe listën e kontrollit. Fokuset e vlerësimit janë arritja e kritereve të suksesit, pra numërimi para dhe prapthazi me radhë si dhe me kapërcime.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Paraardhësi dhe pasardhësi	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.</p> <p>V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).</p> <p>II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve;</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Numër, numërim, paraardhës, pasardhës.	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <p>Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri.</p>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <p>Numëron duke veçuar paraardhësin dhe pasardhësin e numrit të dhënë.</p> <p>Identifikon numrat paraardhës dhe pasardhës të numrave të dhënë.</p> <p>Shkruan numrat që vijnë para dhe pas numrit të dhënë.</p> <p>Krahason numrat duke u bazuar në kërkesa.</p>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <p>Numëro duke veçuar paraardhësin dhe pasardhësin e numrit të dhënë.</p> <p>Veço numrat paraardhës dhe pasardhës të numrave të dhënë.</p> <p>Shkruaj numrat që vijnë para dhe pas numrit të dhënë.</p> <p>Krahaso numrat duke u bazuar në kërkesa.</p>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, lapsi, goma.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Edukata fizike, sportet dhe shëndeti; Jeta e përditshme.	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja njofton nxënësit që sot do të rikujtojmë paraardhësin dhe pasardhësin e një numri.</p> <p>Fillimisht shkruan një numër në tabelë. Për shembull numrin 11, dhe ju drejton pyetje nxënësve” Kur fillojmë të numërojmë nga 1 e tutje, cili numër vije para numrit 11? Sigurisht se përgjigja do të jetë numri 10. “Po pas numrit 11, cili numër vjen?”. Përgjigja do jetë numri 12. Tani mësimdhënësi/ja njofton nxënësit se do zhvillojnë një aktivitet ku mësimdhënësi/ja do t'i caktojë secilit nxënës nga një numër (numrat nga 1 deri në 20) duke kërkuar që secili</p>	



nxënës ta mbaj mend numrin që i është caktuar. Pastaj mësimdhënësi/ja thërret (për shembull) numri 15, më pas kërkon që nxënësi që mban numrin pasardhës të numrit 15 të rreshtohet te numri 15 e që duhet të jetë numri 16, më pas kërkon të vijë nxënësi që përfaqëson numrin paraardhës të numrit 15 d.m.th. numri 14. Kjo procedurë vazhdon edhe më tutje. Më pas kërkohet të dalë një nxënës i cili nuk e zbulon numrin që ka, por thotë: Unë kam paraardhës numrin 18. Cili numër jam? Kështu aktiviteti vazhdon me numra të ndryshëm.

#### Hapi II – Punë me libër

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të hapin librat bazë, faqe 10. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të analizojnë kërkesat në detyrën 1 dhe 2. Po ashtu nxënësit udhëzohen të shkruajnë numrat në katrorët e paraqitur duke u bazuar në kërkesat e parashtruara.

#### Hapi III – Puno në dyshe, shkëmbe me shoqen/shokun

Nxënësit në dyshe, brenda bankave, bashkëpunojnë me shokët apo shoqet në atë mënyrë që secili shkruan në fletore një numër e pastaj shkëmbejnë fletoret në mes vete duke gjetur numrat paraardhës dhe pasardhës të numrave që ka shkruar shoqja apo shoku. Fletoret shkëmbehen përsëri dhe nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë e punës nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:** Si teknika vlerësuese përdoren vëzhgimi, lista e kontrollit dhe vlerësimi i ndërsjellë. Fokuset e vlerësimit janë arritja e kriterëve të suksesit.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)					
NJËSIA MËSIMORE: Dhjetëshet dhe njëshet					
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj. për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.					
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune. 6.2 - Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.					
FJALËT KYÇË: Dhjetëshe, njëshe, kube, shufra					
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.					
REZULTATET E ORËS: Përdorë shufrat dhe kubet për të emërtuar njëshet dhe dhjetëshet me një numër të dhënë; Dallon dhjetëshet dhe njëshet për secilin numër; Ngjyrosë shufra dhe kube aq sa tregon numri i dhënë.	KRITERET E SUKSESIT: Formo dhjetëshe - shufra duke bashkuar njëshet - kubëzat; Veço shifrën e dhjetëshes dhe njëshes në numër dyshifror; Ngjyros aq dhjetëshe dhe aq njëshe sa tregon numri.				
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, lapsi, ngjyrat, kubëza, shufra.					
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet					
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I - Diskutim Mësimdhënësi/ja bashkë me nxënësit rikujtojnë nga klasa e parë se numrat dyshifrorë fillojnë nga numri 10. Numri dhjetë është numri më i vogël dyshifror. Numrat dyshifrorë përbëhen nga dy shifra, shifra e dhjetësheve dhe shifra e njësheve. Merren shembuj konkret të numrave dyshifrorë dhe shifrat e tyre paraqiten me anë të tabelës, si p.sh. numri 18.					
<table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td style="background-color: #f08080;">Dh</td> <td style="background-color: #add8e6;">Nj</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">8</td> </tr> </table>		Dh	Nj	1	8
Dh	Nj				
1	8				
Pra numri 8 paraqet shifrën e njësheve kurse numri 1 paraqet shifrën e dhjetësheve.					
Hapi II – Punë me libër Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të hapin librin, faqe 11. Në detyrën 1 nxënësit udhëzohen të formojnë dhjetëshe me mjete të ndryshme. Në detyrën 2, nxënësit ngjyrosin njëshet në bazë të ilustrimeve të dhëna, kurse në detyrën 3 nxënësit duke shikuar numrin, ngjyrosin aq shufra sa ka dhjetëshe dhe aq kube sa ka njëshe. Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur.					
Hapi III - Diskutim në çifte Nxënësit të ndarë në çifte vazhdojnë punën. Njëri nga nxënësit shkruan një numër dyshifror kurse tjetri duhet ta paraqesë atë numër përmes shufrave dhe kubeve.					
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.					

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen me anë të vëzhgimit. Fokusi i vlerësimit është aftësia e nxënësve për të dalluar dhjetëshet dhe njëshet e një numri si dhe të bëjë paraqitjen e tyre me shufra dhe kube.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Krahasimi i numrave	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.	
FJALËT KYÇE: Numër, numërim, krahasim, shenja, paraardhësi, pasardhësi	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.	
REZULTATET E ORËS: Krahason bashkësitë e dhëna sipas numrit të elementeve. Shkruan numrat e dhënë në rendin rritës dhe në atë zbritës Krahason numrat e ndryshëm duke vendosur shenjat $>$ , $<$ ose $=$ .	KRITERET E SUKSESIT: Numëro objektet e paraqitura në bashkësi dhe krahaso ato. Shkruaj numrat e dhënë në rendin rritës dhe në atë zbritës Krahaso numrat e ndryshëm duke përdorur duke vendosur shenjat $>$ , $<$ ose $=$ .
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, kartat, lapsi, goma, fletorja.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta e përditshme.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Lojë me tiketa Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore me një aktivitet që do të realizohet përmes tiketave. Paraprakisht mësimdhënësi/ja është përkujdesur që grumbulli i tiketave të përmbajë numrat nga 0 deri në 20. Secili nxënës do të përzgjedhë nga një tiketë nga grumbulli dhe do të tregojë cilin numër ka përzgjedhur. Në këtë rast, nxënësi do të tregojë sa dhjetëshe dhe sa njëshe përmban numri. Më pas, secili nxënës do të krahasojë numrin e tij me numrin e shokut/shoqes së bankës dhe së bashku do të gjejnë se cili ka numrin më të madh e cili numrin më të vogël. Çiftet e nxënësve prezantojnë punën e tyre.  Hapi II – Punë me libër Nxënësit punojnë individualisht në faqen 12. Në detyrën 1, nxënësit numërojnë elementet në bashkësi dhe krahasojnë bashkësitë për nga numri i elementeve duke rrethuar bashkësinë që ka më shumë elemente. Në detyrën 2 do të krahasojnë numrat duke vendosur shenjat $>$ , $<$ ose $=$ . Në detyrën 3 dhe 4 do të renditin numrat e dhënë nga më i vogli deri te më i madhi dhe anasjelltas. Në detyrën 5, duke analizuar shenjat vendosin numrat ashtu që të vlejnjë barazimet e dhëna.	

Hapi III – Shkrim i lirë

Nxënësit vazhdojnë punën në fletoret e tyre të matematikës. Mësimdhënësi/ja udhëzon ata që të krijojnë sipas dëshirës nga një detyrë të ngjashme me shembujt e fundit të punuar në libër. Nxënësit lexojnë para shokëve dhe shoqeve të klasës krijimet e tyre. Diskutohet në nivel klase puna e kryer.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke observuar punën e nxënësve në krahasimin e numrave deri në 20.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Numrat çift dhe tek	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj. VI.6 - Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave; 3.2 - Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;	
FJALËT KYÇE: Numër, njëshe, çift, tek	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Zbaton rregulla për të identifikuar numrat çift dhe tek.	
REZULTATET E ORËS: Dallon numrat çift; Identifikon numrat tek; Formon numra çift dhe tek.	KRITERET E SUKSESIT: Gjej numrat çift; Identifiko numrat tek; Plotëso shifrën e njësheve për të formuar numra çift apo tek.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, fletorja, lapsi, goma, ngjyrat.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Gjurmimi në klasë Pas një rikujtimi të shkurtë të koncepteve çift - tek, që nxënësit i kanë mësuar në klasën e parë, fillon një aktivitet real në klasë. Secili nga nxënësit duhet të marrë një fletore, një laps dhe të gjurmojë nëpër klasë objekte që karakterizohen me numër çift apo me numër tek. P.sh. në klasë është vetëm një mësimdhënës/e, por mund të jenë 20 banka. Po ashtu, nxënësit mbajnë shënime për numrin e dritareve, karrigeve dhe afër numrit për secilin objekt shënojnë nëse ai numër është çift apo tek.  Hapi II – Aktivitet në grupe Puna vazhdon në grupe. Nxënësit udhëzohen që të formojnë nga një numër tek dhe nga një numër çift, prej 1 – 20, me anë të shufrave dhe kubeve. Grupet ekspozojnë dhe arsyetojnë punën e bërë.  Hapi III – Punë me libër Puna individuale e nxënësve vazhdon në libër, faqe 13. Në detyrën 1 ata duhet të ngjyrosin ilustrimin e paraqitur duke ngjyrosur numrat çift me një ngjyrë dhe numrat tek me një ngjyrë tjetër. Në vazhdim radhitin numrat çift në trenin e detyrës 2 dhe radhitin numrat tek në trenin e detyrës 3. Nxënësit në çifte krahasojnë radhitjet e numrave dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.	

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:**

Vlerësimi bëhet duke vëzhguar aftësinë e nxënësve për të dalluar, për të ndërtuar me mjete dhe për të radhitur numrat çift dhe numrat tek. Mësimdhënësi/ja vlerëson duke plotësuar listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj. Po ashtu, një pjesë e hapësirës së vlerësimit i dedikohet edhe vlerësimit të ndërsjellë të nxënësve.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Numrat rendorë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave , ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Numër, numër rendorë, rreshtim, renditje.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Përcakton radhën (numrat rendorë);	
REZULTATET E ORËS: Përcakton radhën duke përdorur shprehjet i pari, i dyti etj; Përdor numrat rendorë për të treguar renditjen; Ngjyros rrathët duke përdorur ngjyrat përkatëse për numrat rendorë.	KRITERET E SUKSESIT: Përcakto radhën duke përdorur shprehjet i pari, i dyti etj; Përdor numrat rendorë për të treguar renditjen; Ngjyros rrathët duke përdorur ngjyrat përkatëse për numrat rendorë.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese fletorja, lapsi, goma, ngjyrat.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Ora fillon me aktivitete konkret. Për këtë qëllim realizohen rreshtime të ndryshme të nxënësve. Nxënësit mund të rreshtohen në bazë të karakteristikave të ndryshme siç është gjatësia, sipas radhitjes alfabetike të shkronjës së parë të emrit apo mbiemrit. Nxënësit në fletoret e veta shkruajnë cili nxënës është cili me radhë, herë nga para e herë nga prapa. Po ashtu mësimdhënësi/ja mund të ndajë nga një numër për secilin nxënës dhe të kërkojë nga ta që të rreshtohen sipas radhës herë nga para e herë nga prapa.  Hapi II – Punë me libër Puna mund të vazhdojë në libër faqe 14, ku nxënësit në mënyrë individuale duhet të gjejnë përgjigjen në probleme me fjalë në lidhje me radhitjet dhe numrat rendorë. Në detyrën e dytë duhet të ngjyrosin rrathët sipas udhëzimeve duke dalluar numrat rendorë.  Hapi III – Shkrim i lirë	



Ora vazhdon duke iu ofruar nxënësve mundësinë për ndërtimin e problemeve në lidhje me numrat rendorë. Nxënësit që arrijnë të përfundojnë detyrën brenda orës mësimore, mund të lexojnë problemet e ndërtuara para klasës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:**

Si teknika për vlerësim përdoren vëzhgimi dhe lista e kontrollit. Si fokus i vlerësimit shërbejnë kriteret e suksesit.


TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Zgjidhim probleme	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 min; II.8 Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve;	
FJALËT KYÇË: Numër, mbledhorë, shumë, para.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.	
REZULTATET E ORËS: Përcakton mbledhorët bazuar në ilustrime; Përdor paratë për të përcaktuar shumën; Zgjidh probleme duke u bazuar në situata të ndryshme.	KRITERET E SUKSESIT: Përcakto mbledhorët bazuar në ilustrime; Përdor paratë për të përcaktuar shumën; Zgjidh probleme duke u bazuar në situata të ndryshme.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, fletorja, lapsi, goma, ngjyrat.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Ora fillon me aktivitete konkrete që demonstrojnë dhe modelojnë lidhje numerike. Lidhjet numerike mund të formohen me mjete të ndryshme siç janë fasulet dhe gjësendet e ndryshme që gjenden në çanta të nxënësve. Kështu, mësimdhënësi/ja grumbullon mbi bankë së pari 8 fasule të të njëjtës ngjyre. Pastaj formon edhe një grumbull tjetër me 9 fasule të një ngjyre tjetër. Më tej pyet nxënësit sa fasule gjithsej janë në dy grumbujt? Të gjitha veprimet si dhe përgjigjen e saktë e paraqet në tabelë duke ilustruar lidhje numerike të ngjashme me ato në faqen 15 të librit.  Hapi II – Punë me libër Puna mund të vazhdojë në libër bazë, faqe 15, ku nxënësit në mënyrë individuale u përgjigjen kërkesave të parashtruara në detyrat e kësaj faqeje.  Hapi III – Shkëmbe në dyshe. Ora vazhdon duke iu ofruar nxënësve mundësinë për ndërtimin e problemeve në lidhje me numrat. Secili nxënës paraqet një problem në fletoren e vet. Pastaj shkëmbehen fletoret dhe	

secili nxënës zgjidh problemin e parashtruar nga shoqja/shoku i klasës. Më pas i kthejnë fletoret njëri-tjetrit dhe secili vlerëson zgjidhjen e kryer nga shoqja/shoku i klasës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:**

Vlerësimi bëhet me ndihmën e vëzhgimit dhe listëse së kontrollit. Po ashtu, lejohet hapësirë edhe për vlerësim të ndrsjelltë në mes të nxënësve. Si fokus i vlerësimit shërbejnë kriteret e suksesit.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Mbledhja deri në 20	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 – Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 5.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune.	
FJALËT KYÇE: Numër, mbledhje, plus, mbledhorë, shumë	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.	
REZULTATET E ORËS Kryen veprimin e mbledhjes; Krijon lidhjet pjesë-pjesë-tërësi për të paraqitur mbledhjen e numrave të ndryshëm; Ndërton barazi në lidhje me mbledhjen.	KRITERET E SUKSESIT: Kryej veprimin e mbledhjes; Plotëso pjesën që mungon për të krijuar barazime të sakta për mbledhjen e numrave; Përdor strategjitë e mësuara për të ndertuar barazi lidhur me mbledhjen.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, lapsi, goma, ngjyrat, domino, karton, kapëse.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Mbledhja me domino Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke shpërndarë te të gjithë nxënësit nga një domino. Pasi secili nga nxënësit të ketë dominon e tij, mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit për mënyrën e punës. Çdo domino është e ndarë në dy pjesë dhe në këtë rast këto dy pjesë do të paraqesin mbledhorët ndërsa nxënësit duhet të gjejnë shumën. Këtë do ta bëjnë duke analizuar numrin e pikave në domino dhe duke u bazuar në të, do të krijojnë edhe barazimin e mbledhjes. Secili nxënës prezanton punën e tij.	
Hapi II – Gjejmë shumën Mësimdhënësi/ja ka përgatitur për nxënësit disa fletëza të vogla në të cilat është shkruar nga një detyrë në lidhje me mbledhjen e numrave deri në 20. Fletëzat janë të ngjitura në kapëse të vogla druri. Po ashtu, mësuesja ka përgatitur disa rrathë prej kartoni ku në secilin prej tyre ka vendosur njërin nga numrat 11-20 dhe i ka vendosur në tabelë. Nga nxënësit kërkohet që secili të përzgjedhë në mënyrë të rastësishme njërin nga kapëset (d.m.th një detyrë), pastaj secili me radhë afrohet te tabela dhe e prezanton detyrën e tij duke e lexuar	

me zë të lartë dhe duke e treguar rezultatin (shumën). Kapësen, me detyrën e dhënë nxënësi duhet ta kap tek rrethi përkatës, d.m.th. me rezultatin e detyrës.

### Hapi III – Punë me libër


Nxënësit hapin librin, faqe 16. Aty punojnë në plotësimin dhe paraqitjen simbolike të barazimeve të mbledhjes të paraqitura në forma të ndryshme vizuale. Puna individuale vazhdon në faqe 17 ku nxënësit në detyrat 1, 2 dhe 4 duhet të formojnë barazi të sakta duke u bazuar në të dhënat e detyrës. Në detyrën 3 nxënësit gjejnë shumën në secilin rresht dhe në secilën shtyllë të tabelave katrore. Për shembull:  $7+3+5=15$  apo  $7+4+1=12$ .

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:

Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

### VLERËSIMI:

Nxënësit vlerësohen duke përdorur vëzhgimin dhe listën e kontrollit si teknika vlerësuese, ndërsa fokusin e vlerësimit e përcaktojnë kriteret e suksesit.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Zgjidhim probleme	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.2-Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore II.8- Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta. III.2-Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; 3.5-Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.	
FJALËT KYÇE: Numër, mbledhje, plus, mbledhorë, shumë	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.	
REZULTATET E ORËS: Kryen veprimin e mbledhjes; Gjen mbledhorët që mungojnë; Zgjidh probleme me fjalë dhe arsyeton zgjidhjen.	KRITERET E SUKSESIT: Kryej veprimin e mbledhjes; Gjej mbledhorët që mungojnë; Zgjidh probleme me fjalë dhe arsyeto zgjidhjen.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Shkathësi për jetë, Artet	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I –Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke shpërndarë te të gjithë nxënësit copëza letre. Në secilën copëz letre është i shkruar një numër. Numrat zgjedhen ashtu që dy nga dy japin shumën 20. Njëri nxënës e thotë numrin që ka në letër kurse të tjerët llogaritin shumën e atij numri me numrin që kanë në letrën e tyre. Nxënësi i cili e ka numrin që plotëson shumën 20 lajmërohet dhe të dy së bashku dalin në tabelë dhe shkruajnë barazimin.  Hapi II – Punë me libër Nxënësit hapin librin faqe 18 dhe punojnë në çifte brenda bankave në plotësimin e kërkesave dhe zgjidhjen e problemeve të parashtruara brenda kësaj faqeje. Diskutojnë dhe analizojnë zgjidhjet e problemeve së pari në çifte, e pastaj edhe në nivel klase. Hapi III – Zgjidhim probleme me fjalë Nxënësit punojnë në çifte. Secili nxënës ia parashtron shokut/shoqes një problem duke e shkruar atë në fletore. P.sh.: Gjej shumën nëse mbledhori i parë është 7, ndërsa mbledhori i dytë është 4. Nxënësit shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe secili zgjidh problemin e parashtruar nga shoqja/shoku i bankës. Përsëri shkëmbehen fletoret dhe pason analiza e diskutimi i zgjidhjeve si dhe vlerësimi i ndërsjellë.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.	

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke vëzhguar nëse ndërtojnë barazime të sakta dhe zgjidhin saktë problemet me fjalë.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Zbritja e numrave deri në 20	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3-Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.1-Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; III.2- Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1- Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.3- Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 3.4- Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Zbritje, ndryshim, simbol, blloqe	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.	
REZULTATET E ORËS: Kryen veprimin e zbritjes; Krijon lidhjet pjesë-pjesë-tërësi për të paraqitur ndryshimin e numrave; Zgjidh probleme me fjalë në lidhje me zbritjen.	KRITERET E SUKSESIT: Kryej veprimet e zbritjes duke përdorur mjete; Plotëso pjesën që mungon për të krijuar barazime të sakta; Përdor strategjitë dhe teknikat e mësuara për të zgjidhur probleme me fjalë.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faja e internetit e shtëpisë botuese, blloqe, ve, kuti vezësh, lapsi, goma, lapsa me ngjyrë	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Kllaster Mësimdhënësi/ja nxit nxënësit të japin shkurtimisht ide që lidhen drejtpërdrejt me konceptin e zbritjes dhe që janë pasqyrime të këtij koncepti matematik. Pra, mësimdhënësi/ja iu drejtohet nxënësve me pyetjen – Çfarë iu bie ndërmend kur përmendet fjala zbritje? Derisa nxënësit parashtrajnë idetë e tyre, mësimdhënësi/ja i përmbledhë idetë e parashtruara në një kllaster të përgatitur në një fletë hameri apo të vizatuar në tabelë. Sigurisht që në idetë që do të parashtrohen do të jenë edhe paraqitja simbolike e zbritjes me anë të shenjës -, emërtimi i numrave që marrin pjesë në zbritje—i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi, tërësia, pjesa që largohet dhe pjesa që mbetet.	
Hapi II – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja vendosë mjetet e konkretizimit (blloqet, vezët, dy kuti dhjetëshe të vezëve, ëmbëlsira etj) mbi tavolinën e saj. Ndan nxënësit në dyshe (çifte) dhe kërkon që njëri të shkruaj një barazim të zbritjes kurse tjetri ta paraqet konkretisht atë dhe të gjejë zgjidhjen. P.sh. njëri nxënës shkruan në tabelë shprehjen $12 - 5$ , kurse tjetri në kuti të vezëve vendos 12 ve pastaj largon 5 prej tyre dhe tregon se mbesin 7 ve. Nxënësit vazhdojnë dhe shkruajnë në tabelë barazimin e plotë të zbritjes $12 - 5 = 7$ .	



Ngjashëm veprohet edhe me blloqe. Nxënësit marrin aq blloqe sa tregon numri i parë, pra i zbritshmi. Largojnë pastaj aq blloqe sa tregon numri i dytë, pra zbritësi, si dhe gjejnë ndryshimin.

BArazimin e fituar nxënësit e shkruajnë në tabelë. Mësimdhënësi/ja gjithnjë, krahas kërkesës për shprehjen e mendimeve, kërkon nga nxënësit edhe arsyetim apo argumentim të përgjigjeve të ofruara.

Më tej, kalohet në punë individuale në plotësimin e kërkesave të detyrave të parashtruara në libër.



Hapi III – Punë me libër

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të hapin librin, faqe 19. Nxënësit punojnë në çifte në zgjidhjen e detyrave të parashtruara në këtë faqe dhe në faqen pasardhëse. Pasi të kenë përfunduar punën, secili çift prezanton para klasës zgjidhjen e ndonjëres prej detyrave të parashtruara në këto dy faqe të librit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen me anë të vëzhgimit dhe listës së kontrollit duke u fokusuar në shkathtësinë e zbritjes së numrave dhe argumentimin e përgjigjeve të ofruara.

TEMA: Numrat natyrorë (Rikujtojmë)	
NJËSIA MËSIMORE: Veprimet e përziera	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.1- Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;</p> <p>III.2-Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo material tjetër për të realizuar një veprim /aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>V.2-Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1-Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>3.5-Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune.</p>	
FJALËT KYÇE: Mbledhje, zbritje, veprim, radhë.	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <p>Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave si dhe shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri 100;</p> <p>Gjen vlerën (<i>shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin</i>) e shprehjeve numerike të përbëra (<i>dy veprime</i>).</p>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <p>Kryen veprimet e përziera me numra sipas rregullave;</p> <p>Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes;</p> <p>Gjen zgjidhjen duke kryer aktivitete fizike.</p>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <p>Zgjidh enigmën numerike;</p> <p>Kryej veprimet e përziera sipas radhës;</p> <p>Gjej zgjidhjen e barazimeve duke lëvizur nëpër bosht numerik.</p>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë e punës nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, projektor, boshti numerik, hamer apo fletë A4, fletorja, lapsi, goma	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Edukata fizike, sporti dhe shëndeti; Jeta e përditshme.	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Enigma numerike</p> <p>Mësimdhënësi/ja paraqet para nxënësve një enigmë numerike:</p> <p>U nisa nga shkalla 5 Shkova lart për 6 shkallë Pastaj zbrita për 8 shkallë. Në cilën shkallë jam tani unë?</p> <p>Pyesim nxënësit çfarë veprime duhet të kryejmë për të gjetur zgjidhjen e enigmës. Si mund t'i paraqesim këto veprime përmes barazimeve?</p> <p>Nxënësit ftohen në tabelë që të paraqesin zgjidhjen dhe të arsyetojnë atë. (<math>5 + 6 - 8 = 3</math>).</p> <p>Kështu arrihet deri te koncepti i veprimeve të përziera. Diskutohet edhe për rregullat dhe radhën e kryerjes së veprimeve të përziera.</p>	

### Hapi II – Punë me libër

Meqë nxënësit janë të njoftuar me kuptimin veprime të përziera, dhe e dinë radhën e veprimeve në një shprehje numerike që përmban veprime të përziera, ata udhëzohen që të punojnë në dyshe në faqen 21 të librit dhe të diskutojnë mes vete sipas nevojës nëse paraqitet ndonjë paqartësi apo vështirësi.



### Hapi III – Boshti numerik

Nxënësit ndahen në dy grupe. Nxënësit e njërit grup do të shkruajnë në tabelë barazime me veprime të përziera, ndërsa nxënësit e grupit tjetër lëvizin në boshtin numerik në dyshtemenë e klasës sipas barazimit në tabelë. Kur kemi veprimin e mbledhjes nxënësit lëvizin para e kur kemi veprimin e zbritjes kthehen prapa. Kontrollojmë rezultatin e nxënësve në tabelë a është i njëjtë me numrin mbi të cilin arrin nxënësi në bosht numerik. Kështu nxënësit duke u argëtuar zgjidhin barazime me veprime të përziera.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen me anë të buletinit të pjesëmarrjes. Fokusi i vlerësimit është i dyfishtë. Vlerësohen shkathtësitë e nxënësve për zgjidhje të barazimeve duke lëvizur nëpër bosht numerik dhe për kryerjen e veprimeve të përziera sipas radhës dhe rregullave.

TEMA: Orientimi	
NJËSIA MËSIMORE: Pozita	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.3 - Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit; VI.6 - Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Pozita, objekte, poshtë, lart, majtas, djathtas	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi.	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> Përshkruan pozitën e objekteve të ndryshme. Dallon pozitat poshtë, lart, majtas, djathtas. Analizon pozitën e shkronjave duke përdorur strategjinë e rreshtit dhe shtyllës.	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Përshkruan pozitën e objekteve të ndryshme. Përgjigju në pyetje rreth pozitës së objekteve duke përdorur shprehjet poshtë, lart, majtas, djathtas. Trego pozitën e shkronjave duke përdorur rreshtin dhe shtyllën.
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, lapsi, projektori, letër hamer ose ilustrime.	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Shkencat e natyrës.	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I - Aktivitet konkret Kjo njësi ka si qëllim përfundimin dhe zgjerimin e njohurive të fituara në klasën paraprake lidhur me orientimin e nxënësve në hapësirë dhe përdorimin e fjalëve të duhura për përshkrimin e vendndodhjes së objekteve. Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore duke ftuar disa nxënës të zënë pozita njëri pas tjetrit para tabelës. Diskutohet në nivel klase kush është para e kush prapa. Pastaj mësimdhënësi/ja vendos disa objekte nën dhe mbi tavolinën e saj si p.sh një libër, një laps, një mollë dhe diskuton rreth pozitës së objekteve duke bërë pyetje: Ku ndodhet molla? Cili objekt është në të majtë të lapsit? etj.	
Hapi II - Punë me libër Udhëzohen nxënësit të hapin librin faqe 22. Mësimdhënësi/ja shfaq me anë të projektorit ilustrimin e kësaj faqeje. Nxënësit analizojnë ilustrimin dhe diskutojnë për pozitën e objekteve duke u përgjigjur në pyetjet e dhëna në libër, faqe 23. Më pas, nxënësit vazhdojnë punën në	



detyrën e dytë duke analizuar ilustrimin me shkronja dhe duke diskutuar për pozitën e tyre e duke u përgjigjur në pyetjet e dhëna në libër.

### Hapi III - Përshkruaj dhe qëlllo

Ndahen nxënësit në grupe. Grupi i parë tregon një objekt në klasë, ndërsa grupi tjetër përshkruan pozitën e atij objekti. Pastaj grupi i dytë përshkruan pozitën e një objekti në klasë kurse grupi i radhës qëllon për cilin objekt bëhet fjalë. Procedura përsëritet aq herë sa mësimdhënësi/ja e sheh të nevojshme.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi fokusohet në shkathhtësitë e nxënësve për gjetjen e pozitave të objekteve të ndryshme si dhe përdorimin e shprehjeve adekuate për përshkrimin e vendndodhjes së objekteve.

TEMA: Orientimi	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>II.2-Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore</p> <p>II.8- Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta.</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).</p>	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Pozitë, objekte, poshtë, lart.	
<p><b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b></p> <p>Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi;</p> <p>Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme.</p>	
<p><b>REZULTATET E ORËS:</b></p> <p>Dallon pozitat e objekteve të ndryshme;</p> <p>Konfirmon pozitën e objekteve të dhëna;</p> <p>Përshkruan pozitën e gjësendeve në ilustrimet e dhëna.</p>	<p><b>KRITERET E SUKSESIT:</b></p> <p>Dallo pozitën e objekteve të ndryshme;</p> <p>Konfirmo pozitën e objekteve të dhëna duke vendosur <math>\surd</math> për pohimet e sakta.</p> <p>Përshkruaj pozitën e gjësendeve në ilustrimet e dhëna.</p>
<p><b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, goma, ngjyrat, lapsi</p>	
<p><b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta dhe puna; Shkencat e natyrës.</p>	
<p><b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b></p> <p>Hapi I – Dhoma ime</p> <p>Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke prezantuar para nxënësve ilustrimet e një plani të dhomës ose sjellë në klasë një dhomë nga kartoni. Në këtë mënyrë, mësimdhënësi/ja nxitë diskutimin rreth rregullimit të dhomës. Diskutohet se si duhet së pari të bëhet plani i dhomës ku objektet paraqiten përmes simboleve e pastaj të vendosen objektet në dhomë në pozita si janë të paraqitura në plan. Disa pyetje që mund të diskutohen janë:</p> <p>Çfarë objekte ka në dhomën e paraqitur? Ku ndodhet shtrati? Ku ndodhet dollapi? Ku ndodhet globi? etj.</p>	
<p>Hapi II- Punë me libër</p> <p>Në pjesën e dytë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja, fton nxënësit të hapin librin faqe 24 dhe udhëzon ata të plotësojnë detyrën 1 në të cilën kërkohet të rrethohet opsioni i saktë në lidhje me vendndodhjen e objekteve në ilustrim. Plotësohet edhe detyra 2 dhe 3 të cilat gjithashtu kanë të bëjnë me vendndodhjen e objekteve në ilustrime. Nxënësit vazhdojnë punën në çifte në faqen 25</p>	



të librit. Në detyrën 1 nxënësit analizojnë ilustrimin dhe vizatojnë gjësendet sipas kërkesave të dhëna në libër. Më pas, nxënësit vazhdojnë punën në detyrën 2 duke analizuar pozitën e rrathëve duhet të ngjyrosin rrathët sipas kërkesave të dhëna. Në detyrën 3 nxënësit plotësojnë copëzat e tabelës duke analizuar vendndodhjen e figurave në tabelë. Disa prej çifteve prezantojnë punën para klasës.

Hapi III - Përshkruaj dhe qëlllo

Nxënësit punojnë në çifte brenda bankave. Njëri nxënës përshkruan pozitën e një objekti në klasë kurse tjetri qëllon për cilin objekt bëhet fjalë. Pastaj nxënësit ndërrojnë rolet.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet me ndihmën e vëzhgimit dhe listës së kontrollit, ndërsa fokusin e vlerësimit e përcaktojnë kriteret e suksesit të përcaktuara për këtë orë të mësimi.

TEMA: Orientimi	
NJËSIA MËSIMORE: Paraqitja e pozitës me simbole	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.2-Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore</p> <p>II.8- Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta.</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 -Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Pozita, objekte, simbol, rresht, shtyllë	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <p>Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi.</p> <p>Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme.</p>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <p>Dallon pozitat e kafshëve të ndryshme;</p> <p>Plotëson të dhënat për pozitën e kafshëve nga grafiku i dhënë;</p> <p>Përshkruan pozitën e gjërave ushqimore dhe plotëson grafikun për pozitën e tyre.</p>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <p>Dallo pozitën e objekteve të ndryshme;</p> <p>Trego pozitën e kafshëve duke plotësuar të dhënat nga grafiku;</p> <p>Përshkruaj pozitën e gjërave ushqimore duke plotësuar të dhënat nga grafiku i dhënë.</p>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, lapsi, projektori, letër hamer ose ilustrime.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Shkencat e natyrës.	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I - Kopshti zoologjik</p> <p>Mësimdhënësi/ja paraqet para nxënësve përmes projektorit një kopsht zoologjik. Në mungesë të projektorit mund të përdorë fletë të ilustruara ku paraqitet kopshti zoologjik. Fillon diskutimi. Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit:</p> <p>A keni qenë ndonjëherë në kopsht zoologjik?</p> <p>Cilat kafshë keni parë aty?</p> <p>Cila kafshë ju pëlqen më shumë dhe pse?</p> <p>Pse kafshët vendosen në vende të ndryshme?</p> <p>A mund të jetojnë të gjitha kafshët në kushte të njëjta? etj.</p>	
<p>Hapi II- Punë me libër</p> <p>Udhëzohen nxënësit të hapin librin faqe 26. Në detyrën e parë është paraqitur një kopsht zoologjik. Nxënësit duhet të gjejnë pozitën e kafshëve në kopsht zoologjik dhe të plotësojnë</p>	








katrorët e paraqitur. Pas përfundimit të punës vazhdojnë në deyrën e dytë ku në mënyrë të njëjtë gjejnë pozitën e ushqimeve në tavolinë.

### Hapi III- Pozita e shokut/shoqes

Emërtojmë rreshtat e bankave me nxënës me shkronjat A, B dhe C. Secilit nxënës në rresht i caktohet numri duke filluar nga nxënësi në bankën e parë që mban numrin 1 dhe ashtu me radhë. Mësimdhënësi/ja vendos mbi tavolinën e saj një kuti me copëza letre, ku secila copëz letre ka emrin e ndonjërit nxënës. Fton nxënësit që të nxjerrin një copëz letre nga kutia dhe të përshkruajnë pozitën e nxënësit emri i të cilit figuron në letër p.sh. nxënësi i cili gjendet në rreshtin e mesëm, pra rreshtin B në bankën e tretë ka pozitën B5 ose B6 (sepse në bankën e parë kemi numrat 1 dhe 2, në të dytën 3 dhe 4, në të tretën 5 dhe 6).

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet me ndihmën e vëzhgimit dhe listës së kontrollit, ndërsa fokusin e vlerësimit e përcaktojnë kriteret e suksesit të përcaktuara për këtë orë të mësimt.

TEMA: Orientimi	
NJËSIA MËSIMORE: Labirinti	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.7 - Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 3.4 – Përdorë fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 3.6 – Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë.	
FJALËT KYÇE: Labirint, rrugë, cak, lëvizje.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Zgjidhë labirinte të ndryshme; Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme.	
REZULTATET E ORËS: Zbulon rrugën në labirintet e ndryshme; Zbaton rregullat për plotësimin e labirinteve; Ndërton labirint në mënyrë autonome.	KRITERET E SUKSESIT: Zbulo rrugën në labirintet e ndryshme; Zbato rregullat për plotësimin e labirinteve; Ndërto një labirint me material sipas dëshirës.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, fletorja, lapsi, ngjyrat, letër hamer.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Njeriu dhe natyra; Jeta e përditshme.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Diskutim Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore duke rikujtuar çfarë kanë mësuar orën e kaluar me ndihmën e pyetjeve që ju drejton nxënësve. Pasi të diskutohen gjërat e mësuara orën e kaluar, mësimdhënësi/ja u tregon nxënësve që ekzistojnë disa rrjete që përbëhen nga disa rrugë të ngatërruara prej të cilave vetëm njëra të dërgon në vendin e duhur. Këto rrjete quhen labirinte. Mësimdhënësi/ja paraqet përmes projektorit apo fletave të ilustruara disa shembuj të labirinteve.	
	
Hapi II - Punë me libër Udhëzohen nxënësit të hapin librin faqe 27. Duke lëvizur nëpër labirint nxënësit ndihmojnë majmunin të gjejë rrugën deri te bananet. Po ashtu, në labirintin tjetër ndihmojnë kafshët për të gjetur ushqimet e tyre të pëlqyera. Puna individuale e nxënësve vazhdon në faqen 28, në mënyrë të ngjashme.	
 	
Hapi III - Ndërtojmë labirint Nxënësit ndërtojnë labirinte duke përdorur materiale të ndryshme sipas dëshirës.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.	
VLERËSIMI: Vlerësimi fokusohet në shkathtësitë e nxënësve për t'u orientuar në labirint.	

TEMA: Orientimi	
NJËSIA MËSIMORE: Orientimi	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 3.4 – Përdorë fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 3.6 – Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë;	
FJALËT KYÇE: Orientim, poshtë, lart, majtas, djathtas	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi; Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme.	
REZULTATET E ORËS: Përshkruan orientimin në situata të ndryshme reale; Dallon pozicionet poshtë, lart, majtas, djathtas; Analizon situatat praktike nga jeta e përditshme.	KRITERET E SUKSESIT: Shpjego si orientohesh në jetën e përditshme; Dallo pozicionet poshtë, lart, majtas, djathtas. Analizo situatat praktike nga jeta e përditshme.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, fletorja, lapsi, ngjyrat, letër hamer etj	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Shkencat e natyrës; Edukata fizike, Sporti dhe shëndeti.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I - Orientimi në situata jetësore Mësimdhënësi/ja fillon orën duke paraqitur para nxënësve disa shembuj në formë ilustrimesh, përmes projektorit apo fotografish nga jeta e përditshme. Ajo parashtron pyetje lidhur me ilustrimet. Si shembull mund të merret lëvizja me ashensor. Mësimdhënësi/ja shtron pyetje se si duhet vepruar kur dëshirojmë të lëvizim me ashensor si dhe cilat shenjat duhet shikuar e cilët butona duhet shtypur etj.  Hapi II - Punë me libër Udhëzohen nxënësit të hapin librin faqe 29. Në detyrat e dhëna janë paraqitur situata ku nxënësit duke analizuar ilustrimet rrethojnë drejtimin e duhur të objekteve. Më pas mund të përdoret dhe të plotësohet nga nxënësit fleta e punës e marrë nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.  Hapi III - Lojë në çifte	

Ndahen nxënësit në çifte. Njërit nxënës i mbyllet sytë me shami dhe udhëzohet të dëgjojë me vëmendje udhëzimet e shokut/shoqes dhe të lëvizë sipas tyre. Nxënësit duhet të jenë sa më të qartë gjatë dhënies së udhëzimeve dhe sa më të kujdesshëm gjatë lëvizjes. Këtë lojë nxënësit mund ta zhvillojnë në klasë apo në oborrin e shkollës duke bërë kështu ndërlidhjen e orës së matematikës dhe edukatës fizike.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Nxënësit udhëzohen të paraqesin në fletoret e tyre me ilustrime apo me fjalë objekte të ndryshme që lëvizin lart, poshtë, në të djathtë, në të majtë.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi fokusohet në shkathhtësitë e nxënësve për t`u orientuar dhe për të lëvizur sipas udhëzimeve të dhëna.

TEMA: Orientimi	
NJËSIA MËSIMORE: Përshkruajmë rrugën	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 3.4 – Përdorë fjalorin fillestar të matematikës për t`u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 3.6 – Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune;	
FJALËT KYÇE: Orientim, poshtë, lart, majtas, djathtas , fillim, cak.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi; Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme.	
REZULTATET E ORËS: Përshkruan orientimin në natyrë; Përdor pozicionet poshtë, lart, majtas, djathtas; Analizon një rrugë nga fillimi deri te caku.	KRITERET E SUKSESIT: Shpjego si orientohesh në jetën e përditshme; Përdor pozicionet poshtë, lart, majtas, djathtas. Analizon një rrugë nga fillimi deri te caku.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, fletorja, lapsi, ngjyrat, letër hamer etj.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Shkencat e natyrës; Edukata fizike, sporti dhe shëndeti	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I - Orientimi në natyrë Mësimdhënësi/ja fillon orën duke paraqitur para nxënësve një hartë të Kosovës. Ai/Ajo u tregon nxënësve që për të shkuar në vende të ndryshme ne duhet të orientohemi me hartë dhe të zgjedhim rrugën e përshtatshme. Pastaj në hartë së bashku me nxënësit përcaktojnë drejtimin e lëvizjes dhe gjejnë rrugën për të arritur nga një qytet në tjetrin. Hapi II - Punë me libër Udhëzohen nxënësit të hapin librin në faqe 30. Në detyrën 1 duhet të përshkruajnë rrugën e Jetës nga shtëpia për në shkollë. Në detyrën 2 duhet të përshkruajnë rrugën e Agimit nga shtëpia deri në shkollë. Në detyrën 3 vizatojnë rrugën e tyre nga shtëpia për në shkollë. Hapi III – Shqyrtim i përbashkët Secili nxënës përshkruan me fjalë dhe prezanton vizatimin e rrugës së tij/saj për në shkollë para klasës. Përdoren shprehjet në të majtë, në të djathtë, drejt, lart, poshtë etj. Po ashtu, nëse mbetet kohë mund të punohet në fletën e punës të ndërlidhur me këtë njësi mësimore, të marrë nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Nxënësit vizatojnë një rrugë sipas dëshirës (nga shtëpia deri te gjyshërit apo nga shtëpia deri te kushërinjtë etj) dhe e përshkruajnë me shkrim rrugën e vizatuar.	
VLERËSIMI: Vlerësimi fokusohet në shkathhtësitë e nxënësve për t`u orientuar dhe për të lëvizur sipas udhëzimeve të dhëna.	

TEMA: Orientimi	
NJËSIA MËSIMORE: Paraqitja e rrugës në rrjet	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 3.4 – Përdorë fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 3.6 – Demonstron të menduar të pavarur dhe shpreh punë;	
FJALËT KYÇË: Orientim, rrjet, shigjetë, poshtë, lart, majtas, djathtas	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi; Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme.	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> Shpjegon orientimin e paraqitur përmes rrjetit dhe shigjetave; Përshkruan rrugën nga duhet lëvizur në rrjet; Ngjyrosë në rrjet dhe lëvizë në rrjet sipas udhëzimeve.	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Shpjego orientimin e paraqitur përmes rrjetit dhe shigjetave; Përshkruaj rrugën nga duhet lëvizur në rrjet; Ngjyros dhe lëviz sipas udhëzimeve.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Matematika 2A, Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, fletorja, lapsi, ngjyrat, letër hamer etj.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Shkencat e natyrës; Edukata fizike, sporti dhe shëndeti.	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I – Loja me hapa Loja mund të zhvillohet në klasë apo në oborr të shkollës. Mësimdhënësi/ja fillon orën duke prezantuar para nxënësve lojën. Në një pozitë të caktuar, më të largët, vendoset një top apo një lodër. Një nxënës duhet të nisët nga një pozitë tjetër e caktuar nga mësimdhënësi/ja. Të gjithë nxënësit tjerë në një fletë me katrore në formë të rrjetit mbajnë shënim për hapat që po bën shoku apo shoqja deri në cak. Në këtë rast mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që çdo hap ta shënojnë me shigjetë varësisht nga drejtimi që lëvizet, poshtë lartë, majtas, djathtas etj. Loja mund të vazhdojë edhe me nxënës tjerë. Hapi II - Punë me libër Udhëzohen nxënësit të hapin librin, faqe 31. Duke diskutuar për paraqitjen e rrugës në matematikë me anë të rrjetit dhe shigjetave, nxënësit fillojnë punën në libër. Në detyrën 1 janë paraqitur shigjetat të cilat duhet vendosur në rrjet për të paraqitur rrugën që kalon Agimi për të arritur në shkollë. Në detyrën e dytë shigjetat e paraqitura në rrjet duhet të barten në kornizën poshtë rrjetit. Hapi III – Shkëmbim në dyshe Ndahen nxënësit në çifte. Secili nxënës paraqet një rrugë në fletore apo fletë ku është ndërtuar një rrjet me ndihmën e katrorëve. Nxënësit shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe shigjetat i	

bartin poshtë rrjetit. Përsëri shkëmbehen fletoret dhe nxënësit kontrollojnë, vlerësojnë dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit. krijojnë detyra të ngjashme me ato në faqen 31.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi fokusohet në shkathhtësitë e nxënësve për të zgjidhur detyra të ndryshme sipas udhëzimeve të dhëna përmes rrjetit dhe shigjetave.

TEMA: Orientimi	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b>  II.2-Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore  II.8- Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta.  III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p>	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b>  1.1 -Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;  3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune;  4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Pozita, objekte, rrjet, shigjetë, poshtë, lart, majtas, djathtas	
<p><b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b>  Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi;  Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme.</p>	
<p><b>REZULTATET E ORËS:</b>  Përcakton saktësinë e rrugës së kafshëve deri tek ushqimi i pëlqyer.  Dallon pozitat e shigjetave poshtë, lart, majtas, djathtas për të përshkruar rrugën në rrjet.  Analizon pozitën e objekteve.</p>	<p><b>KRITERET E SUKSESIT:</b>  Përcakto saktësinë e rrugës së kafshëve deri tek ushqimi pëlqyer.  Trego se a është poshtë, lart, majtas apo djathtas secila shigjetë në rrjet.  Analizo pozitën e objekteve.</p>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, lapsi.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Shkencat e natyrës.	
<p><b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b>  Hapi I - Aktivitet konkret  Kjo njësi ka si qëllim përfundimin dhe zgjerimin e njohurive të fituara në klasën paraprake lidhur me orientimin e nxënësve në hapësirë dhe përdorimin e fjalëve të duhura për përshkrimin e vendndodhjes së objekteve. Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore duke ftuar dy nxënës të dalin para tabelës.  Njërit nxënës i kërkohet të shkoj deri te një objekt i caktuar (p.sh. te banka e parafundit, te çanta e Artës)  Tjetri nxënës përshkruan me shigjeta në tabelë rrugën që po kalon nxënësi deri te objekti (çanta). Vazhdohet edhe me disa nxënës të tjerë.  Hapi II- Punë me libër  Udhëzohen nxënësit të hapin librin, faqe 32. Në detyrën 1, nxënësit analizojnë shembujt e paraqitur dhe diskutojnë rrugën e kafshëve në rrjet deri te ushqimi i pëlqyer. Më pas, nxënësit vazhdojnë punën në detyrën 2, ku duke përdorur rrjetin dhe shigjetat ndërtojnë rrugë të ndryshme për kafshët deri te ushqimet e tyre. Në faqen 33 vazhdohet me zgjidhjen e detyrës bazuar në kërkesat e dhëna.  Hapi III-Projekt  Në faqen 34 nxënësi në mënyrë të pavarur projektton rrugën e objekteve të dhëna në rrjet përmes shigjetave. Pastaj paraqet shigjetat në kornizë.</p>	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.	



**VLERËSIMI:** Vlerësimi fokusohet në shkathtësitë e nxënësve për ndërtimin e rrugëve me shigjeta në rrjet si dhe përdorimin e simboleve dhe shprehjeve adekuate në interpretim.

TEMA: Bashkësitë dhe relacionet	
NJËSIA MËSIMORE: Elementet dhe bashkësitë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3 - 5 minutash. II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1-Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2-Zbaton shprehje të arsytimit për të bërë hamendësime; 3.3- Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Bashkësi, veti e përbashkët, objekte, element, diagram	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh që mund të jenë afër/larg njëri-tjetrit; Formon bashkësi sipas vetive të elementeve.	
REZULTATET E ORËS: Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh; Formon bashkësi bazuar në veti të përbashkëta të elementeve; Vizaton objekte sipas kërkesës dhe formon bashkësi.	KRITERET E SUKSESIT: Jep të paktën dy shembuj të bashkësive nga jeta e përditshme; Krijo së paku tri bashkësi bazuar në veti të përbashkëta të elementeve; Prezento raste konkrete të bashkësive nga jeta e përditshme.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, objekte të ndryshme që gjenden në klasë.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Jeta dhe puna; Edukata fizike, sportet dhe shëndeti, Artet; Gjuhët dhe komunikimi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I - Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja fillon orën me udhëzimin që secili nga nxënësit të sjellë nga dy objekte në bankën e mësimdhënësit/es. Derisa nxënësit vendosin se çfarë do të sjellin, mësimdhënësi/ja e vendosë bankën e vet në një vend që është më i përshtatshëm për t'u parë nga të gjithë nxënësit në klasë. Nxënësit mund të sjellin çfarëdo objekte të përzgjedhura sipas dëshirës së tyre që kanë me vete në çantë ose nëpër xhepa. Pas grumbullimit të objekteve, me ç'rast edhe mësimdhënësi/ja mund të shtojë në grumbull disa objekte nga çanta e saj, nxënësit kthehen nëpër vende. Më tutje, mësimdhënësi/ja diskuton me nxënësit mënyrat se si mund të ndahen dhe të grupohen objektet e sjella. Varësisht se çfarë objekte ka në bankën e mësimdhënëses, vendosen edhe kategoritë grumbulluese. P.sh. nëse në bankë ka vetëm mjete mësimore, atëherë grumbullimi bëhet sipas llojeve të mjeteve mësimore, pra: tekste, fletore, lapsa, goma etj. Nëse në bankë ka edhe objekte tjera, përveç atyre mësimore, atëherë grumbullimi bëhet sipas llojeve të objekteve, pra: mjete mësimore, lodra, para, ushqime etj. Pas përcaktimit të mënyrës së grumbullimit, mësimdhënësi/ja përcakton bankat ku do të grumbullohen objektet e ndryshme sipas kategorive. Poashtu edhe nxënësit ndahen në grupe, si është më e përshtatshme, duke përcaktuar cili grup do të grumbullojë cilin lloj të objekteve. Tani puna e nxënësve në ri-grumbullimet e objekteve mund të fillojë. Me përfundimin e aktivitetit, mësimdhënësi/ja ua përkujton nxënësve (nëse atë nuk e ka bërë ndonjë	

nga nxënësit deri tani), se grumbujt e objekteve me ndonjë karakteristikë të përbashkët quhen bashkësi, përderisa objektet që hyjnë në bashkësi quhen elemente të bashkësisë.

#### Hapi II – Diskutim

Diskutimet për bashkësitë dhe elementet e bashkësive vazhdojnë duke kërkuar nga nxënësit që të prezantojnë raste konkrete të bashkësive të ndryshme nga jeta e përditshme (p.sh. bashkësi pemësh, perimesh, rroba, mbathje etj.). Më tej, diskutohet për bashkësitë dhe për gjërat (objektet, gjallesat etj.) që iu takojnë bashkësive të caktuara.

#### Hapi III – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 36, 37. Së pari analizojnë ndarjen e figurave gjeometrike sipas formave të tyre, që po bëjnë Drini dhe Luna në detyrën 1. Më tej, nxënësit në mënyrë individuale punojnë në detyrën 2, ku gjejnë dhe vizatojnë bashkësitë me elementet nga jeta e përditshme. Në detyrën 3, duke rrethuar objektet që kanë ndonjë karakteristikë të përbashkët nxënësit formojnë bashkësi të ndryshme. Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të vazhdojnë punën në faqe 38, ku duhet të plotësojnë bashkësitë duke vizatuar llojet dhe sasi të përkatëse të objekteve sipas kërkesave të dhëna. Disa nga detyrat e prezantuara në këtë faqe mund të përdoren për punë të pavarur në shtëpi.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Disa nga detyrat e faqes 38 të librit.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen me anë të vëzhgimit dhe listës së kontrollit. Fokusi i vlerësimit është aftësia e nxënësve për të arsyetuar klasifikimin e objekteve në bashkësi si dhe formimi i bashkësisë bazuar në veti të përbashkëta të elementeve.

TEMA: Bashkësitë dhe relacionet	
NJËSIA MËSIMORE: I takon apo nuk i takon bashkësisë	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlarësinë midis tyre.</p> <p>III.2-Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p> <p>III.4-Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.</p>	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>1.5- Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>3.4-Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;</p> <p>4.2-Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Bashkësi, element, diagram, i takon, nuk i takon	
<p><b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b></p> <p>Identifikon elementet që i takojnë/nuk i takojnë bashkësisë dhe paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit;</p> <p>Formon bashkësi bazuar në veti të përbashkëta të elementeve.</p>	
<p><b>REZULTATET E ORËS:</b></p> <p>Identifikon elementet që i takojnë apo nuk i takojnë bashkësisë;</p> <p>Formon bashkësi bazuar në veti të përbashkëta të elementeve;</p> <p>Argumenton mënyrën e formimit të bashkësive;</p> <p>Paraqet bashkësi përmes diagramit.</p>	<p><b>KRITERET E SUKSESIT:</b></p> <p>Gjej elementet që i takojnë dhe ato që nuk i takojnë bashkësisë;</p> <p>Rretho elementet me veti të përbashkëta dhe formo bashkësi;</p> <p>Trego si i formove bashkësitë;</p> <p>Paraqit bashkësi përmes diagramit.</p>
<p><b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2A, një shportë, ca pemë dhe perime, projektor apo fletë hamer, fletorja, lapsi, goma, ngjyrat</p>	
<p><b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b></p> <p>Jeta dhe puna; Shkencat e natyrës; Shoqëria dhe mjedisi, Artet</p>	
<p><b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b></p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja mund të fillojë orën duke përdorur një shportë, disa perime dhe disa pemë. Brenda në shportë vendosen disa perime. Jashtë shporte, mbi tavolinë vendosen disa perime të tjera dhe disa pemë. Mësimdhënësi/ja i pyet nxënësit se kush e ka vendin brenda shporte, e kush jo, prej gjërave që ndodhen jashtë? Nxënësit e diskutojnë faktin se a duhet vendosur brenda shporte apo jo secilën nga pemët dhe perimet. Është mirë që të diskutohen disa shembuj të tillë, të natyrave të ndryshme. Shembull i tillë mund të jetë ferma me disa kafshë shtëpiake, e përcjellur me disa kafshë tjera jashtë ferme, prej të cilave disa janë shtëpiake e disa të egra. Poashtu, si kontekste për shembuj mund të shërbejnë edhe veshmbathjet, prodhimet ushqimore, prodhimet industriale etj. Në mungesë të mjeteve mësimdhënësi/ja me anë të projektorit, ose me ndihmën e vizatimeve në hamer paraqet shembuj vizual të tillë. Pasi mësimdhënësi/ja e sheh se fëmijët janë në gjendje që në mënyrë të argumentuar të përfundojnë nëse një element i takon apo nuk i takon bashkësisë, mund të kalohet në punë me libër.</p>	



### Hapi II – Punë me libër

Udhëzohen nxënësit të hapin librin, faqe 39. Në detyrën e parë janë paraqitur tri bashkësi në mënyrë vizuale. Janë paraqitur edhe disa elemente jashtë bashkësive. Në rast se elementi jashtë i takon ndonjëres prej bashkësive, nxënësit duhet ta lidhin elementin dhe bashkësinë me shigjetë. Në rast se elementi nuk i takon asnjërës prej bashkësive, atëherë ai element duhet vijëzuar. Në detyrën e dytë, nxënësit përzgjedhin nga grumbujt e dhënë elementet të cilat mund të formojnë një bashkësi në bazë të ndonjë vetie të përbashkët. Vazhdohet me detyrat 3, 4, 5 dhe 6 në të cilat kërkohet vendosja e simbolit në katrorin e zbrazët për të vërtetuar nëse elementi i takon apo nuk i takon bashkësisë së dhënë.

### Hapi III – Punë në fletore

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të vizatojnë në fletoret e tyre katër rrathë (diagrame). Secili prej tyre paraqet një stinë të vitit. Pastaj, mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë një listë me veshmbathje të ndryshme. Nxënësit duhet të vendosin në secilin diagram veshmbathje që ata mendojnë se i përkasin asaj stinë. Disa prej veshmbathjeve mund të vendosen edhe në dy apo më shumë diagrame, varësisht nga mendimet e nxënësve. Bashkësitë e plotësuara me elemente diskutohen në nivel klase dhe bëhen përmirësime sipas nevojës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen për aktivitetet, pjesëmarrje në diskutim dhe punë të pavarur në libër. Vlerësimi kryhet me anë të vëzhgimit dhe listës së kontrollit.

TEMA: Bashkësitë dhe relacionet	
NJËSIA MËSIMORE: Krahasimi i bashkësive	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3-Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>II.1-Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;</p> <p>II.8- Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta.</p> <p>III.3 - Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.4-Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;</p> <p>2.1-Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve;</p> <p>3.4-Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Bashkësi, krahasim, element, më shumë, më pak, barazi	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <p>Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve (më pak, më shumë, aq sa).</p>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <p>Jep shembuj praktik për krahasimin e bashkësive;</p> <p>Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve;</p> <p>Formon bashkësi me numër të njëjtë dhe të ndryshëm të elementeve;</p> <p>Përdor strategji për zgjidhjen e problemeve.</p>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <p>Jep së paku dy shembuj praktik për krahasimin e bashkësive;</p> <p>Krahaso së paku katër bashkësi sipas numrit të elementeve;</p> <p>Formo nga dy bashkësi me numër të njëjtë dhe me numër të ndryshëm të elementeve;</p> <p>Përshkruaj strategjinë e përdorur për zgjidhjen e problemeve.</p>
<p>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, objekte të ndryshme që mund të gjenden në klasë, litar, laps, gomë, ngjyra.</p>	
<p>LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Jeta dhe puna, Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë fizike, sporti dhe shëndeti.</p>	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Punë me mjete</p> <p>Pjesa hyrëse e orës mbështetet në aktivitete të formimit të bashkësive reale. Ky aktivitet mund të zhvillohet në çifte, ashtu si janë të sistemuar nxënësit nëpër banka. Nxënësit mund të formojnë bashkësi nga petëzat, apo nga objektet që i kanë me vete. Për shembull, njëri nxënës formon bashkësinë e ngjyrave që i ka me vete, tjetri formon bashkësinë e fletoreve. Ata formojnë bashkësitë duke i grumbulluar objektet përkatëse në bankë, para vetes. Pasi bashkësitë të jenë formuar, nxënësit fillojnë numërimin e elementeve të bashkësive, dhe në fund, në secilën bankë krahasohen dy bashkësitë e formuara, cila ka më shumë elemente, e cila ka më pak.</p>	



Mësimdhënësi/ja kujdeset që gjatë diskutimit të përdoren termat: bashkësi me më shumë elemente, bashkësi me më pak elemente, bashkësi me numër të barabartë elementesh. Po ashtu, duhet të përdoren termet: më shumë, më pak, aq sa. Si përfundim, mund të diskutohet edhe bashkësia që ka më së shumti elemente në gjithë klasën, e po ashtu edhe ajo që ka më së paku elemente.

#### Hapi II-Sporti i preferuar

Merren tre litarë me ngjyra të ndryshme dhe formohen rrethë prej tyre. Ftohen nxënësit që pëlqejnë futbollin të hyjnë brenda rrethit të parë, ata që pëlqejnë basketbollin të hyjnë brenda rrethit të dytë, kurse ata që pëlqejnë sportet tjera në rrethin e tretë. Kështu formohen tri bashkësi me nxënës. Duke numëruar nxënësit brenda secilës bashkësi krahasohen bashkësitë sipas numrit të elementeve. Diskutohet cila bashkësi është më e madhe se tjetra, cila bashkësi është më e vogël se tjetra si dhe a ka bashkësi të barabarta sipas numrit të elementeve.

#### Hapi III-Punë me libër

Tani nxënësit e kanë të qartë konceptin e krahasimit të numrit të elementeve të bashkësive, prandaj mund të kalohet në punë në libër, faqe 40. Analizohet detyra e parë dhe e dytë duke diskutuar në nivel klase. Nxënësit vazhdojnë zgjidhjen e detyrës së tretë me punë të pavarur. Detyra e tretë është me fund të hapur, domethënë, nxit të menduarit kreativ dhe gjenerimin e ideve autonome matematike. Puna vazhdon në faqen 41. Nxënësit punojnë detyrat me fjalë dhe diskutojnë e arsyetojnë në çift zgjidhjet e tyre.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen për aftësinë e të gjeturit të shembujve nga jeta e përditshme për krahasimin e bashkësive sipas numrit të elementeve, si dhe për aftësinë e ndërtimit të bashkësive me numër të njëjtë dhe me numër të ndryshëm të elementeve.

TEMA: Bashkësitë dhe relacionet	
NJËSIA MËSIMORE: Shoqërimi i elementeve të dy bashkësive	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; III.4-Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 3.2-Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor; 4.2-Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme; 5.1-Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Bashkësi, lidhje, shoqërim, elemente, rregull	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Shoqëron objektet (elementet) e bashkësisë së dhënë me objekte (elemente) të një bashkësie tjetër.	
REZULTATET E ORËS: Shoqëron objekte reale; Zbulon rregullën e shoqërimit të elementeve të dy bashkësive; Zbaton rregulla autonome të shoqërimit të elementeve të bashkësive të ndryshme.	KRITERET E SUKSESIT: Shoqëro objekte të ndryshme reale në mes vete; Paraqit 3 - 4 shembuj praktik nga jeta lidhur me shoqërimin e elementeve; Argumento përmes shembujve mënyrën e shoqërimit në mes elementeve të dy bashkësive.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, objekte të ndryshme që gjenden në klasë, sheqerka, fletorja, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta dhe puna; Shkencat e natyrës	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I-Mendo dhe përgjigju Mësuesja fillon orën me evokimin e konceptit të shoqërimit. Pyetja e parë drejtuar nxënësve mund të jetë– Çfarë do të thotë shoqërim? – Pasi që nxënësit shprehin mendimet e veta në lidhje me konceptin në fjalë, mësimdhënësi/ja u drejton atyre pyetjen e dytë – A mund të shoqërohen elementet nga dy bashkësi të ndryshme? - Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit shembuj konkret të shoqërimit të objekteve nga përvojat e tyre reale. Për shembull, shoqërimi i bashkësisë së nxënësve me bashkësinë e çantave apo me bashkësinë e sheqerkave (mund të marrim sheqerka dhe secilit nxënës ia ndajmë nga një) etj. Hapi II-Punë me libër Pas përfundimit të eksplorimeve dhe diskutimeve të shembujve real të shoqërimit të elementeve të bashkësive të ndryshme, mund të vazhdohet puna në libër faqe 42. Diskutohet së pari paraqitja vizuale në detyrën 1, si dhe rregulla e shoqërimit. Në këtë fazë duhet të diskutohet fakti që secili shoqërim e ka një rregull që e përcjell atë shoqërim. Më tej diskutohet për rregullat e shoqërimit të bashkësive në detyrën 2 dhe 3. Puna vazhdon në faqe 43. Të gjitha detyrat e paraqitura zgjidhen me teknikën "Zbulo rregullën". Bëhet fjalë për zbulimin e rregullës së shoqërimit të dyshet e paraqitura të bashkësive. Në detyrën e parë, rregulla e shoqërimit është –	





shoqërimi i secilit frutë me ngjyrën përkatëse, në të dytën shoqërimi i secilës figurë gjeometrike me ngjyrën e saj. Aty janë edhe katër detyra me bashkësi numerike, ku në bazë të shembujve të dhënë të elementeve të shoqëruara kuptojmë rregullën për shoqërimin e të gjitha elementeve tjera.

### Hapi III -Shoqërojmë elemente

Udhëzohen nxënësit që të punojnë në fletore ku duhet të krijojnë dy bashkësi sipas dëshirës dhe të shoqërojnë elementet e tyre duke lidhur ato me shigjeta. Nxënësit prezantojnë dhe argumentojnë punën e bërë dhe lidhjet e krijuara. Kështu duke bërë shoqërimin e elementeve të bashkësive në mënyrë të pavarur ata përforcojnë njohuritë e marra në këtë orë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen me anë të vëzhgimit dhe listës së kontrollit. Fokusi i vlerësimit është aftësia e nxënësve për të zbuluar rregullat e shoqërimit dhe për të ndërtuar relacione në mes të bashkësive.

TEMA: Bashkësitë dhe relacionet	
NJËSIA MËSIMORE: Bashkimi i dy bashkësive	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> II.1 - Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren, etj. për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 6.3 - Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme 7.1 - Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtë shkollor	
FJALËT KYÇE: Bashkësi, bashkim, elemente, diagram	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna.	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> Bashkon elementet e dy bashkësive reale; Plotëson elementet që mungojnë në bashkësi ose në bashkimin e dy bashkësive; Paraqet simbolikisht bashkësitë e reja të ndërtuara me bashkimin e dy bashkësive.	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Kryej bashkimin e dy bashkësive të ndërtuara me elemente reale; Plotëso elementet e duhura që mungojnë në bashkësi; Paraqit simbolikisht bashkësitë e reja të ndërtuara me bashkimin e dy bashkësive.
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2A, petëza, objekte të ndryshme që gjenden në klasë dhe në çanta të nxënësve, projektor ose fleta hamer, lapsi, goma, ngjyrat	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja thërret të gjitha vajzat e klasës të ngrihen dhe të afrohen pranë saj. Duke diskutuar bashkë me nxënësit për bashkësinë e formuar të vajzave, mësuesja thërret edhe djemtë që të grumbullohen dhe të formojnë, në anën tjetër, bashkësinë e djemve. Më tej, mësuesja shtron pyetjen – po sikur të grumbullohen tani bashkë të dy bashkësitë, edhe bashkësia e vajzave edhe ajo e djemve, çfarë do të fitonim? Natyrisht, shumë shpejtë do të arrihet deri te përgjigja se me bashkimin e dy bashkësive fillestare fitohet një bashkësi më e madhe, bashkësia e të gjithë nxënësve të klasës. Në këtë mënyrë nxënësit njoftohen me konceptin e bashkimit (unionit) të bashkësive. Hapi II – Aktivitet konkret Nxënësit vazhdojnë punën në banka, me një aktivitet të radhës, me përdorimin e petëzave ose objekteve të ndryshme që kanë në çantat e veta. Aktiviteti mund të zhvillohet në dyshe, brenda bankës. Secili nga nxënësit formon një bashkësi nga petëzat e veta. Më tej, në secilën bankë bashkohen dy bashkësitë dhe formohet një bashkësi më e madhe e petëzave, ku nxënësit në fund të aktivitetit diskutojnë dhe komentojnë hapat e aktivitetit si dhe emërtimet e të gjitha bashkësive të formuara (si për shembull, unë kisha formuar bashkësi të rrathëve, Agroni kishte formuar bashkësi të katrorëve dhe tani kemi një bashkësi të ndërtuar nga katrorët dhe rrathët). Ora vazhdon me paraqitjen e shembujve të ngjashëm ku me bashkimin e dy bashkësive fitohet një bashkësi më e madhe. Shembujt prezantohen para klasës me anë të projektorit, vizatimeve në hamer ose hamerëve të printuar. Shembuj të qëlluar, të cilët do të ishin efikas dhe do të mundësonin të	

kuptuarit e bashkimit të dy bashkësive janë: shportat me lloje të ndryshme frutash, bashkësitë me lloje të ndryshme kafshësh apo shpezësh etj.

Hapi III – Punë me libër

Puna vazhdon në libër faqe 44, ku së pari diskutohet bashkimi i dy bashkësive të paraqitura në detyrën 1. Pastaj, në detyrën 2 dhe 3, nxënësit plotësojnë elementet që mungojnë, qoftë në dy bashkësitë më të vogla që bashkohen, qoftë në bashkësinë më të madhe që formohet pas bashkimit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell zhvillimin e aktivitetit në çifte, pjesëmarrjen e secilit nxënës në diskutim dhe punën individuale të nxënësve në libra, duke plotësuar listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.

TEMA: Bashkësitë dhe relacionet	
NJËSIA MËSIMORE: Elementet e përbashkëta të dy bashkësive	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike. 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash 6.2 - Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.	
FJALËT KYÇE: Bashkësi, element, i përbashkët, diagram i Venit, prerje.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësive.	
REZULTATET E ORËS: Identifikon elementet e njëjta tek dy bashkësi të dhëna; Vendosë saktë në diagram të Venit elementet e përbashkëta; Arsyeton para klasës ndërtimin e diagramit me elemente të përbashkëta të dy bashkësive.	KRITERET E SUKSESIT: Identifiko elementet e njëjta te dy bashkësi të dhëna; Vendos saktë në diagram të Venit elementet e përbashkëta; Arsyeto para klasës ndërtimin e diagramit me elemente të përbashkëta të dy bashkësive.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, objekte të ndryshme që gjenden në klasë dhe në çanta të nxënësve, projektor ose fletë hameri, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi; Njeriu dhe natyra, Jeta e përditshme	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I - Diskutim Mësimdhënësi/ja fillon orën duke prezantuar me projektor ose duke paraqitur me vizatim në fletë hameri dy bashkësi të ndryshme me figura gjeometrike. Dy bashkësitë e paraqitura veç e veç përmbajnë nga dy elemente të njëjta, pra bashkësitë kanë dy elemente të përbashkëta. Duke ndërruar pamjet në projektor hap pas hapi vijmë deri te paraqitja e këtyre dy bashkësive dhe prerjes së tyre me anë të diagramit të Venit. Nxënësit, pra, shohin hap pas hapi procesin e të vendosurit të elementeve të përbashkëta në diagram, duke diskutuar dhe arsyetuar nevojën e vendosjes së tillë. Më tutje mësimdhënësi/ja me nxënësit diskutojnë edhe raste tjera të çifteve të bashkësive me elemente të përbashkëta. Mund të jenë bashkësi me objekte reale apo me objekte matematike. Çdo çift i bashkësive duhet të ketë nga një apo nga dy elemente të njëjta, që pastaj hap pas hapi vendosen në diagram të Venit. Hapi II – Aktivitet konkret Ora vazhdon duke udhëzuar nxënësit që në çifte, me anë të petëzave të formojnë nga dy bashkësi të ndryshme me elemente të përbashkëta. Bashkësitë e petëzave mund të formohen duke marrë për bazë ngjyrën apo formën e petëzave. Pastaj, çifteve iu shpërndahet nga një fletë A4 me diagram të gatshëm për paraqitjen e bashkësive që ata kanë ndërtuar. Më tej nxënësit arsyetojnë para klasës diagramet e paraqitura.	

### Hapi III – Punë me libër

Ora vazhdon ashtu që nxënësit hapin librat bazë, faqe 45, dhe analizojnë e diskutojnë paraqitjet e bashkësive me elemente të përbashkëta në detyrën 1. Më tej vazhdojnë me punë individuale në detyrën 2, ku ata duhet ti vendosin në diagram kafshët që jetojnë në tokë, kafshët që jetojnë në ujë dhe si pjesë e përbashkët e këtyre dy bashkësive, kafshët që jetojnë edhe në tokë edhe në ujë. Në detyrën 3 nxënësit duhet të plotësojnë hapësirat e zbrazëta duke u bazuar në diagramet e dhëna. Nëse koha premtion, nxënësit mund të vazhdojnë të punojnë në faqe 46, ku gjenden 4 çifte të bashkësive me elemente të përbashkëta që duhet të sistemohen në diagram të Venit, e më pastaj të listohen poshtë diagramit elementet e përbashkëta të tyre. Ndonjë nga detyrat e prezantuara në faqe 46 mund të alokohet për punë të pavarur në shtëpi.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Ndonjë nga detyrat e faqes 46 të librit.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja observon punën e nxënësve duke u fokusuar në aktivitetet individuale në libër. Vlerësimi kryhet duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin personal.

TEMA: Bashkësitë dhe relacionet	
NJËSIA MËSIMORE: Nënbashkësia	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>III.3 - Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.</p> <p>III.6 - Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta</p> <p>3.1 - Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore</p> <p>6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme</p>	
FJALËT KYÇE: Bashkësi e madhe, bashkësi e vogël, grumbullim, veti, nënbashkësi, diagram.	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <p>Formon nënbashkësi nga bashkësia e dhënë.</p>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <p>Gjen bashkësi më të vogla brenda bashkësisë së madhe;</p> <p>Dallon vetitë për formimin e nënbashkësive të ndryshme;</p> <p>Paraqet nënbashkësitë me diagram të Venit.</p>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <p>Gjej nënbashkësitë e bashkësive të formuara nga objektet reale;</p> <p>Argumento mënyrën e ndarjes së elementeve në nënbashkësi;</p> <p>Paraqit nënbashkësitë me anë e diagramit të Venit.</p>
<p>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, projektor ose fletë hameri, objekte të ndryshme që mund të gjenden në klasë, tabela, markeri, tekstet, lapsi, goma</p>	
<p>LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi</p>	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja e fillon orën e mësimit duke thirrur para klasës një nxënës vullnetar i cili duhet të marrë çantën me vete. Duke prezantuar çantën e nxënësit si një bashkësi të shumë llojeve të mjeteve mësimore, formohen dhe diskutohen nënbashkësitë nga llojet e veçanta të mjeteve mësimore që gjenden në çantë. Kështu mund të ndahen librat nga njëra anë, fletoret nga tjetra, ngjyrat etj.</p> <p>Hapi II - Diskutim</p> <p>Ora vazhdon duke paraqitur në projektor ose si vizatime në hamer, disa shembuj të bashkësive tek të cilat nxënësit do të mund të identifikojnë një apo më tepër nënbashkësi. Shembuj të tillë mund të jenë: një shportë me mollë dy apo tri ngjyrash, një frigorifer me prodhime qumështi, mishi, pemë e perime, një dollap që përmban tessa të stinëve të ndryshme, një bashkësi me dy lloje të ndryshme shpezësh etj.</p> <p>Hapi III – Punë me libër</p> <p>Pasi që koncepti i nënbashkësisë dhe mundësitë e formimit të nënbashkësive janë të qarta për nxënësit, mund të kalohet në punë me libër faqe 47. Në libër punohet individualisht, duke paraqitur bashkësitë e kërkuara me anë të diagramit të Venit, dhe duke gjetur nënbashkësitë e bashkësive të formuara.</p>	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Projekt nga faqja 48 e librit.	

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell zhvillimin e aktivitetit në çifte, pjesëmarrjen e secilit nxënës në diskutim dhe punën individuale të nxënësve në tekste, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin personal.

TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Dhjetëshet e plota	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2-Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇË: Numër, numërim, vlerë, krahasim, dhjetëshe e plotë, njëshe	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;	
REZULTATET E ORËS: Identifikon dhjetëshet e plota. Numëron objekte në ilustrime duke veçuar dhjetëshet e plota. Shkruan dhjetëshet e plota me shifra dhe me fjalë. Gjen dhe krahason dhjetëshet e plota paraardhëse dhe pasardhëse. Krahason dhjetëshet e plota.	KRITERET E SUKSESIT: Numëro me dhjetëshe të plota. Numëro objektet e paraqitura në ilustrime duke veçuar dhjetëshet e plota. Shkruaj dhjetëshet e plota me shifra dhe me fjalë. Gjej dhjetëshet e plota paraardhëse dhe pasardhëse. Krahaso dhjetëshet e plota.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A dhe fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, pikado, lapsi, goma	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Edukata fizike; Artet; Jeta e përditshme	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja u paraqet nxënësve një pikado e cila ka pikët me dhjetëshe të plota nga 10 deri në 100. Pikado mund të jetë edhe e vizatuar në tabelë. Është e rëndësishme që dhjetëshet e plota (pikët në pikado) most ë jenë të radhitura sipas radhës nëpër rrathët e pikados. Në lojë përfshihen të gjithë nxënësit. Secili nxënës ka të drejtë të shënjojë vetëm një here në pikado me shigjetë apo shkumës. Pikët e shënuara mbahen shënim. Më pas kërkohet që të analizohen rezultatet e gjuajtjeve. Duke treguar kush ka fituar më pak pike e kush më shumë, nxënësit renditin dhjetëshet e plota deri në 100, njëkohësisht duke krahasuar ato në mes vete. Hapi II – Punë me libër Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të hapin librat faqe 50. Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të analizojnë ilustrimin dhe të komentojnë për dhjetëshet e plota dhe radhitjen e tyre në ilustrim. Puna vazhdon në faqen 51 duke dhënë përgjigje në kërkesat e detyrave të parashtruara aty mungojnë. Hapi III – Punë e pavarur	




Nxënësit në mënyrë të pavarur punojnë në kërkesat e detyrave të parashtruara në faqen 52 të librit. Rezultatet e fituara diskutohen në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese ose material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke përdorur si teknika vlerësuese vëzhgimin dhe listën e kontrollit. Fokuset e vlerësimit janë identifikimi, shkrimi dhe radhitja e dhjetësheve të plota.


TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Numrat deri në 30	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave , ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t’u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Numër, dyshifror, njëshe, dhjetëshe	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri;	
REZULTATET E ORËS: Lexon numrat nga 1-30 në rendin rritës dhe rendin zbritës. Shkruan numrat 1 deri në 30 në rendin rritës dhe zbritës. Përcakton dhjetëshet dhe njëshet te numrat dyshifrorë.	KRITERET E SUKSESIT: Lexo numrat nga 1-30 në rendin rritës dhe rendin zbritës. Shkruaj numrat 1 deri në 30 në rendin rritës dhe zbritës. Përcakto dhjetëshet dhe njëshet te numrat dyshifrorë.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, rruaza, penj, lapsi, ngjyrat, goma, karta me numra dhe dhjetëshe e njëshe.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke diskutuar me nxënësit rreth dhjetësheve dhe njësheve. Sigurisht, kjo nuk është hera e parë që nxënësit dëgjojnë për dhjetëshet dhe njëshet, andaj së pari nxënësit rikujtojnë se 1 Dh = 10 Nj. Më tutje, mësimdhënësi/ja ndan nxënësit në grupe përmes ndonjë teknike të përshtatshme. Për secilin grup mësimdhënësi/ja ndan një grumbull rruazash dhe disa fije peri. Mësimdhënësi/ja paraprakisht kujdeset që grumbulli i rruazave të mos tejkalojë numrin 30. Më pas udhëzohen nxënësit që përmes rruazave dhe fijeve të perit të formojnë dhjetëshe dhe të shohin sa rruaza do ju teprojnë. Pra, nxënësit do të vendosin nga 10 rruaza në fijen e perit në mënyrë që të formojnë dhjetëshe. Kështu, në fund të aktivitetit, nxënësit do të numërojnë sa dhjetëshe kanë formuar dhe sa njëshe u kanë tepruar. Në këtë rast nxënësit do të zbulojnë se cilin numër kanë formuar. Grupet prezantojnë punën e tyre. Hapi II – Bingo	



Ora mësimore vazhdon edhe me një aktivitet tjetër në mënyrë që nxënësit të përforcojnë kuptimin e dhjetësheve dhe njësheve si dhe të ushtrojnë numrat deri në 30.

Mësimdhënësi/ja paraprakisht përgatit disa karta me të cilat do të zhvillojë një lojë me nxënësit. Kartat mund të jenë të plastifikuara ose edhe të ndërtuara nga letra e thjeshtë. Në njërën anë duhet të jenë të vendosura shufrat e dhjetësheve dhe kubëzat e njësheve, ndërsa në anën e kundërt ndodhet numri që përket me shufrat dhe kubëzat (shih shembullin në foto).

25



Mësimdhënësi/ja do të përdorë nga një kartë për secilin nxënës. Ai/Ajo do të shfaq para nxënësit/es kartën ku shihen shufrat dhe kubëzat dhe nxënësi/ja do të tregojë për cilin numër bëhet fjalë. Nxënësit do të vërtetojnë saktësinë e tyre duke rrotulluar kartën për të parë numrin.

#### Hapi III – Punë me libër


Mësimdhënësi/ja diskuton me nxënësit përmes pyetjeve rreth detyrës 1, në faqen 53 të librit, në të cilën janë paraqitur numrat e dhjetësheve së parë, dytë dhe tretë. Në detyrën 2 shkruhen numrat që mungojnë në tabelë. Më pas, nxënësit do të vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në detyrën 3, ku duke analizuar ilustrimet me shufra dhe kubëza do të zbulojnë dhe shkruajnë numrat.

Puna e pavarur vazhdon edhe në faqen 54.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Disa nga detyrat e faqes 54 të librit.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke vëzhguar nëse nxënësi punon saktë me dhjetëshe dhe njëshe, si dhe duke mbajtur shënime nëse dallon saktë numrat deri në 30.

TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Numrat deri në 40	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; VI.6 - Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;	
FJALËT KYÇE: Numër, dhjetëshja e katërt, dyshifror, njëshe, dhjetëshe	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> Lexon numrat deri në 40 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; Shkruan numrat deri në 40; Dallon dhjetëshet dhe njëshet e numrave dyshifrorë deri në 40.	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Lexo numrat deri në 40; Plotëso tabelën me numra deri në 40; Përcakto dhjetëshet dhe njëshet te numrat dyshifrorë.
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2A, fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, kopsa (pulla), gota plastike, lapsi, ngjyrat, goma.	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe puna	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke rikujtuar me nxënësit dhjetëshet dhe njëshet. Më tutje, mësimdhënësi/ja ndan nxënësit në grupe. Për secilin grup mësimdhënësi/ja ndan një grumbull kopsash (në vend të kopsave mund të përdoren edhe fasule, rruaza, guralecë etj.) dhe disa gota plastike. Mësimdhënësi/ja paraprakisht kujdeset që grumbulli i kopsave të mos tejkalojë numrin 40. Më pas udhëzohen nxënësit që përmes kopsave dhe gotave të plastikës të formojnë dhjetëshe dhe të shohin sa kopsa do ju teprojnë. Pra, nxënësit do të vendosin nga 10 kopsa në gotën e plastikës në mënyrë që të formojnë dhjetëshe. Kështu, në fund të aktivitetit, nxënësit do të numërojnë sa dhjetëshe kanë formuar dhe sa njëshe u kanë tepruar. Në këtë rast nxënësit do të zbulojnë se cilin numër kanë formuar. Grupet prezantojnë punën e tyre. Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në libër, faqe 55. Në detyrën 1, nxënësit do të plotësojnë numrat që mungojnë në tabelën me numra deri në 40. Po ashtu diskutohen rregullat që mund të vërehen për numrat që qëndrojnë në të njëjtin rresht apo në të njëjtën shtyllë. Duke lëvizur në rresht në të djathtë numrat rriten me nga 1. Duke lëvizur në rresht në të majtë numrat	



zvogëlohen me nga 1. Duke lëvizur në shtyllë poshtë, numrat rriten me nga 10. Duke lëvizur në shtyllë lart numrat zvogëlohen me nga 10. Më pas, nxënësit plotësojnë kërkesat e parashtruara në detyrat 2 dhe 3 të po të njëjtës faqe. Rezultatet diskutohen në nivel klase.

Hapi III – Punë me libër

Për aq kohë sa ka mbetur, nxënësit vazhdojnë punën e pavarur në faqe 56.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë e punës nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke vëzhguar nëse nxënësi numëron në rendin rritës dhe rendin zbritës me numra deri në 40, nëse lexon saktë numrat deri në 40 dhe nëse arrin të zbatojë rregullat në tabelën me numra deri në 40.

TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Numrat deri në 50	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike. 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune.	
FJALËT KYÇE: Numër, paraardhës, pasardhës, njëshe, dhjetëshe.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri.	
REZULTATET E ORËS: Lexon dhe shkruan numrat deri në 50 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 50 (me njëshe dhe dhjetëshe) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri; Dallon dhjetëshet dhe njëshet e numrave dyshifrorë deri në 50.	KRITERET E SUKSESIT: Lexo numrat në rendin rritës (1-50) dhe rendin zbritës (50-1); Trego rregullën e renditjes së numrave në tabelën me numra nga 1-50; Përcakto dhjetëshet dhe njëshet te numrat dyshifrorë.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A dhe fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese, fletë hamer ose projektori, lapsi, ngjyrat, goma	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Diskutim Si zakonisht, puna në njësinë aktuale fillon me një aktivitet në klasë. Paraqesim në një fletë hameri ose projektor tabelën me numrat nga 1-50. Lexohen numrat në rendin rritës dhe zbritës. Fillojnë eksplorimet dhe diskutimet për rregullat që mund të zbulohen në tabelë. Diskutohen disa shembuj nga tabela, duke kërkuar që nxënësit të flasin për relacionin ndërmjet numrit të dhënë dhe numrit në të majtë të tij, në të djathtë të tij, lart tij, poshtë tij. Me këtë rast përsëriten edhe konceptet e paraardhësit dhe pasardhësit. Veçohen numrat që i takojnë dhjetëshes së parë, dytë, tretë, katërt dhe të pestë Hapi II – Punë me libër	

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50

Puna individuale e nxënësve vazhdon në libër faqe 57.

Hapi III – Punë në çifte

Puna e nxënësve vazhdon në çifte. . Secili nxënës shkruan një numër deri në 50. Shkëmbehen fletoret ndërmjet nxënësve që ulen në të njëjtën bankë dhe nga shoqja/shoku i bankës kërkohet të tregojë se cilës dhjetëshe i takon numri i shkruar, si dhe ta paraqesë atë në sa më shumë forma që mundet (në forma të ndryshme vizuale, me blloqe, me pulla si dhe me fjalë). Kontrollimi i detyrave bëhet në çift duke verifikuar saktësinë e detyrës së punuar.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke vëzhguar nëse nxënësi numëron deri në 50 në rendin rritës dhe atë zbritës, nëse lexon saktë numrat deri në 50 dhe nëse arrin të shkruajë saktë numrat deri në 50.

TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Numrat deri në 100	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike. 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune.	
FJALËT KYÇE: Numër, numërim, njëshe, dhjetëshe	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri.	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> Lexon dhe shkruan numrat deri në 100; Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100; Përcakton dhjetëshet dhe njëshet e numrave deri në 100.	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Lexo numrat 1-100 Numëro 1 – 100 në rendin rritës dhe rendin zbritës; Numëro 1 – 100 dhe anasjelltas me nga 5; Përcakto dhjetëshet dhe njëshet te numrat dyshifrorë.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A shporta, fletëzat me numra, projektori, lapsi, ngjyrat,	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe puna	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I – “Bingo” me numra Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke vendosur para nxënësve një enë qelqi në të cilën ndodhën fletëza të palosura të ngjyrave të ndryshme. Brenda fletëzave ndodhen numrat nga 1 – 100, domethënë secila fletëz ka një numër i cili është i ndryshëm nga numrat e fletëzave tjera. Nxënësit me radhë do të përzgjedhin nga një fletëz nga ena e qelqit dhe pasi ta shpalosin atë, do ta lexojnë numrin që është i shkruar në të dhe të tregojnë sa dhjetëshe dhe sa njëshe ka ai numër. Hapi II – Punë me libër Pas prezantimeve dhe diskutimeve në nivel klase, puna vazhdon në mënyrë individuale, në faqet 58 dhe 59 të librit. Plotësohet dhe eksplorohet tabela në mënyrë individuale dhe diskutohen në nivel klase të gjitha rregullat e gjetura nga nxënësit. Po ashtu, nxënësit përgjigjen në pyetjet e parashtruara në tekst në lidhje me pozitat e numrave në tabelë. Gjithashtu, edhe ngjyrosin sipas udhëzimeve të dhëna në detyrën 2 në faqen 59. Hapi III – Video	



Mësimdhënësi/ja paraqet para nxënësve një video nga Youtube, në lidhje me numrat deri në 100 dhe shkrimin e tyre. Linku për video është: <https://www.youtube.com/watch?v=8V7p7vQpbo>

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë e punës nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke vëzhguar gjetjen e numrave në tabelë, gjetjen dhe arsyetimin e përgjigjeve të parashtruara si në lidhje me tabelën ashtu edhe me kërkesat pasuese në libër, si dhe zbulimin dhe shkrimin e saktë të numrave dyshifrorë nga paraqitjet vizuale.

TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Njëshet dhe dhjetëshet	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave , ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 2.3 Dallon dhe klasifikon ligjësi për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.4 Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t’u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Numër, paraardhës, pasardhës, njëshe, dhjetëshe	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> Lexon dhe shkruan numrat deri në 100; Përcakton dhjetëshet dhe njëshet e numrave dyshifrorë; Ndërton numra dyshifrorë me mjete të ndryshme.	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Lexo numrat nga 1-100 në rendin rritës dhe rendin zbritës; Përcakto dhjetëshet dhe njëshet te numrat dyshifrorë; Përdor mjete sipas dëshirës për të formuar numra dyshifrorë.
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2A, lapsi, ngjyrat, kubëzat, shufrat, tabela me numrat 1-100	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I – Aktivitet konkret Ora fillon me një aktivitet konkret të ndërtimit të numrave 1-100 me anë të manipulativëve siç janë shkopinjte, shufrat, kubëzat, fasulet dhe pullat (zhetonat) të cilat nxënësit kanë sjellë me vete sipas porosisë së mësimdhënësit/es nga ora e kaluar. Nxënësit punojnë në dyshe brenda bankave për të ndërtuar numra të ndryshëm nga materialet e sjellura. Nxënësit udhëzohen që secili numër i ndërtuar të përcjellët edhe me paraqitje tjera të të njëjtit numër, si p.sh. me fjalë, me shifra, etj. Pra, numrat paraqiten në të gjitha mënyrat që nxënësit dinë. Nxënësit punojnë ashtu që njëri prej tyre e ndërton numrin, tjetri e gjen cili numër është ndërtuar dhe e paraqet atë pastaj në sa mënyra di. Dyshet pastaj shkëmbejnë punën në mes vete, d.m.th, i dyti e ndërton numrin, ndërsa i pari e paraqet atë në mënyra të ndryshme. Pasi	

secila dyshe të ketë ndërtuar dhe paraqitur nga dy numra, paraqitjet e disa prej numrave prezantohen dhe diskutohen në nivel klase.

**Hapi II – Punë me libër**

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në mënyrë individuale në faqen 60 në libër, ku do të zbulojnë numrat përmes paraqitjeve me pulla (zhetona) dhe më pas do të shkruajnë më fjalë secilin numër.

**Hapi III – Punë me libër**

Puna e nxënësve vazhdon në mënyrë të pavarur, në faqen 61 të librit. Në këto detyra, nxënësit do të zbulojnë numrat duke numëruar shigjetat që kanë qëlluar në dhjetëshe dhe shigjetat që kanë qëlluar në njëshe. Më pas, mësimdhënësi/ja bashkë me nxënësit diskutojnë zgjidhjet e detyrave në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Nxënësit paraqitin me ilustrime, me blloqe ose me pulla (zhetonë) numrat 48, 51, 73 dhe shkruajnë me fjalë secilin numër.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke vëzhguar gjetjen e numrave dhe rregullave në tabelë, gjetjen dhe arsyetimin e përgjigjeve në faqen pasuese si dhe zbulimin dhe shkrimin e saktë të numrave dyshifrorë nga paraqitjet vizuale.


TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Numërimi	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.1 - Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave , ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 2.3 Dallon dhe klasifikon ligjësi për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;	
FJALËT KYÇË: Numër, numërim, para, praptazi	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe) si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri.	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> Numëron deri në 100 në rendin rritës dhe zbritës; Zbulon numrat që mungojnë në vargje të ndryshme	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Numëro nga 0-100 dhe nga 100-0 Plotëso vargjet duke shkruar numrat që mungojnë.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletët A4 me boshte numerike, lapsi, goma, ngjyrat, fletë të bardha A4	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I – Aktivitet konkret Kjo njësi fillon me realizimin e aktiviteteve me ndihmën e boshtit numerik në dyshe. Përgatiten disa boshte. Boshtet mund të përgatiten nga fletët A4 ose nga materiale tjera dhe përmbajnë vargje numerike me gjatësi të ndryshme, të ndërtuara prej numrave 1 – 100 . Për shembull një bosht mund të përmbajë numrat 30 – 50, ose 67 – 82 etj. Pasi të zhvillohen disa aktivitete të tilla, nxënësit fillojnë vetë të ndërtojnë vargje të ndryshme në fleta A4 dhe të demonstrojnë numërimin para-prapa në to. Hapi II – Punë me libër Puna më tej mund të vazhdojë në libër, faqe 62. Në detyrën 1 nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë numrat nëpër vargjet e dhëna numerike. Fillimisht duhet të zbulojnë nëse vargu është rritës apo zbritës e pastaj të plotësojnë numrat që mungojnë. Në detyrën 2 nxënësit duhet të numërojnë me nga 5 dhe të shkruajnë numrat. Njëjtë vazhdohet edhe me detyrën 3, ku numërimi dhe shkrimi i numrave vazhdohet me nga 3. Hapi III – Punë në çifte Mësimdhënësi/ja ndan për secilin nxënësi nga një fletë të bardhë të formatit A4. Secili nxënësi do të formojë sipas dëshirës një varg numerik të numrave me radhë (p.sh. 26 – 34),	

mirëpo në varg duhet vendosur vetëm disa prej numrave dhe më pas do t`i jap fletën shoqes/shokut të bankës që të zbulojë rregullën dhe të plotësojë numrat që mungojnë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Për detyrë shtëpie mund të shfrytëzohen detyrat nga faqja 63.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke observuar punën e nxënësve në formimin e vargjeve dhe në numërimin para – prapa.

TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Krahasimi i numrave	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.</p>	
FJALËT KYÇE: Numër, numërim, krahasim, shenja, paraardhësi, pasardhësi.	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <p>Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.</p>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <p>Krahason numrat deri në 100;</p> <p>Zbulon numrat sipas përshkrimeve të dhëna.</p> <p>Përdorë shenjat <math>&gt; = &lt;</math> për të krahasuar numrat.</p> <p>Radhitë numrat prej më të voglit deri te më i madhi dhe anasjelltas.</p>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <p>Krahaso numrat deri në 100.</p> <p>Zbulo numrat duke u bazuar në përshkrim.</p> <p>Përdor shenjat <math>&gt; = &lt;</math> për të krahasuar numrat.</p> <p>Radhit numrat prej më të voglit deri te më i madhi dhe anasjelltas.</p>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, kartat, lapsi, goma, fletorja	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Lojë me karta</p> <p>Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore me një aktivitet që do të realizohet përmes kartave. Paraprakisht mësimdhënësi/ja është përkujdesur që nga grumbulli i kartave të largojë kartat J, Q, K dhe Joker.</p> <p>Secili nxënës do të përzgjedhë nga 2 karta nga grumbulli dhe do të formojë një numër me to. Në këtë rast, nxënësit do të kenë nga dy mundësi për të krijuar numrin, p..sh. nëse ka qëlluar kartat 9 dhe 2, atëherë nxënësi/ja mund të formojë numrin 92 ose numrin 29. Kjo mbetet në dëshirën e nxënësve. Më pas, secili nxënës do të ndajë numrin e tij me shokun/shoqen e bankës dhe së bashku do të gjejnë se cili ka numrin më të madh e cili numrin më të vogël. Çiftet e nxënësve prezantojnë punën e tyre.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit punojnë individualisht në faqen 64. Në detyrën 1, nxënësit do të krahasojnë numrat duke vendosur njërën nga shenjat <math>&gt;</math>, <math>=</math> apo <math>&lt;</math> në secilin nga rrathët e zbrazët. Në detyrën 2 do të plotësojnë shifrën e njësheve apo dhjetësheve në mënyrë që krahasimi të vlejë. Në detyrën 3 dhe 4 ndërtojnë numra dyshifrorë me shifrat e dhëna dhe i radhitin ata nga më i vogli deri te më i</p>	



madhi dhe anasjelltas. Në faqen 65 në detyrën 1 duke u bazuar në kërkesën e dhënë në libër gjejnë dhe shkruajnë numrat e duhur. Në detyrën 2, duke analizuar fjalët e monstrave, nxënësit do të zbulojnë se për cilët numra bëhet fjalë.

**Hapi III – Shkrim i lirë**

Nxënësit vazhdojnë punën në fletoret e tyre të matematikës. Mësimdhënësi/ja udhëzon ata që të krijojnë sipas dëshirës nga një detyrë të ngjashme me shembujt e fundit të punuar në libër. Nxënësit lexojnë krijimet e tyre. Diskutohet puna e bërë në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë e punës nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke observuar punën e nxënësve në krahasimin e numrave deri në 100.

TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Numrat çift dhe tek	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p> <p>VI.6 - Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;</p> <p>3.2 - Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor;</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fllëstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;</p>	
FJALËT KYÇE: Numër, njëshe, çift, tek	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <p>Zbaton rregulla për të identifikuar numrat çift dhe tek.</p>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <p>Dallon numrat çift;</p> <p>Identifikon numrat tek;</p> <p>Formon numra çift dhe tek.</p>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <p>Gjej numrat çift;</p> <p>Identifiko numrat tek;</p> <p>Plotëso shifrën e njësheve për të formuar numra çift apo tek.</p>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletorja, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi.	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Gjurmimi në klasë</p> <p>Pas një rikujtimi të shkurtë të koncepteve çift-tek, që nxënësit i kanë mësuar në klasën e parë, fillon një aktivitet real në klasë. Secili nga nxënësit duhet të marrë një fletore, një laps dhe të gjurmtojë nëpër klasë objekte që karakterizohen me numër çift apo me numër tek. Psh. në klasë është vetëm një mësimdhënës/e, por mund të jenë 26 nxënës. Po aq sa nxënës, ka edhe çanta. Poashtu, nxënësit mbajnë shënime për numrin e dritareve, bankave, karrigeve etj dhe afër numrit për secilin objekt shënojnë nëse ai numër është çift apo tek.</p> <p>Hapi II – Aktivitet në grupe</p> <p>Puna vazhdon në grupe. Nxënësit udhëzohen që të formojnë nga një numër tek dhe nga një numër çift, prej 1 – 100, me anë të shufrave dhe kubeve të vizatuara. Grupet ekspozojnë dhe arsyetojnë punën e bërë.</p> <p>Hapi III – Punë me libër</p> <p>Puna individuale e nxënësve vazhdon në libër bazë, faqe 66, me aktivitet të anasjelltë. Tani numri është i dhënë ma anë të paraqitjes vizuale, ndërsa nxënësit duhet ta dallojnë se a është numri i dhënë çift apo tek. Natyrisht, nxënësit arsyetojnë në nivel klase përzgjedhjet e bëra dhe tregojnë mënyrën se si kanë ardhur deri në përfundim nëse numri është çift apo tek.</p>	



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë e punës nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke observuar aftësinë e nxënësve për të dalluar dhe për të ndërtuar numrat çift dhe numrat tek. Mësuesja vlerëson duke plotësuar listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.


TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Numrat rendorë	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Numër, numra rendorë, rreshtim, renditje	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> Përcakton radhën (numri rendor)	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> Përcakton radhën duke përdorur shprehjet i pari, i dyti etj; Përdor numrat rendorë për të treguar renditjen; Ngjyrosë rrathët duke përdorur ngjyrat përkatëse sipas udhëzimeve për numrat rendorë.	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Përcakto radhën duke përdorur shprehjet i pari, i dyti etj; Përdor numrat rendorë për të treguar renditjen; Ngjyros rrathët duke përdorur ngjyrat përkatëse sipas udhëzimeve.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletorja, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna .	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I – Aktivitet konkret Ora fillon me aktivitete reale. Për këtë qëllim demonstrohen rreshtime të nxënësve të gjatësive të ndryshme, me ç'rast nxënësit shënojnë dhe lexojnë para klasës shënimet, ku tregohet cili nxënës është cili me radhë, herë nga para e herë nga prapa. Përveç renditjeve të nxënësve sipas gjatësisë së tyre, mësimdhënësi/ja mund të ndajë nga një numër për secilin nxënës dhe të kërkojë nga ta që të rreshtohen sipas radhës herë nga para e herë nga prapa.  Hapi II – Punë me libër Puna mund të vazhdojë në libër, faqe 67, ku nxënësit në mënyrë individuale duhet të gjejnë përgjigjen në probleme me fjalë në lidhje me radhitjet dhe numrat rendorë.  Hapi III – Shkrim i lirë	

Ora vazhdon duke iu ofruar nxënësve mundësinë për ndërtimin e problemeve autonome në lidhje me numrat rendorë. Nxënësit që arrijnë të përfundojnë detyrën brenda orës mësimore, mund të lexojnë problemet e tyre para klasës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Shkrim i lirë – nxënësit udhëzohen të formojnë detyra problemore për numrat rendorë.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke observuar dhe duke mbajtur shënime për aftësinë e nxënësve për të dalluar numrat rendorë deri në njëqind. Mësimdhënësi/ja vlerëson duke vëzhguar dhe duke plotësuar listë kontrolli.

TEMA: Numrat natyror (Numrat deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Rigrupimi i njësheve dhe dhjetësheve	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave , ngjyrave, formave, madhësive,vizatimeve dhe objekteve 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme	
FJALËT KYÇE: Grupim, dhjetëshe, njëshe	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> Zbulon numrat duke grupuar dhe rigrupuar dhjetëshet e njëshet. Përcakton vlerën e numrit sipas vendit që zë. Zgjidhë problema të thjeshta duke u bazuar në modele.	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Zbulon numrin duke grupuar dhe rigrupuar dhjetëshet e njëshet. Përcakton vend-vlerën e shifrave për numrat e dhënë. Zgjidh problema të thjeshta duke u bazuar në modele.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, shkopinj, llastik, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I – Aktivitet konkret Ora fillon me aktivitet konkret. Nxënësit punojnë në dyshe. Secilës dyshe i jepet nga një zarf me një numër të caktuar të shkopinjve. Preferohet që numri i shkopinjve të jetë i madh, pra të përzgjedhen numra afër 100 –shit. Me gjithë shkopinj, nxënësve iu ofrohen edhe goma elastike për të lidhur tufat e shkopinjve që do t'i ndërtojnë dhe po ashtu u jepet edhe nga një fletë A4, e formësuar si tabelë me dhjetëshe dhe me njëshe. Poshtë tabelës duhet të jetë edhe një vend për të shkruar numrin dyshifror që fitohet në fund të aktivitetit. Nxënësit punojnë në numërimin e shkopinjve, formimin e tufave me nga dhjetë shkopinj, shënojnë në tabelë numrin e dhjetësheve dhe njësheve të mbetura dhe përcaktojnë numrin e fituar. I gjithë aktiviteti dhe rezultatet diskutohen në nivel klase. Hapi II – Punë me libër	



Puna vazhdon në libër bazë faqe 68, ku diskutohen një nga një të gjitha rigrupimet e paraqitura në detyrën 1, 2 dhe 3. Përfundimi është se sipas nevojës, një dhjetëshe mund të rigrupohet si dhjetë njëshe, por mund të bëhet edhe e anasjellta, dhjetë njëshe të rigrupohen si një dhjetëshe. Ndërsa në detyrën 4 kërkohet të zbulohet numri duke rigrupuar njëshet në dhjetëshe.

Hapi III – Video

Mësimdhënësi/ja më anë të projektorit shfaqë para nxënësve një video ku tregohet rigrupimi i njësheve në dhjetëshe përmes shembujve të ndryshëm. Kështu nxënësit mund të përforcojnë edhe më tepër konceptin e rigrupimit.

Linku për video është: <https://www.youtube.com/watch?v=8IJhOXUoZk>

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Shkrim i lirë – nxënësit udhëzohen të formojnë detyra problemore lidhur me rigrupimet

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duhet vëzhguar nxënësit se si grupojnë shkopinjtë dhe si e kryejnë rigrupimin në detyrat e dhëna në libër.

<b>TEMA:</b> Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
<b>NJËSIA MËSIMORE:</b> Mbledhja e dhjetësheve të plota me mjete	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. IV. 5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 – Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete	
<b>FJALËT KYÇË:</b> Mbledhje, mbledhorë, numër, dhjetëshe, shumë, kubëza, shufra	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.	
<b>REZULTATET E ORËS</b> Modelon numrat me anë të kubëzave dhe shufrave. Gjen shumën përmes përdorimit të kubëzave dhe shufrave. Arsyeton mënyrën e mbledhjes së dy numrave.	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> Modelo numrat me anë të kubëzave dhe shufrave. Gjej shumën përmes përdorimit të kubëzave dhe shufrave. Arsyeto mënyrën e mbledhjes së dy numrave.
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2A, kubëza, pulla, kapakë, fleta, shkopinj, kube lego	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Artet.	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> Hapi I – Mbledhja me materiale të ndryshme Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke ndarë nxënësit në çifte. Secilit çift i shpërndanë materiale të ndryshme si kubëza, pulla, kapakë, shkopinj, fleta të prera në formë katrore dhe në formë shufrash. Pastaj secilit çift i jep nga një numër të shkruar në një fletë - një dhjetëshe të plotë. Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit për mënyrën e punës. Çdo çift ka për detyrë të paraqet numrin e dhënë me mjetet që posedon. Secili nxënës prezanton punën e tij. Hapi II – Gjejmë shumën Mësimdhënësi/ja kërkon që dy nga dy çifte të mbledhin numrat e formuar në mes vete. Tani prezantohet shuma e formuar nga mbledhja e numrave në mes çiftesh. Hapi III – Punë me libër Nxënësit hapin librin në faqen 70. Së pari diskutohet ilustrimi në faqen 70, e pastaj vazhdon puna në faqen 71, ku nxënësit duhet të plotësojnë detyrën 1 dhe 2 bazuar në ilustrimin e faqes paraprake. Në detyrën 3 plotësojnë pjesët që mungojnë për të ndërtuar barazime të sakta në	

lidhje me mbledhjen e dhjetësheve të plota. Në detyrën 4 nxënësi ndërton barazi në bazë të ilustrimit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke vëzhguar nëse zgjidhin saktë detyrat duke u bazuar në shkathtësinë e aplikimit të mjeteve konkretizuese.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100 )	
NJËSIA MËSIMORE: Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. IV. 5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme .6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete	
FJALËT KYÇË: Mbledhje, numër, mbledhor, ndërrim vendi, shumë	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Përdorë vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave.	
REZULTATET E ORËS Demonstron vetinë komutative duke përdorur materiale të ndryshme në zgjidhjen e detyrave. Gjen shumën e numrave në detyra të ndryshme me numra dyshifrorë. Arsyeton mënyrën e mbledhjes së dy numrave duke përdorur vetinë komutative.	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro me shembuj vetinë komutative duke përdorur materiale të ndryshme në zgjidhjen e detyrave. Gjej shumën e numrave në detyra të ndryshme me numra dyshifrorë. Arsyeto mënyrën e mbledhjes së dy numrave duke përdorur vetinë komutative.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, gota plastike, fasule, misër, makarona etj., fletore, laps, gomë	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Shkathësi për jetë, Artet	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke ndarë nxënësve nga një gotë plastike. Në secilën gotë kujdeset që të vendosë fasule (misër, makarona etj.) që përfaqësojnë dhjetëshe të plota (gotat përgatiten më herët). Secilit nxënës i kërkohet që të numërojë numrin e fasuleve. Pastaj secilit çift i drejtohet pyetja: ‘‘Sa është numri i fasuleve i juve të dyve bashkë?’’. Më pas nxënësve u kërkohet të ndërrojnë gotat mes vete. Përsëriten kërkesat dhe pyetja se sa fasule kanë tani dytë bashkë? Diskutohet fakti se asgjë nuk ka ndërruar me ndërrimin e gotave sa i përket shumës. Pra, pavarësisht ndërrimit të vendeve të mbledhorëve shuma nuk ndryshon. Hapi II – Punë me libër Nxënësit hapin librin, faqe 72. Në detyrën 1 dhe 2 nxënësit bazuar në ilustrim njehsojnë shumën duke zbatuar vetinë e ndërrimit të mbledhorëve. Në detyrën 3 plotësojnë pjesët që mungojnë për të ndërtuar barazime të sakta. Në detyrën 4 nxënësit lidhin me shigjetë copëzat që kanë vlerë të njëjtë.	




Hapi III – Punë në çifte

Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit ndërtojnë nga një detyrë me mbledhje të dhjetësheve të plota e pastaj shkëmbejnë fletoret në çifte dhe secili zbaton vetinë e ndërrimit të vendeve të mbledhorëve, duke gjetur shumën ehe në rastin e parë edhe në të dytin.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë e punës nga faqja e internetit e shtëpisë botuese ose material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke vëzhguar nëse zgjidhin saktë detyrat duke u bazuar në shkathësinë për të aplikuar vetinë e ndërrimit të vendeve të mbledhorëve si dhe përdorimin e mjeteve konkretizuese.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Mbledhja e dhjetësheve të plota në mënyra të ndryshme	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes IV. 5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash	
FJALËT KYÇE: Mbledhje, numër, mbledhor, shumë, tabelë, bosht numerik, shtyllë.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100. Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.	
REZULTATET E ORËS Demonstron shembuj të njehsimit të mbledhjes së numrave me bosht numerik, tabelë dhe në shtyllë. Gjen shumën e dhjetësheve të plota deri në 100. Argumenton mënyrën e mbledhjes së dy numrave në mënyra të ndryshme.	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro shembuj të njehsimit të mbledhjes së numrave me bosht numerik, tabelë dhe në shtyllë. Gjej shumën e dhjetësheve të plota deri në 100. Argumento mënyrën e mbledhjes së dy numrave në mënyra të ndryshme.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, shkumës, fletë hamer ose projektor, fletore, laps, gomë	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti, Artet	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke vizatuar me shkumës një bosht numerik në dyshe. Ambienti më i përshtatshëm për këtë është oborri i shkollës. Boshtin numerik e ndanë me ndarje të barabarta nga 10: 0, 10, 20, 30, 40, 50, deri në 100. Më pas secilit nxënës i jepet një numër i shkruar në letër që është dhjetëshe e plotë. P.sh: nxënësi që ka numri 20, i kërkohet të pozicionohet te numri 20 në boshtin numerik. Mësimdhënësi/ja thotë më pastaj një numër tjetër, p.sh 30. Nxënësi që është te numri 20 duhet të kërcej me dy këmbët tri herë deri se të arrijë te shuma që formohet nga numrat 20 dhe 30.	
	
Aktiviteti vazhdohet edhe me nxënësit e tjerë varësisht nga numri që posedojnë. Kështu, nxënësit numërojnë kërcimet dhe zbulojnë cilët mbledhorë po e formojnë cilën shumë.	
Hapi II – Punë me libër Nxënësit hapin librin, faqe 73. Në faqen 73 nxënësit në detyrën 1 duhet të plotësojnë numrin që mungon në bosht dhe të njehsojnë shumën e numrave dyshifrorë.	

Për detyrën e dytë kërkohet shqyrtim i përbashkët me mësimdhënësin/sen. Mësimdhënësi/ja paraqet një tabelë me numra deri në 100 (me projektor apo me hamer) dhe bashkë me nxënësit fillohet shqyrtimi i përbashkët.

Tani, nxënësit mësojnë si ta përdorin tabelën me 100 numra për të mbledhur dhjetëshe të plota. Bashkë me tabelën, duhet të punohen edhe unazat e gjelbra, të kuqe të cilat do tu shërbejnë nxënësve gjatë punës. Unazat e gjelbra shërbejnë për të shenjuar mbledhorin nga i cili fillohet mbledhja. Unazat e kuqe shërbejnë për të shenjuar sa dhjetëshe duhet shtuar. Mënyra e mbledhjes në tabelë është shumë e thjeshtë.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

Nxënësit vendosin unazën e gjelbër (me ngjitës) tek mbledhori ku fillon puna, e pastaj shkojnë vertikalisht poshtë tabelës për aq numra sa ka dhjetëshe mbledhori i dytë. Shtimi i çdo dhjetësheje bëhet duke rrethuar numrin e radhës me unazë të kuqe.

Në detyrën 3 njehsohet mbledhja e numrave në shtyllë.

Hapi III – Punë në çifte

Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit krijojnë detyra me mbledhje të numrave. Pastaj shkëmbehen fletoret dhe shoku/shoqja e bankës paraqet detyrat me bosht, me tabelë apo në shtyllë. Më tej, nxënësit kontrollojnë dhe diskutojnë së bashku, në çifte, detyrat e zgjidhura.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke vëzhguar nëse zgjidhin saktë detyrat duke u bazuar në shkathtësinë për të aplikuar mënyrat e ndryshme të mbledhjes.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Zbritja e dhjetësheve të plota me mjete	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 -Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. IV. 5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 – Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete	
FJALËT KYÇE: Zbritje, i zbritshmi, zbritësi, dhjetëshe, ndryshim, kubëza, shufra	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.	
REZULTATET E ORËS Modelon numrat me anë të kubëzave dhe shufrave. Gjen ndryshimin duke përdorur kubëza dhe shufra. Arsyeton mënyrën e zbritjes së dy numrave duke përdorur mjetet.	KRITERET E SUKSESIT: Modelo numrat me anë të kubëzave dhe shufrave. Gjej ndryshimin duke përdorur kubëza dhe shufra. Arsyeto mënyrën e zbritjes së dy numrave duke përdorur mjetet.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, kubëza, pulla (zhetona), shkopinj, fletore, laps, gomë.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Stuhi mendimesh Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të tregojnë se çfarë kanë mësuar deri tani për veprimin e zbritjes. Ora mësimore fillon me pyetje të përgatitura nga mësimdhënësi/ja, përmes së cilave bëhet një përsëritje e njohurive të marra për zbritjen e numrave. Me anë të teknikës Stuhi mendimesh, mësimdhënësi/ja përmbledh mendimet e nxënësve në tabelë, ndërsa nxënësit punojnë në fletoren e tyre. Hapi II – Punë me libër Nxënësit fillojnë punën individuale në libër, në faqe 74. Po ashtu përdorin kubëzat, pullat, apo shkopinjtë për të zgjidhur detyrat, ku të gjitha detyrat e dhëna kanë të bëjnë me paraqitje të zbritjes së dhjetësheve të plota. Nxënësit analizojnë paraqitjet e dhëna dhe plotësojnë kërkesat e shprehura në detyra. Te detyra 1, nxënësit do ta gjejnë ndryshimin bazuar në ilustrim. Në detyrën 2, kërkohet nga nxënësit që të plotësojnë atë që mungon ku në njërin detyrë duhet të vijëzohet	

shufrat që përfaqëson zbritësi dhe të shkruajnë ndryshimin, ndërsa në detyrën tjetër të vizatojnë shufrat që përfaqëson i zbritshmi dhe të vijëzojnë aq sa është zbritësi, e pastaj të plotësojnë ndryshimin. Në detyrën 3, nxënësit do të gjejnë numrat që përfaqësojnë të zbritshmin, zbritësin duke u bazuar në ilustrimet e dhëna dhe të njehsojnë ndryshimin. Në detyrën 4, nxënësit do të shkruajnë barazimin e zbritjes sipas ilustrimit. Me përfundim të punës, diskutohen në nivel klase rezultatet e fituara nga ana e nxënësve.


Hapi III – Krijim i lirë me mjete

Pasi të ketë përfunduar puna me libër, nxënësit do të vazhdojnë punën në bashkëpunim me shoqen/shokun që kanë afër për të ndërtuar barazime në lidhje me zbritjen e dhjetësheve të plota duke përdorur mjetet. Nxënësit mund të mbajnë shënim në fletore për barazimet që kanë nxjerrë nga detyrat e zhvilluara në çift.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke vëzhguar nëse zgjidhin saktë detyrat duke u bazuar në shkathësinë për të aplikuar mënyrat e ndryshme të zbritjes së dhjetësheve të plota duke përdorur mjetet.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Zbritja e dhjetësheve të plota në bosht dhe në tabelë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes IV. 5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash	
FJALËT KYÇE: Zbritje, i zbritshmi, zbritësi, ndryshim, dhjetëshe e plotë, tabelë, bosht numerik.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100. Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.	
REZULTATET E ORËS Demonstron shembuj të njehsimit të zbritjes së numrave me bosht numerik dhe tabelë. Gjen ndryshimin e numrave në detyra të ndryshme me numra dyshifrorë deri në 100. Argumenton mënyrën e zbritjes së dy numrave duke përdorur mënyra të ndryshme.	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro shembuj të njehsimit të zbritjes së numrave me bosht numerik dhe tabelë. Gjej ndryshimin e numrave në detyra të ndryshme me numra dyshifrorë deri në 100. Argumento mënyrën e zbritjes së dy numrave duke përdorur mënyra të ndryshme.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, shkumës, hamer ose projektor, fletore, laps, gomë	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti, Artet	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke vizatuar me shkumës një bosht numerik në dyshe. Ambient më i përshtatshëm për këtë është oborri i shkollës. Më pas secilit nxënës i jepet një numër, një dhjetëshe e plotë, e shkruar në letër. P.sh. nxënësi që ka numrin 60, i kërkohet të pozicionohet te numri 60 në boshtin numerik. Mësimdhënësi/ja tani thotë një numër tjetër, p.sh numrin 30. Nxënësi duhet të kërcej me dy këmbët nga e majta e numrit 60, tri herë që do të thotë duhet të zbresë për 3 dhjetëshe: duke thënë në kërcimin e parë 60 minus 10 bëjnë 50, në kërcimin e dytë minus 10 bëjnë 40, në kërcimin e fundit minus 10 bëjnë 30. Pra ndryshimi është 30. Aktiviteti vazhdohet edhe me nxënësit e tjerë. Hapi II – Punë me libër	



Nxënësit hapin librin, faqe 75. Në faqen 75 nxënësit në detyrën 1 duhet të njehsojnë ndryshimin duke u bazuar në bosht numerik. Detyra e dytë, ngjashëm me aktivitetin hyrës, kërkon gjetjen e ndryshimit duke paraqitur zbritjen me anë të boshtit. Për detyrën e tretë kërkohet shqyrtim i përbashkët me mësimdhënësin/sen. Mësimdhënësi/ja paraqet një tabelë me numra deri në 100 (me projektorë apo me hamer) dhe bashkë me nxënësit fillohet shqyrtimi i përbashkët.

Tani, nxënësit do të zbulojnë si ta përdorin tabelën me 100 numra për të zbritur dhjetëshet e plota. Bashkë me tabelën duhet të punohen edhe unazat e gjelbra dhe të kuqe, të cilat do tu shërbejnë nxënësve gjatë punës. Unazat e gjelbra shërbejnë për të shenjuar të zbritshmin nga i cili fillohet zbritja. Unazat e kuqe shërbejnë për të shenjuar sa dhjetëshe duhet hequr. Mënyra e zbritjes në tabelë është shumë e thjeshtë.

P.sh  $60-20=$  \_\_\_\_

Nxënësit vendosin unazën e gjelbër (me ngjitës) tek i zbritshmi, në këtë rast numri 60, dhe pastaj shkojnë vertikalisht lart për aq sa ka dhjetëshe zbritësi, në këtë rast 20. Lëvizja lart bëhet duke shenjuar numrat me unaza të kuqe. Pra unaza e fundit e kuqe e vendosur tregon ndryshimin, që në këtë rast është numri 40,  $60 - 20 = 40$ .

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

Në të njëjtën mënyrë zgjidhen detyrat edhe në detyrën 4.

Hapi III – Punë në çifte

Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit shkëmbejnë fletoret në çifte dhe krijojnë detyra me zbritje të numrave. Më pas marrin detyrat e përgatitura dhe fillojnë të zgjidhin ato në mënyrë të pavarur, duke përdorur mënyra të ndryshme.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke vëzhguar nëse zgjidhin saktë detyrat duke u bazuar në shkathësinë për të aplikuar mënyrat e ndryshme të zbritjes.





TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100 )	
NJËSIA MËSIMORE: Mbledhja me mjete	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.1-Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numërotoren, etj. për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes IV. 5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash	
FJALËT KYÇE: Mbledhje, mbledhor, shumë, mjete	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100. Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.	
REZULTATET E ORËS Demonstron shembuj të njehsimit të mbledhjes me mjete. Gjejnë shumën e numrave në detyra të ndryshme me numra dyshifrorë deri në 100. Argumenton mënyrën e mbledhjes së dy numrave.	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro shembuj të njehsimit të mbledhjes me mjete. Gjej shumën e numrave në detyra të ndryshme me numra dyshifrorë deri në 100. Argumento mënyrën e mbledhjes së dy numrave.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fleta, fletore, laps, gomë	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja ju kërkon nxënësve që para vetes të vendosin mjetet konkretizuese që mund të jenë kubëza, pulla apo shkopinjtë. Fillimisht kërkon nga nxënësit të formojnë me mjete konkretizuese numrin 13 (një dhjetëshe dhe tri njëshe) dhe pasi të kenë formuar kërkohet që këtij numri ti shtohet numri 4 (katër njëshe). Më pas pyet: Sa dhjetëshe dhe sa njëshe ka shuma? Pra, shuma e fituar është 17. Shuma shprehet edhe me anë të barazimit $13 + 4 = 17$ . Mësimdhënësi/ja paraqet edhe disa shembuj të tjerë. Nxënësit me anë të mjeteve kryejnë veprimet e mbledhjes së numrave. Hapi II – Punë me libër Nxënësit hapin librin, faqe 77. Sipas kërkesave të detyrave që përmban kjo faqe nxënësit duhet të bëjnë mbledhjen e dy numrave duke bërë ndërlidhjen në mes të paraqitjes vizuale të mbledhjes dhe asaj simbolike. Pra, kur kanë paraqitjen vizuale të mbledhjes duhet atë ta kthejnë në simbolike dhe anasjelltas. Hapi III – Punë e pavarur në fletore Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit në mënyrë të pavarur duke përdorur mjetet apo vizatimet apo vetëm paraqitjet simbolike (pra ashtu si u konvenon atyre më shumë) zgjidhin detyrat e dhëna nga mësimdhënësi/sja.	

$35 + 4 =$	$21 + 30 =$	$26 + 8 =$	$32 + 14 =$
------------	-------------	------------	-------------

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

VLERËSIMI: Nxënësit vlerësohen ma ndihmë të vëzhgimit dhe plotësimit të listës së kontrollit. Fokusi i vlerësimit është aftësia për mbledhjen e saktë të numrave dyshifrorë duke përdorur mënyra të ndryshme të mbledhjes.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Mbledhja në bosht	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>III.1-Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj. për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes</p> <p>V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).</p>	
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë.</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.</p> <p>6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>	
FJALËT KYÇE: Bosht numerik, hap, kërcim, dhjetëshe, njëshe.	
<p><b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b></p> <p>Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.</p>	
<p><b>REZULTATET E ORËS</b></p> <p>Përdorë boshtin numerik në detyrat e ndryshme.</p> <p>Kryen mbledhjen e numrave dyshifrorë me ndihmën e boshtit numerik.</p> <p>Argumenton mënyrën e mbledhjes së dy numrave duke përdorur boshtin numerik.</p>	<p><b>KRITERET E SUKSESIT:</b></p> <p>Përdor boshtin numerik për të zgjidhur detyrat.</p> <p>Kryej mbledhjen e numrave dyshifrorë me ndihmën e boshtit numerik.</p> <p>Argumento mënyrën e mbledhjes së dy numrave duke përdorur boshtin numerik.</p>
<p><b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b></p> <p>Libri Matematika 2A, boshti numerik në dysheme, fletore, laps, gomë</p>	
<p><b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Edukata fizike, Sportet dhe shëndeti, Artet.</p>	
<p><b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b></p> <p>Hapi I – Shqyrtim i përbashkët</p> <p>Mësimdhënësi/ja fillon orën e mësimit me aktivitete reale të ndërlidhura me përdorimin e boshtit numerik në dysheme. Mësimdhënësi/ja gjatë aktiviteteve përdor boshte të ndryshme numerike. Boshti i parë duhet të përmbajë numra pa kapërcime dhe hapi këtu e ka gjatësinë një. Nxënësit mbledhin numra duke përdorur hapat. P.sh. te mbledhja <math>11+3</math>, nxënësi së pari vendoset te numri 11 e pastaj bën tre hapa dhe shikon ku ka arritur.</p> <p>Mësimdhënësi/ja, më tej, diskuton ndërtimin e boshteve numerike me kërcime. P.sh. shënon në tabelë shembullin <math>24 + 30</math> dhe duke vizatuar boshtin e ri numerik, pyet nxënësit si mund ta gjejnë e ta paraqesin shumën në bosht numerik me sa më pak hapa dhe sa më shpejtë. Mësimdhënësi/ja sqaron më tej se në bosht numerik hapat mund të bëhen edhe me kapërcime dhe ta kenë gjatësinë më të madhe se një. Kështu, nxënësit duke vizatuar boshte numerike, dhe duke bërë hapa me gjatësi të ndryshme, vijnë edhe deri te zbulimi i hapave me gjatësi 10. E gjithë ideja e kësaj ore është që të zbulohet hapi me gjatësi dhjetë. Faktikisht, kombinimi i hapave dhjetëshe dhe hapave njëshe tek i njeiti bosht numerik është thelbi i strategjisë së mbledhjes me ndihmën e boshtit numerik, që është përdorur në tekste. Pasi që të jenë punuar</p>	

disa shembuj me gjetjen e shumës në bosht numerik, duke përdorur së pari hapat dhjetëshe (duke shtuar kështu të gjitha dhjetëshet që i ka numri i dytë) e pastaj hapat njëshe (për të shtuar kështu të gjitha njëshet që i ka numri i dytë), mund të kalohet me zbatimin individual të strategjisë së sapo-mësuar në tekstin bazë.

Hapi II – Punë me libër

Nxënësit hapin librin, faqe 78. Në detyrën 1 duhet të njehsojnë mbledhjen e numrit dyshifror me një numër njëshifror duke përdorur boshtin numerik. Në detyrën dy kërkohet të shkruhen në drejtkëndësh numrat e fituar nga kapërcimet e paraqitura në bosht dhe njehësimi i shumës kur mbledhori i dytë është numër dyshifror. Në detyrën 3 kërkohet të gjejnë shumën e numrave duke përdorur boshtin numerik.

Hapi III – Punë e pavarur në fletore

Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit në mënyrë të pavarur duke përdorur boshtin numerik zgjidhin detyrat e dhëna nga mësimdhënësi/sja.

$$15 + 3 = \quad 22 + 30 = \quad 36 + 13 = \quad 52 + 24 =$$

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen me ndihmën e vëzhgimit dhe listës së kontrollit. Fokus i vlerësimit është shkathtësia për të aplikuar boshtin numerik në zgjidhjen e detyrave me mbledhje.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)

NJËSIA MËSIMORE: Mbledhja në tabelë

KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:  
III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:

1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë.

3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.

3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.

FJALËT KYÇE: Tabelë, numër, mbledhje, unaza

REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:

Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.

REZULTATET E ORËS

Kryen mbledhjen e numrave dyshifrorë me ndihmën e tabelës.

Argumenton mënyrën e mbledhjes së dy numrave duke përdorur tabelën.

KRITERET E SUKSESIT:

Kryej mbledhjen e numrave dyshifrorë me ndihmën e tabelës.

Argumento mënyrën e mbledhjes së dy numrave duke përdorur tabelën.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri Matematika 2A, hamer, unaza, fletore, laps, gomë, fleta të printuara me tabelë

LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:

Hapi I – Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit janë të njoftuar me tabelat numerike, e veçanërisht me tabelën me 100 numra, ku kanë punuar një sërë aktivitetesh më herët. Tani, do të zbulojnë si ta përdorin tabelën me 100 numra për të mbledhur një numër dyshifror me një numër njëshifror ose me një numër dyshifror. Puna në tabelë mund të fillojë me një demonstrim në tabelë të punuar në një fletë hamer, të vendosur në tabelën e klasës. Bashkë me tabelën, duhet të punohen edhe unazat e gjelbra, të kuqe dhe të kaltra të cilat do tu shërbejnë nxënësve gjatë punës. Unazat e gjelbra shërbejnë për të shenjuar mbledhoren nga i cili fillohet mbledhja. Unazat e kuqe shërbejnë për të shenjuar sa dhjetëshe duhet shtuar, unazat e kaltra shërbejnë për të shenjuar sa njëshe duhet shtuar. Mënyra e mbledhjes në tabelë është shumë e thjeshtë.


P. sh :  $21 + 13 = 34$

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

Nxënësit vendosin unazën e heqje) tek mbledhori ku

vertikalisht poshtë për aq numra sa ka dhjetëshe mbledhori i dytë. Shtimi i çdo dhjetësheje bëhet duke përdorur unazat e kuqe. Pastaj shkohet horizontalisht nga e djathta për aq numra sa ka njëshe mbledhori i dytë. Shtimi i çdo njësheje bëhet duke përdorur unazë të kaltër.

Mësimdhënësi/ja, paraqet disa shembuj të mbledhjes në tabelë, shembuj të cilët i punon në



gjelbër (me ngjitës me mundësi fillon puna, e pastaj shkojnë

mënyrë të përbashkët me nxënësit. Detyrat duhet të jenë mbledhja e një numri dyshifrorë me njëshifror dhe një numër dyshifrorë me një numër dyshifrorë.

Hapi II – Punë me libër

Nxënësit hapin librin, faqe 79. Në detyrën 1 duhet të njehsojnë shumën e numrit dyshifror me një numër njëshifror duke përdorur tabelën. Në detyrën dy kërkohet njehsimi i shumës kur mbledhori i dytë është numër dyshifror. Ngjashëm, edhe detyrat 3 dhe 4 kërkojnë gjetjen e shumës me ndihmën e tabelës.

Hapi III – Punë e pavarur në fletore

Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit në mënyrë të pavarur duke përdorur tabelën zgjidhin detyrat e dhëna nga mësimdhënësi/ja. Mësimdhënësi/ja kujdeset që paraprakisht të përgatitë fleta me tabela të zbrazëta.

$$25 + 4 = \quad 21 + 40 = \quad 32 + 13 = \quad 51 + 34 =$$

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

VLERËSIMI: Nxënësit vlerësohen duke vëzhguar nëse zgjidhin saktë detyrat duke u bazuar në shkathtësinë për të aplikuar tabelën në zgjidhjen e detyrave të ndryshme me mbledhje.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Mënyra tjera të mbledhjes	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë. 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash. 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Dhjetëshe, njëshe, mbledhje, shtyllë, diagram	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.	
REZULTATET E ORËS: Përdorë mënyra të ndryshme për njehsimin e shumës. Kryen mbledhjen e numrave dyshifrorë në shtyllë dhe diagram. Argumenton mënyrën e mbledhjes së dy numrave përmes mbledhjes së dhjetësheve me dhjetëshe dhe njësheve me njëshe.	KRITERET E SUKSESIT: Përdor mënyra të ndryshme për njehsimin e shumës. Kryej mbledhjen e numrave dyshifrorë në shtyllë dhe diagram. Argumento mënyrën e mbledhjes së dy numrave përmes mbledhjes së dhjetësheve me dhjetëshe dhe njësheve me njëshe.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, hamer, diagram, fletore, laps, gomë.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Shqyrtim i përbashkët Nxënësit janë tashmë të njohur me mbledhjen e numrave në shtyllë. Tani, do të mësojnë ta përdorin diagramin për të mbledhur një numër dyshifror me një numër njëshifror ose me një numër dyshifror. Puna mund të fillojë me një demonstrim në tabelë të mbledhjes së numrave me ndihmën e diagramit. Nxënësit do të mësojnë përdorimin e një diagrami si mënyrë e mbledhjes ku dhjetëshet shënohen dhe mbledhen veç, e po ashtu edhe njëshet. Në fund të diagramit, njëshet i shtohen dhjetësheve dhe fitohet shuma. Pas disa shembujve të punuar bashkë me nxënësit vazhdohet puna e pavarur në libër. Hapi II – Punë me libër Nxënësit hapin librin, faqe 80. Detyrat 1 dhe 2 të paraqitura në këtë faqe kanë të bëjnë me mbledhjen në shtyllë, përderisa detyrat 3 dhe 4 kanë të bëjnë me mbledhje duke përdorur diagramin e sapo-mësuar. Hapi III – Punë në çifte Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit paraqesin barazime të mbledhjes me anë të simboleve dhe shkëmbejnë pastaj fletoren me shoqen/shokun e bankës. Secili nxënës punon në mënyrë të pavarur në zgjidhjen e detyrës së parashtuar nga shoqja/shoku, duke përdorur shtyllën dhe diagramin. Nxënësit analizojnë dhe diskutojnë rezultatet e detyrave në çifte dhe bëjnë vlerësimin e njëri-tjetrit.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.	

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet me anë të vëzhgimit dhe listës së kontrollit. Fokusi i vlerësimit është shkathtësia për të aplikuar shtyllën dhe diagramin në zgjidhjen e detyrave të ndryshme me mbledhje.



TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Zbritja me mjete	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes</p> <p>IV. 5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë.</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.</p> <p>6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>	
FJALËT KYÇE: Zbritje, mjete, shufra, kubëza.	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <p>Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100. Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.</p>	
<p>REZULTATET E ORËS</p> <p>Demonstron shembuj të zbritjes me mjete.</p> <p>Gjen ndryshimin e numrave dyshifrorë.</p> <p>Argumenton mënyrën e zbritjes së dy numrave.</p>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <p>Demonstro shembuj të zbritjes me mjete.</p> <p>Gjej ndryshimin e numrave dyshifrorë.</p> <p>Argumento mënyrën e zbritjes së dy numrave.</p>
<p>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</p> <p>Libri Matematika 2A, fleta, fletore, kubëza, pulla, shkopinj, laps, gomë</p>	
<p>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Artet</p>	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që para vetes të vendosin mjetet e konkretizimit që mund të jenë kubëza, pulla apo shkopinj. Fillimisht kërkon nga nxënësit që me mjete të formojnë numrin 27 (2 dhjetëshe dhe 7 njëshe). Pasi të kenë formuar këtë numër, kërkohet që atij t'i zbritet numri 5 (5 njëshe). Më pas, mësimdhënësi/ja pyet nxënësit: Sa dhjetëshe dhe sa njëshe kemi tani? Pra, numri i fituar është 22. Më tej, zbritja shprehet edhe me simbole: <math>27 - 5 = 22</math>. Mësimdhënësi/ja paraqet edhe disa shembuj të tjerë. Nxënësit paraqesin gjithnjë zbritjen me anë të mjeteve, pasuar nga paraqitja simbolike.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit hapin librin në faqen 82. Në detyrën 1 duhet të kryejnë zbritjen e numrit dyshifror me një numër njëshifror duke përdorur mjetet. Në detyrën dy kërkohet të shkruhen barazimet e zbritjes duke u bazuar në zbritjen e dhënë me mjete. Në detyrën 3 kërkohet të bëhet plotësimi i paraqitjes vizuale bazuar në barazimin e dhënë.</p> <p>Hapi III – Punë e pavarur në fletore</p> <p>Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit në mënyrë të pavarur duke përdorur mjetet, vizatimet apo vetëm paraqitjet simbolike (pra, ashtu si ju konvenon) zgjidhin detyrat e dhëna nga mësimdhënësi/ja.</p>	

$35 - 4 =$	$49 - 7 =$	$26 - 5 =$	$32 - 20 =$
------------	------------	------------	-------------

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

VLERËSIMI: Vlerësimi bëhet duke u fokusuar në aftësitë e nxënësve për zgjidhjen e detyrave me zbritje me përdorim të mjeteve konkrete.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Zbritja në bosht	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë. 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash. 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Bosht numerik, hap, kërcim, zbritje, dhjetëshe, njëshe	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.	
REZULTATET E ORËS Përdor boshtin numerik në detyrat e ndryshme. Kryen zbritjen e numrave dyshifrorë me ndihmën e boshtit numerik. Argumenton mënyrën e zbritjes së dy numrave duke përdorur boshtin numerik.	KRITERET E SUKSESIT: Përdor boshtin numerik në detyrat e ndryshme. Kryej zbritjen e numrave dyshifrorë me ndihmën e boshtit numerik. Argumento mënyrën e zbritjes së dy numrave duke përdorur boshtin numerik..
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, boshti numerik në dysHEME, fletore, laps, gomë.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Shqyrtim i përbashkët Mësimdhënësi/ja fillon orën e mësimimit me aktivitete reale - përdorimin e boshtit numerik në dysHEME për zbritjen e numrave. Së pari fillohet me zbritjen e numrave njëshifror nga ata dyshifror, e pastaj vazhdohet me situata më të komplikuar. Mësuesja gjatë aktiviteteve përdor boshte të ndryshme numerike. Boshti i parë duhet të përmbajë numrat e radhitur pa kapërcime dhe hapi këtu e ka gjatësinë një. Nxënësit zbresin numra duke përdorur hapat. Psh. te zbritja $13 - 4$ , nxënësi nisat te numri 13 dhe bën katër hapa prapa, e pastaj e shikon ku ka arritur. Mësimdhënësi/ja, më tej, menaxhon ndërtimin e boshteve numerike me kërcime. Këto boshte nuk janë të përshtatshme për dysHEME. Më të përshtatshme janë për tu paraqitur në mënyrë vizuale në tabelë. Psh. shënon në tabelë shembullin $59 - 22$ dhe pyet nxënësit si mund ta gjejnë e ta paraqesin ndryshimin në bosht numerik me sa më pak hapa dhe sa më shpejtë. Kështu, nxënësit duke vizatuar boshte numerike, dhe duke bërë hapa me gjatësi të ndryshme, vijnë edhe deri te hapat me gjatësi 10, të cilët tashmë i kanë përdorur tek mbledhja. Kombinimi i hapave dhjetëshe dhe hapave njëshe tek i njëjti bosht numerik është thelbi i strategjisë së zbritjes me ndihmën e boshtit numerik, që është përdorur në tekste. Pasi që të jenë punuar disa shembuj me	

gjetjen e ndryshimit në bosht numerik, duke përdorur së pari hapat dhjetëshe (duke hequr kështu të gjitha dhjetëshet që i ka numri i dytë) e pastaj hapat njëshe (për të hequr kështu të gjitha njëshet që i ka numri i dytë), mund të kalohet me zbatimin individual të strategjisë së sapomësuar në tekstin bazë.

Hapi II – Punë me libër

Nxënësit hapin librin, faqe 83. Në detyrën 1 duhet të njehsojnë zbritjen e numrit dyshifror me një numër njëshifror duke përdorur boshtin numerik. Në detyrën dy kërkohet të njehsohet ndryshimi nga kapërcimet e paraqitura në bosht. Në detyrën 3 kërkohet të gjejnë ndryshimin e numrave duke përdorur boshtin numerik.

Hapi III – Punë e pavarur në fletore

Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit në mënyrë të pavarur duke përdorur boshtin numerik zgjidhin detyrat e dhëna nga mësimdhënësi/ja.

$$15 - 3 = \quad 22 - 10 = \quad 36 - 13 = \quad 52 - 21 =$$

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:

Fletë e punës nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.

VLERËSIMI:

Nxënësit vlerësohen duke vëzhguar nëse zgjidhin saktë detyrat duke u bazuar në shkathhtësinë për të aplikuar boshtin numerik në zgjidhjen e detyrave të ndryshme me zbritje.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100 )

NJËSIA MËSIMORE: Zbritja në tabelë

KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:  
III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:

1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë.

3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.

3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.

FJALËT KYÇE: Tabelë, numër, zbritje, unaza.

REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:

Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.

REZULTATET E ORËS

Përdor drejtë vendosjen e unazave në tabelën e numrave në detyrat e ndryshme.

Kryen zbritjen e numrave dyshifrorë me ndihmën e tabelës.

Argumenton mënyrën e zbritjes së dy numrave duke përdorur tabelën.

KRITERET E SUKSESIT:

Përdor drejtë vendosjen e unazave në tabelën e numrave në detyrat e ndryshme.

Kryej zbritjen e numrave dyshifrorë me ndihmën e tabelës.

Argumento mënyrën e zbritjes së dy numrave duke përdorur tabelën.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri Matematika 2A, hamer, unaza, fletore, laps, gomë, fleta të printuara me tabelë.

LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:

Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:

Hapi I – Shqyrtim i përbashkët


Nxënësit janë të njoftuar me tabelat numerike, e veçanërisht me tabelën me 100 numra, ku kanë punuar një sërë aktivitete. Tani, do të zbulojnë si ta përdorin tabelën me 100 numra për të zbritur një numër dyshifror me një numër njëshifror ose me një numër dyshifror. Puna në tabelë mund të fillojë me demonstrim të zbritjes në tabelë të punuar në një fletë hamer, të vendosur në tabelën e klasës.

$$P. sh : 29 - 6 = 23$$

$$38 - 27 = 11$$

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100



Hapi II – Punë me libër

Nxënësit hapin librin, faqe 84. Detyrat 1 dhe 2 janë punuar gjatë shqyrtimit të përbashkët, kështu që nxënësit punojnë në mënyrë individuale në detyrat e mbetura.

Hapi III – Punë e pavarur

Vazhdohet me punë individuale në zgjidhjen e detyrave. Nxënësit në mënyrë të pavarur duke përdorur tabelën zgjidhin detyrat e dhëna nga mësimdhënësi/ja. Mësimdhënësi/ja kujdeset që paraprakisht të shpërndajë fleta me detyra dhe me tabela të zbrazëta.

$$25 - 4 = \quad 21 - 10 = \quad 32 - 12 = \quad 54 - 33 =$$

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë e punës nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

VLERËSIMI: Nxënësit vlerësohen duke u bazuar në shkathtësinë për të aplikuar tabelën në zgjidhjen e detyrave të ndryshme me zbritje.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100 )	
NJËSIA MËSIMORE: Mbledhja me rigrupim (njëri mbledhor njëshifror)	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.	
FJALËT KYÇE: Mbledhje, mbledhor, shumë, grupim, dhjetëshe, njëshe, mjete.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100. Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.	
REZULTATET E ORËS Demonstron shembuj të njehsimit të mbledhjes me mjete. Gjejnë shumën e numrave dyshifrorë me një numër njëshifror me rigrupim. Argumenton mënyrën e mbjedhjes së dy numrave në probleme të thjeshta.	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro shembuj të njehsimit të mbledhjes me mjete. Gjej shumën e numrave dyshifrorë me një numër njëshifror me rigrupim. Argumento mënyrën e mbjedhjes së dy numrave në probleme të thjeshta.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, shkopin, llastik, kubëza, shufra, fleta, fletore, laps, gomë.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Shqyrtim i përbashkët Mësimdhënësi/ja ju kërkon nxënësve që para vetes të vendosin mjetet konkretizuese që mund të jenë kubëza, pulla apo shkopin. Fillimisht kërkon nga nxënësit të formojnë me mjete numrin 26 (2 dhjetëshe dhe 6 njëshe). Pasi të kenë formuar këtë numër kërkohet që këtij numri ti shtohet numri 7 (7 njëshe). Më pas, mësimdhënësi/ja pyet nxënësit: Sa dhjetëshe keni formuar dhe sa njëshe? Pra shuma e fituar është 2 dhjetëshe apo shufra dhe 13 njëshe apo kubëza. Tani fillon diskutimi për rigrupimin e 10 njësheve në 1 dhjetëshe dhe në fund e gjitha kjo paraqitet me simbolikën matematike: $26 + 7 = 33$ Gjatë shqyrtimit të përbashkët punohet gjithashtu edhe nga një shembull i mbledhjes me rigrupim në shtyllë dhe duke plotësuar dhjetëshen.	

Hapi II – Punë me libër

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale në detyrat e parashtruara në libër faqe 88 dhe 89. Rezultatet e detyrave diskutohen në nivel klase, ashtu që disa prej nxënësve prezantojnë zgjidhjet e veta para klasës.

Hapi III – Punë në çifte

Puna vazhdon në fletore. Secili nxënës shkruan nga një barazim të mbledhjes si psh.

$$35 + 7 = \quad 28 + 3 = \quad 26 + 9 = \quad 34 + 7 =$$

Çifti i nxënësve shkëmben fletoret mes vete dhe secili nxënës zgjidh detyrën e parashtruar nga shoqja/shoku i bankës duke zbatuar ndonjërin prej teknikave të sapo-mësuara të mbledhjes me rigrupim. Shkëmbehen fletoret përsëri dhe secili çift analizon dhe diskuton zgjidhjet në çift.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen me anë të vëzhgimit duke plotësuar listën e kontrollit.

Fokus i vlerësimit janë shkathtësitë e përdorimit të mënyrave të ndryshme të mësuara gjatë orës për mbledhjen me rigrupim.



TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Mbledhja me rigrupim (mbledhori i dytë numër dyshifror)	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.	
FJALËT KYÇE: Mbledhje, mbledhor, shumë, grupim, dhjetëshe, njëshe, mjete.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100. Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.	
REZULTATET E ORËS Demonstron shembuj të njehsimit të mbledhjes me mjete. Gjejnë shumën e numrave dyshifrorë me një numër dyshifror me rigrupim. Argumenton mënyrën e mbledhjes së dy numrave në probleme të thjeshta.	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro shembuj të njehsimit të mbledhjes me mjete. Gjej shumën e numrave dyshifrorë me një numër dyshifror me rigrupim. Argumento mënyrën e mbledhjes së dy numrave në probleme të thjeshta.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, shkopinj, llastik, kubëza, shufra, fleta, fletore, laps, gomë	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Artet	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Shqyrtim i përbashkët Mësimdhënësi/ja ju kërkon nxënësve që para vetes të vendosin mjetet konkretizuese që mund të jenë kubëza, pulla apo shkopinj. Fillimisht kërkon nga nxënësit të formojnë me mjete numrin 37 (3 dhjetëshe dhe 7 njëshe). Pasi të kenë formuar këtë numër kërkohet që këtij numri ti shtohet numri 18 (1 dhjetëshe dhe 8 njëshe). Më pas, mësimdhënësi/ja pyet nxënësit: Sa dhjetëshe keni formuar dhe sa njëshe? Pra shuma e fituar është 4 dhjetëshe apo shufra dhe 15 njëshe apo kubëza. Tani fillon diskutimi për rigrupimin e 10 njësheve në 1 dhjetëshe dhe në fund e gjitha kjo paraqitet me simbolikën matematike: $37 + 18 = 55$ Gjatë shqyrtimit të përbashkët punohet gjithashtu edhe nga një shembull i mbledhjes me rigrupim në shtyllë dhe duke plotësuar dhjetëshen.	

Hapi II – Punë me libër

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale në detyrat e parashtruara në libër faqe 90 dhe 91. Rezultatet e detyrave diskutohen në nivel klase, ashtu që disa prej nxënësve prezantojnë zgjidhjet e veta para klasës.

Hapi III – Punë në çifte

Puna vazhdon në fletore. Secili nxënës shkruan nga një barazim të mbledhjes si psh.

$$35 + 37 = \quad 28 + 13 = \quad 26 + 49 = \quad 34 + 57 =$$

Çifti i nxënësve shkëmben fletoret mes vete dhe secili nxënës zgjidh detyrën e parashtruar nga shoqja/shoku i bankës duke zbatuar ndonjërin prej teknikave të sapo-mësuara të mbledhjes me rigrupim. Shkëmbehen fletoret përsëri dhe secili çift analizon dhe diskuton zgjidhjet në çift.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen me anë të vëzhgimit duke plotësuar listën e kontrollit. Fokus i vlerësimit janë shkathtësitë e përdorimit të mënyrave të ndryshme të mësuara gjatë orës për mbledhjen me rigrupim.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Shoqërimi i mbledhorëve	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. II.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike. 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët 6.3 - Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme	
FJALËT KYÇE: Mbledhje, numër, mbledhor, shoqërim, shumë	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Përdorë vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave. Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.	
REZULTATET E ORËS Demonstron vetinë asociative duke përdorur materiale të ndryshme në zgjidhjen e detyrave. Gjejnë shumën e numrave në detyra të ndryshme me numra dyshifrorë. Arsyeton mënyrën e mbledhjes së dy numrave duke përdorur vetinë asociative.	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro me shembuj vetinë asociative duke përdorur materiale të ndryshme në zgjidhjen e detyrave. Gjej shumën e numrave në detyra të ndryshme me numra dyshifrorë. Arsyeto mënyrën e mbledhjes së dy numrave duke përdorur vetinë asociative.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, kubëza, shufra, shkopinj, fletore, laps, gomë.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Në këtë orë mësimore nxënësit së pari rikujtojnë vetinë komutative dhe vetinë asociative të mbledhjes. Vetia komutative është mësuar më herët, në njërin prej orëve të mëhershme, ndërsa vetia e shoqërimit të mbledhorëve është përmendur edhe në klasën e parë. Mësimdhënësi/ja, si zakonisht, fillon orën e mësimin me një aktivitet konkret. Udhëzon dy nxënës (nga dy rreshta të ndryshëm) që të nxjerrin të gjithë tekstet ose fletoret ose lapsat që i kanë dhe ti numërojnë ato. Pas numërimit, udhëzon të dy nxënësit që në një fletë të formatit A4 secili të shënojnë numrin e mjeteve që kanë para vetes. Më tutje udhëzon të dy nxënësit që duke mbajtur fletën A4 të bëjnë një xhiro në klasë në mënyrë që të gjithë nxënësit të shohin numrin e shënuar në fletë. Në të njëjtën kohë, nxënësit tjerë udhëzohen që sapo ti shohin numrat në fletë, së pari t'i shkruajnë në fletore, e pastaj të gjejnë shumën e tyre. Sigurisht që nxënës të ndryshëm do ta kenë renditjen e ndryshme të numrave që i mbledhin. Duke diskutuar radhitjen e ndryshme që	

kanë nxënësit në fletore dhe faktin se të gjithë kanë arritur te shuma e njëjtë, rikujtohet se radhitja e mbledhorëve nuk ndikon në shumë, pra vlen vetia komutative. Më tutje, për të arritur deri te arsyetimi i vetisë asociative, mësimdhënësi/ja shënon në tabelë tre numra, dy prej të cilëve me mbledhje japin dhjetëshe të plotë. Një shembull i tillë janë numrat 27, 69, 33. Tre numrat nuk shënohen me radhë, mund të shënohen në mënyrë të çrregullt, lart e poshtë në tabelë. Më tej mësuesja iu drejton nxënësve pyetjen se si mund të mbledhen më së lehti dhe më së shpejti këta tre numra. Sigurisht se ndonjë nga nxënësit do ta jep idenë e formimit së pari të dhjetëshes së plotë nga numrat 27 dhe 33, e pastaj shtimin e numrit 69. Më tej, mësuesja e diskuton faktin se sido që të shoqërohen këta tre mbledhorë, ndikim në shumë nuk do të ketë, prandaj gjithnjë gjatë mbledhjes, mbledhorët shoqërohen sipas mënyrës më të lehtë për të arritur deri te shuma.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit hapin librin, faqe 94. Së pari diskutohet në mënyrë të përbashkët, në nivel klase, mbledhja e kryer në detyrën 1, ku paraqitet dobia e zbatimit të vetisë së shoqërimit gjatë mbledhjes. Pastaj, me punë të pavarur individuale nxënësit punojnë në detyrën 2. Në çifte brenda bankave diskutohen detyrat e punuara.

#### Hapi III – Punë në çifte

Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit shkëmbejnë fletoret në çifte dhe krijojnë detyra për shoqen/shokun e bankës. Më pas marrin detyrat e përgatitura dhe fillojnë të zgjidhin ato në mënyrë të pavarur duke aplikuar shoqërimin e mbledhorëve.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Fokusi i vlerësimit është zbatimi i suksesshëm i vetisë së shoqërimit të mbledhorëve.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100 )	
NJËSIA MËSIMORE: Zbritja me rigrupim (zbritësi njëshifror)	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. 2.1 - Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.	
FJALËT KYÇE: Zbritje, zbritës, ndryshim, grupim, dhjetëshe, njëshe, mjete	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100. Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.	
REZULTATET E ORËS: Demonstron shembuj të njehsimit të zbritjes me mjete. Gjen ndryshimin e një numri dyshifrorë me një numër njëshifror (me rigrupim). Argumenton mënyrën e zbritjes së dy numrave (me rigrupim).	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro shembuj të njehsimit të zbritjes me mjete. Gjej ndryshimin e numrave dyshifrorë me një numër njëshifror, me rigrupim. Argumento mënyrën e zbritjes së dy numrave (me rigrupim).
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, shkopinj, gomë elastike, kubëza, shufra, fleta, fletore, laps, gomë	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që para vetes të vendosin mjetet konkretizuese që mund të jenë kubëza, pulla apo shkopinj. Fillimisht kërkon nga nxënësit që të formojnë me mjete numrin 26 (2 dhjetëshe dhe 6 njëshe) pasi të kenë formuar kërkohet që këtij numri ti zbritet numri 7 (7 njëshe). Më pas pyet: Sa dhjetëshe keni tani dhe sa njëshe? Shumë nga nxënësit me siguri do të shprehen se duhet të prishin një shufër dhe ta shndërrojnë atë në kubëza njëshe për të zbritur numrin 7. Pas diskutimit të këtij rigrupimi të 1 dhjetësheje në 10 njëshe, zbritja shprehet me simbolikë matematike: $26 - 7 = 19$ Mësimdhënësi/ja paraqet edhe disa shembuj të tjerë të zbritjes me rigrupim duke përdorur mjetet. Para nxënësve prezantohet edhe zbritja në shtyllë si dhe ajo në boshtin numerik duke zgjidhur detyrat e parashtruara së bashku. Hapi II – Punë me libër	

Nxënësit ndahen në grupe në ndonjë mënyrë të përshtatshme dhe fillojnë punë në detyrat e parashtruara në faqet 95 dhe 96 të librit. Secili grup punon një prej detyrave të parashtruara në këto dy faqe.

Hapi III – Prezantim dhe diskutim

Grupet prezantojnë punën e vet para klasës. Diskutohet për mënyrat e zbritjes dhe rezultatet e arritura.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke u fokusuar në aftësitë e nxënësve për aplikimin e teknikave për zbritje me rigrupim.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Zbritja me rigrupim (zbritësi dyshifror)	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. 2.1 - Demonstron të kuptuarint e konceptit të numrimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.	
FJALËT KYÇE: Zbritje, zbritës, ndryshim, grupim, dhjetëshe, njëshe, mjete.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100. Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.	
REZULTATET E ORËS Demonstron shembuj të njehsimit të zbritjes me mjete. Gjejnë ndryshimin e numrave dyshifrorë me një numër dyshifror me rigrupim. Argumenton mënyrën e zbritjes së dy numrave në probleme të thjeshta.	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro shembuj të njehsimit të zbritjes me mjete. Gjej ndryshimin e numrave dyshifrorë me një numër dyshifror me rigrupim. Argumento mënyrën e zbritjes së dy numrave në probleme të thjeshta.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, shkopinj, llastik, kubëza, shufra, fleta, fletore, laps, gomë.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që para vetes të vendosin mjetet konkretizuese që mund të jenë kubëza, pulla apo shkopinj. Fillimisht kërkon nga nxënësit që të formojnë me mjete numrin 34 (3 dhjetëshe dhe 4 njëshe) pasi të kenë formuar kërkohet që këtij numri ti zbritet numri 19 (1 dhjetëshe dhe 9 njëshe). Më pas pyet: Sa dhjetëshe keni tani dhe sa njëshe? Shumë nga nxënësit me siguri do të shprehen se duhet të prishin një shufër dhe ta shndërrojnë atë në kubëza njëshe për të zbritur numrin 19. Pas diskutimit të këtij rigrupimi të 1 dhjetësheje në 10 njëshe, zbritja shprehet me simbolikë matematike: $34 - 19 = 25$ Mësimdhënësi/ja paraqet edhe disa shembuj të tjerë të zbritjes me rigrupim duke përdorur mjetet. Para nxënësve prezantohet edhe zbritja në shtyllë si dhe ajo në boshtin numerik duke zgjidhur detyrat e parashtruara së bashku. Hapi II – Punë me libër	

Nxënësit ndahen në grupe në ndonjë mënyrë të përshtatshme dhe fillojnë punë në detyrat e parashtruara në faqet 97 dhe 98 të librit. Secili grup punon një prej detyrave të parashtruara në këto dy faqe.

Hapi III – Prezantim dhe diskutim

Grupet prezantojnë punën e vet para klasës. Diskutohet për mënyrat e zbritjes dhe rezultatet e arritura.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Vlerësimi bëhet duke u fokusuar në aftësitë e nxënësve për aplikimin e teknikave për zbritje me rigrupim.



TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Lidhja ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike. 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët. 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Mbledhja, zbritja, numër, lidhje.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave si dhe shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri 100.	
REZULTATET E ORËS Kryen mbledhjen e numrave dyshifrorë Kryen zbritjen e numrave dyshifrorë Argumenton lidhjen ndërmjet veprimeve të mbledhjes dhe zbritjes si dy veprime të anasjellta mes vete	KRITERET E SUKSESIT: Kryej mbledhjen e numrave dyshifrorë Kryej zbritjen e numrave dyshifrorë Argumento lidhjen ndërmjet veprimeve të mbledhjes dhe zbritjes
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, petëza apo materiale të tjera, fletore, laps, gomë	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Artet	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Synimi kryesor i kësaj ore mësimore është konkretizimi i ndërlidhjes së ngushtë ndërmjet veprimit të mbledhjes dhe atij të zbritjes, duke zbatuar mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 100. Nxënësit janë njoftuar edhe më herët me këtë ndërlidhje. Gjatë orës aktuale nevojitet të bëhet rifreskimi dhe përforcimi i idesë se mbledhja dhe zbritja janë veprime të kundërta në mes vete. Siç është përmendur edhe në klasë të parë performimi i njëpasnjëshëm i tyre, e kthen rezultatit në fillim, ashtu si ishte para performimit të veprimit të parë. Së pari mësuesja organizon një aktivitet konkret në klasë. Thërret nxënësit të punojnë në grupe dhe të përdorin një numër të caktuar të petëzave ose cilitdo objekt tjetër që mund të përdoret në klasë. Në secilën bankë, njëri prej nxënësve numëron dhe vendos në bankë para vetes, le të themi, nga 23 petëza (të të njëjtës ngjyrë). Pastaj nxënësi i dytë shton aty edhe 5 petëza të tjera (të ngjyrës tjetër). Në tabelë shkruhet barazimi i përbashkët i mbledhjes për të gjitha petëzat, pra $23 + 5 = 28$ I njëjti nxënës që ka shtuar petëzat, tani i merr prapa po ato petëza që i ka shtuar. Përsëri, në tabelë, situata përcillet me barazimin e duhur të zbritjes: $28 - 5 = 23$	

Diskutohet në mënyrë të hollësishme lidhja që ekziston ndërmjet dy veprimeve matematike, mbledhjes dhe zbritjes, së pari në nivel grupesh, e pastaj në nivel klase. Kjo lidhje mund të përshkruhet duke thënë se mbledhja dhe zbritja janë veprime të kundërta për njëri tjetrin. D.m.th. nëse së pari performohet mbledhja e një numri me numrin e dytë, e pastaj menjëherë prapa nga shuma zbritet numri i dytë, do të fitohet përsëri numri fillestar.

Hapi II – Punë me libër

Nxënësit hapin librin, faqe 100. Në mënyrë individuale zgjidhin detyrat që përmbahen në këtë faqe.

Hapi III – Prezantim dhe diskutim

Disa nga nxënësit prezantojnë punën e vet para klasës. Në nivel klase diskutohen dhe analizohen detyrat e zgjidhura.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Fokusi i vlerësimit është aftësia e nxënësve për të demonstruar dhe aplikuar në detyra ndërlidhjen në mes mbledhjes dhe zbritjes.

TEMA: Numrat natyrorë (Mbledhja dhe zbritja deri në 100)	
NJËSIA MËSIMORE: Veprimet e përziera me numra	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë. 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune. 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Mbledhje, zbritje, shprehje numerike, veprime të përziera, barazim, numër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).	
REZULTATET E ORËS: Kryen veprimet me radhë nga e majta në të djathtë. Formon barazim me veprime të përziera bazuar në situatë reale.	KRITERET E SUKSESIT: Kryej veprimet me radhë nga e majta në të djathtë. Formo barazim me veprime të përziera bazuar në situatë reale.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, topta letre dhe kavanoz, fletore, laps, gomë	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Zhvillimi i njësisë aktuale duhet të fillojë me një aktivitet konkret. Një ndër mundësitë është aktiviteti me një kavanoz apo ndonjë enë tjetër të ngjashme dhe me një sasi topash të vegjël, të cilët mund të formësohen edhe nga letra e ndrydhur. Mësimdhënësi/ja udhëzon një prej nxënësve që të vijë dhe të fus brenda në enë një numër të caktuar topash. Sasia e topave përzgjedhet sipas nevojës. Mësimdhënësi/ja thërret pastaj një nxënës të dytë që të nxjerr një sasi të caktuar topash nga kavanozi. Në fund thërret nxënësin e tretë që të shtojë një sasi të re topash në kavanoz. Pasi që të jenë kryer këto veprime, mësuesja shtron pyetje se sa topa janë gjithsej në kavanoz. Nxënësit do të japin përgjigje përmes ndërtimit të barazimit me dy veprime, mbledhje e zbritje dhe me kryerjen e njëpasnjëshme të dy veprimeve matematike – zbritjes dhe mbledhjes. Nxënësit diskutojnë dhe shënojnë në tabelë barazimin me veprime të përziera me anë të cilit e kanë zgjidhur problemin e numrit të topave në kavanoz. Më tej puna mund të vazhdojë në dyshe, nëpër banka. Secila dyshe duhet të ndërtojë nga një situatë kontekstuale problemore, ku përfshihen mbledhja dhe zbritja, duke u mbështetur në modelin e problemit të paraqitur me topta. Hapi II – Punë me libër Nxënësit hapin librin, faqe 101. Nxënësit ndahen në grupe në ndonjë mënyrë të përshtatshme dhe secili grup zgjidh njërën nga detyrat e prezantuara në këtë faqe të librit. Hapi III – Prezantime dhe diskutime Secili grup prezanton punën e vet para klasës. Në nivel klase, nxënësit diskutojnë dhe analizojnë rezultatet dhe punën e bërë.	

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Fokusi i vlerësimit është aftësia e nxënësve për të kryer veprimet e përziera sipas radhës së duhur, si dhe aftësia e modelimit të barazimeve me veprime të përziera nga situatat reale.

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Vijat	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2 - Zbaton shprehje të arsyetit për të bërë hamendësime; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehje pune; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehjeve matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Vijë, e drejtë, e lakuar, e thyer, e mbyllur, e hapur	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Përcakton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura.	
REZULTATET E ORËS Identifikon llojet e vijave; Modelon lloje të ndryshme të vijave; Emërton lloje të ndryshme të vijave me gojë dhe me shkrim.	KRITERET E SUKSESIT: Identifiko llojet e vijave; Modelo vija në fletoren tënde; Paraqit llojet e ndryshme të vijave me vizatim dhe me fjalë.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, lapsi, goma, fletorja, ngjyrat, copa litari, penjë, fije elastike, pipëza të plastikës ngjitës.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja sjell në klasë disa copa litari. Thërret katër nxënës. Secili prej tyre kap nga një skaj litari. Çiftit të parë të nxënësve u thotë që ta tërheqin fort litarin në dy skajet që të fitohet vijë e drejtë. Çiftit tjetër të nxënësve u thotë që të afrohen dhe mos ta tërheqin litarin, por vetëm ta mbajnë lirshëm. Mësimdhënësi/ja në bashkëbisedim me nxënësit diskutojnë për llojet e fituara të vijave. E para është vijë e drejtë, ndërsa e dyta vijë e lakuar. Me pjesët e mbetura të litarit mësimdhënësi/ja gjithashtu mund të modelojë lloje tjera vijash në dysheme apo në tavolinën e saj. Kështu, nxënësit diskutojnë dhe emërtojnë vijat e drejta, vijat e lakuara, vijat e thyera, vijat e mbyllura, vijat e hapura. Hapi II – Modelojmë vija Pas demonstrimit dhe emërimit të llojeve të vijave, pason modeli i vijave në fletore të nxënësve me anë të punës individuale. Vijat mund të modelohen nga materiale të ndryshme, siç janë: peri, fjet elastike, pipëzat e plastikës etj. Secila vijë e modeluar në fletore përcillet edhe me emërtimin e saj me fjalë përskaaj vijës së ndërtuar. Hapi III – Punë me libër Në vazhdim, mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të hapin librin faqe 106. Në detyrën 1 janë paraqitur llojet e vijave për të cilat edhe u diskutua në fazën paraprake të orës. Në detyrën 2, nxënësit analizojnë vijat duke i lidhur me emërtimet përkatëse. Në faqen 108	

nxënësit plotësojnë detyrat nga 1 deri në 6, në të cilat kërkohet të vizatohen vijat e ndryshme. Në detyrën 7 kërkohet të shënohen emërtimet e vijave të dhëna me ilustrim. Pas përfundimit të plotësimit të kërkesave të librit, librat shkëmbehen në mes të dysheve të nxënësve të sistemuar në të njëjtën bankë, ashtu që detyrat kontrollohen dhe vlerësohen në mënyrë të ndërsjellë dhe diskutohen e korrigjohen në dyshe.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës gjatë aktivitetit të modelimit të vijave dhe gjatë punës në tekste, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Segmentet	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>III.3 - Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 – Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>3.1 – Përdorë gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Vijë, segment, pikë, skaje.	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <p>Përkufizon segmentin dhe përdorë vizoren/trekëndëshin për të caktuar gjatësinë e segmentit.</p> <p>Mbledh, zbrit dhe krahason gjatësitë e segmenteve të ndryshme duke përdorur njësitë matëse standarde (<i>cm, m</i>);</p>	
<p>REZULTATET E ORËS</p> <p>Dallon segmentin nga vijat tjera;</p> <p>Veçon karakteristikat e segmentit;</p> <p>Identifikon segmentet në figura të ndryshme;</p> <p>Paraqet simbolikisht segmentet e identifikuar.</p> <p>Vizaton segmente dhe i krahason ato.</p>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <p>Dallo segmentin nga vijat tjera;</p> <p>Veço karakteristikat e segmentit;</p> <p>Gjej segmentet në figurat e paraqitura;</p> <p>Shkruaj me simbole segmentet e identifikuar.</p> <p>Vizato segmente dhe krahason ato.</p>
<p>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</p> <p>Libri Matematika 2A, lapsi, goma, ngjyrat, fletorja, penjë.</p>	
<p>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme.</p>	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I - Diskutim</p> <p>Mësimdhënësi/ja fillon diskutimin me nxënësit duke rikujtuar vijat e drejta. Ai/ajo merr një lëmsh peri të trashë dhe një copë peri të këputur. Duke lëshuar një pjesë peri nga lëmshi në dysheme, formon një vijë të drejtë. Lëmshin e lëshon po ashtu në dysheme, në fund të vijës së drejtë. Po ashtu, duke tërhequr dhe drejtuar copën e perit të këputur ndërton një vijë tjetër të drejtë. Më tej, mësimdhënësi/ja parashtron pyetje para nxënësve në lidhje me dallimin në mes të dy vijave të drejta të formuara. Hap pas hapi arrihet në përfundim se njëra vijë e drejtë, ajo nga copa e këputur e perit është e kufizuar nga të dy anët, pra, ka pikënisje dhe pikë përfundimi. Vija tjetër, është e kufizuar vetëm në njërin anë, pra, ka pikë nisje, por pikë përfundimi jo. Mësimdhënësi/ja sqaron se vijën e drejtë e cila ka fillimin dhe mbarimin, në matematikë, e quajmë segment. Fillimi dhe mbarimi i segmentit janë dy pika, të cilat në matematikë shënohen me shkronja të mëdha. Kështu, në bashkëpunim me nxënësit, vizatohet një segment në tabelë, emërtohet me A pika e fillimit dhe me B pika e mbarimit të segmentit.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p>	

Hapen librat në faqen 109. Nxënësit analizojnë dhe me fjalë të veta diskutojnë paraqitjet në detyrën 1. Vazhdon puna në detyrën 2, ku nxënësit duhet të identifikojnë segmentet duke i rrethuar me ngjyrë të gjelbër. Në detyrën 3 nxënësit duhet të identifikojnë të gjitha segmentet në figurat e paraqitura në ilustrim dhe të shkruajnë me radhë segmentet e identifikuar. Në detyrën 4 nxënësit duhet të ndërtojnë dhe të shkruajnë aq segmente sa është e mundur nga katër pikat e dhëna.

#### Hapi III – Punë në fletore

Në pjesën e mbetur të orës, vazhdohet me punë në fletore. Nxënësit duhet të vizatojnë segmente të gjatësive të ndryshme duke përdorur vizoren dhe t'i krahasojnë segmentet sipas gjatësive të tyre.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës në diskutim. Po ashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.



TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Figurat gjeometrike	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta III.3 - Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 – Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 6.1 – Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme; 6.2 – Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.	
FJALËT KYÇE: Figurë, formë, trekëndësh, katror, rreth, drejtkëndësh	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Emërton figurat gjeometrike siç është katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi dhe rrethi; Vizaton figura të ndryshme gjeometrike; Krahason figurat gjeometrike.	
REZULTATET E ORËS: Dallon figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin, rrethin, drejtkëndëshin); Emërton figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin, rrethin, drejtkëndëshin); Gjen karakteristikat e figurave gjeometrike.	KRITERET E SUKSESIT: Identifiko figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin, rrethin, drejtkëndëshin); Emërto figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin, rrethin, drejtkëndëshin); Diskuto për karakteristikat e figurave gjeometrike.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A fletë A4, petëza, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja ndan nxënësit në grupe me nga katër nxënës. Në secilin grup shpërndan nga katër petëza. Nga një petëz në formë trekëndëshi, katrori, rrethi dhe drejtkëndëshi. Nxënësit fillimisht punojnë bashkërisht në grup për të identifikuar figurat gjeometrike që kanë para vetes dhe pastaj analizojnë e gjejnë karakteristika, ngjashmëri dhe dallime për secilën prej tyre. Pas diskutimit të përbashkët, nxënësit ndajnë përgjegjësitë ku secili merr nga një fletë të bardhë A/4 dhe merr përsipër njërin nga 4 figurat gjeometrike. Secili nxënës vizaton dhe emërton figurën e vet si dhe shkruan karakteristikat dhe të dhënat tjera nga analiza e realizuar në grup. Kjo procedurë zgjat rreth 15 minuta.  Hapi II – Diskutim Grupet prezantojnë punën e tyre në nivel klase. Secila figurë diskutohet veç e veç në nivel klase. Nxënësit sqarojnë, bëjnë pyetje dhe përgjigjen për figurat e analizuar.  Hapi III – Punë me libër Puna vazhdon në libër, faqe 110. Në detyrën 1 kërkohet diskutim në mes çifteve për të analizuar se si janë formuar kafshët e dhëna në ilustrim. Në detyrën 2 nxënësit duhet të shkruajnë emërtimin për secilën figurë gjeometrike (trekëndëshin, katrorin, rrethin dhe	

drejkëndëshin). Në detyrën 3 kërkohet një analizë për të identifikuar cili objekt në cilën figurë gjeometrike ngjan. Pas identifikimit, secili objekt duhet ngjyrosur sipas ngjyrës së figurës. Sapo nxënësit të përfundojnë punën, shkëmbehen librat brenda dysheve të nxënësve të sistemuar në të njëjtat banka. Bëhet vlerësimi i ndërsjellë, diskutohen dhe eventualisht përmirësohen gabimet brenda dysheve.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.





**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës gjatë aktivitetit konkret në grupe dhe gjatë punës në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj. Një pjesë e vlerësimit po ashtu përbëhet edhe nga vlerësimi i ndërsjellë në mes të nxënësve.

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Trekëndëshi dhe katrori	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta III.3 - Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 – Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 6.1 – Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme; 6.2 – Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.	
FJALËT KYÇE: Figurë, formë, trekëndësh, katror, rreth, drejtkëndësh.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Emërton figurat gjeometrike siç është katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi dhe rrethi; Vizaton figura të ndryshme gjeometrike; Krahason figurat gjeometrike.	
REZULTATET E ORËS Dallon figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin); Emërton figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin); Gjen karakteristikat e figurave gjeometrike.	KRITERET E SUKSESIT: Identifiko figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin); Emërto figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin); Diskuto për karakteristikat e figurave gjeometrike.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë A4, petëza, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja u shpërndanë nxënësve nga një fletë me nga një objekt real të vizatuar. Objektet kanë forma të ndryshme – disa kanë formën e trekëndëshit, disa të katrorit, si dhe disa të tjera kanë formën e figurave tjera gjeometrike. Më pas kërkon nga nxënësit të veçojnë vetëm objektet reale që kanë formën e trekëndëshit dhe ato që kanë formën e katrorit. Të gjithë nxënësit që kanë fletë me objekt në formë trekëndëshi ose katrori dalin dhe e vendosin fletën e vet në tabelë. Hapi II – Diskutim Secila figurë (trekëndëshi dhe katrori) diskutohet veç e veç në nivel klase. Nxënësit sqarojnë, bëjnë pyetje dhe përgjigjen për figurat e analizuar. Hapi III – Punë me libër Puna vazhdon në libër, faqe 111.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.	
VLERËSIMI: Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës gjatë aktivitetit konkret në grupe dhe gjatë punës në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.	

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Drejtkëndëshi dhe rrethi	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta III.3 - Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 – Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 6.1 – Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme; 6.2 – Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.	
FJALËT KYÇE: Figurë, formë, trekëndësh, katror, rreth, drejtkëndësh.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Emërton figurat gjeometrike siç është katrori, drejtkëndëshi , trekëndëshi dhe rrethi; Vizatona figura të ndryshme gjeometrike; Krahason figurat gjeometrike.	
REZULTATET E ORËS: Dallon figurat gjeometrike (rrethin, drejtkëndëshin); Emërton figurat gjeometrike (rrethin, drejtkëndëshin); Gjen karakteristikat e figurave gjeometrike.	KRITERET E SUKSESIT: Identifikon figurat gjeometrike (rrethin, drejtkëndëshin); Emërton figurat gjeometrike (rrethin, drejtkëndëshin); Diskuto për karakteristikat e figurave gjeometrike.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë A4 fotografi, petëza, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja u shpërndanë nxënësve nga një fletë me nga një objekt real të vizatuar. Objektet kanë forma të ndryshme – disa kanë formën e drejtkëndëshit, disa kanë formën e rrethit, si dhe disa të tjera kanë formën e figurave tjera gjeometrike. Më pas kërkohet nga nxënësit të veçojnë vetëm objektet reale që kanë formën e drejtkëndëshit dhe ato që kanë formën e rrethit. Të gjithë nxënësit që kanë fletë me objekt në formë drejtkëndëshi ose rrethi dalin dhe e vendosin fletën e vet në tabelë. Hapi II – Punë me libër Puna vazhdon në libër, faqe 112. Në detyrën 1 kërkohet diskutim në mes çifteve për të analizuar të gjitha objektet e dhëna dhe duke veçuar ato në formë drejtkëndëshi (në kornizën e parë) dhe ato në formë rrethi (në kornizën e dytë) të lidhin objektet me emërtimin në mes të kornizës. Detyra 2 dhe 3 kërkohet formimin e një drejtkëndëshi apo një rrethi duke lidhur copat e duhura, ndërsa detyra 4 parashtron kërkesë për vizatimin e këtyre dy figurave gjeometrike – drejtkëndëshit dhe rrethit. Hapi III – Punë në fletore Kërkohet nga nxënësit që duke vizatuar rrathë dhe drejtkëndësha të ndryshëm të krijojnë figura të ndryshme. Nxënësit prezantojnë punën para nxënësve të tjerë.	

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimitdhënësi/ja.

VLERËSIMI: Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës gjatë aktivitetit konkret dhe gjatë punës në tekste, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e tij/saj.

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Kompozimi i figurave gjeometrike	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash IV.5 – Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet ... etj) dhe i përdorë në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet. VI.6 – Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë 6.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme 6.3 – krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Figurë, objekt, kombinim, trekëndësh, katror, rreth, drejtkëndësh.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Dallon objekte që asocojnë me katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshin dhe rrethin; Krahason figurat gjeometrike.	
REZULTATET E ORËS Dallon figurat gjeometrike që ndërtojnë një objekt; Numëron nga sa prej secilit lloj të figurave gjenden në kompozim; Ndërton objekte duke kombinuar figura të ndryshme gjeometrike.	KRITERET E SUKSESIT: Dallo figurat gjeometrike që ndërtojnë një objekt; Numëro nga sa prej secilit lloj të figurave gjenden në kompozim; Ndërto objekte duke kombinuar figura të ndryshme gjeometrike.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë hamer, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet në grupe Mësimdhënësi/ja ndan nxënësit në grupe ashtu si është më e përshtatshme për punë në klasë. Pastaj, me ndihmën e projektorit apo me ndihmën e vizatimeve në fletë hamer, paraqet para nxënësve ilustrime të objekteve reale të ndryshme të kompozuar tërësisht nga figurat gjeometrike. Shembuj të tillë mund të shihen në foton e bashkëngjitur. Pra, objektet e paraqitura mund të jenë kafshë të ndryshme, mjete komunikacioni, shtëpi, ndërtesë etj. Pas diskutimit të përbashkët të ilustrimeve, grupeve u shpërndahet nga një fletë hamer, ku ata do të ndërtojnë kompozime të ndryshme të figurave gjeometrike të cilat formojnë objekte reale.	
<div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;">     </div>	
Hapi II – Turi i galerisë	

Pas përfundimit të punës, ekspozohen punimet e të gjitha grupeve në murin e klasës. Nxënësit janë të lirë të lëvizin nëpër klasë për të analizuar dhe komentuar punimet e ekspozuara.

### Hapi III – Punë me libër

Puna vazhdon në libër, faqe 113. Aty janë paraqitur disa objekte reale të ndërtuara me kompozimin e figurave gjeometrike. Nxënësit duhet të numërojnë sa nga secili lloj i figurave formon secilin nga objektet si dhe duhet të diferencojnë figurat gjeometrike në mes vete duke i ngjyrosur ato me ngjyra të ndryshme. Sapo nxënësit të përfundojnë punën, shkëmbehen librat brenda dysheve të nxënësve të sistemuar në të njëjtat banka. Bëhet vlerësimi i ndërsjellë, diskutohen dhe eventualisht përmirësohen gabimet brenda dysheve.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Për punë të pavarur në shtëpi, nxënësit udhëzohen që të përgatisin nga një kompozim të figurave gjeometrike sipas dëshirës.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimit dhe gjatë punës në tekste, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj. Një pjesë e vlerësimit po ashtu përbëhet edhe nga vlerësimi i ndërsjellë në mes të nxënësve.

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Tabela gjeometrike	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.3 - Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.3 - Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike. 5.1 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. 6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Figurë, objekt, kombinim, trekëndësh, katror, rreth, drejtkëndësh	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Dallon objekte që asocojnë me katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshin dhe rrethin; Vizaton figura të ndryshme gjeometrike; Krahason figurat gjeometrike.	
REZULTATET E ORËS Dallon figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin, rrethin, drejtkëndëshin); Emërton figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin, rrethin, drejtkëndëshin); Gjen karakteristikat e figurave gjeometrike.	KRITERET E SUKSESIT: Identifiko figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin, rrethin, drejtkëndëshin); Emërto figurat gjeometrike (trekëndëshin, katrorin, rrethin, drejtkëndëshin); Diskuto për karakteristikat e figurave gjeometrike.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, tabela gjeometrike, goma elastike, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja prezanton para nxënësve tabelën gjeometrike. Tabela gjeometrike mund të jetë nga plastika apo nga çfarëdo materiali tjetër i përshtatshëm. Me ndihmën e gomave elastike, ndërtohen figura të ndryshme në tabelë gjeometrike. Pra fillimisht ndërtohen trekëndëshi, katrori dhe drejtkëndëshi, e pastaj fillohet me ndërtimin e kompozimeve të ndryshme të figurave gjeometrike. Një shembull i tillë mund të shihet në foton e bashkëngjitur. Secili kompozim i ndërtuar diskutohet në nivel klase, duke cekur figurat që e ndërtojnë atë.	
<div data-bbox="922 1413 1398 1753" data-label="Image"> </div>	
Hapi II – Punë me libër Puna vazhdon në libër, faqe 114. Aty janë paraqitur tabelat gjeometrike së bashku me kompozimin që duhet të vizatohet në secilën prej tabelave. Nxënësit me punë individuale përfundojnë vizatimet e kërkuara.	



Hapi III – Rishikim në dyshe

Sapo nxënësit të përfundojnë punën, shkëmbehen librat brenda dysheve të nxënësve të sistemuar në të njëjtat banka. Bëhet vlerësimi i ndërsjellë, diskutohen dhe eventualisht përmirësohen gabimet brenda dysheve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

VLERËSIMI: Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës gjatë aktivitetit të ndërtimit të figurave në tabelë gjeometrike. Po ashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekste, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj. Një pjesë e vlerësimit po ashtu përbëhet edhe nga vlerësimi i ndërsjellë në mes të nxënësve.

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Tangrami	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta III.3 - Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.	
FJALËT KYÇE: Figurë, copëza, objekt, tangram, kombinim, katërkëndësh, trekëndësh, katror.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Dallon objekte që asocojnë me katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshi dhe rrethin.	
REZULTATET E ORËS Përcakton vendin e secilit element të tangramit në kompozim; Komponon objekte reale me ndihmën e elementeve të tangramit; Diskuton për kompozimet e ndërtuara.	KRITERET E SUKSESIT: Cakto vendin e secilit element të tangramit në kompozim; Ndërto objekte reale me ndihmën e elementeve të tangramit; Diskuto për objektet e ndërtuara me ndihmën e tangramit.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, gërshërët, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Realizimi gjatë tërë orës mësimore– Aktivitet konkret Kjo orë fokusohet në zgjidhje të problemeve vizuale gjeometrike. Zgjidhja e problemeve nënkupton kompozimin e objekteve të ndryshme reale. Si mjet për zgjidhjen e problemeve shërben një mjet antik gjeometrik i quajtur tangram, që përbëhet prej shtatë pjesëve – pesë trekëndëshave dhe dy katërkëndëshave. Mësimdhënësi/ja prezanton para nxënësve tangramin me shtatë copëzat apo elementet e tij të paraqitura në libër, faqe 115. Nxënësit kanë sjellë gërshërë me vete sipas kërkesës së mësimdhënësit/es nga ora e kaluar. Ata presin me gërshërë një nga një shtatë pjesët e tangramit. Sapo të jenë gati me prerjen e figurave, nxënësit fillojnë kompozimin e objekteve reale të paraqitura në faqet 115 të librit bazë me ndihmën e elementeve të tangramit. Secili kompozim i ndërtuar diskutohet në nivel klase. Gjatë punës me tangram, mund të bëhen foto të objekteve të ndërtuara, në mënyrë që të pasurohen portfoliot e nxënësve apo edhe të ekspozohen fotot në murin e klasës.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Për punë të pavarur në shtëpi, nxënësit udhëzohen që të përdorin copëzat e prera të tangramit për kompozimin e objekteve të tjera që lehtësisht	

mund t'i gjejnë në internet. Një vegëz ku mund të drejtohen nxënësit për të gjetur objekte të tilla: <https://www.pinterest.fr/pin/346355027582617787/>

Si evidencë për ndërtimin e objekteve në shtëpi shërbejnë fotot e sjellura nga nxënësit.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës në aktivitetet. Ai/ajo udhëheqë listë kontrolli dhe mban shënime në ditarin e tij/saj.

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Elementet e figurave gjeometrike	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta II.3 - Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; 6.3- Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme;	
FJALËT KYÇE: Figurë, formë, modelim, trekëndësh, katror, rreth, drejtkëndësh, kulm, brinjë, kënd	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit;	
REZULTATET E ORËS Dallon brinjët, kulmet dhe këndet e katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit; Emërton elementet e figurave gjeometrike; Modelon figurat gjeometrike dhe elementet e tyre.	KRITERET E SUKSESIT: Dallo brinjët, kulmet dhe këndet e katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit; Trego elementet e figurave gjeometrike; Modelo figurat gjeometrike dhe elementet e tyre me rrëmojsa (shkopinj) dhe plastelinë.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, plastelinë, rrëmojsa ose shkopinj, materiale nga faqja e internetit e shtëpisë botuese.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Punë me libër Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të hapin librin, faqe 116. Përmbajtjet e prezantuara aty flasin për elementet e ndërlidhura me figurat gjeometrike: kulmet e figurave gjeometrike, brinjët e figurave gjeometrike dhe këndet që formojnë figurat gjeometrike. Nxënësit analizojnë përmbajtjet e prezantuara dhe në bashkëbisedim me mësimdhënësin/en sjellin përfundim se çfarë paraqesin kulmet, çfarë paraqesin brinjët dhe çfarë paraqesin këndet. Mësimdhënësi/ja vazhdimisht gjatë diskutimit sjellë shembuj konkret në lidhje me tri llojet e elementeve, duke përdorur objekte reale në klasë. Po ashtu, tani është rast i mirë të sqarohet edhe fakti që rrethi nuk ka as kulme, as brinjë as nuk formon kënde. Plotësohet detyra 2 duke krahasuar figurat gjeometrike dhe zbulohen gjëegjëzat e dhënë në detyrën 3. Hapi II – Modelim Pasi mësimdhënësi/ja të jetë siguruar me anë të pyetjeve dhe përgjigjeve të marra se nxënësit i kanë të qartë konceptet e kulmit, brinjëve dhe këndeve, fillon modelimi i figurave gjeometrike dhe elementeve të tyre. Nxënësit, sipas porosisë së mësimdhënësit/es nga ora e kaluar, kanë sjellë me vete rrëmojsa (apo shkopinj të vegjël të pa mprehur në majë) dhe	

plastelinë. Secili nxënës modelon njërën nga tri figurat gjeometrike të mësuara më parë: katrorin, trekëndëshin apo drejtkëndëshin. Kulmet e figurave modelohen me anë të plastelinës, ndërsa brinjët modelohen me anë të shkopinjve apo rrëmojsave.

Hapi III – Turi i galerisë

Nxënësit prezantojnë punën e tyre në nivel klase ashtu që ndërtohet një ekspozitë. Nxënësit janë të lirë të lëvizin nëpër klasë, të analizojnë dhe të diskutojnë për punimet e ekspozuara.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës në diskutim si dhe gjatë aktivitetit të modelimit. Mësuesi/ja udhëheqë listë kontrolli dhe mban shënime në ditarin e saj.

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Simetria	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore. II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 – Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme	
FJALËT KYÇE: Formë, simetri, drejtëz, bosht, pasqyrë, objekte reale	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Ngjyrosë figurën simetrike dhe krijon figura simetrie.	
REZULTATET E ORËS Diskuton për formimin e objekteve simetrike me ndihmën e pasqyrës; Eksploron formimin e objekteve simetrike me ndihmën e ngjyrës tempero dhe palosjes së fletës; Dallon drejtëzën apo boshtin e simetrisë; Krijon figura simetrike duke ngjyrosur një të gjysmë të figurës sipas gjysmës tjetër.	KRITERET E SUKSESIT: Diskuto për formimin e objekteve simetrike me ndihmën e pasqyrës; Eksploro formimin e objekteve simetrike me ndihmën e ngjyrës tempero dhe palosjes së fletës; Dallo drejtëzën apo boshtin e simetrisë; Krijon figura simetrike duke ngjyrosur një të gjysmë të figurës sipas gjysmës tjetër.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri bazë Matematika 2A, pasqyra, objekte të ndryshme reale apo fletë me vizatime, fletë të bardha A4, ngjyra tempero, lapsi, goma.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I - Diskutim Për të sqaruar sa më konkretisht konceptin e simetrisë, mësimdhënësi/ja mund të përdorë fillimisht një pasqyrë. Së pari, vendosë në bankë një fletë me një vizatim të një objekti, një petëz apo figura të ndryshme. Në pasqyrën e vendosur pranë vizatimit, petëzës apo figurës, reflektimi do të na jep edhe një objekt, petëz apo figurë të tillë. Mësimdhënësi/ja sqaron se në këtë mënyrë, se me ndihmën e pasqyrës është fituar objekt, petëz apo figurë simetrike me atë që kemi pasur në fillim. Diskutohet se si shumë objekte nga jeta e përditshme janë simetrike, si për shembull duart, këmbët, flutura etj. Procedura mund të vazhdojë, duke afuar pranë pasqyrës vizatime me figura dhe objekte të përgjysmuara. Objekti mund të jetë shtëpi, flutur, mollëkuqe, akullore etj. Duke u reflektuar në pasqyrë, nga objekti i përgjysmuar fitohet një objekt i tërë. Në këtë rast, mësimdhënësi/ja u thotë nxënësve se figura e kompletuar me ndihmën e pasqyrës, që ka dy gjysma plotësisht të njëjta, në	

matematikë quhet figurë simetrike. Reflektimin e vizatimeve dhe figurave me pasqyrë e provojnë edhe nxënësit, duke ndërtuar në këtë mënyrë figura simetrike.

#### Hapi II – Aktivitet konkret

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të marrin secili nga një fletë të bardhë A/4 dhe atë ta palosin në gjysmë. Në këtë mënyrë u sqaron se fleta është një objekt simetrik, ndërsa vija e palosjes quhet drejtëza apo boshti i simetrisë. Për të kuptuar më mirë konceptin e simetrisë, mësimdhënësi/ja vendosë në fletën e secilit nxënës nga pak ngjyrë tempero. Nga nxënësit kërkohet të përhapin ngjyrën sipas dëshirës vetëm në njërin gjysmë të fletës dhe pasi të përfundojnë këtë procedurë, udhëzohen që ta palosin përmes vijës (drejtëzës apo boshtit të simetrisë) që kanë krijuar më herët. Nxënësit ushtrojnë forcë mbi fletën e palosur dhe pastaj e hapin. Diskutohet ndërtimi i figurave simetrike nga ana e nxënësve.

#### Hapi III – Punë me libër

Nxënësit hapin librin, faqe 117. Analizojnë përmbajtjen e detyrës 1 e cila jep informatë mbi konceptin e simetrisë. Më tej, ngjyrosin anët e djathta të figurave të paraqitura në detyrën 2, ashtu që të fitojnë figura simetrike. Me të njëjtën veprimtari vazhdohet edhe në detyrën 3 – tani ngjyrosja bëhet nga ana e majtë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Detyrat nga faqja 118 e librit.

VLERËSIMI: Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës në diskutim, aktivitet dhe punë në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e tij/saj.

TEMA: Figurat gjeometrike	
NJËSIA MËSIMORE: Drejtëza e simetrisë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore. II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 – Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Simetri, drejtëz, bosht, figura, objekte reale.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Vizaton drejtëzën/drejtëzat e simetrisë si dhe përcakton sa drejtëza simetrie ka figura.	
REZULTATET E ORËS: Diskuton për drejtëzën e simetrisë të objekteve dhe figurave të ndryshme; Eksploron numrin e drejtëzave të simetrisë që ka një objekt; Vizaton drejtëzën/drejtëzat e simetrisë në figurat e dhëna në libër.	KRITERET E SUKSESIT: Diskuto për drejtëzën e simetrisë të objekteve dhe figurave të ndryshme; Eksploro numrin e drejtëzave të simetrisë që ka një objekt; Vizato drejtëzën/drejtëzat e simetrisë në figurat e dhëna në libër.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, objekte të ndryshme reale në klasë, fletë të bardha A4, lapsi, goma	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I - Diskutim Për të diskutuar sa më konkretisht rreth konceptit të drejtëzës të simetrisë dhe faktit se një figurë apo objekt mund të ketë më shumë se një drejtëz simetrie, mësimdhënësi/ja mund të përdorë fillimisht një rreth kartoni apo pjatë plastike të ngjyrosur me një ngjyrë, apo me shumë ngjyra ku ngjason në një tortë apo picë. Duke e palosur përgjysmë në shumë mënyra, dhe duke sqaruar këtë mundësi të palosjes përgjysmë në shumë mënyra, bëhet e qartë për nxënësit se një objekt apo një figurë mund të ketë më tepër se një drejtëz simetrie. Hapi II – Aktivitet në dyshe Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në dyshe, ashtu siç janë të sistemuar nëpër banka. Secila dyshe merr nga një fletë të bardhë A/4 dhe ndërton në të një listë të objekteve që kanë më shumë se një drejtëz simetrie. Lista ndërtohet duke filluar nga provat konkrete që nxënësit i bëjnë me palosjen e një flete, pastaj duke udhëzuar ata të mendojnë se në sa mënyra mund ta palosin përgjysmë fletoren, librin, tabelën e klasës, derën e klasës, bankën etj. Listat e ndërtruara me bashkëpunim në dyshe, lexohen dhe komentohen në nivel klase. Hapi III – Punë me libër	



Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 119 dhe 120 Me punë individuale analizojnë dhe plotësojnë kërkesat e parashtruara në detyrat e prezantuara në libër. Që të gjitha detyrat trajtojnë konceptin e drejtëzës (drejtëzave) të simetrisë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës në diskutim, aktivitet dhe punë në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e tij/saj.

TEMA: Modelet	
NJËSIA MËSIMORE: Modelet	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2 - Zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësime; 6.3 - Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme;	
FJALËT KYÇE: Modele, rregull, varg, përsëritje etj.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Zbaton formula të thjeshta për të plotësuar vargun numerik.	
REZULTATET E ORËS Diskuton për rregullat e përsëritjes së figurave të ndryshme; Eksploron modele të ndryshme në mjedisin ku jeton; Zbulon rregullat dhe aplikon modelet në situata të ndryshme.	KRITERET E SUKSESIT: Diskuto për rregullat e përsëritjes së figurave të ndryshme; Analizo modele të ndryshme në mjedisin ku jeton; Zbulon rregullat dhe aplikon modele në situata të ndryshme.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, letra të prera me figura të ndryshme, fletë të bardha A4, lapsi, goma, ngjyr	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja ka përgatitur paraprakisht disa figura nga copat e letrave të prera si katrorë, rrrathë, forma lulesh, drejtkëndësha, numra etj. Së bashku me nxënësit diskutojnë për rregullat e përsëritura me anë të të cilave fitohen modelet dhe në të njëjtën kohë ndërtojnë së bashku modele të ndryshme me radhitjen dhe përsëritjen e figurave nga copat e letrës. Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë rreshtimet dhe modelet e krijuara. Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër faqe 122 dhe faqe 123. Së pari analizohet ilustrimi në faqen 122 dhe diskutohen e përshkruhen rregullat që kanë përdorur fëmijet në ilustrim për të ndërtouar modelet me blloqe. Në detyrën 2 të faqes 123 diskutohet për modelet reale që mund të gjenden gjithandej në jetën e përditshme. Në një diskutim të përbashkët nxënësit eksplorojnë modele të cilat mund t'i gjejnë në klasë apo në shtëpi. Me punë individuale nxënësit analizojnë dhe plotësojnë kërkesat e parashtruara në detyrën 3. Hapi III – Punë në fletore Nxënësit vazhdojnë punën në fletore. Duke përdorur katrorët e fletores dhe ngjyrat ndërtojnë modele të ndryshme të cilat i prezantojnë para klasës.	

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës në diskutim, aktivitet dhe punë në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.

TEMA: Modelet	
NJËSIA MËSIMORE: Modele me gjëra reale	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2 - Zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësime; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehje pune; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehjeve matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Modele, rregull, klasifikim, veti, përsëritje etj.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Klasifikon objektet sipas vetive të tyre.	
REZULTATET E ORËS Identifikon rregullat e përsëritjes së figurave të ndryshme; Eksploron modele të ndryshme në mjedisin ku jeton; Zbulon figurën e radhës duke aplikuar rregullat.	KRITERET E SUKSESIT: Identifikoj rregullat e përsëritjes së figurave të ndryshme; Eksploro modele të ndryshme në mjedisin ku jeton; Zbuloj figurën e radhës duke aplikuar rregullat.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, objekte të ndryshme reale në klasë, fletë të bardha A4, lapsi, goma, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta dhe puna; Jeta e përditshme	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Kuiz Mësimdhënësi/ja ka përgatitur paraprakisht disa fotografi kafshësh, sendesh, mjetesh shkollorë etj. të printuara të cilat nxënësit duhet t'i presin me gërrshërë dhe t'i vendosin me ngjitës në fletë A4 duke krijuar modele të ndryshme. Varësisht nga modeli që kanë krijuar ata duhet të lënë disa nga figurat që janë pjesë e modelit pa ngjitur. Me përfundimin e modelit secili nxënës del para tabelës dhe prezanton modelin e dhënë. Ai zgjedh një nxënës tjetër që të përcaktojë se cila figurë/fotografi do të duhej të ngjitet në rreshtin e figurave. Secili nxënës parashtron një detyrë për dikë dhe po ashtu i përgjigjet kërkesës së dikujt për të zbuluar figurën e radhës. Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër faqe 124. Analizohet ilustrimi në faqen 124 dhe zbulohet figura që vjen me radhë. Hapi III – Punë në fletore Nxënësit vazhdojnë punën në fletore. Nxënësit krijojnë modele dhe shkëmbejnë fletoret me shoqen/shokun e bankës duke vazhduar modelet e krijuara nga njëri-tjetri. Me përfundim të detyrës analizojnë e diskutojnë punën e bërë si dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.	

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës në aktivitetet dhe në punë në libër e në fletore, duke vlerësuar shkathtësinë për të klasifikuar dhe zbuluar rregullat e një modeli të caktuar.

TEMA: Modelet	
NJËSIA MËSIMORE: Modele me numra	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2 - Zbaton shprehjet të arsyetimit për të bërë hamendësime; 6.3 - Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme;	
FJALËT KYÇË: Modele, rregull, përsëritje, varg, numra etj.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Zbaton formula të thjeshta për të plotësuar vargun numerik.	
REZULTATET E ORËS Zbulon rregullat e modeleve të ndryshme me numra; Plotëson vargjet e numrave sipas rregullave përkatëse; Krijon modele të numrave në boshtin numerik.	KRITERET E SUKSESIT: Zbulon rregullat mbi të cilat janë krijuar modelet e numrave; Plotëson vargjet e numrave sipas rregullës përkatëse; Përdor boshtin numerik për të paraqitur modelet e ndryshme me numra.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, projektor ose hamer, fletë të bardha A4 të prera në formë shiriti, lapsi, goma, ngjyra.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësuesi/ja fton disa nxënës të tabela dhe i rreshton një vajzë, një djalë, një vajzë, një djalë dhe kërkon nga nxënësit të vazhdojnë të rreshtohen sipas asaj rregulle. Kështu arrihet deri te koncepti i vargut dhe i rregullës. Pas kësaj, mësuesi/ja mund të fillojë rreshtimin e nxënësve edhe sipas gjatësisë duke filluar nga ai me gjatësi më të vogël. Mësuesi/ja formon një varg në tabelë, p.sh.: 1, 5, 9, 13, dhe kërkon nga nxënësit të zbulojnë rregullën se si është kaluar nga numri 1 në numrin 5 e kështu me radhë. Të njëjtën gjë e bëjnë edhe me një shembull ku rregulli i numrave të vargut lidhet me zbritjen e numrave. Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër në faqe 126, ku nxënësit në detyrën 1, 2, 3 dhe 4 duhet të zbulojnë rregullat dhe të plotësojnë vargjet e numrave duke zbatuar rregullat përkatëse. Vazhdohet në detyrën 5, ku nxënësit duhet të zbulojnë rregullën duke analizuar boshtin numerik e pastaj plotësojnë numrat që mungojnë. Hapi III – Punë në fletore Nxënësit vazhdojnë punën në fletore, shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe krijojnë vargjet numerike për shoqen/shokun duke kërkuar që pas kthimit të fletorës, secili të zbulojë me cilët numra duhet të vazhdohet vargu numerik bazuar në rregull. Me përfundim të detyrës nxënësit në çifte brenda bankave analizojnë e diskutojnë punën e bërë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.	

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës në aktivitet dhe punë në libër e në fletore, duke vlerësuar shkathhtësinë për të zbuluar rregullat e vargjeve numerike dhe për të vazhduar vargjet me numra të duhur.

TEMA: Modelet	
NJËSIA MËSIMORE: Modele me blloqe	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 – Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 6.1 – Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme; 6.2 – Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive. 6.3 - . Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme;	
FJALËT KYÇË: Modele, rregull, përsëritje, varg, numra	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: Klasifikon objektet sipas vetive të tyre.	
REZULTATET E ORËS Demonstron modele duke përdorur blloqet; Plotëson modelet me blloqe duke klasifikuar sipas ngjyrës; Krijon modele me blloqe të ndryshme.	KRITERET E SUKSESIT: Demonstro modele duke përdorur blloqet; Plotëso modelet me blloqe duke klasifikuar sipas ngjyrës; Krijon modele me blloqe të ndryshme.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2A, fletë e bardhë A4, fletorja, lapsi, goma, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Jeta.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE: Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja shpërndan fleta A4 për secilin nxënës. Nxënësit vizatojnë sipas dëshirës modele me blloqe. Disa prej nxënësve prezantojnë para klasës modelet e krijuara. Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër në faqe 127, ku nxënësit kanë për detyrë të ngjyrosin modelet sipas blloqeve me ngjyra të dhëna. Gjithashtu evidentojnë numrin e blloqeve të përdorura për secilin model. Hapi III – Punë në fletore Nxënësit vazhdojnë punën në fletore, duke përdorur katrorët e fletores për të punuar modele të ndryshme kreative dhe autonome. Disa prej nxënësve prezantojnë para klasës modelet e krijuara në fletore.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Fletë pune nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo material i përgatitur nga mësimdhënësi/ja.	
VLERËSIMI: Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës në aktivitet, në punë në libër dhe në fletore, duke vlerësuar shkathtësinë për të krijuar modele me blloqe.	



TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Kuptimi dhe shenja e shumëzimit	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>2.2 - Zbaton shprehje të arsytimit për të bërë hamendësime;</p> <p>3.1 - Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇË: Grupe, objekte, shumëzimi, shenja e shumëzimit	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë strategji të ndryshme (mbledhjen e pësëritur, rreshtimet etj) për ta gjetur prodhimin e numrave (prodhimi <math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbaton shumëzimin për numërimin e objekteve të ndara në grupe të njëjta;</li> <li>• Përdor mbledhjen e pësëritur për të kryer shumëzimin;</li> <li>• Përdor shenjën e shumëzimit.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbato shumëzimin për numërimin e objekteve të ndara në grupe të njëjta;</li> <li>• Përdor mbledhjen e pësëritur për të kryer shumëzimin;</li> <li>• Përdor shenjën e shumëzimit.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor apo fletë hameri, objekte të ndryshme që gjenden në klasë, petëza, lapsi, goma, tabela, markeri.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA, ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shogëria dhe mjedisi	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Qëllimi i kësaj ore, si edhe të gjitha orëve tjera të ndërlidhura me konceptin e shumëzimit është që nxënësit të kuptojnë këtë koncept e jo vetëm të memorizojnë procedurat e shumëzimit. Së pari, mësindhënësi/ja në bashkëpunim me nxënësit, formon disa grupe të njëjta. Grupet e tilla mund të formohen nga çfarëdo lloj objektesh që gjenden në klasë, ose në çanta të nxënësve. Mund të përdoren edhe petëzat. Pas formimit të disa grupeve të njëjta (psh: 4 grupe me nga 5 objekte), fillon diskutimi se si është më së lehti të bëhet numërimi i objekteve në gjitha grupet. Sigurisht që nxënësit do të parashtrajnë ide të ndryshme për mënyrat e numërimit të numrit të</p>	

përgjithshëm të objekteve. I detë duhet të diskutohen një nga një. Sigurisht që një prej ideve që nxënësit vetë do t'i parashtrijnë do të jetë mbledhja e përsëritur e katër pesësheve. Dmth  $5+5+5+5=20$ . Sigurisht, prej këtu, mësimitdhënësi/ja do ta ketë shumë të lehtë që kësaj mbledhjeje të përsëritur t'i referohet si 'katër pesëshe bëjnë 20'. Mësimitdhënësi/ja kërkon tani nga nxënësit që me anë të petëzave të formojnë në bankat e veta, në dyshe, nga disa grupe të njëjta. Më tutje, kërkon që numrin e përgjithshëm të objekteve ta gjejnë me anë të mbledhjes së përsëritur, duke u kujdesur që fjalori me të cilin i referohen mbledhjes së përsëritur të jetë si në shembullin e mësipërm.

#### Hapi II – Punë me libër/ Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 6 dhe 7. Analizohet ilustrimi në faqen 6 dhe diskutohen pemët e paraqitura duke numëruar numrin e frutave. Në detyrën 1 nxënësit duhet të numërojnë frutat dhe të shënojnë numrin e frutave si mbledhje e përsëritur si p.sh  $5+5+5+5=20$ . Një të vazhdohet edhe me ilustrimet tjera të paraqitura te detyra 1. Në detyrën 2 analizohet se sa zogj janë nëpër çerdhe dhe këtë e paraqesin përmes barazimeve të mbledhjes së përsëritur. Ngjashëm punohet edhe në detyrën 3. Në një diskutim të përbashkët nxënësit eksplorojnë edhe modele të tjera të cilat ata i gjejnë në klasë apo në mjedise të tjera. Mësimitdhënësi/ja në këtë rast e rithekson se mbledhja e përsëritur e grupeve të barabarta paraqet shumëzimin dhe në tabelë e shënon shembullin  $3+3+3+3+3=15$ . Përmes këtij shembulli, mësimitdhënësi/ja tregon që mbledhja e përsëritur mund të shkruhet edhe si shumëzim ( $3+3+3+3+3=15$  ose  $5 \cdot 3 = 15$ ). Po ashtu, mësimitdhënësi/ja tregon për nxënësit se shenja e shumëzimit është • por mund ta gjeni edhe si x dhe lexohet HERË.

#### Hapi III – Punë e pavarur në libër

Nxënësit vazhdojnë punën në faqen 8, ku në detyrën 1 duhet të numërojnë se sa ëmbëlsira janë në secilën kuti. Në detyrën 2 duhet të numërohen pikat te mollëkuqet. Në detyrën 3, 4 dhe 5 analizojnë ilustrimet dhe shkruajnë detyrat si mbledhje e përsëritur dhe si shumëzim. Analizojnë detyra e zgjidhura në çifte dhe më pas zgjidhjet diskutohen në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performansën e secilit nxënësi në diskutim, aktivitet dhe punë në libër, duke shqyrtuar së bashku zgjidhjet përfundimtare.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me grupe të barabarabarta	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjë, ngjyrat, numëroren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Grupe të njëjta, objekte, shumëzim, numër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj) për ta gjetur prodhimin e numrave (prodhimi <math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkruan barazimet e shumëzimit përmes grupeve të barabarta;</li> <li>• Plotëson diagramet me grupe të njëjta sipas barazimeve të dhëna.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkruaj barazimet e shumëzimit sipas ilustrimeve të dhëna;</li> <li>• Plotëso diagramet me grupe të njëjta sipas barazimeve të dhëna.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor apo fletë hameri, objekte të ndryshme që gjenden në klasë, petëza, shkopinj, rrëmojsa, fasule, lapsi, goma, tabela, markeri, gota plastike.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shogëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja paraprakisht ka marrë gota plastike dhe nxënësve të ulur në banka ju shpërndanë një sasi të gotave plastike. Përsëmbull, një çifti u jep 4 gota, një çifti tjetër 5 gota etj. Më pas, varësisht prej mjeteve që posedon në klasë, ju shpërndanë çifteve shkopinj, fasule, rrëmojsa, petëza etj. Tani mësimdhënësi/ja ju kërkon që secili grup të vendosin nga 5 objekte që posedojnë në secilën gotë. Varësisht nga numri i gotave të shpërndara në çifte, nxënësit do të paraqesin grupet	



e formuara. Më pas, mësimitdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të gjejnë numrin e të gjitha objekteve që kanë vendosur brenda gotave. Meqë nxënësit kanë mësuar të paraqesin shembuj të tillë si mbledhje e përsëritur, lehtësisht do ta paraqesin barazimin që përkon me punën e tyre. Mësimitdhënësi/ja duke u ndërlidhur në shembujt e punuar nga nxënësit, sqaron për ta se shumëzimin mund ta gjejnë duke vizatuar grupe të barabarta. Pra, nxënësit njoftohen se një prej mënyrave që mund ta përdorin ata për kryerjen e veprimit të shumëzimit është vizatimi i grupeve të barabarta dhe numërimi i sasisë së përgjithshme të objekteve në to. Ky është thelbi i përmbajtjes që duhet të zhvillohet gjatë kësaj ore mësimore.

### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 9. Në detyrën 1 nxënësit duhet të numërojnë kërpudhat dhe të tregojnë se sa grupe të barabarta janë dhe sa kërpudha ka secili grup. Kështu duke analizuar grupet dhe numrin e elementeve brenda tyre, mësimitdhënësi/ja tregon se për ilustrimin e dhënë mund të shkruajmë  $3 \cdot 2 = 6$ .



Nxënësit analizojnë dhe diskutojnë paraqitjen e grupeve të njëjta në bazë të ilustrimeve të dhëna në detyrat e tjera dhe i shkruajnë si shumëzim të dy numrave.

### Hapi III – Punë në libër

Nxënësit vazhdojnë punën e pavarur në faqe 10. Në detyrat 1, 2 dhe 3 nxënësit plotësojnë ilustrimet dhe kryejnë shumëzimin. Në detyrën 4 dhe 5 duhet të kryejnë shumëzimin duke plotësuar/vizatuar grupet e barabarta. Në çifte analizojnë detyrat e zgjidhura dhe për çdo vështirësi diskutohet në mënyrë të përbashkët me mësimitdhënësin/en.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të paraqitjes së grupeve të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të shumëzimit.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi si mbledhje e përsëritur	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; 5.1 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Mbledhja e përsëritur, numër, shumëzim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj) për ta gjetur prodhimin e numrave (prodhimi <math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë mbledhjen e përsëritur për të kryer shumëzimin;</li> <li>• Ndërlidh shumëzimin me mbledhjen e përsëritur;</li> <li>• Paraqet barazimet e shumëzimit me ndihmën e mbledhjes së përsëritur.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor mbledhjen e përsëritur për të kryer shumëzimin;</li> <li>• Ndërlidh shumëzimin me mbledhjen e përsëritur;</li> <li>• Paraqit barazimet e shumëzimit me ndihmën e mbledhjes së përsëritur.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor apo fletë hameri, objekte të ndryshme që gjenden në klasë, petëza, shkopinj, rrëmojsa, fasule, fletë A4, lapsi, goma, tabela, markeri, gota plastike.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Shqyrtim i përbashkët/Lojë në çifte Në këtë orë, nxënësit do të mësojnë që përgjigjet në problemet e shumëzimit mund t'i gjejnë edhe në mënyra tjera, përveç vizatimit të grupeve të njëjta. Një nga mënyrat është duke shënuar barazimet e mbledhjes së përsëritur, pa përdorur fare diagrame apo vizatime. Natyrisht, mbledhja e përsëritur është lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me kuptimin e shumëzimit në orën e parë kur nxënësit kanë mësuar për shumëzimin, mirëpo, tani përforcojnë faktin se çdo barazim dhe problem i shumëzimit mund të kthehet drejtpërdrejt në mbledhje të përsëritur. Ky është thelbi i përmbajtjes që duhet të zhvillohet gjatë kësaj ore mësimore, sa i përket mbledhjes	

së përsëritur. Mësimdhënësi/ja fillon orën e mësimit me paraqitjen e një barazimi të shumëzimit në tabelë, i cili, zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndihmën e mbledhjes së përsëritur. Tani mësimdhënësi/ja ju kërkon që secili çift duke përdorë gotat dhe shkopinjët apo manipulant të tjerë të paraqes një detyrë që pastaj shoqja/shoku ta paraqes në fletë si mbledhje të përsëritur. Më pas ndrohen rolet dhe nxënësi tjetër praqet një detyrë për shoqen/shokun me manipulant ajo/ai duhet ta zgjidh si mbledhje e përsëritur në fletë.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 11. Në detyrën 1 nxënësit duhet të plotësojnë barazimet bazuar në mbledhjen e përsëritur, si p.sh  $5+5+5= 15$ . Në detyrën 2 kryejnë shumëzimin me anë të mbledhjes së përsëritur. Në detyrën 3 dhe 4 kërkohet të kryhen detyra që kanë të bëjnë me njehsimin e shumëzimit si dhe ndërlidhjen me paraqitjen e shumëzimit si mbledhje e përsëritur. Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur edhe me detyrat e faqës 12.

#### Hapi III – Aktivitet me sajuese

Nxënësit vazhdojnë punën me një aktivitet. Mësimdhënësi/ja ka përgatitur fleta të cilat janë të prera në formë të sajueseve (puzzle). Mësimdhënësi/ja ju shpërndanë nxënësve në kuverta pjesëzat e prera dhe kërkon që të bashkojnë pjesën e barazimit me mbledhjen e përsëritur që i përgjigjet barazimit. Rezultatet diskutohen në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performansën e secilit nxënës në diskutim, aktivitet dhe punë në libër, duke vlerësuar ndërlidhjen e shumëzimit me mbledhjen e përsëritur.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi në bosht	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes; IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh; 5.1 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇË: Mbledhja e përsëritur, boshti numerik, numër, shumëzim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj) për ta gjetur prodhimin e numrave (prodhimi <math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë boshtin numerik si strategji e shumëzimit;</li> <li>• Zgjidh detyra të ndryshme duke aplikuar boshtin numerik;</li> <li>• Paraqet barazimin e shumëzimit duke analizuar boshtin numerik.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor boshtin numerik si strategji e shumëzimit;</li> <li>• Zgjidh detyra të ndryshme duke aplikuar boshtin numerik;</li> <li>• Paraqit barazimet e shumëzimit nga boshti numerik.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor apo fletë hameri, bosht numerik në dysHEME, tekstet, lapsi, goma, tabela, markeri.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Në këtë orë, nxënësit do të mësojnë që përgjigjet në problemet e shumëzimit mund t'i gjejnë edhe në mënyra tjera, përveç vizatimit të grupeve të njëjta, mbledhjes së përsëritur mënyra tjetër për kryerjen e shumëzimit është përdorimi i boshtit numerik. Shumëzimi përmes boshtit numerik është, si edhe strategjitë e mëhershme, mjaft e thjeshtë dhe e lehtë për përdorim. Këtu zbatohet si aktivitet në klasë apo në oborrin e shkollës duke përdorur boshtin numerik në dysHEME apo duke e vizatuar me shkumës në oborr. Njëri faktor paraqet gjatësinë e hapave (kërcimeve), tjetri faktor paraqet numrin e hapave. Duhet pasur kujdes faktin që të ketë aktivitete reale në bosht numerik dhe paraqitje të boshteve numerike në tabelë, që vijnë si përgjigje në detyrat e shtruara të shumëzimit.	

Tani mësimdhënësi/ja ju kërkon që secili çift duke përdorë gotat dhe shkopinjët apo manipulant të tjerë të paraqes një detyrë që pastaj shoqja/shoku ta paraqes në fletë si mbledhje të përsëritur. Më pas ndrohen rolet dhe nxënësi tjetër praqet një detyrë për shoqen/shokun me manipulant ajo/ai duhet ta zgjidh si mbledhje e përsëritur në fletë.

#### Hapi II – Punë me libër/ Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 13. Në detyrën 1 nxënësit duhet që duke shikuar boshtin numerik dhe pozitën e shigjetave të paraqesin detyrën si mbledhje të përsëritur dhe si shumëzim. Veprimtaria e njëjtë vazhdohet edhe në detyrën 2.

#### Hapi III – Punë e pavarur në libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër në faqen 14. Në detyrën 1 kërkohet të kryejnë shumëzimin dhe të paraqesin atë me mbledhje të përsëritur. Në detyrën 2 janë dhënë detyra të ndryshme ku kërkohet të kryhet shumëzimi duke përdorur boshtin numerik.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performancën e secilit nxënës në diskutim, aktivitet dhe punë në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin personal.



TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me rreshtime	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.4 - Përdor fjalorin ffilestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 5.1 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Rreshtimi, diagram, shumëzim, numër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj) për ta gjetur prodhimin e numrave (prodhimi <math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbaton rreshtimin si strategji për shumëzim;</li> <li>• Ndërton rreshtim sipas barazimit të shumëzimit;</li> <li>• Ndërton barazimin e shumëzimit sipas rreshtimit të dhënë.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbato rreshtimin si strategji për shumëzim;</li> <li>• Ndërto rreshtim sipas barazimit të shumëzimit;</li> <li>• Ndërto barazimin e shumëzimit sipas rreshtimit të dhënë.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, objekte të ndryshme që gjenden në klasë, manipulativë të ndryshëm, petëza, lapsi, goma, tabela, markeri.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Në këtë orë, nxënësit do të mësojnë që përgjigjet në problemet e shumëzimit mund t'i gjejnë edhe në mënyra tjera. Strategji shumë e përshtatshme për kryerjen e veprimit të shumëzimit është edhe rreshtimi. Nxënësit gjatë kësaj ore mësojnë që barazimet e shumëzimit në mënyrë shumë efektive mund të modelohen dhe të zgjidhen me anën e rreshtimeve. Si rreshtimi, ashtu edhe të gjitha strategjitë e përmendura më herët shërbejnë që nxënësit ta kuptojnë në thelb konceptin e shumëzimit dhe të mund ta zbërthejnë e ta kryejnë atë, ashtu si ju konvenon. Natyrisht, gjithçka fillon përmes aktiviteteve reale. Duke shkruar në tabelë një barazim të shumëzimit, mësuesi/ndihmësi/ja me asistencën e nxënësve, demonstroi rreshtimin e ndonjë manipulativ në bankën e saj. Si manipulativë mjaft të përshtatshëm për këtë punë janë kubëzat me shumë lidhje, ndonjë lloj tjetër i kubëzave ose petëzat. Poashtu, për demonstrimin e rreshtimit mund të shërbejnë edhe disa prej nxënësve të cilët thirren të dalin para klasës dhe rreshtohen sipas nevojës. Përshembull, shumëzimi $4 \cdot 5$ mund të përfaqësohet me katër rreshta	

me nga pesë kubëza, petëza ose nxënës. Pas numërimit të objekteve ose nxënësve, shenohet në tabelë rezultati i shumëzimit. Puna vazhdon në atë mënyrë që mësuesja parashtron barazimet e shumëzimit në tabelë, ndërsa nxënësit formojnë rreshtimet përmes manipulativëve, në dyshe nëpër banka. Diskutimet duhet të jenë të gjëra dhe të thellësishme pas zgjidhjes së secilit barazim.

#### Hapi II – Punë me libër/ Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 15. Në detyrën 1 nxënësit duke analizuar ilustrimin duhet të paraqesin barazimin e shumëzimit. Veprimtaria e njëjtë vazhdohet edhe në detyrën 2 në të cilën kërkohet të formohet barazim sipas rreshtimit të dhënë, ndërsa në detyrën 3 kërkohet të formohet rreshtim sipas barazimit të dhënë.

#### Hapi III – Punë e pavarur në libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër në faqen 16. Në detyrat e dhëna nxënësit duhet të shkruajnë barazimet bazuar në rreshtimet e dhëna me ilustrim.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja fokusohet në ndërlidhjet që gjejnë nxënësit në mes të rreshtimeve dhe kuptimit të shumëzimit, aktivitetet dhe punë në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin personal.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Faktorët dhe prodhimi	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇË: Barazim, faktorë, prodhim, shumëzim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon në shprehje; faktorët, prodhimin, të pjesëtueshmin, pjesëtuesin dhe herësin e numrave natyror deri 100.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon faktorët në një barazim shumëzim;</li> <li>Emërton faktorët në një barazim shumëzim;</li> <li>Emërton prodhimin në një barazim shumëzim;</li> <li>Ndërton barazim të shumëzimit bazuar në ilustrime dhe kërkesa.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifiko faktorët në një barazim shumëzim;</li> <li>Emërto faktorët në një barazim shumëzim;</li> <li>Emërto prodhimin në një barazim shumëzim;</li> <li>Ndërto barazim të shumëzimit bazuar në ilustrimet dhe kërkesat e dhëna.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, goma, tabela, markeri.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Deri më tani, gjatë punës në barazime të shumëzimit, nxënësi iu është referuar numrave që ndodhen aty si numrat që shumëzohen ose rezultati i shumëzimit. Tani është koha që në fjalorin e nxënësve të futen termet – faktorë dhe prodhim. Mësimdhënësi/ja mund të përzgjedhë pesë nxënës dhe secilit prej tyre ua shpërndanë nga një fletë të formatit A4. Nëpër fleta gjenden elementet për formimin e një barazimi të shumëzimit, psh: $42, 6, 7, \cdot, =$ Mësimdhënësi/ja iu bën thirrje nxënësve që t'u ndihmojnë pesë nxënësve të rregullohen sipas radhës së duhur për ta formuar një barazim të shumëzimit me këto elemente ( $2 \cdot 7 = 14$ ose $7 \cdot 2 = 14$ ), derisa nxënësit e përzgjedhur mbajnë secili letrën e vet para vetes. Pasi të formohet barazimi i duhur, mësimdhënësi/ja diskuton për emërtimin e numrave brenda barazimit dhe tregon se vendi ku ndodhet numri brenda barazimit e përcakton emrin e tij: numrat që shumëzohen janë faktorë, rezultati është prodhimi.	

### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 17. Detyra 1 paraqet informimin për emërtimin e faktorëve dhe prodhimit. Në detyrën 2 nxënësit duke analizuar ilustrimin duhet të paraqesin barazimin e shumëzimit dhe të rrethojnë numrin që përfaqëson prodhimin. Veprimtaria e njëjtë vazhdohet edhe në detyrën 3 në të cilën kërkohet të formohet barazimi i shumëzimit dhe të rrethohet faktori i parë. Ndërsa në detyrën e 4 kërkohet të formohet barazimi sipas ilustrimit të dhënë dhe të rrethohet faktori i dytë. Në detyrën 5 kërkohet të formohen barazimet e shumëzimit duke veçuar faktorin e parë, të dytë dhe prodhimin.

### Hapi III – Punë në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore. Shkëmbejnë fletoret me shoqen/shokun e bankës dhe krijojnë barazime të shumëzimit duke veçuar faktorët dhe prodhimin.

Detyrat	Emërtimet
$7 \cdot 3 = 21$	7- faktori i parë 3- faktori i dytë 21- prodhimi

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet në emërtimet e faktorëve/ prodhimit kuptimit, aktivitetet dhe punë në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin personal.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Ndërrimi i vendit të faktorëve	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj, për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.2 - Zbaton shprehin të arsytimit për të bërë hamendësime; 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Faktorët, ndërrim i vendeve	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor rreshtimin për të paraqitur ndërrimin e vendeve të faktorëve;</li> <li>• Argumenton vetinë e ndërrimit të vendeve të faktorëve;</li> <li>• Zbaton vetinë e ndërrimit të vendeve të faktorëve.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor rreshtimin për të paraqitur ndërrimin e vendeve të faktorëve;</li> <li>• Argumento vetinë e ndërrimit të vendeve të faktorëve;</li> <li>• Zbato vetinë e ndërrimit të vendeve të faktorëve.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, objekte të ndryshme që gjenden në klasë, manipulativë të ndryshëm, petëza, fletë A4, lapsi, goma, tabela, markeri.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Kjo orë mësimore i kushtohet nxënies dhe zbatimit të vetisë komutative të shunëzimit të dy numrave, Me fjalë tjera, nxënësit duhet që në fund të orës mësimore ta kenë të qartë se shumëzimi i dy numrave gjithnjë jep të njëjtin rezultat, pa marrë parasysh cili është vendosur i pari e cili është vendosur i dyti. Pra, nxënësit duhet ta kuptojnë faktin që të shumëzimit, nuk është me rëndësi cili prej faktorëve merret si numri i grupeve dhe cili merret si numri i objekteve brenda grupit. Rezultati është krejtësisht i njëjtë. Kjo është ideja kryesore që duhet të përçohet. Për ta qartësuar më mirë këtë ftohen të dalin te tabela 8 nxënës. Nxënësit rreshtohen në dy rreshta me nga katër nxënës. Këtë e paraqesim si barazim në tabelë $2 \cdot 4$ dhe më pas po të njëjtit nxënës formojnë katër rreshta me nga dy nxënës dhe e shkruajmë barazimin në tabelë $4 \cdot 2$ . Gjejmë prodhimin e barazimeve dhe vërtetojmë se pavarësisht ndërrimit të vendeve të faktorëve prodhimi është i njëjtë. Më pas mund të përmendim edhe mënyrën e uljes në banka dhe ta paraqesim si barazim të shumëzimit. Rreshtimet janë mënyra më efikase e të kuptuarit	


të vetisë komutative të shumëzimit. Më pas paraqiten disa shembuj në tabelë dhe kërkohet nga nxënësit në dyshe që duke përdorur petëza apo manipulativë të ndryshëm të paraqesin shembuj lidhur me ndërrimin e vendeve të faktorëve.

**Hapi II – Punë me libër**

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 18. Detyra 1 kërkohet të analizojnë dy prodhimet e paraqitura me ilustrim dhe të vërtetojnë se ndërrimi i vendeve të faktorëve na jep prodhimin e njëjtë. Në detyrën 2 nxënësit duke analizuar ilustrimin duhet të paraqesin barazimin e shumëzimit duke ndërruar vendin e faktorëve dhe të ngjyrosin në tabelë rreshtimin e ri. Veprimtaria pothuajse e njëjtë vazhdohet edhe në detyrën 3 në të cilën kërkohet që duke shikuar barazimet të ngjyrosin rreshtimet në tabelë.

**Hapi III – Punë e pavarur në fletore /libër**

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore duke krijuar barazime të shumëzimit e duke veçuar ndërrimin e vendeve të faktorëve. Puna mund të vazhdohet me detyrat në faqen 19 për të ushtruar zbatimin e vetisë komutative në shumëzim.

Faktorët	Ndërrimi i vendeve të faktorëve
2 dhe 6	

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja fokusohet në zbatimin e vetisë komutative në shumëzim, aktivitet dhe punë në libër, duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin personal.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me 1 dhe 2	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinj të, ngjyrat, numëroren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë;</p> <p>6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>	
FJALËT KYÇE: Shumëzim, numër, objekt.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS:	KRITERET E SUKSESIT:
<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërton barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryen veprimin e shumëzimit me 1;</li> <li>Kryen veprimin e shumëzimit me 2.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërto barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit me 1;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit me 2.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, gota plastike, lapsa, markeri, tabela	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkathtësi për jetë	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:	
<p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet konkret. Mësimdhënësi/ja ka siguruar 10 gota plastike dhe poashtu njëzet lapsa ose shkopinj me të cilët do të bëjë shpjegimin e shumëzimit me 1 dhe 2. Fillimisht mësimdhënësi/ja do vendosë një gotë mbi tavolinë dhe në të do vendos një laps. Tani do parashtrij pyetjen “Sa lapsa ka në gotë?” Sigurisht se përgjigjia do jetë se në një gotë ka një laps. Pas përgjigjes së nxënësve, mësimdhënësi/ja shkruan barazimin e shumëzimit në tabelë <math>1 \cdot 1 = 1</math>.</p> <p>Vazhdon diskutimi duke shtuar edhe një gotë dhe sërish pyeten nxënësit “Sa lapsa ka në dy gota?” Pasi nxënësit të tregojnë se gjithsej kemi 2 lapsa, mësimdhënësi/ja shkruan barazimin e shumëzimit në tabelë, <math>2 \cdot 1 = 2</math>.</p> <p>Njëjtë vazhdon të shtohet numri i gotave dhe lapsave dhe në këtë mënyrë do të arrijmë të paraqesim tabelën e shumëzimit me 1.</p>	

### Hapi II – Punë me libër/Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 20. Detyra 1 është e ngjashme me aktivitetin në klasë. Në detyrën 2 nxënësit duhet të ngjyrosin rezultatin i cili përkon me detyrën e dhënë në kërcellin e kërpudhës. Veprimtaria pothuajse e njëjtë vazhdohet para se të kalohet në punë në faqen 21. Fillimisht zbatojmë aktivitetin me gota por tani duke vendosur nga dy lapsa në një kuti dhe duke parashtruar pyetjet pas çdo veprimi do të arrihet në përfundim të kuptimit edhe të tabelës së shumëzimit me 2. Tani nxënësit shikojnë ilustrimin në faqen 21 dhe duke numëruar qershitë do të gjejnë prodhimin e numrave me numrin 2. Në detyrën 2 do të plotësojnë numrat që mungojnë. Këtë mund të punojnë duke përdorur edhe manipulantë. Kjo detyrë shqyrtohet edhe në mënyrë të përbashkët me mësime të mësimdhënës/ën.

### Hapi III – Punë e pavarur në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore. Fletat e përgatitura, të ngjashme me këto në fotografi, nxënësit i presin me gërshtë dhe i ngjeshin me ngjites në fletore e më pas vazhdojnë punën duke plotësuar shumëzimin me 1 dhe 2.



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësime të mësimdhënës/ës/ësja.

**VLERËSIMI:** Mësime të mësimdhënës/ës/ësja fokusohet në vlerësimin e zbatimit të shumëzimit me 1 dhe 2 duke përdorur strategji të ndryshme, aktivitetet dhe punën në libër.





TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me 3	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjë, ngjyrat, numëroren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes; IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë; 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Shumëzim, numër, prodhim	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërton barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit me 3.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërto barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit 3.</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, pulla, pjata plastike, lapsi, tabela, fletorja, ngjyrat	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b>  Hapi I – Aktivitet konkret Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet konkret. Mësimdhënësi/ja ka siguruar 10 pjata plastike dhe poashtu pulla (shkopinj, fasule etj) me të cilët do të bëjë shpjegimin e shumëzimit me 3. Fillimisht mësimdhënësi/ja do vendosë një pjatë mbi tavolinë dhe në të do vendosë tri pulla. Tani do parashtrij pyetjen “Sa pulla ka në një pjatë?” Sigurisht se përgjigjia do jetë se në një pjatë ka tri pulla. Me shumëzim do ta shprehim si $1 \cdot 3 = 3$ . Tani vazhdohet duke shtuar edhe një pjatë me tri pulla dhe sërish pyeten nxënësit “Sa pulla ka në dy pjata?”. Sigurisht, nxënësit lehtësisht do të gjejnë që në 2 pjata ka 6 pulla. Me shumëzim e shënojmë $2 \cdot 3 = 6$ Njëjtë vazhdohet të shtohet numri i pjatave dhe pullave dhe në këtë mënyrë do të arrijmë të paraqesim tabelën e shumëzimit me 3.  Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 22. Detyra 1 është e ngjashme me aktivitetin në klasë. Nxënësit duke numëruar pullat shkruajnë barazimet e shumëzimit me 3. Në detyrën 2	

nxënësit duhet të ngjyrosin vetëm dhuratat apo stolitë që bartin rezultatet e shumëzimit me numrin 3. Pra duhet të ngjyrosen: 3, 6, 9, 12, 15, 18, 21, 24, 27, 30.


**Hapi III – Punë e pavarur në fletore**

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore. Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të krijojnë një tabelë në fletore dhe në njërën anë të paraqesin barazimet e shumëzimit me 3 ndërsa në anën tjetër të paraqesin ilustrimet që përkojnë me secilin barazim.


Shumëzimi	Paraqitja me ilustrim
$1 \cdot 3 = 3$	
$2 \cdot 3 = 3$	

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e zbatimit të shumëzimit me 3 duke përdorur strategji të ndryshme, aktivitet dhe punë në libër.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me 4	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjte, ngjyrat, numëroren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes; IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë; 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Shumëzim, numër, prodhim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërton barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit me 4.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërto barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit 4.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletorja, lapsi, goma, ngjyrat, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Shqyrtim i përbashkët Kjo orë mësimore fillon me zbatim të drejtpërdrejtë duke përdorur një shembull në tabelë dhe bashkë me nxënësit plotësohet duke analizuar hap pas hapi çdo veprim.	
Kërkesa	Zgjidhja
Kemi një bashkësi me katër banane. Sa banane kemi?  	$1 \cdot 4 = 4$  Ne kemi 4 banane.

Kemi dy bashkësi me katër banane.  
Sa banane kemi?



$$2 \cdot 4 = 8$$

Ne kemi 8 banane.

Kështu vazhdohet edhe më tutje deri sa të arrijmë deri te prodhimi 40.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 23. Detyra 1 është e ngjashme me aktivitetin në klasë. Nxënësit duke numëruar bananet shkruajnë barazimet e shumëzimit me 4. Në detyrën 2 nxënësit duhet të gjejnë se sa banane ka në pako dhe të lidhin me etiketën përkatëse.

#### Hapi III – Punë e pavarur në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore. Secili nxënës paraqet tri detyra të ndryshme lidhur me shumëzimin me 4. Pastaj nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun/shoqen dhe vlerësojnë njëri-tjetrin për saktësinë e zgjidhjes së detyrave.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e zbatimit të shumëzimit me 4 duke përdorur strategji të ndryshme, aktivitet dhe punë në libër.

TEMA: Numrat natyrorë							
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me 5							
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;</p> <p>V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).</p>							
<p><b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b></p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune;</p> <p>6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>							
FJALËT KYÇE: Shumëzim, numër, prodhim							
<p><b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>							
<p><b>REZULTATET E ORËS:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërton barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit me 5.</li> </ul>	<p><b>KRITERET E SUKSESIT:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërto barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit 5.</li> </ul>						
<p><b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, lapsi, goma, tabela, markeri</p>							
<p><b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Edukata fizike sportet dhe shëndeti.</p>							
<p><b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b></p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet të thjeshtë. Ftohet një nxënës që të dalë para nxënësve të tjerë dhe shtrohet pyetja: “Sa gishta ka një dorë?”. Nxënësi ngrit dorën lart dhe nxënësit tjerë mbajnë shënim në një fletë A4.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 50%;">Kërkesa</th> <th style="width: 50%;">Zgjidhja</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">Sa gishta ka një dorë?</td> <td style="text-align: center;"><math>1 \cdot 5 = 5</math></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Sa gishta kanë dy duar?</td> <td style="text-align: center;"><math>2 \cdot 5 = 10</math></td> </tr> </tbody> </table> <p>Kështu vazhdohet edhe më tutje deri sa të arrijmë deri te prodhimi 50.</p>		Kërkesa	Zgjidhja	Sa gishta ka një dorë?	$1 \cdot 5 = 5$	Sa gishta kanë dy duar?	$2 \cdot 5 = 10$
Kërkesa	Zgjidhja						
Sa gishta ka një dorë?	$1 \cdot 5 = 5$						
Sa gishta kanë dy duar?	$2 \cdot 5 = 10$						

### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 24. Detyra 1 është e ngjashme me aktivitetin në klasë. Nxënësit duke numëruar gishtërinjtë shkruajnë barazimet e shumëzimit me 5. Në detyrën 2 nxënësit duhet të gjejnë dhe ngjyrosin rezultatet e shumëzimit.

### Hapi III – Loja “Peshkaqeni”

Nxënësit vazhdojnë lojën “Peshkaqeni”. Peshkaqeni paraqet një barazim, p.sh:  $2 \cdot 5$ . Nxënësit duhet të vrapojnë për të bashkuar duart në mënyrë që të formojnë prodhimin e barazimit të dhënë. Më pas duhet të ngriten lart duart e bashkuara. Për barazimin  $2 \cdot 5$  që paraqet prodhimin 10, atëherë një nxënës mund të ngritë lart dy duart e tij të bashkuara apo mund të bashkojë dorën e tij me dorën e një nxënësi tjetër. Ata që nuk kanë paraqitur prodhimin e saktë largohen nga loja apo konsiderohet që i ka gëlltitur peshkaqeni.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e zbatimit të shumëzimit me 5 duke përdorur strategji të ndryshme, aktivitet dhe punë në libër.

TEMA: Numrat natyrorë

NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me 6

KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:

III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;

III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;

IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:

1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;

2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;

3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë;

6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

FJALËT KYÇE: Shumëzim, numër, prodhim

REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:

- Gjen prodhimin dhe herësin e numrave ( $\leq 50$ );

REZULTATET E ORËS:

- Ndërton barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;
- Kryej veprimin e shumëzimit me 6.

KRITERET E SUKSESIT:

- Ndërto barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;
- Kryej veprimin e shumëzimit 6.




BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, goma, tabela, marker, gërsërë, ngjithësi, projektori, laptopi

LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:

Hapi I – Aktivitet konkret

Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet të përgatitur paraprakisht nga mësimdhënësi/ja. Nxënësit ndahen në grupe me nga 4 nxënës. Mësimdhënësi ka përgatitur detyrat lidhur me shumëzimin e numrave me numrin 6 në sajueset (puzzle) të prera ngjashëm si modelet më poshtë, të cilat janë të ndryshme dhe ju shpërndahen grupeve. Kërkohet nga grupet e nxënësve që brenda një kohe të caktuar të bashkojnë pjesët e sajueseve që të fitojnë barazinë e saktë. Me përfundimin e punës grupore, nxënësit prezantojnë sajuset e formuara. Tani në mënyrë të përbashkët shënohen në tabelë barazimet e shumëzimit me 6.



### Hapi II – Punë me libër


Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 25. Në detyrën 1 kërkohet të numërohen pikat në zar. Nxënësit duke lexuar kërkesat e dhëna shkruajnë barazimet e shumëzimit me 6. Në detyrën 2 nxënësit duhet të paraqesin me shumëzim numrin e pikave në zare. Këto barazime mund t'i paraqesin në fletore.

### Hapi III – Mësojmë shumëzimin me gishtërinj

Nxënësit vazhdojnë të ndjekin një video që ua mëson shumëzimin me 6 duke përdorur duart.

Linku për video është:

<https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=nI373EFqBaY>



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e zbatimit të shumëzimit me 6 duke përdorur strategji të ndryshme, aktivitetet dhe punë në libër.




TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me 7	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë;</p> <p>6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>	
FJALËT KYÇE: Shumëzim, numër, prodhim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>);</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS:	KRITERET E SUKSESIT:
<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërton barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit me 7.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërto barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Kryej veprimin e shumëzimit 7.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, shkopinj, fasule, gota plastike lapsi, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:	
<p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet të përgatitur paraprakisht nga mësuesi/ndërmësi/ja. Nxënësit ndahen në grupe. Mësuesi ka përgatitur paraprakisht etiketa për secilin grup në të cilat janë paraqitur barazimet e shumëzimit me 7 (<math>3 \cdot 7</math>) apo si mbledhje e përsëritur (<math>7 + 7 + 7 + 7</math>). Secilit grup ju ndahen shkopinj apo fasule dhe ju kërkohet që varësisht nga kërkesa që kanë në etiketë të formojnë grupe të barabarta në gotat plastike. Më pas secili grup prezanton para klasës punën që kanë zbatuar. Çdo barazim shkruhet në tabelë dhe argumentohet ndërlidhja ndërmjet shumëzimit dhe mbledhjes së përsëritur.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 26. Në detyrën 1 kërkohet të numërohen topat e palaçove. Nxënësit duke lexuar kërkesat e dhëna shkruajnë barazimet e shumëzimit me 7. Në detyrën 2 nxënësit duke lidhur detyrat me rezultatet e tyre do të gjejnë topin e secilit palaço.</p>	

### Hapi III – Aktivitet në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore me një aktivitet në të cilin kërkohet që të ndërtohet figura duke zbuluar prodhimin. Secila pjesë përmbanë prodhimin e që duhet të pritët me gërshërë dhe të vendoset te katrori që paraqet shprehjen numerike të dhënë me shumëzim. Kur plotësohet në tërësi figura me pjesët e ngjitura, atëherë ngjyroset.


Linku për fletën e punës është:

<https://ëëë.pinterest.com/pin/4714774600743190/>



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja fokusohet për vlerësimin e zbatimit të shumëzimit me 7 duke përdorur strategji të ndryshme, aktivitet dhe punë në libër.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me 8	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë; 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Shumëzim, numër, prodhim.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: • Gjen prodhimin dhe herësin e numrave ( $\leq 50$ );	
REZULTATET E ORËS: • Ndërton barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale; • Kryej veprimin e shumëzimit me 8; • Krijon rreshtime lidhur me shumëzimin e numrave me 8.	KRITERET E SUKSESIT: • Ndërto barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale; • Kryej veprimin e shumëzimit 8; • Paraqit rreshtimet sipas katrorëve të fletores për barazimet e dhëna.
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, goma, tabela, marker, fletorja	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:	
<p>Hapi I – Aktivitet në fletore</p> <p>Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet. Nga nxënësit kërkohet që në fletoret e tyre të paraqesin barazimet duke përdorur katrorët e fletores. Barazimet duhet të jenë me tabelën e shumëzimit me 8 p.sh <math>2 \cdot 8</math>, <math>8 \cdot 3</math>, <math>5 \cdot 8</math>, <math>8 \cdot 4</math> etj.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 27. Në detyrën 1 kërkohet të numërohen këmbët e oktapodëve. Nxënësit duke lexuar kërkesat e dhëna shkruajnë barazimet e shumëzimit me 8. Në detyrën 2 nxënësit duhet të plotësojnë tabelën lidhur me shumëzimin e numrave. Zgjidhet e nxënësve diskutohen në nivel klase.</p> <p>Hapi III – Garë me shumëzim të numrave</p> <p>Secili nxënës do të paraqes 10 detyra lidhur me shumëzimin në fletore e më pas do t'i shkëmbejnë fletoret me shoqen/shokun e bankës. Nxënësi i cili do të zgjidhë saktë i pasi të gjitha detyrat do të jetë fitues i garës. Gara vazhdon sërish njësoj me pjesën tjetër të klasës, derisa të shpallet një fitues.</p>	

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja fokusohet për vlerësimin e zbatimit të shumzimit me 8 duke përdorur strategji të ndryshme, aktivitet dhe punë në libër.

TEMA: Numrat natyrorë

NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me 9

KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:  
III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;

III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;

IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:

1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;

2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;

3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë;

6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

FJALËT KYÇE: Shumëzim, numër, prodhim.

REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:

- Gjen prodhimin dhe herësin e numrave ( $\leq 50$ ).

REZULTATET E ORËS:

- Ndërton barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;
- Gjen prodhimin e numrave të ndryshëm njëshifrorë,

KRITERET E SUKSESIT:

- Ndërto barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;
- Gjej prodhimin e numrave të dhënë.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, tabelat me kapakë, fletë A4, lapsi, goma, tabela, marker, fletorja, ngjyrat

LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:

Hapi I – Aktivitet konkret  
Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet në klasë me anë të kapakëve të paketimeve të lëngjeve. Në kapakë janë të shënuara prodhimet mirëpo nuk janë të vendosura te tabela e cila përmbanë barazimet. Kapakët janë të përzier dhe secili nga nxënësit tërheq një kapak. Nxënësve ju kërkohet që të vendosin kapakët me prodhimet e shënuara te barazimi që përfaqëson.




### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 28. Në detyrën 1 kërkohet të numërohen fasulet. Nxënësit duke lexuar kërkesat e dhëna shkruajnë barazimet e shumëzimit me 9. Në detyrën 2 nxënësit duke bërë njehsime të sakta duhet të lidhin me shigjetë secilën pulë me zogjtë e saj.

### Hapi III – Puna në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore ose fletë A4 në të cilën kërkohet që të krijojnë barazime si shembulli i dhënë në fotografi.



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja fokusohet për vlerësimin e zbatimit të shumëzimit me 9 duke përdorur strategji të ndryshme, aktivitetet dhe punë në libër.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shumëzimi me 10 / Shumëzimi me 0	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë;</p> <p>6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>	
FJALËT KYÇE: Shumëzim, numër, prodhim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>);</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS:	KRITERET E SUKSESIT:
<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërton barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Gjen prodhimin e numrave njëshifrorë dhe numrit 10;</li> <li>Gjej prodhimin e numrave njëshifrorë dhe numrit 0.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërto barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve vizuale;</li> <li>Gjej prodhimin e numrave njëshifrorë dhe numrit 10;</li> <li>Gjej prodhimin e numrave njëshifrorë dhe numrit 0.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, gota plastike, shkopinj, fletë A4, lapsi, tabela, markeri, laptopi, projektori	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:	
<p>Hapi I – Shqyrtim i përbashkët</p> <p>Kjo orë mësimore fillon me një diskutim të përbashkët. Mësimdhënësi/ja vendos para nxënësve 10 gota plastike. Më pas pyet nxënësit “Nëse vendosim në secilën gotë nga një shkop, sa shkopinj kemi në dhjetë gota?”. Pas përgjigjes sigurisht se këtë do e shkruajmë edhe si barazim <math>10 \cdot 1 = 10</math>. Përsërisim aktivitetin duke shtuar nga dy shkopinj e kështu me radhë.</p> <p>Më pas në dhjetë gotat plastike të vendosura përpara pyesim nxënësit “Po sikur të mos vendosim asnjë shkop në një gotë, sa shkopinj kemi?”; “Po sikur të mos vendosim asnjë shkop në tri gota, sa shkopinj kemi?” Përgjigjia do jetë zero pra <math>1 \cdot 0 = 0</math>; <math>3 \cdot 0 = 0</math></p> <p>Nga ky shembull ritheksojmë se çdo numër që shumëzohet me zero prodhimi është zero.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 29 dhe 30. Në detyrën 1 në faqen 29 kërkohet të numërohen pikat e mollëkuqeve. Nxënësit duke lexuar kërkesat e dhëna shkruajnë barazimet e shumëzimit me 10. Në detyrën 2 nxënësit duhet të numërojnë pikat në mollëkuqe dhe të</p>	

paraqesin barazimet e shumëzimit për secilin ilustrim. Puna e nxënësve vazhdon edhe në faqen 30. Në detyrën 1, nxënësit do të punojnë duke u bazuar në ilustrimet e dhëna. Ngjashëm punohet edhe në detyrën 2.

Hapi III – Lojë në çifte/grupe

Nxënësit vazhdojnë me një lojë. Linku për lojën në fjalë është:

<https://matheasily.com/multiplication-board-games.html>

Kjo lojë luhet në çifte ose grupe dhe kërkohet që të hedhet zari dhe duke shkuar në rrathët që paraqesin detyra me shumëzim t'i zgjidhin ato dhe në rastin kur nuk është zgjidhur detyra saktë kthehet në pozicionin paraprak. Kush arrin i pari në fund është fitues.

Aktivitete për lojra të ndryshme mund të vizitohet këto vegza.



<https://ëëë.teachstarter.com/au/blog/8-magical-multiplication-activities-for-the-classroom/>

<https://toytheater.com/category/math-games/multiplication/>

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e zbatimit të shumëzimit me 10 dhe 0 duke përdorur strategji të ndryshme, aktivitetet dhe punë në libër.



TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme me fjalë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave; 2.2 - Zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësime; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shpreh punë; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Probleme, tekst, barazim, shumëzim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstron shkathhtësi dhe shpreh për zgjidhje të problemave;</li> <li>• Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor strategji të ndryshme për zgjidhjen e problemeve;</li> <li>• Zbaton shumëzim në probleme të ndryshme;</li> <li>• Argumenton zgjidhjen e detyrave lidhur me shumëzimin.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor strategji sipas dëshirës për zgjidhjen e problemeve;</li> <li>• Zbato shumëzim në probleme të ndryshme;</li> <li>• Argumento zgjidhjen e detyrave lidhur me shumëzimin.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, goma, ngjyrat, fletë A4, fletorja	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Diskutim i përbashkët Mësimdhënësi/ja do të ndajë nxënësit në grupe ku për secilin grup ka përgatitur nga një detyrë me fjalë. Psh: <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Një paketim vezësh zë 6 vezë. Sa vezë do të mund të paktohen nëse kemi 7 paketime?</li> <li>➤ Një lule ka 5 petale. Sa petale do të kenë 10 lule?</li> <li>➤ Në një klasë janë formuar 3 grupe me nga 9 nxënës. Sa nxënës janë në klasë?</li> <li>➤ Katër nxënës kanë nga 8 euro. Sa euro kanë gjithsej nxënësit?</li> </ul> Pasi grupet të përfundojnë punën, ata prezantojnë zgjidhjet e tyre para klasës dhe diskutohet me pjesën tjetër të klasës nëse kanë strategji tjera të cilat do t'i përdornin për zgjidhjen e detyrave në fjalë.  Hapi II – Punë me libër/ Shqyrtim i përbashkët Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 31 dhe 32. Gjatë kësaj ore mësimore, nxënësit duhet të punojnë në modelimin matematik dhe në zgjidhjen e problemeve të thjeshta me fjalë të cilat ndërlidhen me konceptin e shumëzimit.	

Gjatë procesit të modelimit të problemeve të paraqitura me fjalë, nxënësit duhet të jenë të lirë të përdorin manipulativë, vizatime e diagrame, si dhe strategji sipas dëshirës së tyre. Mund të punohet në mënyrë individuale, në çifte ose në grupe, por është e domosdoshme që zgjidhja e secilit problem me fjalë të bëhet në nivel klase. Gjatë zgjidhjes së problemeve, mësimitdhënësi/ja duhet të komunikojë me nxënës deri sa të verifikojë se secili nxënës, ose çifte ose grup e ka kuptuar problemin dhe kërkesat e problemit. Gjithashtu, edhe pse mënyra e zgjidhjes së problemeve realizohet sipas dëshirës së nxënësve, mësimitdhënësi/ja duhet të insistojë që secili nxënës të paraqes barazimin e shumëzimit – pra ta modelojë fillimisht problemin si barazim të shumëzimit. Kujdes i veçantë duhet t`i kushtohet provës së detyrës, reflektimit dhe lidhjes së rezultatit të fituar me kontekstin e detyrës.

### Hapi III – Punë e pavarur në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore. Nxënësit do të krijojnë një detyrë me fjalë lidhur me shumëzimin sipas dëshirës. Pasi të krijojnë detyrën me fjalë, duhet të paraqesin edhe zgjidhjen e atij problem.

Përmes ndonjë teknike përzgjidhen disa nxënës për të prezantuar punën e tyre para klasës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja fokusohet në mënyrën se si zgjidhin problemet me fjalë si dhe zbatimin e shumëzimit në detyra të ndryshme.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Ndërtojmë probleme	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; II.7 - Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave; 2.2 - Zbaton shprehje të arsytimit për të bërë hamendësime; 3.2 - Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor.	
FJALËT KYÇË: Probleme, tekst, barazim, shumëzim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;</li> <li>• Demonstron shkathtësi dhe shprehje për zgjidhje të problemave.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërton probleme me fjalë bazuar në ilustrimet e dhëna;</li> <li>• Shkruan barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve të dhëna.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërto probleme me fjalë bazuar në ilustrimet e dhëna;</li> <li>• Shkruaj barazimet e shumëzimit sipas paraqitjeve të dhëna.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletorja, fotografi të ndryshme, lapsi, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shogëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Diskutim i përbashkët Mësimdhënësi/ja do të përgatitë disa fotografi dhe do paraqesë para nxënësve ato duke ju kërkuar që në dyshe të ndërtojnë nga një problem me fjalë bazuar në fotografi. Nxënësit lexojnë problemet e ndërtuara duke i zgjidhur në mënyrë të përbashkët.  Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 33. Gjatë kësaj ore mësimore, nxënësit duhet të punojnë në zgjidhjen e problemeve të thjeshta me ilustrime të cilat ndërlidhen me konceptin e shumëzimit. Gjatë procesit të modelimit të problemeve të paraqitura me ilustrime, nxënësit duhet të jenë të lirë të përdorin manipulative, vizatime e diagrame, si dhe strategji sipas dëshirës së tyre. Mund të punohet në mënyrë individuale, në çifte ose në grupe, por është e domosdoshme që zgjidhja e secilit problem të bëhet në nivel klase. Gjatë zgjidhjes së problemeve, mësimdhënësi/ja duhet të komunikojë me nxënës deri sa të verifikojë se secili nxënës, ose çifte ose grup e ka kuptuar problemin dhe kërkesat e problemit. Gjithashtu, edhe pse mënyra e zgjidhjes së problemeve realizohet sipas dëshirës së nxënësve, mësimdhënësi/ja duhet të insistojë që secili nxënës të paraqes barazimin	

e shumëzimit – pra ta modelojë fillimisht problemin si barazim të shumëzimit. Kujdes i veçantë duhet t' i kushtohet provës së detyrës, reflektimit dhe lidhjes së rezultatit të fituar me kontekstin e detyrës.

### Hapi III – Punë e pavarur në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore. Nxënësit në çifte shkëmbejnë fletoret dhe krijojnë probleme me ilustrim për shokun apo shoqen dhe i zgjidhin në mënyrë të pavarur. Më pas rishikojnë zgjidhjet dhe analizojnë mënyrën e zgjidhjes.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet në mënyrën se si ndërtojnë dhe zgjidhin problemet si dhe zbatimin e shumëzimit në detyra të ndryshme.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Shoqërimi i faktorëve	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 6.3 - Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Faktor, numër, shoqërim, prodhim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave;</li> <li>• Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstron vetinë asociative duke përdorur materiale të ndryshme në zgjidhjen e detyrave;</li> <li>• Gjen prodhimin e tre numrave duke përdorur vetinë asociative.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstron vetinë asociative duke përdorur materiale të ndryshme në zgjidhjen e detyrave;</li> <li>• Gjej prodhimin e tre numrave duke përdorur vetinë asociative.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, kubëza, shufra, shkopinj, fletorja, lapsi, goma, projektori	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke shfaqur para nxënësve një video me anë të projektorit.  Linku për video është: <a href="https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=Ëëqxfm7EPcjo">https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=Ëëqxfm7EPcjo</a>  Gjatë kohës që mësimdhënësi/ja shfaq këtë video, mund të bëjë shkëputje herë pas herë dhe të diskutojë me nxënësit lidhur me shumëzimin e tre numrave. Pasi të kenë shikuar videon dhe të jetë diskutuar rreth vetisë së shoqërimit të faktorëve, mësimdhënësi/ja merr edhe disa shembuj tjerë në tabelë dhe fton nxënësit që të paraqesin zgjidhjet e atyre detyrave në fletoret e tyre. Zgjidhjet diskutohen në nivel klase. Shembuj të tillë merren derisa mësimdhënësi/ja sheh	

që të gjithë nxënësit e kanë kuptuar që faktorët mund të shoqërohen sipas dëshirës sepse prodhimi mbetet i njëjtë.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit hapin librin, faqe 34. Dhe ftohen të vendosin para vetës mjetet si kubëzat, shufrat apo shkopinjë. Në faqen 34 nxënësit në detyrën 1 bazuar në ilustrim analizojnë prodhimin duke zbatuar vetinë e shoqërimit të faktorëve që më pas të zgjidhin detyrat e paraqitura. Në detyrën 2 plotësojnë pjesët që mungojnë duke shoqëruar faktorët në mënyrë që të arrihet shumëzimi më lehtë.

#### Hapi III – Punë në çifte

Puna vazhdohet në fletore. Nxënësit shkëmbejnë fletoret në çifte dhe krijojnë detyra për shoqen/shokun e bankës. Më pas marrin detyrat e përgatitura dhe fillojnë të zgjidhin në mënyrë të pavarur duke aplikuar shoqërimit të faktorëve. Nxënësit mund të përdorin edhe mjetet për ta zgjidhur detyrën apo mund ta paraqesin atë përmes vizatimit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Nxënësit vlerësohen duke vëzhguar nëse zgjidhin saktë detyrat duke u bazuar në shkathësinë për të aplikuar vetinë e shoqërimit të faktorëve si dhe përdorimin e mjeteve aplikative.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Kuptimi dhe shenja e pjesëtimit	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.1 - Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇË: Pjesëtim, numër, shenjë e pjesëtimit	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektesh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të njëjta;</li> <li>• Vizaton grupe të njëjta objektesh;</li> <li>• Gjen herësin e dy numrave.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjaj në grupe të njëjta objektet reale;</li> <li>• Vizato grupe të njëjta objektesh;</li> <li>• Gjej herësin e dy numrave.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor apo fletë hameri, objekte të ndryshme që gjenden në klasë, petëza, lapsi, goma, tabela, markeri.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Ora mësimore fillon si zakonisht, me realizimin e një aktiviteti real në klasë. Qëllimi i kësaj ore është që nxënësit të kuptojnë konceptin e pjesëtimit e jo vetëm të memorizojnë procedurat e pjesëtimit. Në klasë të dytë, nxënësit nuk duhet ende të memorizojnë faktet e pjesëtimit, ose të mund të derivojnë faktet e pjesëtimit nga ato të shumëzimit. Prandaj, mjafton që nxënësit vetëm të njihen me konceptin e pjesëtimit. Kështu që, për të zgjidhur problemet e pjesëtimit të parapara në këtë klasë, nxënësit gjatë tërë kohës mund të përdorin vizatime, manipulativë dhe objekte. Së pari, mësimdhënësi/ja me bashkëpunim me nxënësit grumbullon në bankën e saj një numër të caktuar të objekteve. Këto mund të jenë çfarëdo lloj objektesh që gjenden në klasë ose në çanta të nxënësve. Mund të përdoren edhe petëzat. Mësimdhënësi/ja pastaj kërkon nga</p>	

nxënësit që ti ndihmojnë për të formuar një numër të caktuar të grupeve të njëjta të objekteve të grumbulluara. Duke shpërndarë një nga një objektet nëpër grupe, numërohet numri i objekteve në secilin grup për tu bindur se grupet janë të njëjta. Ndarja e bërë, më tutje paraqitet në tabelë me anë të barazimit përkatës të pjesëtimit. Kështu, para nxënësve është prezentuar koncepti i pjesëtimit si ndarje në mënyrë të barabartë. Ngjashëm, mësimitdhënësi/ja e prezanton konceptin e pjesëtimit si grupim i numrit të caktuar të objekteve. Pra, tani nuk ua jep nxënësve numrin e grupeve, por ua jep numrin e objekteve që duhet të jetë në secilin grup. Kështu nxënësit në fund e fitojnë numrin e grupeve. Punën e bërë, poashtu, mësimitdhënësi/ja e paraqet me anë të barazimit në tabelë.

#### Hapi II – Punë me libër/ Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 36. Analizohet ilustrimi në faqen 36 dhe diskutohet për karotat e paraqitura dhe mënyrën se si mund të ua shpërndajmë lepurushëve. Një të vazhdohet edhe me ilustrimet tjera. Mësimitdhënësi/ja në këtë rast e rithekson se në matematikë ndarjen e një tërësie në grupe të njëjta e quajmë pjesëtim dhe senja e pjesëtimit është : dhe e lexojmë si PJESTUAR.

#### Hapi III – Punë e pavarur në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në fletore. Nxënësve ju paraqiten disa situata në tabelë të cilat i ka përgatitur mësimitdhënësi/ja paraprakisht dhe kërkohet që ato të i paraqesin me ilustrim dhe të shkruajnë barazimin e pjesëtimit. Psh:

- Nëse kemi 12 topa dhe dëshirojmë të ua ndajmë 2 grupeve me fëmijë, sa topa do të ketë secili grup?



$$12 : 2 = 6$$

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen dhe performansën e secilit nxënës në diskutim, aktivitet dhe punë në libër, duke shqyrtuar së bashku zgjidhjet përfundimtare.



TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me grupe të barabarabarta	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjë, ngjyrat, numëroren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëson diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëso diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor apo fletë hameri, objekte të ndryshme që gjenden në klasë, petëza, shkopinj, rrëmojsa, fasule, lapsi, goma, tabela, markeri, gota plastike	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja parapakisht ka marrë gota plastike dhe nxënësve të ulur në banka ju shpërndanë nga 5 gota plastike. Më pas varësisht prej mjeteve që posedon në klasë, ju shpërndanë çifteve shkopinj, fasule, rrëmojsa, petëza etj. Tani mësimdhënësi/ja ju kërkon që secili grup të ndajë 20 shkopinj apo fasule në mënyrë të barabartë në gotat e plastikës. Më pas mësimdhënësi/ja	



bashkë me ta shqyrton se cila është sasia e shkopinjve/fasuleve që ka një gotë dhe sqaron për nxënësit që ky numër paraqet herësin. Me këtë rast duhet treguar se pjesëtimin mund ta gjejmë duke vizatuar grupe të barabarta. Mësimdhënësi/ja merr një shembull të cilin e paraqet në tabelë, psh. vizaton 12 lule dhe kërkon nga nxënësit që të tregojnë si mund t'i ndajmë këto lule në tri grupe të barabarta. Diskutimi vazhdon derisa nxënësit të kenë të qartë se si gjejmë pjesëtimin përmes grupeve të barabarta.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 37. Në detyrën 1 nxënësit duhet të numërojnë pullat dhe të tregojnë sa pulla ka secili grup. Pasi të kenë analizuar ilustrimin, shkruajnë barazimin e pjesëtimin që përkon me të. Njësoj punohet edhe në detyrat tjera.

#### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën e pavarur në fletore. Nxënësit do të paraqesin numër të elementeve sipas dëshirës dhe më pas t'i ndajnë në grupe të barabarta dhe të shkruajnë barazimin e pjesëtimin lidhur me ilustrimin që kanë paraqitur. Përmes ndonjë teknike përzgjedhen disa nxënës për të prezantuar punën e tyre para klasës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimin.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: I pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 5.1 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Barazim, pjesëtim, i pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon në shprehje; faktorët, prodhimin, të pjesëtueshmin, pjesëtuesin dhe herësin e numrave natyror deri 100;</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon të pjesëtueshmin në një barazim pjesëtimi;</li> <li>• Identifikon pjesëtuesin në një barazim pjesëtimi;</li> <li>• Identifikon herësin në një barazim shumëzimi;</li> <li>• Ndërton barazime të pjesëtimit sipas kërkesave të dhëna.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qarko të pjesëtueshmin në një barazim pjesëtimi;</li> <li>• Qarko pjesëtuesin në një barazim pjesëtimi;</li> <li>• Qarko herësin në një barazim shumëzimi;</li> <li>• Ndërto barazime të pjesëtimit sipas kërkesave të dhëna.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletë A4, fletorja, lapsi, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Deri më tani, gjatë punës në barazime të pjesëtimit, nxënësi iu është referuar numrave që ndodhen aty si numrat që pjesëtohen ose si rezultati i pjesëtimit. Tani është koha që në fjalorin e nxënësve të futen termet – i pjesëtueshmi, pjesëtuesi dhe herësi. Mësimdhënësi/ja mund të përzgjedhë pesë nxënës dhe secilit prej tyre ua shpërndanë nga një fletë të formatit A4. Nëpër fleta gjenden elementet për formimin e një barazimi të pjesëtimit, psh.: $32, 8, 4, : =$ Mësimdhënësi/ja iu bën thirrje nxënësve që t'u ndihmojnë pesë nxënësve të rregullohen sipas radhës së duhur për ta formuar një barazim të pjesëtimit me këto elemente ( $32 : 4 = 8$ ose $32 : 8 = 4$ ), derisa fëmijët e përzgjedhur mbajnë secili letrën e vet para vetes.	

Pasi të formohet barazimi i duhur, mësuesi/ja diskuton për emërtimin e numrave brenda barazimit dhe tregon se vendi ku ndodhet numri brenda barazimit e përcakton emrin e tij.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 38. Në detyrën 1 nxënësit duhet të analizojnë numrat e dhënë dhe emërtimet e tyre. Në detyrën 2 duke analizuar ilustrimet shkruajnë barazimin e pjesëtimit dhe identifikojnë herësin të cilin duhet ta rrethojnë. Në detyrën 3 kërkohet analizë e ilustrimit dhe të shkruajnë barazimin e pjesëtimit dhe të identifikojnë të pjesëtueshmin duke e rrethuar atë. Në detyrën 4, duke shikuar ilustrimet shkruajnë barazimin dhe rrethojnë pjesëtuesin. Në detyrën 5, bazuar në kërkesat e dhëna, shkruajnë barazimet e pjesëtimit.

#### Hapi III – Punë në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën e pavarur në fletore. Secili çift shkëmben fletoret dhe krijojnë detyra për njëri-tjetrin duke parashtruar kërkesa që lidhen me identifikimin e të pjesëtueshmit, pjesëtuesit dhe herësit. Në çifte analizojnë detyrat e zgjidhura dhe për çdo vështirësi diskutohet në mënyrë të përbashkët me mësuesin/en.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja fokusohet më së shumti në identifikimin e të pjesëtueshmit, pjesëtuesit dhe herësit në barazimet e pjesëtimit.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me 2	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëroren, etj, për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëson diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale.</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëso diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, etiketa me barazime të pjesëtimit me 2, shkopinj, fasule, lapsi, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:	
<p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja ka përgatitur etiketa me barazime të ndryshme të pjesëtimit (si p.sh 8:2, 6:2, 12:2 etj.) dhe pasi të ketë ndarë nxënësit në grupe e t'u ketë shpërndarë nga një barazim pjesëtimi, kërkon që secili grup të ndajë shkopinj, fasule apo mjete tjera sipas barazimit të dhënë. Pasi grupet të përfundojnë punën e tyre, bëhet prezantimi i punës së secilit grup dhe</p>	

diskutohet në nivel klasë. Në këtë diskutim, mësimitdhënësi/ja ndërlidhë diskutimin rreth pjesëtimit me numrin 2, meqë edhe barazimet me të cilat punuan nxënësit kishin pjesëtuesin 2.

**Hapi II – Punë me libër**


Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 39. Në detyrën 1 nxënësit duhet të ndihmojnë Ronën dhe Florin që të ndajnë sheqerkat në mënyrë të barabartë. Nxënësit analizojnë dhe diskutojnë kërkesat e paraqitura dhe shkruajnë barazimet e pjesëtimit. Në detyrën e dytë kërkohet të analizohet tabela dhe në diskutim me nxënësit tregohet se cili numër përfaqëson të pjesëtueshmin, pjesëtuesin dhe herësin. Kur njëri mungon mund ta gjejmë me anë të shumëzimit. P.sh Cili është ai numër që kur shumëzojmë me 10 na jep numrin 10 etj.

**Hapi III – Ushtrime në fletore**

Nxënësit vazhdojnë punën e pavarur në fletore. Në fletore kërkohet që të paraqiten me ilustrim dhe të zgjidhen detyrat e dhëna:

8 : 2 =            18 : 2 =            14 : 2 =            6 : 2 =

Psh: 8:2

Ilustrim	Zgjidhja	Analizë
	$8:2 = 4$	8 - i pjesëtueshmi 2 - pjesëtuesi 4 - herësi

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimit.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me 3	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjë, ngjyrat, numëroren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇË: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëson diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale.</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëso diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale.</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme.</li> </ul>
<p>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</p> <p>Libri Matematika 2B, etiketat me detyra, goma, tabela, marker, fletorja, lapsi, ngjyrat</p>	
<p>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi</p>	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja paraprakisht ka përgatitur nga një etiketë dhe nxënësit i ndanë në 5 grupe. Secilit grup ju jep nga një etiketë në të cilën përmbahen dy kërkesa. Psh, për grupin 1:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Kërkesa 1 - Ndaj 3 shkopinj në tri grupe të barabarta e më pas shkruaj barazimin e pjesëtimit.</li> <li>➤ Kërkesa 2 - Ndaj shkopinj në tri grupe të barabarta e më pas shkruaj barazimin e pjesëtimit.</li> </ul>	

Për secilin grup paraqiten kërkesa të ngjashme, por kuptohet që kërkesat duhet të jenë me numrat tjerë si 6, 9, 12, 15, 18, 27 dhe duhet të ndahen në 3 grupe në mënyrë që të punohet me pjesëtimin me numrin 3. Pasi nxënësit të kenë përfunduar punën, të gjitha grupet dalin dhe prezantojnë para klasës duke argumentuar mënyren se si i kanë zgjidhur kërkesat e dhëna.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 40, ku duke analizuar ilustrimin e dhënë do të shkruajnë barazimet e pjesëtimimit me 3.


#### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në fletore. Në fletore kërkohet që të paraqiten me ilustrim dhe të zgjidhen detyrat e dhëna:

$$6 : 3 = \quad 9 : 3 = \quad 15 : 3 = \quad 18 : 3 =$$

Psh: 6:3

Ilustrim



Zgjidhja

$$6 : 3 = 2$$

Analizë

6 - i pjesëtueshmi  
3 - pjesëtuesi  
2 - herësi

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimimit.



TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me 4	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëroren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëson diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 4.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëso diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 4.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletë A4, plastelinë, lapsi, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja paraprakisht ka përgatitur disa detyra të cilën i shkruan në tabelë dhe nxënësit në çifte duke përdorur plastelinën i paraqesin ato dhe shkruajnë barazimet për secilën detyrë. Kërkesat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Nëse kemi 16 toptha (toptha plasteline) të ndarë në 4 grupe, sa toptha përmbanë një grup?</li> <li>➤ Nëse kemi 32 toptha (toptha plasteline) të ndarë në 4 grupe, sa toptha përmbanë një grup?</li> <li>➤ Nëse kemi 12 toptha (toptha plasteline) të ndarë në 4 grupe, sa toptha përmbanë një grup?</li> <li>➤ Nëse kemi 20 toptha (toptha plasteline) të ndarë në 4 grupe, sa toptha përmbanë një grup?</li> </ul>	

Mund të shtohen edhe kërkesa tjera të ngjashme.

Pasi të kenë përfunduar punën të gjitha çiftet e nxënësve, dalin dhe prezantojnë para klasës duke argumentuar mënyrën se si kanë zgjidhur kërkesat e dhëna.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 41. Në detyrën, duke analizuar ilustrimin e dhënë, nxënësit do të shkruajnë barazimet e pjesëtimit me 4. Në detyrën 2 kërkohet nga nxënësit që duke bërë njehsimet e duhura të lidhin pakot me etiketat përkatëse.

#### Hapi III – Krijuesit e vegjël

Nxënësit do të punojnë në çifte. Secili çift i nxënësve (ashtu si janë të ulur në banka) do të krijojë një detyrë numerike lidhur me pjesëtimin me 4 ( $24:4=?$ ). Detyrën do ta bartë te çifti i nxënësve që janë të ulur mbrapa tyre. Çifti që pranon detyrën, do ta paraqesë me ilustrim dhe të gjejnë herësin. Çifti i cili është i ulur në fund të rreshtit, do të bartë detyrën te çifti i cili është i ulur në bankën e parë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimit.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me 5	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëson diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra lidhur me pjesëtimin me 5.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Plotëso diagramet me grupe të njëjta;</li> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 5.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletorja, kartat, lapsi, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja paraprakisht ka përgatitur një aktivitet me karta (mund të përdoren edhe mjete tjera). Fton të dalin pesë nxënës para tabelle dhe mësimdhënësi/ja para nxënësve tregon se ajo posedon 25 karta. Parashtron pyetjen për nxënësit: Nëse do ua ndajmë në mënyrë të barabartë kartat pesë nxënësve, sa karta do të ketë secili nxënës?</p>	



Fillimisht kërkon që të tregojnë numrin e kartave që posedon mësimitdhënësi/ja. Pas përgjigjes së nxënësve, mësimitdhënësi/ja shënon numrin 25 në tabelë. Meqë këto karta do të ndahen në 5 grupe të barabarta, mësimitdhënësi/ja pyet nxënësit se cili veprim matematik lidhet me ndarjen e tërësisë në pjesë të barabarta. Pasi nxënësit të përgjigjen se ndarjen në pjesë të barabarta e quajmë pjesëtim, atëherë mësimitdhënësi/ja në tabelë shkruan 25:5

Mësimitdhënësi/ja fton një nxënës të ua ndaj kartat nxënësve në mënyrë të barabartë. Me përfundimin e aktivitetit mësimitdhënësi/ja rithekson se secili nxënës ka nga 5 karta dhe e shënon  $25:5 = 5$ .

Aktiviteti mund të përsëritet edhe me disa shembuj tjerë.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 42. Në detyrën 1 nxënësit duhet të plotësojnë barazimet duke analizuar kërkesat dhe ilustrimin e dhënë. Në detyrën 2 nxënësit duke analizuar ilustrimet e dhëna duhet të gjejnë barazimet e pjesëtimimit.

#### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në fletore. Në fletore ata krijojnë detyra për shoqen/shokun e bankës. Psh:

Lidh me shigjetë herësin me barazimin.

$35:5 =$	1	$= 15:5$
	7	
$10:5 =$	3	$= 25:5$
	5	
$5:5 =$	10	$= 50:5$
	2	

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimimit.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me 6	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:  II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;  IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:  1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;  2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;  3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh;  4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale.</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 6.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale.</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 6.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor apo fletë hameri, fletorja, lapsi, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Detyrë problemore  Mësimdhënësi/ja paraprakisht ka përgatitur detyrë problemore të cilën e shfaq me projektor apo në hamer. Detyra është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Gjyshe Drita ka përgatitur 54 biskota për ditëlindjen e Emës. Ema ka ftuar 5 miq. Duke llogaritur edhe Emën, sa biskota do të ketë secili fëmijë?</li> </ul> <p>Tani nxënësit në mënyrë të pavarur provojnë ta zgjidhin detyrën problemore dhe më pas diskutohet në nivel klasës zgjidhja e këtij problemi.</p> <p>Hapi II – Punë me libër  Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 43. Në detyrën 1 nxënësit duhet të plotësojnë barazimet duke analizuar kërkesat e dhëna. Në detyrën 2 kërkohet të plotësojnë tabelën duke zbuluar të pjesëtueshmin/pjesëtuesin që mungon.</p>	

Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në fletore. Në fletore ata krijojnë detyra për njëri-tjetrin. Psh:

- I pjesëtueshmi është 30 dhe herësi është 5. Sa është pjesëtuesi?


**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimit.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me 7	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 7.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 7.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, mjete shkollore, fletorja, lapsi, goma, tabela, marker, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shogëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Detyrë problemore Mësimdhënësi/ja paraprakisht ka siguruar disa mjete si fletore, libra e mjete të tjera që gjenden në klasë (afërsisht 10) ku secilës ua vendos çmimin prej 7 eurosh. Pyetja për nxënësit është: ➤ Sa mjete shkollore blihen me 21 euro? Tani nxënësit në mënyrë të pavarur provojnë ta zgjidhin detyrën problemore dhe më pas diskutojnë në prani të klasës se si kanë zgjidhur detyrën. Në tabelë shënohet barazimi $21:7 = 3$ . Vazhdohet edhe me pyetje tjera të ngjashme lidhur me pjesëtimin me 7.  Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 44. Në detyrën 1 nxënësit duhet të plotësojnë barazimet duke analizuar kërkesat e dhëna. Në detyrën 2 kërkohet nga nxënësit që duke analizuar grupet e barabarta, të shkruajnë barazimet e pjesëtimit.	

### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në fletore. Secili nxënës krijon 3 detyra sipas shembujve më poshtë:



$$\square : \square = \square$$



$$\square : \square = \square$$

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimit.



TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me 8	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:  II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;  IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:  1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;  2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;  3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh;  4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 8.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 8.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, topa pingpongu, lapsi, goma, tabela, markeri, fletorja, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet kokret  Mësimdhënësi/ja paraprkishtë ndan nxënësit në 8 grupe. Para tyre paraqet 16 topa pingpongu dhe ju kërkon nxënësve grupet t'i ndajnë në mënyrë të barabartë këta topa. Pasi nxënësit të tregojnë se si e gjejnë nga sa topa do të ketë secili grup, mësimdhënësi/ja në tabelë shkruan <math>16:8 = 2</math>. Mësimdhënësi/ja përsëritë aktivitetin duke pyetur nxënësit se nëse do të kishim 32 topa pingpongu, nga sa topa do të merrte secili grup nëse ndarja do të bëhej në mënyrë të barabartë. Diskutimi vazhdon duke shtruar edhe pyetje tjera të ngjashme.</p> <p>Hapi II – Punë me libër  Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 45. Në detyrën 1 duhet të shkruajnë barazimet e pjesëtimit duke analizuar kërkesat e dhëna. Në detyrën 2 kërkohet të plotësojnë tabelën duke zbuluar të pjesëtueshmin/pjesëtuesin që mungon.</p>	

Hapi III – Ushtrojmë në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në fletore. Në fletore ata krijojnë detyra nga tri detyra sipas shembullit më poshtë:

- I pjesëtueshmi është 72 dhe herësi është 9. Sa është pjesëtuesi?

Secili nxënës do të prezantojë nga një detyrë para klasës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimit.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me 9	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:  II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;  IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:  1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;  2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;  3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh;  4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 9.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 9.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, kavanozë, fasule, lapsi, goma, tabela, markeri, fletorja, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitetet kokret  Mësimdhënësi/ja paraprakisht ka marrë në klasë një kavanoz në të cilin ka vendosur 9 fasule. Do të pyes nxënësit se sa kavanoza do të përdorim për të vendosur 27 fasule nëse rregulli është që një kavanoz duhet të përmbajë vetëm 9 fasule. Pas përgjigjeve të nxënësve, në tabelë shënohet <math>27: 9 = 3</math>.  Mësimdhënësi/ja përsëritë aktivitetin duke bërë pyetje të ngjashme lidhur me pjesëtimin me 9.</p> <p>Hapi II – Punë me libër  Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 46. Në detyrën 1 nxënësit duhet të plotësojnë barazimet duke analizuar kërkesat e dhëna. Në detyrën 2, nxënësit duke bërë njehsimet e duhura do të gjejnë zogjtë e secilës pulë.</p>	

Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në fletore. Në fletore ata krijojnë nga një detyrë sipas dëshirës sipas shembullit të dhënë:

72 : 9

72 : 9 = 8

72 – i pjesëtueshmi  
9 – pjesëtuesi  
8 - herësi

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimit.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Pjesëtimi me 10	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes; IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndan në grupe të barabarta një sasi objektesh apo një numër të dhënë;</li> <li>Gjen prodhimin dhe herësin e numrave.</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale.</li> <li>Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 10.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale.</li> <li>Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme lidhur me pjesëtimin me 10.</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, etiketat, fletorja, ngjyrat, lapsi, goma, tabela, markeri	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b>  Hapi I – Detyrë problemore Mësimdhënësi/ja paraprakisht ka ndarë nxënësit në 4 grupe. Secilit grup ju ka parashtruar nga një detyrë problemore në etiketa të cilat nëse radhiten saktë krijojnë një detyrë problemore. Kërkohet nga grupet e nxënësve që ta zgjidhin problemin e dhënë dhe ta prezantojnë para klasës strategjinë e përdorur për të arritur deri te zgjidhja. Shembull të detyrave të tilla janë:	

- Fermeri ka për të shpërndarë në 8 shtëpi 80 vezë. Shpërndarja e vezëve duhet të bëhet në mënyrë të barabartë për secilën shtëpi. Nga sa vezë do të shpërndajë fermeri në secilën shtëpi?
- Fermeri ka 60 vezë. Ai sistemon vezët në pako të njëjta. Sa pako i nevojiten fermerit nëse një pako zë 10 vezë?
- Fermeri 70 vezë. Ai do të ndajë në mënyrë të barabartë nga 10 vezë për një famije. Sa familje mund të marrin nga 10 vezë?

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 47. Në detyrën 1 nxënësit duhet të plotësojnë barazimet duke analizuar kërkesat e dhëna. Në detyrën 2 kërkohet që duke analizuar ndarjet në grupe të barabarta, të shkruajnë barazimet e pjesëtimit.

#### Hapi III – Ushtrojmë në fletore

Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në fletore. Nxënësit krijojnë nga një detyrë me fjalë lidhur me pjesëtimin e numrave. Secili nxënës prezanton punën e tij para klasës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimit.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Ushtrojmë pjesëtimin	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëroren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemesh; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Grupe të njëjta, objekte, pjesëtim, numër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në grupe të barabarta një sasi objektësh apo një numër të dhënë;</li> <li>• Gjen prodhimin dhe herësin e numrave.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Paraqet barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjen herësin e numrave në detyra të ndryshme.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndaj objektet në grupe të barabarta;</li> <li>• Paraqit barazimet e pjesëtimit me ndihmën e paraqitjeve vizuale;</li> <li>• Gjej herësin e numrave në detyra të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, shporta, fletëzat me barazime, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shogëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja ka përgatitur disa fletëza me barazime të ndryshme të pjesëtimit dhe i ka vendosur në një shportë. Fton me radhë secilin nxënës që të përzgjedhë një fletëz nga shporta dhe të shkruajë barazimin e pjesëtimit në tabelë. Më pas, nxënësi duhet të krijojë paraqitje vizuale me grupe të njëjta lidhur me barazimin e pjesëtimit që ka shkruar në tabelë.  Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 48 dhe 49. Në detyrat e dhëna nxënësit duhet njehsojnë herësin duke ndarë në mënyrë të barabartë elementet që janë paraqitur në ilustrim.	

Hapi III – Garë me pjesëtim

Mësimdhënësi/ja do të organizojë një lojë në formë gare për nxënësit. Fillimisht gara do të zhvillohet mes nxënësve që ndajnë të njëjtën bankë. Mësimdhënësi/ja parashton një detyrë me pjesëtim dhe nxënësi i cili përgjigjet i parë shpallet fitues. Loja vazhdon derisa të zgjedhet një fitues.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të ndarjes së pjesëve në grupe të njëjta dhe ndërtimit të barazimit të pjesëtimit.



TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: III.1 - Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj, për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; 5.1 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Shumëzim, pjesëtim, lidhje, barazim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave si dhe shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri 100.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon me fjalë lidhjen në mes të shumëzimit dhe pjesëtimit;</li> <li>Ndërton barazimin e pjesëtimit në bazë të atij të shumëzimit;</li> <li>Ndërton barazimin e shumëzimit në bazë të atij të pjesëtimit.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Trego me fjalë lidhjen në mes të shumëzimit dhe pjesëtimit;</li> <li>Ndërto barazimin e pjesëtimit në bazë të atij të shumëzimit;</li> <li>Ndërto barazimin e shumëzimit në bazë të atij të pjesëtimit.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, objekte të ndryshme që gjenden në klasë, petëza, shkopinj, rrëmojsa, fasule, lapsi, goma, tabela, markeri, gota plastike	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Synimi kryesor i kësaj ore mësimore është konkretizimi i ndërlidhjes së ngushtë ndërmjet veprimit të shumëzimit dhe atij të pjesëtimit. Gjatë kësaj ore nevojitet të ndërtohet ideja se shumëzimi dhe pjesëtimi janë veprime të kundërta në mes vete. Pra, thënë me tjera fjalë, performimi i njëpasnjëshëm i tyre, e kthen rezultatin në fillim, ashtu si ishte para performimit të veprimit të parë. Së pari mësimdhënësi/ja organizon një aktivitet konkret në klasë. Thërret nxënësit të punojnë në grupe dhe të përdorin një numër të caktuar të petëzave ose objekte tjera që mund të përdoren në klasë. Në secilën bankë, njëri prej nxënësve numëron dhe vendos në bankë para vetes, le të themi nga 28 petëza. Pastaj nxënësi i dytë i ndan në grupe të njëjta,	

natyrisht duke u kujdesur që numri i grupeve dhe anëtarëve të grupeve të caktohet ashtu që mos të ketë mbetje. Në tabelë shkruhet barazimi i përbashkët i pjesëtimit për të gjitha grupet, psh:  
 $28: 7 =$

Nxënësi i parë tani përdorë shumëzimin për të paraqitur numrin e përgjithshëm të petëzave të ndara në grupe, pra:

$$7 \cdot 4 =$$

Diskutohet në mënyrë të hollësishme lidhja që ekziston ndërmjet dy veprimeve matematike, shumëzimit dhe pjesëtimit. Së pari në nivel grupesh, e pastaj në nivel klase. Kjo lidhje mund të përshkruhet duke thënë se shumëzimi dhe pjesëtimi janë veprime të kundërta për njëri tjetrin. Dmth. nëse së pari performohet njëri veprim, e pastaj tjetri, do të fitohet përsëri numri fillestar.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 50. Në detyrën 1 dhe 2 kërkohet të diskutohet duke potencuar se shumëzimi dhe pjesëtimi janë veprime të kundërta me njëri- tjetrin. Në detyrën 3 dhe 4 kërkohet që duke analizuar të plotësohet barazimi. Në detyrën 5 kërkohet që të ndërtojnë nga dy barazime të shumëzimit dhe dy të pjesëtimit me numrat e dhënë.

#### Hapi II – Punë e pavarur në libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 50 dhe faqe 51. Zgjidhjet diskutohen në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet më së shumti në ndërlidhjen që bën nxënësi në mes të shumëzimit dhe të pjesëtimit si dy veprime të kundërta me njëra-tjetrën.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme me fjalë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.7 - Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave; 2.2 - Zbaton shprehje të arsytimit për të bërë hamendësime; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehje pune; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehjeve matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Probleme, tekst, barazim, shumëzim, pjesëtim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;</li> <li>• Demonstron shkathhtësi dhe shprehje për zgjidhje të problemave;</li> <li>• Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidh detyrat duke përdorur strategjitë e shumëzimit dhe pjesëtimin;</li> <li>• Zbaton shumëzimin dhe pjesëtimin në probleme të ndryshme;</li> <li>• Argumenton zgjidhjen e detyrave lidhur shumëzimin dhe pjesëtimin.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidh detyrat duke përdorur strategjitë e shumëzimit dhe pjesëtimin;</li> <li>• Zbato shumëzim dhe pjesëtimin gjatë zgjidhjes së problemave të dhëna;</li> <li>• Argumento zgjidhjen e detyrave lidhur shumëzimin dhe pjesëtimin.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, etiketat, lapsi, ngjyrat, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Copëza të përziera Mësimdhënësi/ja do të ndajë nxënësit në grupe ku për secilin grup ka përgatitur nga një detyrë me fjalë. Nxënësit duhet të rendisin fjalitë si duhet për të kuptuar problemin me fjalë e më pas të paraqesin zgjidhjen e atij problem duke përdorur strategji sipas dëshirës. Nëse ka mendime të ndryshme brenda grupit, nxënësit mund të paraqesin më shumë se mënyrë të zgjidhjes së problemit. Pasi nxënësit të përfundojnë punën, bëhet prezantimi dhe diskutimi i detyrave në nivel klase.  Hapi II – Punë me libër/ Shqyrtim i përbashkët Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 52.	

Gjatë kësaj ore mësimore, nxënësit duhet të punojnë në modelimin matematik dhe në zgjidhjen e problemeve të thjeshta me fjalë të cilat ndërlidhen me konceptin e shumëzimit dhe pjesëtimit. Gjatë procesit të modelimit të problemeve të paraqitura me fjalë, nxënësit duhet të jenë të lirë të përdorin manipulative, vizatime e diagrame, si dhe strategji sipas dëshirës së tyre. Mund të punohet në mënyrë individuale, në çifte ose në grupe, por është e domosdoshme që zgjidhja e secilit problem me fjalë të bëhet në nivel klase. Gjatë zgjidhjes së problemeve, mësimitdhënësi/ja duhet të komunikojë me nxënës deri sa të verifikojë se secili nxënës, ose çifte ose grup e ka kuptuar problemin dhe kërkesat e problemit. Gjithashtu, edhe pse mënyra e zgjidhjes së problemeve realizohet sipas dëshirës së nxënësve, mësimitdhënësi/ja duhet të insistojë që secili nxënës të paraqes barazimin e shumëzimit dhe pjesëtimit – pra ta modelojë fillimisht problemin si barazim. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet provës së detyrës, reflektimit dhe lidhjes së rezultatit të fituar me kontekstin e detyrës.

### Hapi III – Punë e pavarur në libër

Nxënësit vazhdojnë punën në faqe 53. Nxënësit në mënyrë të pavarur ndërtojnë problema duke analizuar ilustrimet.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja fokusohet në mënyrën se si zgjidhin problemet me fjalë si dhe zbatimin e shumëzimit dhe pjesëtimit në detyra të ndryshme.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Veprimet e përziera me numra	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët; 6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
FJALËT KYÇE: Mbledhje, zbritje, shumëzim, objekte, rreshtim	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon rradhën e veprimeve matematikore;</li> <li>Ndërto barazimet matematike në bazë të paraqitjeve vizuale;</li> <li>Zgjidh barazime matematike me veprime të përziera.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon rradhën e veprimeve matematikore;</li> <li>Ndërto barazimet matematike në bazë të paraqitjeve vizuale;</li> <li>Zgjidh barazime matematike me veprime të përziera.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Diskutim i përbashkët Zhvillimi i njësisë aktuale fillon me paraqitje vizuale të rreshtimeve dhe objekteve shtesë, apo rreshtimeve ku mungon ndonjë prej objekteve. Pra, paraqitje vizuale të ngjyshme me ato të mëhershmet. Më tutje, duke diskutuar situatat e prezentuara bashkë me nxënësit ndërtohen barazimet adekuate matematike me veprime të përziera, zgjidhja e të cilave jep numrin e të gjitha objekteve në paraqitje. Sasitë e objekteve përzgjedhen në pajtim me numrat e mësuar dyshifror deri në 100. Më pas paraqiten disa detyra me veprime të përziera. Psh: $3 \cdot 4 + 5 =$ $9 - 6 : 3 =$ Në të dy detyrat potencohet se veprimi i parë që kryhet është shumëzimi dhe pjesëtimi e pastaj mbledhja dhe zbritja. $12 : 4 + 5 \cdot 3 =$ Në rastet kur kemi edhe pjesëtim edhe shumëzim fillohet nga e majta në të djathtë që në këtë rast kryhet fillimisht pjesëtimi pastaj shumëzimi dhe në fund mbledhja.	

Hapi II – Punë me libër/ Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 54. Gjatë kësaj ore mësimore, nxënësit në mënyrë të përbashkët punojnë detyrën 1 dhe 2 duke analizuar veprimet që duhet të kryhen dhe në detyrën e dytë i kushtohet vëmendje vendosjes së shenjave të shumëzimit, pjesëtimit, mbledhjes apo zbritjes për të fituar barazinë.

Hapi III – Punë në çifte

Nxënësit vazhdojnë punën në faqe 55. Nxënësit në çifte punojnë detyrat e dhëna e më pas zgjidhjet diskutohen në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet në mënyrën se si zgjidhin detyrat me veprime të përziera dhe zbatimin e radhëve të veprimeve matematikore për zgjidhje të saktë të detyrave.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Vargjet e numrave	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>IV.5 - Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;</p> <p>V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>2.3 - Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune;</p> <p>6.4 - Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>	
FJALËT KYÇË: Varg, numër, kufizë, rritet, zvogëlohet	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Shumëfishon numrat njëshifrorë dhe krijon vargje numerike (<math>\leq 50</math>).</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Krijon vargjet numerike sipas një rregulle të caktuar;</li> <li>Shumfishon një numër njëshifrorë;</li> <li>Përdor boshtin numerik për të krijuar vargje me numra.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Plotëso vargjet numerike duke zbuluar rregullën përkatëse për secilin varg;</li> <li>Krijo vargje numerike duke shumëfishuar numrat njëshifrorë;</li> <li>Vazhdo vargun e numrave sipas boshteve numerike.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, litari për tharje, fletat A4, lapsi, goma, tabela, markeri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Edukata fizike sportet dhe shëndeti.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:	
<p>Hapi I – Litari për tharje</p> <p>Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet të thjeshtë. Në litarin e klasës mësimdhënësi/ja vendose një fletë A4 në të cilin është shënuar numri 2. Mësimdhënësi/ja ju thotë nxënësve se ne duhet të vazhdojmë vendosjen e fletave tjera me numra duke përfillur rregullën që numri pasues është për 2 më i madh se numri paraprak. Pyet nxënësit se si mund ta gjejmë këtë. Pasi nxënësit të gjejnë përgjigjen, ftohet një nxënës të vendose fletën A4 me numrin 4 në litarin për tharje. Kështu vazhdohet edhe me vendosjen e numrave tjerë që vijnë në radhë: 6, 8, 10, 12 . . .</p> <p>Kështu vazhdohet edhe më tutje me shembuj të tjerë për krijimin e vargjeve të tjera duke përdorur si rregull, mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimi deri sa të arrijmë të kuptuarit e formimit të vargjeve numerike.</p>	

### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 56. Detyra 1 është e ngjashme me aktivitetin në klasë. Nxënësit duke zbuluar rregullën zbulojnë vargun e numrave të dhënë. Në detyrën 2 analizohen numrat dhe zbulohet rregulla për të vazhduar me plotësimin e vargjeve numerike. Në detyrën e tretë kërkohet ndërtimi i vargjeve duke u bazuar në boshtin numerik.

### Hapi III – Punë në fletore

Nxënësit në fletore ndërtojnë vargje numerike dhe më pas shkëmbejnë fletoret me për njëritjetrin ashtu siç janë të ulur nëpër banka. Më pas secili nxënës do të vlerësojë punën e shoqes/shokut të bankës duke i treguar nëse ka arritur të zbulojë saktë rregullën e vargut dhe ka plotësuar si duhet numrat që vijnë në radhë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.


**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e formimit të vargjeve numerike si dhe strategjinë për ta zbuluar rregullën e formimit të një vargu numerik.



TEMA: Trupat gjeometrikë	
NJËSIA MËSIMORE: Kubi	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.1- Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;</p> <p>II.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;</p> <p>6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Trup, kub, faqe, kulm. brinjë	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);</li> <li>• Gjen faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë;</li> <li>• Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëron kulmet, brinjët dhe faqet e kubit të ndërtuar nga rrëmojsat dhe plastelina;</li> <li>• Numëron objekte reale në formë të kubit;</li> <li>• Modelon kubin duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëro kulmet, brinjët dhe faqet e kubit të ndërtuar nga rrëmojsat dhe plastelina;</li> <li>• Numëron objekte reale në formë të kubit;</li> <li>• Modelo kubin duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektori, lapsi, goma, materiale për modelim	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës, Jeta dhe puna	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Diskutim</p> <p>Kjo orë mësimore fillon me një diskutim. Shfaqet para nxënësve ilustrimi i faqes 58 përmes projektorit në të cilën janë paraqitur fëmijët në një dhomë gjumi të cilët janë duke luajtur me lojëra të ndryshme. Parashtrihen pyetjet si: Çfarë po bëjnë fëmijët? A mund të emërtohen trupat gjeometrik që sheh në ilustrim? Numëro nga sa prej secilit lloj të trupave sheh aty?</p> <p>Kështu vazhdohet edhe më tutje duke treguar shembuj të tjerë të objekteve reale që kanë formë të trupave gjeometrikë.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 59. Në detyrën 1 nxënësit duhet të numërojnë objekte të tjera reale që kanë formën e kubit. Në detyrën 2 analizohet kubi dhe ngjyrosen secila faqe e kubit.</p>	

### Hapi III – Modelim


Në detyrën 3 kërkohet modelimi i kubit me rrëmojsa dhe plastelinë. Pasi të kenë modeluar kubin secili nxënës e prezanton punën duke ritheksuar numrin e brinjëve, kulmeve dhe faqeve të kubit. Më pas nxënësit punojnë detyrën 4 të dhënë në libër, faqe 59.



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.


**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e identifikimit të kubit me gjësunde të ngjashme në jeten reale si dhe veçoritë e tij si dhe shkathtësinë për të modeluar një kub me materiale të ndryshme.

TEMA: Trupat gjeometrikë	
NJËSIA MËSIMORE: Kuboidi	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1- Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.	
FJALËT KYÇË: Trup, kuboid, faqe, kulm. brinjë	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);</li> <li>• Gjen faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë;</li> <li>• Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëron objekte reale të ngjashme me kuboidin;</li> <li>• Numëron kulmet, brinjët dhe faqet e kuboidit të ndërtuar nga rrëmojsat dhe plastelina;</li> <li>• Modelon kuboidin duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëro objekte reale të ngjashme me kuboidin;</li> <li>• Numëro kulmet, brinjët dhe faqet e kuboidit të ndërtuar nga rrëmojsat dhe plastelina;</li> <li>• Modelo kuboidin duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletë A4 me rrjetën e kuboidit, lapsi, gërshërë, ngjitës, materiale për modelim	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës, Jeta dhe puna	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Modelim nga letra Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet të thjeshtë. Nxënësve u shpërndahet rrjeta e kuboidit e printuar në një fletë A4 dhe kërkohet nga nxënësit ta presin dhe duke thyer faqet e tij të ngjesin këndet për të formuar kuboidin. Pas përfundimit me punimet fillon analizimi i kuboidit duke veçuar elementet e tij se sa faqe ka, sa brinjë dhe sa kulme.</p> <p>Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 60. Në detyrën 1 nxënësit duhet të numërojnë objekte të tjera reale që kanë formën e kuboidit. Në detyrën 2 analizohet kuboidi dhe ngjyroset secila faqe e kuboidit.</p>	




### Hapi III – Modelim

Në detyrën 3 kërkohet modelimi i kuboidit me rrëmojsa dhe plastelinë. Pasi të kenë modeluar kuboidin secili nxënës e prezanton punën duke ritheksuar numrin e brinjëve, kulmeve dhe faqeve të kuboidit. Më pas nxënësit punojnë detyrën 4 të dhënë në libër, faqe 60.



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e identifikimit të kuboidit me objekte në jetën reale si dhe veçoritë e tij, shkathtësinë për të modeluar një kuboid me materiale të ndryshme.

TEMA: Trupat gjeometrikë	
NJËSIA MËSIMORE: Sfera	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> II.1- Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Trup, sferë, mbështjellës	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);</li> <li>• Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë.</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëron objekte reale të ngjashme me sferën;</li> <li>• Modelon sferën duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëron objekte reale të ngjashme me sferën;</li> <li>• Modelo sferën duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, materiale për modelim etj.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës, Shkathësi për jetë	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b>  Hapi I – Diskutim Kjo orë mësimore fillon me një diskutim të përbashkët. Mësidhnësi/ja merr pranë vetës një top dhe një glob. Pyet nxënësit rreth formës së tyre dhe se me cilin trup gjeometrik ngjason. Nxënësit rikujtojnë sferën dhe njohuritë e fituara gjatë klasës së parë. Kështu tregohen disa karakteristika të sferës e më pas tregohen objekte reale të ngjashme me sferën.	
	
Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 61. Në detyrën 1 kërkohet nga nxënësit që të numërojnë objekte të tjera reale që kanë formën e sferës. Këtë detyrë nxënësit do ta punojnë në fletore ku do të paraqesin me ilustrim objekte reale në formë të sferës e më pas do t'i prezantojnë para klasës.	

Hapi III – Modelim/Punë në libër


Nxënësit vazhdojnë punën sipas kërkesës së dhënë në libër, detyra 3. Nxënësit do të modelojnë sferën duke përdorur materiale sipas dëshirës. Në detyrën e fundit kërkohet nga nxënësit që të dallojnë kubet, kuboidët dhe sferat duke i ngjysorur me ngjyrat përkatëse e më pas numërojnë nga sa janë prej secilit lloj.



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e identifikimit të sferës me gjësende të ngjashme në jetën reale si dhe veçoritë e saj, shkathtësinë për të modeluar një sferë me materiale të ndryshme.

TEMA: Trupat gjeometrikë	
NJËSIA MËSIMORE: Cilindri	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1- Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Cilindër, bazë, rreth, mbështjellës	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);</li> <li>• Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëron objekte reale të ngjashme me cilindrin;</li> <li>• Modelon cilindrin duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëron objekte reale të ngjashme me cilindrin;</li> <li>• Modelon cilindrin duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, gërrshërët, ngjitësi, materiale për modelim	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës, Shkathtësi për jetë	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Modelim nga letra Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet të thjeshtë. Nxënësve u shpërndahet rrjeta e cilindrit e printuar në një fletë A4 dhe kërkohet nga nxënësit ta presin dhe të formojnë cilindrin.</p> <p>Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në librin, faqe 62. Në detyrën 1 nxënësit duhet të numërojnë objekte të tjera reale që kanë formën e cilindrit. Këtë detyrë nxënësit do ta punojnë në fletore duke paraqitur me ilustrim objekte reale në formë të cilindrit. Më pas nxënësit prezantojnë punën e tyre.</p> <p>Hapi III – Modelim Në vazhdim, nxënësit do të modelojnë cilindrin duke përdorur materiale të ndryshme. Mund të përdorin tela dekorativë, rollet e faculetave, plastelinë etj. Në detyrën e fundit kërkohet nga</p>	




nxënësit që të dallojnë trupat gjeometrikë duke i ngjysorur me ngjyrat përkatëse e më pas numërojnë nga sa janë prej secilit lloj.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e identifikimit të cilindrit me objektet në jeten reale si dhe veçoritë e tij, shkathtësinë për të modeluar një cilindër me materiale të ndryshme.



TEMA: Trupat gjeometrikë	
NJËSIA MËSIMORE: Koni	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1- Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.4 - Përdor fjalorin fllëstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Trup, koni, bazë, rreth	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);</li> <li>• Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton elementet e konit;</li> <li>• Numëron objekte reale të ngjashme me konin;</li> <li>• Modelon konin duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërto elementet e konit;</li> <li>• Numëron objekte reale të ngjashme me konin;</li> <li>• Modelon konin duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, ngjyrat, materiale për modelim	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës, Shkathtësi për jetë	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Modelim nga letra Kjo orë mësimore fillon me një aktivitet të thjeshtë. Nxënësve u shpërndahet rrjeta e konit e printuar në një fletë A4 dhe kërkohet nga nxënësit ta presin dhe të formojnë konin.</p> <p>Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 63. Në detyrën 1 kërkohet nga nxënësit të numërojnë objekte të tjera reale që kanë formën e konit. Në detyrën 2 analizohet koni dhe ngjyrosin pjesët e tij. Në detyrën 4 kërkohet që të ngjyrosen kapelat e fëmijëve që kanë formën e konit.</p>	
	

### Hapi III – Modelim

Në detyrën 3 kërkohet modelimi i konit me materiale të ndryshme. Nxënësit mund të përdorin tela dekorativ apo letra kartoni. Pasi të kenë modeluar konin secili nxënës e prezanton punën duke ritheksuar elementet që e karakterizojnë këtë trup gjeometrik.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.


**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e identifikimit të konit me objektet në jeten reale si dhe veçoritë e tij, shkathtësinë për të modeluar një kon me materiale të ndryshme.

TEMA: Trupat gjeometrikë	
NJËSIA MËSIMORE: Piramida	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1- Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.4 - Përdor fjalorin fllëstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Trup, piramidë, bazë, faqe	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);</li> <li>• Gjen; faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë;</li> <li>• Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton elementet e piramidës;</li> <li>• Numëron objekte reale të ngjashme me piramidën;</li> <li>• Modelon piramidën duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërto elementet e piramidës;</li> <li>• Numëron objekte reale të ngjashme me piramidën;</li> <li>• Modelon piramidën duke përdorur materiale të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, ngjyrat materiale për modelim	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës, Shkathtësi për jetë	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Modelim</p> <p>Mësuesimdhënësi/ja shpërndanë për nxënësit nga një fletë A4 dhe udhëzon ata që të presin me gërshërë fletën ku është paraqitur sipërfaqja e piramidës katërfaqësore (dmth rrjeta e piramidës katërfaqësore). Udhëzohen nxënësit që të formojnë figurën 3D. Pasi nxënësit të përfundojnë ndërtimin e kësaj figure 3D (piramidës), kërkohet nga ta që të tregojnë karakteristikë që i vërejnë në të, p.sh që qenka e formuar nga 1 katror dhe 4 trekëndësha, trekëndëshat janë të njëjtë dhe po takohen në një pikë, paska 5 kulme etj. Mësuesja diskuton me nxënësit dhe u jep sqarime shtesë rreth piramidës.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 64. Në detyrën 1 kërkohet nga nxënësit që të numërojnë objekte të tjera reale që kanë formën e piramidës. Në detyrën 2 analizohet piramida dhe ngjyrosin pjesët e saj. Në detyrën 4 kërkohet nga nxënësit që të dallojnë trupat gjeometrikë</p>	

(kubin, kuboidin, cilindrin, sferën, konin dhe piramidën) duke i ngjyrosur sipas ngjyrave përkatëse dhe më pas numërojnë nga sa janë prej secilit lloj.

### Hapi III – Modelim

Në detyrën 3 kërkohet modelimi o piramidës me materiale të ndryshme, në këtë rast mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të modelojnë piramidën katërfaqësore duke përdorur rrëmojsa dhe plastelinë. Pasi të kenë modeluar piramidën secili nxënës e prezanton punën duke ritheksuar elementet që e karakterizojnë.



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e identifikimit të piramidës me objektet në jetën reale si dhe veçoritë e tij, shkathtësinë për të modeluar një piramidë me materiale të ndryshme.

TEMA: Trupat gjeometrikë	
NJËSIA MËSIMORE: Kompozimi i trupave gjeometrikë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1- Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.4 - Përdor fjalorin fllëstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.	
FJALËT KYÇË: Trup, kub, kuboid, cilindër, kon, sferë, piramidë	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);</li> <li>• Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton trupat gjeometrikë;</li> <li>• Numëron trupat gjeometrikë në një ilustrim;</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërto trupat gjeometrik;</li> <li>• Numëro trupat gjeometrikë në një ilustrim;</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, ngjyrat, projektori, laptopi	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës, Shkathtësi për jetë	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Film i animuar Kjo orë mësimore fillon me një film të nanimuar për trupat gjeometrikë (Learn 2D and 3D Shapes and Race Monster Trucks - TOYS (FULL CARTOON)   Videos for Children). Linku për filmin është: <a href="https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=1A-yZ4iëëië">https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=1A-yZ4iëëië</a></p> <p>Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në librin, faqe 65. Në detyrën 1 nxënësit duhet të numërojnë trupat gjeometrikë nga secili lloj dhe të shënojnë numrin në tabelë. Më pas sipas ngjyrës së caktuar të ngjyrosin trupat në ilustrimet e paraqitura.</p> <p>Hapi III – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në faqen 66, ku duhet të zbulojnë rregullën dhe të gjejnë se cili trup vjen me radhë.</p>	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.	
VLERËSIMI: Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin e identifikimit të trupave gjeometrikë dhe dallimin e karakteristikave veçuese.	

TEMA: Trupat gjeometrikë	
NJËSIA MËSIMORE: Krahasimi i trupave gjeometrikë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1- Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.4 - Përdor fjalorin fllëstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 6.1 - Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Trup, kub, kuboid, cilindër, kon, sferë, piramidë	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjen; faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë;</li> <li>• Krahason trupat gjeometrikë (përmasat e tyre);</li> <li>• Tregon dallimet ndërmjet trupave gjeometrikë (me qoshe dhe të rrumbullak).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon karakteristikat e trupave gjeometrikë;</li> <li>• Gjen dallimet mes trupave të ndryshëm gjeometrikë;</li> <li>• Klasifikon trupat gjeometrikë në trupa rrotullues, trupa që rrëshqasin dhe që i kanë të dy këto veti.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Trego karakteristikat e trupave gjeometrikë;</li> <li>• Gjej dallimet mes trupave të ndryshëm gjeometrikë;</li> <li>• Klasifiko trupat gjeometrikë në trupa rrotullues, trupa që rrëshqasin dhe që i kanë të dy këto veti.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, trupa gjeometrikë, lapsi, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës, Shkathtësi për jetë	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Loja: Kush e gjen? Mësimdhënësi/ja ka marrë trupa gjeometrikë në formë të kubit, kuboidit, konit, cilindrit, sferës dhe piramidës të madhësive të ndryshme. Të gjithë këta trupa i vendosë në një thes dhe më pas kërkon nga secili nxënës të vendos dorën brenda dhe me sy mbyllur të kap një trup dhe të përpiqet që ta qëllojë pa e parë atë. Nxënësi para se të qëllojë duhet ta përshkruajë atë duke veçuar karakteristikat dhe më pas e nxjerrë nga thesi për ta vërtetuar nëse e ka qelluar atë. Loja vazhdon derisa secili nxënës të përfundojë këtë procedurë.  Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 67. Meqë në detyrën 1 është paraqitur loja e cila veç është realizuar në pjesën e parë të orës mësimore, nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë të	

pavarur në detyrën 2 ku kërkohet nga nxënësit që të dallojnë cilat figura gjeometrikë përmbahen në trupat gjeometrikë duke vendosur V ose X.

**Hapi III – Punë me libër**

Në faqen 68 në detyrën 1, nxënësit duhet të shënojnë numrin e faqeve, brinjëve dhe kulmeve për secilin trup të dhënë në tabelë. Në detyrën 2 dhe 3 kërkohet që nxënësit në çifte të krahasojnë dy trupa gjeometrikë duke veçuar të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja fokusohet për vlerësimin se si nxënësit bëjnë krahasimin e trupave gjeometrikë dhe dallimin e karakteristikave veçuese.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Krahasimi i gjatësisë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Gjatësi, matje, më i gjatë, më i shkurtër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet; më i gjatë, më i shkurtër, po aq;</li> <li>Vlerëson dhe renditë objektet sipas madhësive.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Përshkruan duke matur me sy gjatësinë e objekteve;</li> <li>Krahason me sy gjatësinë e dy e më shumë objekteve;</li> <li>Përcakton objekte me të gjata ose më të shkurtëra se objekti i dhënë.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Përshkruaj duke matur me sy gjatësinë e objekteve;</li> <li>Krahaso me sy gjatësinë e dy e më shumë objekteve;</li> <li>Përcakto objekte me të gjata ose më të shkurtëra se objekti i dhënë.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës,	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja merr pranë vetës një objekt, qoftë laps apo dicka tjetër. Diskutohet me nxënësit për objektet që kanë gjatësi më të madhe se lapsi dhe tregohen disa shembuj. Poashtu, diskutohet edhe për objekte që kanë gjatësi më të vogël se lapsi dhe tregohen disa shembuj.	



Pas diskutimit, mësuesimdhënësi/ja merr pranë vetës një objekt tjetër, psh një vizore. Nga nxënësit kërkohet që secili me radhë të tregoj nga një objekt real që ka gjatësi më të madhe se vizorja mirëpo rregulli duhet të jetë i tillë që secili shembull që tregohet të ketë gjatësi më të madhe se shembulli paraprak. Psh, nëse mësuesimdhënësi/ja mban në dorë vizoren, nxënësi tjetër mund të cekë librin, nxënësi i dytë me radhë duhet të tregojë dicka që ka gjatësi më të madhe se libri, psh çanta. Nxënësi i tretë me radhë duhet të tregojë dicka që ka gjatësi më të madhe se çanta e kështu me radhë. Kjo bëhet në mënyrë që të fitohet një renditje e objekteve nga ai me gjatësi më të vogël tek ai me gjatësi më të madhe, por njëkohësisht bëhet edhe krahasimi i gjatësive të shumë objekteve të ndryshme.

I njëjti shembull përsëritet edhe për të treguar objekte me gjatësi më të vogla.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 71. Në detyrën 1 nxënësit duke analizuar ilustrimin në faqen paraprake krahasojnë kafshët. Në detyrën 2, nxënësit duhet të vlerësojnë me sy gjatësinë e litarëve dhe të tregojnë se cili është më i gjatë e cili më i shkurtër. Në detyrën 3 duke analizuar objektet duhet të bëjnë renditjen e tyre nga ai është më i shkurti deri te më i gjati.

#### Hapi III – Punë praktike

Në detyrën 4 dhe 5, kërkohet nga nxënësit që të bëjnë punë praktike duke krahasuar gjatësinë e tyre me gjatësinë e shokut apo shoqes së bankës dhe më pas të vazhdohet me krahasimin e objekteve që gjenden në klasë duke filluar nga objekti më i shkurtër.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Matja e gjatësisë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; II.8- Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Gjatësi, matje, më i gjatë, më i shkurtër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Matë gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde.</li> <li>• Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet; më i gjatë, më i shkurtër, po aq.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan duke matur me njësi jostandarde gjatësinë e objekteve;</li> <li>• Krahason gjatësinë e dy e më shumë objekteve;</li> <li>• Veçon objekte me të gjata ose më të shkurtëra se objekti i dhënë.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruaj duke matur me njësi jostandarde gjatësinë e objekteve;</li> <li>• Krahaso gjatësinë e dy e më shumë objekteve;</li> <li>• Veço objekte me të gjata ose më të shkurtëra se objekti i dhënë.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, shirita, lapsi, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja merr pranë vetës disa shirita dhuratash me gjatësi dhe ngjyra të ndryshme. Ndanë nxënësit në grupe dhe secilit grup ju jep nga një shirit të cilin ata duhet ta matin me pëllëmbë. Pasi ta kenë përfunduar mësimdhënësi/ja bashkë me nxënësit shkruan në tabelë të	

dhënat që kanë arritur nxënësit në grupet e tyre. Diskutohet me nxënësit për shiritat duke i krahasuar ata se cili është më i gjatë se cili, apo cili është më i shkurtër se cili.

#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 72. Në detyrën 1 nxënësit duke analizuar ilustrimet duhet të përcaktojnë gjatësinë e objekteve në ilustrim duke marrë si njësi matëse kaset prej letre, gomat, lapsat dhe kubëzat. Në detyrën 2 kërkohet aktivitet konkret ku nxënësit me pëllëmbë do të matin gjatësinë e bankës. Më pas nxënësit do të krahasojnë rezultatet e tyre mes vete meqë pëllëmba e dorës në këtë rast është njësi jostandarde për matjen e gjatësisë dhe rezultatet që do të fitojnë nxënësit do të jenë të ndryshme. Në detyrën 3 duke analizuar shiritat duhet të përcaktojnë se cili është më i shkurtër e cili më i gjati.

#### Hapi III – Punë praktike

Nxënësit duhet të gjejnë disa objekte në klasë dhe të bëjnë matjen e tyre duke përdorur mjete jostandarde si lapsin, kapëse letre apo pëllëmbën. Të dhënat i shënojnë në fletore dhe i paraqesin me vizatim.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst, fletore duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Metri	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. VI.6 - Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme. 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Gjatësi, matje, njësi, metri	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Matë gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde.</li> <li>• Vlerëson dhe renditë objektet sipas madhësive.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon njësinë matëse të gjatësisë (metri);</li> <li>• Tregon dallimin në mes të njësive standarde nga ato jostandarde;</li> <li>• Rendit objektet sipas gjatësive të tyre.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifiko njësinë matëse të gjatësisë (metri);</li> <li>• Trego dallimin në mes të njësive standarde nga ato jostandarde;</li> <li>• Rendit objektet sipas gjatësive të tyre.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, metri, lapsi, ngjyrat, fletorja, goma	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret	

Mësimdhënësi/ja fillimisht diskuton me nxënësit se metri është njësi për matjen e gjatësisë dhe e shënojmë me (m). Gjithashtu ai/ajo përmes projektorit apo ndonjë forme tjetër paraqet lloje të ndryshme të metrit. Më pas, para nxënësve prezanton metrin duke treguar se si përdoret nëse duam të matim gjatësinë trupore. Mësimdhënësi/ja njofton nxënësit se ne sot do të zbulojmë përmes metrit se kush është më i shkurtër se një metër e kush më i gjatë se një metër. Të dhënat shënohen në tabelë, psh:





Më i gjatë se 1 metër	Më i shkurtër se 1 metër
Jeta	Agimi

### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 73. Në detyrën 1 nxënësit duke analizuar ilustrimet duhet të përcaktojnë gjatësinë e fëmijëve ngjashëm me aktivitetin në klasë. Në detyrën 2 kërkohet aktivitet konkret ku nxënësit do të analizojnë në klasë objektet duke zbuluar 3 objekte më të gjata se 1 metër dhe 3 më të shkurtra se 1 metër. Në detyrën 3 nxënësit do të mbledhin dhe do të zbresin njësitë të shprehura në metra.

### Hapi III – Punë në fletore

Nxënësit në fletore vizatojnë nga katër objekte që kanë gjatësinë më të vogël se 1 metër dhe 4 që kanë gjatësinë më të madhe se 1 metër.

Më i gjatë se 1 metër	Më i shkurtër se 1 metër
	

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst, fletore duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Centimetri	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Gjatësi, matje, metri, njësi, centimetri	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Matë gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde.</li> <li>• Përdorë metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde;</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon njësinë matëse të gjatësisë (centimetri);</li> <li>• Dallon centimetrin nga metri dhe trego lidhjen mes tyre;</li> <li>• Mat me vizore gjatësitë e objekteve të ndryshme.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifiko njësinë matëse të gjatësisë (centimetri);</li> <li>• Dallo centimetrin nga metri dhe trego lidhjen mes tyre;</li> <li>• Mat me vizore gjatësitë e objekteve të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, ngjyrat, goma, fletorja	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja fillimisht diskuton me nxënësit se metri është njësi për matjen e gjatësisë dhe e shënojmë me (m) gjithashtu ai/ajo potencon se brenda metrit janë edhe centimetrat të cilat e përbëjnë metrin, pra 1metër është i barabartë me 100 centimetra. Centimetrin e shënojmë me (cm). Tani njofton nxënësit se ne do të zbulojmë gjatësinë tonë trupore. Mësimdhënësi/ja njofton nxënësit se ne sot do të zbulojmë përmes metrit dhe centimetrit se sa është gjatësia e trupit tonë. Këto të dhëna shënohen në tabelë, psh:	



Emri i nxënësit	Metër	Centimetra
Jeta	1m	23cm

### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 74. Në detyrën 1 nxënësit duke analizuar ilustrimet diskutojnë për centimetrin. Në detyrën 2 kërkohet që nxënësit të analizojnë gjatësinë e lapsave dhe ta shprehin me centimetra. Në detyrën 3 kërkohet aktivitet konkret ku nxënësit duhet të matin gjësendet sipas kërkesave të dhëna dhe të shënojnë gjatësitë e tyre.

### Hapi III – Punë në fletore

Nxënësit në fletore vizatojnë nga katër objekte që kanë gjatësinë më të vogël se 3 centimetra dhe 4 që kanë gjatësinë më të madhe se 3 centimetra.

Më i gjatë se 3 centimetra	Më i shkurtër se 3 centimetra
	

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst, fletore duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Metri dhe centimetri	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 3.6 – Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Gjatësi, matje, metri, njësi, centimetri	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Matë gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde;</li> <li>• Përdorë metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon njësitë matëse të gjatësisë (metrin dhe centimetrin);</li> <li>• Dallon centimetrin nga metri;</li> <li>• Krahason gjatësitë e objekteve të ndryshme.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifiko njësinë matëse të gjatësisë metrin dhe centimetrin;</li> <li>• Dallo centimetrin nga metri;</li> <li>• Krahaso gjatësitë e objekteve të dhëna në libër.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, ngjyrat.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Kllaster Mësimdhënësi/ja fillimisht diskuton me nxënësit për metrim dhe centimetrin. Tani kërkon të shënojë në fletore disa karakteristika që i veçojnë këto njësi matëse. Nxënësit mund të organizojnë të dhënat në formë kllasteri, sipas shembullit të dhënë më poshtë.	





### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 75. Detyra 1 nxënësit duke analizuar ilustrimet lidhin objektet që janë më të përshtatshme për t`u matur me metër dhe ato që janë më të përshtatshme për t`u matur me centimetër. Në detyrën 2 kërkohet që nxënësit të analizojnë gjatësinë e perimeve dhe ta shprehin me centimetra e më pas të krahasojnë gjatësitë e këtyre perimeve.

### Hapi III – Punë e pavarur në libër

Nxënësit në libër faqe 76, duke analizuar kërkesat e dhëna në detyrat e caktuara duhet të plotësojnë dhe kryejn matje të ndryshme të cilat i shënojnë në libër.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst duke udhëhequr listë kontrolli dhe duke mbajtur shënime në ditarin e saj.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme me fjalë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë.	
FJALËT KYÇE: Probleme, strategji, zgjidhje etj.	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidh problema me fjalë nga jeta e përditshme.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon kërkesat e problemeve me fjalë;</li> <li>• Përdor strategji për zgjidhjen e problemeve me fjalë;</li> <li>• Argumenton strategjinë e përdorur dhe zgjidhjen e problemit.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon kërkesat e problemeve me fjalë;</li> <li>• Përdor strategji për zgjidhjen e problemeve me fjalë;</li> <li>• Argumenton strategjinë e përdorur dhe zgjidhjen e problemit.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, goma, ngjyrat.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Detyrë problemore</p> <p>Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore duke u parashtruar nxënësve një detyrë problemore në lidhje me gjatësinë e objekteve., psh: <i>Miri është i gjatë 87 cm, ndërsa nëna e tij është 1.69cm e gjatë. Sa cm është më e gjatë nëna sesa Miri?</i></p> <p>Nxënësit shkruajnë detyrën në fletore dhe pasi të gjejnë rezultatin, mësimdhënësi/ja diskuton me ta rreth strategjive të ndryshme që kanë përdorur në zgjidhjen e këtij problemi. Secili nxënës tregon mënyrën se si ka arritur deri te rezultati në mënyrë që të ketë laramani të strategjive.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 77. Detyrat e paraqitura në këtë faqe kanë kërkesa të ndryshme të cilat nxënësit duke i analizuar duhet të gjejnë strategjinë më të lehtë për ta zgjidhur detyrën e dhënë me fjalë. Zgjidhjet e detyrave diskutohen në nivel klase.</p> <p>Hapi III – Shkrim i lirë</p> <p>Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore duke krijuar secili nga 3 detyra me fjalë sipas dëshirës. Përmes ndonjë teknike mësimdhënësi/ja përzgjedh disa nxënës për të prezantur punën e tyre para klasës.</p>	

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

VLERËSIMI: Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Matja dhe krahasimi i segmenteve	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Segment, gjatësi, matje, centimetër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet; më i gjatë, më i shkurtër, po aq;</li> <li>• Bën lidhje ndërmjet numrave dhe matjeve;</li> <li>• Përdorë metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor vizorën për të kryer matjet;</li> <li>• Krahason gjatësinë e segmenteve;</li> <li>• Veçon segmentin me të gjata ose më të shkurtëra se segmenti i dhënë.</li> <li>• Njehson gjatësinë e segmenteve të dhëna.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor vizorën për të kryer matjet;</li> <li>• Krahaso gjatësinë e segmenteve;</li> <li>• Veço segmentin me të gjata ose më të shkurtëra se segmenti i dhënë.</li> <li>• Njehso gjatësinë e segmenteve të dhëna.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, pipa lëngjesh, vizore, gërshërë, ngjitës, fletë A4, lapsi, goma, ngjyrat, fije peri	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës,	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret	

Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore duke u parashtruar nxënësve një detyrë. Nxënësit duhet të jenë të ndarë në grupe. Paraprakisht mësimdhënësi/ja ka përgatitur nga tre pipa lëngjesh të cilët kanë gjatësi të ndryshme dhe u shpërndanë secilit grup nga tre fyshta. Ata kanë për detyrë të matin me vizore gjatësinë e pipave. Pas përfundimit të detyrës, nxënësit prezantojnë para klasës gjatësinë e pipave, i krahasojnë gjatësitë e secilit pip dhe në fund u kërkohet të mbledhin gjatësinë e të tre pipave për të kuptuar se çfarë gjatësie do të fitohej sikur t'i lidhnim bashkë të tre.



#### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 78. Detyra 1 ka të bëjë me matjen që duhet të kryejnë nxënësit për të vazhduar me krahasimin e segmenteve. Në detyrën 2 kërkohet të matet gjatësia e secilit segment, të plotësohen dhe të llogariten gjatësitë e segmenteve në kombinime të ndryshme.

#### Hapi III – Aktivitet në fletë A4

Secili nxënës do të shkruaj 3 gjatësi të ndryshme të shprehura me centimetra (psh: 4cm, 7cm, 9cm). Më pas, nxënësit do të shkëmbejnë fletat e tyre me shoqen/shokun e bankës dhe secili nxënës do të presë me gërshërë fije peri sipas gjatësive që ka shkruar shoqja/shoku i bankës dhe t'i vendosin me ngjitës në fletë. Në fund nxënësit do të vlerësojnë njëri-tjetrin duke shikuar nëse fijet e perit kanë gjatësitë sipas kërkesave të tyre.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Perimetri i figurave gjeometrike	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Gjatësi, matje, perimetër	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Matë gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde;</li> <li>• Përdorë metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor vizorën për matjen e gjatësive të brinjëve të figurave gjeometrike;</li> <li>• Krahason gjatësinë e brinjëve;</li> <li>• Njehson perimetrin e figurave gjeometrike duke bërë matjet e sakta.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor vizorën për matjen e gjatësive të brinjëve të figurave gjeometrike;</li> <li>• Krahaso gjatësinë e brinjëve;</li> <li>• Njehso perimetrin e figurave gjeometrike duke bërë matjet e sakta.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, vizore, gërshërë, ngjitës, fletë A4, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës,	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Diskutim / Aktivitet i përbashkët</p> <p>Mësimdhënësi/ja diskuton me nxënësit rreth figurave gjeometrike, fokusin e vë te katrori dhe drejtkëndëshi. Mësuesimdhënësi/ja mund të sjellë në klasë tabelën gjeometrike mirëpo, në rast të mungesës së saj, mësuesja mund të përdorë petëzat në formë katrori dhe drejtkëndëshi. Poashtu, mësuesimdhënësi/ja ka me vete edhe disa fije peri, me anë të të cilave tregon gjatësinë e formave të sipërpërmendura. Psh, në tabelën gjeometrike mund</p>	





TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune.</p>	
FJALËT KYÇE: Probleme, strategji, zgjidhje	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Matë gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njehson perimetrin e figurave të ndryshme.</li> <li>• Përdor strategji për zgjidhjen e detyrave me perimetër;</li> <li>• Argumenton strategjinë e përdorur dhe zgjidhjen e problemeve.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njehson perimetrin e figurave të ndryshme.</li> <li>• Përdor strategji për zgjidhjen e detyrave me perimetër;</li> <li>• Argumento strategjinë e përdorur dhe zgjidhjen e problemeve.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkenca e Natyrës	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Detyrë problemore Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore duke u parashtruar nxënësve një detyrë problemore në lidhje me perimetrin. Ai/ajo ka sjellë një fotografi në klasë dhe kërkon të di se sa është perimetri saj në mënyrë që të blejë kornizën e përshtatshme për fotografinë. Fton dy nxënës ku njëri me vizore bën matjen dhe tjetri shkruan përmasat në tabelë. Më pas diskutohet në klasë dhe shkruhet perimetri i fotografisë.</p> <p>Hapi II – Punë me libër Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 81. Detyrat e paraqitura në këtë faqe kanë kërkesë të njëjtë, ku nxënësit duke analizuar ilustrimet duhet të gjejnë strategjinë më të lehtë për të njehsuar perimetrin e figurave. Zgjidhjet dhe strategjitë e përdorura diskutohen në nivel klase.</p> <p>Hapi III – Punë në fletore Nxënësit do të punojnë të kundërtën e punës që bënë në libër. Tani mësimdhënësi/ja do të kërkojë që secili prej tyre duke përdorur katrorët e fletorës të paraqesin një figurë e cila ka</p>	



perimetrin 27 cm. Nxënësit prezajtojnë punën e tyre dhe krahasojnë me ato të shoqeve e shokëve të klases meqë figurat e paraqitura nga nxënësit do të jenë të llojllojshme.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst.

TEMA: Sipërfaqja	
NJËSIA MËSIMORE: Sipërfaqja	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5minutash;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Sipërfaqja, trekëndëshi, katërkëndëshi, e brendshme, e jashtme	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon sipërfaqen brenda, jashtë dhe në figurë.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon figurën gjeometrike dhe sipërfaqën brenda dhe jashtë saj;</li> <li>Ngjyros sipërfaqën brenda/jashtë katrorit;</li> <li>Demostron me shembuj të ndryshëm sipërfaqen e brendshme dhe të jashtme të figurës.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallo figurën gjeometrike dhe sipërfaqën brenda dhe jashtë saj;</li> <li>Ngjyros sipërfaqën brenda/jashtë katrorit;</li> <li>Demostro me shembuj të ndryshëm sipërfaqen e brendshme dhe të jashtme të figurës.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor, fletë hameri, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Diskutim i përbashkët</p> <p>Ora fillon duke paraqitur para nxënësve sipërfaqe të ndryshme, qoftë shumëkëndëshe e qoftë të lakuara. Paraqitjet mund të bëhen në projektor ose në fletë hameri. Diskutohen sipërfaqet e figurave të paraqitura, vetë figurat si dhe sipërfaqet jashtë figurave. Më tej, secilit nxënës i shpërndahet nga një fletë A4, ku janë vizatuar disa sipërfaqe të ndryshme. Udhëzohen nxënësit që të ngjyrosin me çfarë ngjyra të dëshirojnë të gjitha sipërfaqet e figurave që i dallojnë në fletë. Pas përfundimit të aktivitetit, mund të formohet një galeri duke varur fletat me sipërfaqe të llojllojshme në murin e klasës.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 82 dhe 83. Detyra 1 përmban disa pyetje në të cilat nxënësit duhet të përgjigjen duke analizuar ilustrimin në fq. 82. Në detyrën 2 jepet</p>	

sqarim për sipërfaqen e brendshme dhe atë të jashtme. Në detyrën 3 kërkohet të ngjyroset sipas ngjyrave sipërfaqja e brendshme dhe e jashtme e figurave të dhëna. Në detyrën 4 kërkohet që brenda rrathëve të vizatohen disa figura dhe të ngjyroset me ngjyra të ndryshme sipërfaqja e brendshme dhe ajo e jashtme.

### Hapi III – Punë në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Nxënësit shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe secili vizaton disa figura ku kërkohet të ngjyroset sipërfaqja e brendshme dhe e jashtme.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.


**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst.

TEMA: Sipërfaqja	
NJËSIA MËSIMORE: Matja e sipërfaqes	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5minutash;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>VI.6 - Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Sipërfaqja, matje, njësi katrore	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Njehson syprinën e figurave të paraqitura në sipërfaqe me katror.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Njehson sipërfaqen me njësi katrore;</li> <li>Demonstron me shembuj të ndryshëm të matjes së sipërfaqës së brendshme;</li> <li>Mat sipërfaqën me njësi katrore në detyra të ndryshme.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Njehson sipërfaqen me njësi katrore;</li> <li>Demonstron me shembuj të ndryshëm të matjes së sipërfaqës së brendshme;</li> <li>Mat sipërfaqën me njësi katrore në detyra të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri bazë Matematika 2B, fletë të bardha, fleta të prera në formë katrore, ngjitës, lapsi, goma, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Ora fillon me një aktivitet konkret. Mësimdhënësi/ja ka përgatitur disa fleta të bardha të madhësive të ndryshme për 5 grupe si dhe fleta të vogla me ngjyra të ndryshme me formë katrore. Tani nxënësit ndahen në 5 grupe dhe secilit grup u jepet nga një fletë e bardhë me madhësi të ndryshme. U shpërndahen edhe sasi të caktuara të fletave të vogla në formë katrore të cilat janë me ngjyra të ndryshme. Tani ju kërkohet që duke përdorur fletat e vogla katrore të mbulojnë pjesën e brendshme të fletës së bardhë. Ata mund të ngjeshin me ngjitës fletat me ngjyra në fletën e bardhë. Pas përfundimit të detyrës secili grup prezanton punën e bërë dhe tani analizohen në mënyrë të përbashkët se sa katrorë është dashur për të mbuluar pjesën e brendshme të fletës. Me këtë rast mësimdhënësi/ja veçon se për të gjetur sipërfaqen e një figure ne marrim për njësi matëse katror e cila mund të jetë e përmasave të ndryshme.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 84. Detyra 1 është dhënë në formë saqarimi për nxënësit lidhur me matjen e sipërfaqes së figurave.</p>	

Në detyrën 2 kërkohet të kryejnë matjen e sipërfaqeve të dhëna dhe rezultatet diskutohen në nivel klase.

### Hapi III – Punë në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Nxënësit shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe secili vijëzon katrorët e fletorës duke kërkuar nga shoqja/shoku i bankës që të zbulojë sipërfaqen e brendshme të figurës së paraqitur.



**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst.

TEMA: Sipërfaqja	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5minutash;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj;</p> <p>V.2 - Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e ftores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet);</p> <p>VI.6 - Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Sipërfaqja, matje, njësi katrore	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Njehson syprinën e figurave të paraqitura në sipërfaqe me katror.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS:	KRITERET E SUKSESIT:
<ul style="list-style-type: none"> <li>Njehson sipërfaqen e figurave të ndryshme;</li> <li>Vizaton katrorin me sipërfaqe aq njësi katrore sa janë dhënë;</li> <li>Vizaton drejtkëndëshin me sipërfaqe aq njësi katrore sa janë dhënë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njehso sipërfaqen e figurave të ndryshme;</li> <li>Vizato katrorin me sipërfaqe aq njësi katrore sa janë dhënë;</li> <li>Vizato drejtkëndëshin me sipërfaqe aq njësi katrore sa janë dhënë.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor, fletë hameri, lapsi, goma, ngjyrat.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:	
<p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Ora fillon me një aktivitet konkret. Mësimdhënësi/ja ka përgatitur disa fleta të printuara. Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup ka për detyrë të numërojë katrorët njësi për të llogaritur sipërfaqen e figurës. Nxënësit njehsojnë sipërfaqen e secilës figurë dhe i prezantojnë para grupeve tjera.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 85. Në detyrën 1 janë dhënë 2 ilustrime dhe nga nxënësit kërkohet të gjejnë sipërfaqen e këtyre dy figurave duke numëruar katrorët e</p>	

ngjyrosur. Në detyrat e tjera kërkohet të vizatojnë katrorë dhe drejtkëndësha duke përdorur numrin e saktë të katrorëve njësi të dhënë në kërkesë.


### Hapi III – Projekt

Nxënësit tani vazhdojnë punën në libër për të analizuar projektin e dhënë 86, 87. Nxënësit mund të punojnë në çifte dhe të analizojnë rezultatet e fituara.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Më i lehtë apo më i rëndë	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Masë, matje, më i rëndë, më i lehtë	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Demonstron peshimin me anë të balancës duke përdorur sende të ndryshme.</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon masën e objekteve duke krahasuar me sy;</li> <li>Identifikon objektet më të rënda dhe më të lehta;</li> <li>Krahason kush është më i lehtë më i rëndë dhe po aq sa.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Trego masën e objekteve duke krahasuar me sy;</li> <li>Identifiko objektet më të rënda dhe më të lehta;</li> <li>Krahaso kush është më i lehtë më i rëndë dhe po aq sa.</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, lapsi, ngjyra, varësja, objektet e ndryshme në klasë	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe Puna	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja vendosë para nxënësve një varëse rrobash në skajet e të cilës janë të lidhura dy qese. Varësen e vendosë diku në klasë dhe fton nxënësit që në qese të vendosin gjëra të ndryshme dhe pastaj fillon e diskuton cila qese është më e rëndë e cila më e lehtë. Si e dimë këtë? A mund ta dimë vetëm duke parë me sy?</p> <p>Kështu, nxënësit e kuptojnë që qesja që zhvendoset poshtë ka peshë më të rëndë, ndërsa ajo që mbetet lart është më e lehtë.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 89. Fillimisht diskutohet për detyrën 1 në të cilën nxënësit duke analizuar ilustrimin në faqen paraprake gjejnë se cili nga fëmijët është më i rëndë.</p>	





Në detyrën 2 kërkohen aktivitete praktike dhe analizë e ilustrimeve duke diskutuar për të zbuluar se cili objekt është më i rëndë se tjetri. Në detyrën 3 kërkohet hulumtim për të zbuluar 4 objekte më të rënda se çanta dhe 4 më të lehta.

### Hapi III – Ushtrime

Nxënësit tani vazhdojnë punën në libër për të analizuar kërkesat e dhëna në faqen 90. Nxënësit mund të punojnë në çifte dhe të analizojnë rezultatet e fituara.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst.

TEMA: Njësitë matëse

NJËSIA MËSIMORE: Masa

KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:

I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;

II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre;

III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:

1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;

1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;

3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;

4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.

FJALËT KYÇE: Masë, matje, më i rëndë, më i lehtë, aq sa

REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:

- Demonstron peshimin me anë të balancës duke përdorur sende të ndryshme.

REZULTATET E ORËS:

- Përshkruan masën e objekteve duke krahasuar me sy;
- Vizaton objekte më masa sipas kërkesave në tekst;
- Krahason kush është më i lehtë, më i rëndë dhe po aq sa.

KRITERET E SUKSESIT:

- Përshkruaj masën e objekteve duke krahasuar me sy;
- Vizato objekte më masa sipas kërkesave në tekst;
- Krahaso kush është më i lehtë, më i rëndë dhe po aq sa.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, ngjyra, fletorja, varësja, objektet e ndryshme në klasë

LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:

Hapi I – Aktivitet konkret

Mësimdhënësi/ja duke diskutuar me nxënësit, rikujtojnë njohuritë e fituara gjatë orës paraprake ku theks të vecantë i jepet aktivitetit me varëse duke theksuar që gjithmonë objekti me masë më të madhe e tërhiqte varësen poshtë ndërsa objekti më i lehtë shkon lart.

Nxënësit me anë të varëses provojnë me objekte të ndryshme të bëjnë krahasime lidhur me masën e objekteve të ndryshme që ata kanë zgjedhur dhe mbajnë shënim se cili objekt është më i rëndë, cili më i lehtë e cilët kanë masë të barabartë.



### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 91. Në detyrën 1 kërkohet nga nxënësit që duke analizuar ilustrimin të plotësojnë fjalitë e dhëna. Nxënësit fillimisht duhet të bëjnë gjeje të masës e objekteve të ndryshme duke përdorur si njësi matëse (jostandarde) kubëzat. Psh, nxënësit duhet të tregojnë sa kubëza peshon një breshkë, një pulë, një majmun etj. Duhet pasur parasysh kombinimet e kafshëve, masa e tyre duhet të shndërrohen në kubëza në mënyrë që të arrihet rezultati përfundimtar për masën e secilës kafshë e më pas plotësohen fjalitë e dhëna në libër.


### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit do të paraqesin në fletore 7 kafshë të ndryshme dhe so të bëjnë krahasime duke treguar kush është më i rëndë e kush më i lehtë. Më pas, do t'i renditën kafshët e përzgjedhura duke filluar nga më e lehta deri te më e rënda.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

### VLERËSIMI:

Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst bazë dhe në fletore.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Kilogrami	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fllëstar të matematikës për t’u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Masë, matje, kilogram, peshore	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton peshën e objekteve (kg).</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon njësinë për matjen e masës;</li> <li>• Krahason objektet duke krahasuar masat e tyre;</li> <li>• Gjen masën e objekteve të ndryshme duke analizuar peshoret</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikoj njësinë për matjen e masës;</li> <li>• Krahaso objektet duke krahasuar masat e tyre;</li> <li>• Gjej masën e objekteve të dhëna duke shikuar të dhënat në peshore</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, ngjyrat, peshoret	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës, Jeta dhe puna	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:	
<p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja paraqet në klasë para nxënësve një peshore (të vogël) duke u treguar që është mjeti me të cilin matet masa e objekteve të ndryshme. Poashtu, mësuesja nxit nxënësit të mendojnë se cila është njësia për matjen e masës dhe pas identifikimit të kilogramit, rikujtojnë edhe simbolin kg. Më pas mësimdhënësi/ja paraqet edhe një peshore tjetër që shërben për matjen e masës trupore të njerëzve. Ajo fton nxënësit që të peshohen dhe të gjejnë masën e tyre trupore. Këto të dhëna i shënojnë në fletore.</p>	
	

### Hapi II – Punë me libër

Nxënësit vazhdojnë punën në librin bazë, faqe 92. Fillimisht diskutohet rreth detyrës 1 e më pas në detyrën 2 nxënësit duhet të plotësojnë fjalitë duke vendosur fjalët ‘‘më i rëndë’’ ose ‘‘më i lehtë’’ bazuar në ilustrimet e dhëna. Në detyrën 3 duhet të tregojnë se sa peshojnë objektet bazuar në vlerat e paraqitura në peshoret të cilat mbajnë gjësende të ndryshme.

### Hapi III – Kilogramët e mi

Mësimdhënësi/ja fton nxënësit që me radhë të vijnë te tabela dhe të gjejnë sa kg ka secili prej tyre duke u matur në peshoren të cilën mësimdhënësi/ja e ka prezantuar në fillim të orës mësimore.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst.

<b>TEMA:</b> Njësitë matëse	
<b>NJËSIA MËSIMORE:</b> Vlerësojmë kush çfarë mase ka	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
<b>FJALËT KYÇE:</b> Masë, matje, kilogram, peshore	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton peshën e objekteve (kg).</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon njësinë për matjen e masës;</li> <li>• Krahason objektet duke krahasuar masat e tyre;</li> <li>• Hamendëson rreth masës së përafërt të objekteve reale.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifiko njësinë për matjen e masës;</li> <li>• Krahaso objektet duke krahasuar masat e tyre;</li> <li>• Qarko masën më të përafërt të objekteve reale.</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, projektor ose fotografi, lapsi, ngjyrat, fletorja	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b>  <p>Hapi I – Kuiz</p> <p>Mësimdhënësi/ja paraqet me anë të projektorit disa fotografi të kafshëve dhe gjësedeve duke ofruar disa alternativa për masën që mund të kenë. Paraqiten fotografitë dhe nxënësit e ndarë në grupe duhet të përgjigjen duke hamendësuar për masën e asaj që shohin në fotografi. Krejt në fund përcaktohet grupi që ka qëlluar më së shumti përgjigje të sakta.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 93. Në detyrën 1 kërkohet nga nxënësit që të rrethojnë përgjigjen e saktë për masën që mund të ketë secila nga 7 kafshët e dhëna. Në shembullin 8 nxënësit duhet të hamendësojnë për masën e fëmijës. Në detyrën 2 nxënësit duhet të zbulojnë masën e kubit të verdhë, ndërsa në detyrën 3 duhet të zbulojnë masën e kubit portokalli.</p>	

Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Duke shkëmbyer fletoret krijojnë detyra për njëritjetrin të ngjashme me detyrën 2 dhe 3.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst dhe në fletore.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Veprime me kilogram	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;</p> <p>3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Masë, matje, kilogram, më e madhe, më e vogël, e barabartë.	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton peshën e objekteve (kg).</li> <li>• Përdor shenjat: <math>&lt;</math>, <math>&gt;</math>, <math>=</math>, për peshat e objekteve.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njehson detyra me kilogram;</li> <li>• Krahaso masat e ndryshme duke përdorur simbolet <math>&lt;</math>, <math>&gt;</math>, <math>=</math>;</li> <li>• Zgjidh detyra të ndryshme lidhur me masën.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njehso detyra me kilogram;</li> <li>• Krahaso masat e ndryshme duke përdorur simbolet <math>&lt;</math>, <math>&gt;</math>, <math>=</math>;</li> <li>• Zgjidh detyra të ndryshme lidhur me masën.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, etiketa, lapsi, ngjyra, fletorja, ngjitësi, fletë A4	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Copëza të përziera</p> <p>Mësimdhënësi/ja paraprakisht ka përgatitur detyra me mbledhjen dhe zbritjen me kilogram të cilat i ka ndarë në copëza. Tani nxënësit e ndarë në grupe marrin disa nga detyrat e ndara në copëza të cilat kur të bashkohen si duhet formojnë barazi të saktë. Këto copëza të bashkuara nxënësit duhet t'i vendosin me ngjitës në një fletë të bardhë A4 e më pas grupet prezantojnë lidhjet e copëzave që kanë bërë dhe argumentojnë rezultatet.</p> <p>Hapi II – Punë me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 94. Detyra 1 dhe 2 kanë të bëjnë me mbledhjen dhe zbritjen e njërive të ndryshme të dhëna në kilogramë, ndërsa detyra 3 dhe 4 kanë të bëjnë me krahasimin e masave të ndryshme duke përdorur shenjat <math>&lt;</math>, <math>&gt;</math>, <math>=</math>.</p> <p>Hapi III – Ushtrime në fletore</p>	



Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Duke shkëmbyer fletoret krijojnë detyra për njëritjetrin të ngjashme me ato që punuan në libër.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst dhe në fletore.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme me fjalë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave; 3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune.	
FJALËT KYÇE: Probleme, strategji, zgjidhje	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Zgjidh problema me fjalë nga jeta e përditshme.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon kërkesat e probleme me fjalë;</li> <li>Përdorë strategji për zgjidhjen e problemeve me fjalë;</li> <li>Argumenton strategjinë e përdorur dhe zgjidhjen e problemit.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifiko kërkesat e probleme me fjalë;</li> <li>Përdor strategji për zgjidhjen e problemeve me fjalë;</li> <li>Argumento strategjinë e përdorur dhe zgjidhjen e problemit.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletore, lapsi, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Detyrë problemore Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore duke u parashtruar nxënësve një detyrë problemore në lidhje me masën e objekteve. Psh: <i>Miri peshon 67 kg, ndërsa motra e tij peshon 43 kg. Sa kg më shumë peshon Miri sesa motra e tij?</i></p> <p>Nxënësit shkruajnë detyrën në fletore dhe pasi të gjejnë rezultatin, mësimdhënësi/ja diskuton me ta rreth strategjive të ndryshme që kanë përdorur në zgjidhjen e këtij problemi me fjalë. Secili nxënës tregon mënyrën se si ka arritur deri te rezultati në mënyrë që të ketë laramani të strategjive.</p> <p>Hapi II – Shqyrtim i përbashkët Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 95. Detyrat e dhëna në formë problemash analizohen dhe zgjidhen sipas strategjisë më të përshtatshme. Pas çdo detyre diskutohen në mënyrë të përbashkët për të mundësuar vlerësimin e veprimtarive në zgjidhjen e problemeve me fjalë.</p> <p>Hapi III – Punë e pavarur</p>	

Nxënësit tani vazhdojnë punën në mënyrë të pavarur në libër fq. 96 ku janë dhënë disa probleme të ngjashme me ato në faqen 95.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst dhe në fletore.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Vëllimi	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj; III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2 - Zbaton shprehje të arsyetit për të bërë hamendësime; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Sasi, krahasim, vëllim	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahason vëllimin e enëve të ndryshme, të njohura për ta.</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahason vëllimin e enëve të ndryshme;</li> <li>• Analizon cila enë zë më shumë sasi.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahaso vëllimin e enëve të ndryshme;</li> <li>• Analizo cila enë zë më shumë sasi.</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, fletore, lapsi, ngjyra, enë të ndryshme, gota plastike, fletëza, projektori	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Shkencat e Natyrës	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Që nxënësit të kenë më të lehtë kuptimin e vëllimit, mësimitdhënësi/ja fillimisht merr në klasë një lugë, një filxhan, një gotë. Mësimitdhënësi/ja fillon diskutimin me nxënësit se cila nga enët zë sasi më të madhe të ujit dhe pse? Më pas me ndihmën e projektorit mësimitdhënësi/ja paraqet para nxënësve disa kube të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme dhe pyet nxënësit se cili nga ta zë sasi më të madhe e cili sasi më të vogël. Në rast mungese të projektorit, mësuesja mund të printojë kubet në fleta A4 dhe t'i vendosë në tabelë që të mund t'i shohin të gjithë nxënësit.</p> <p>Hapi II – Shqyrtim i përbashkët</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 99. Në detyrën 1 nxënësit duhet të analizojnë ilustrimin në faqen paraprake (fq 98) dhe të përgjigjen në pyetjen e parashtruar. Në detyrën 2 nxënësit duhet të krahasojnë vëllimin e enëve të ndryshme sipas sasisë së lëngut që zënë ato. Këto enë nxënësit duhet t'i shenojnë me numra nga 1 deri në 12 duke filluar nga ajo enë që paraqet vëllimin me sasi më të vogël. Në detyrën 3 kërkohet të krahasojnë vëllimin e enëve duke analizuar sa filxhanë me ujë mund të mbushë secila prej tyre.</p> <p>Pas përfundimit të çdo detyre, rezultatet diskutohen në nivel klase për të mundësuar verifikimin e zgjidhjeve të detyrave dhe të bëhet argumentimi i zgjidhjeve për secilën prej këtyre detyrave.</p>	

### Hapi III – Punë praktike

Nxënësit tani vazhdojnë punën në grupe. Secilit grup i vendosen shishe të ndryshme të mbushura me ujë dhe disa gota plastike. Shishet duhet të jenë të formave të ndryshme, disa më të ngushta e më të gjata e disa tjera më të gjera e më të shkurtra. Nxënësit duhet të gjejnë se sa gota me ujë mund të mbushen nga secila shishe e më pas të krahasojnë enët duke filluar nga ajo me vëllim më të madh. Këto të dhëna nxënësit i diskutojnë në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;</p> <p>2.2 - Zbaton shprehje të arsytimit për të bërë hamendësime;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Sasi, krahasim, vëllim	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidh problema me fjalë nga jeta e përditshme.</li> <li>• Krahason vëllimin e enëve të ndryshme, të njohura për ta.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahason vëllimin e enëve të ndryshme;</li> <li>• Analizon cila enë zë më shumë sasi.</li> <li>• Përdor strategji praktike për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahaso vëllimin e enëve të ndryshme;</li> <li>• Analizo cila enë zë më shumë sasi.</li> <li>• Përdor strategji praktike për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletore, lapsi, ngjyrat, enë të ndryshme	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Shkencat e Natyrës	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Detyrë problemore/Aktivitet konkret</p> <p>Mësimdhënësi/ja fillon diskutimin me nxënësit me një situatë problemore. Mësimdhënësi/ja ka marrë një enë kuzhine të cilën e vendosë para nxënësve dhe gjithashtu një filxhan kafeje dhe një shishe. Tani fillon diskutimi: Sa filxhana kafeje do të na nevojiten për të mbushur enën e kuzhinës? Nxënësit hamendësojnë duke shprehur mendimet e tyre. Më pas shtrohet pyetja: Sa filxhana na duhen për të mbushur shishen? Pas përgjigjeve të dhëna fillojmë me aktivitetin konkret duke provuar që ta mbushim enën e kuzhinës dhe duke mbajtur shënim, më pas mbushim edhe shishen dhe tani nxjerrim përfundimet duke rishqyrtuar së bashku.</p> <p>Hapi II- Puna me libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër, faqe 100. Detyrat e dhëna janë problemore që kërkojnë analizë dhe diskutim. Nxënësit në çifte diskutojnë dhe zgjidhin problemat e paraqitura me fjalë.</p>	

Hapi III – Shkrim i lirë

Nxënësit do të krijojnë në fletore një detyrë problemore sipas dëshirës lidhur me vëllimin. Pas përfundimit të detyrës nxënësit prezantojnë detyrën para klasës dhe kërkojnë nga shoqet/shokët e klasës që ta zgjidhin detyrën. Ftohet një nxënës që të dalë te tabela dhe të zgjidhë detyrën e prezantuar.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve. Poashtu, përcjell punën individuale të nxënësve në tekst dhe në fletore.

TEMA: Njësitë matëse	
NJËSIA MËSIMORE: Punojmë me vëllime	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.2 - Sqaron me anë të folurit procedurën e zgjidhjes së një problem matematikorë me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.1- Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.2 - Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Sasi, vëllim, recetë, ëmbëlsirë	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahason vëllimin e enëve të ndryshme, të njohura për ta</li> <li>• Bën lidhje ndërmjet numrave dhe matjeve.</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mat vëllimin me njësi jostandarde;</li> <li>• Krahason vëllimet e matura me njësi jostandarde;</li> <li>• Përdor strategji praktike për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mat vëllimin me njësi jostandarde;</li> <li>• Krahason vëllimet e matura me njësi jostandarde;</li> <li>• Përdor strategji praktike për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme.</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, enë, gotë, lugë, pjatë, biskota, sheqer, gjalpë, kokos, qumësht, kakao	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, Jeta dhe puna	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> <p>Hapi I – Prezantimi i punës praktike  Mësimdhënësi/ja fillon orën duke njoftuar nxënësit që ne sot do të gatuajmë në klasë dhe fillon të njoftojë nxënësit me mjetet që do përdoren gjatë gatimit, receten dhe përbërësit si dhe ndarjen e detyrave për secilin.</p> <p>Hapi II- Puna praktike  Kjo orë i përkushtohet matjes reale të vëllimit me anë të enëve të kuzhinës. Në klasë duhet të sillen enët e domosdoshme për realizimin e projektit,që gjendet në tekst, fq. 101. Enët e domosdoshme janë: një enë mjaft e madhe sa për të zënë të gjithë përbërësit e nevojshëm, një gotë për të matur sasinë e duhur të sheqerit dhe qumështit, një lugë për të matur sasinë e duhur të kakaos, një pjatë për të derdhur aty miellin e kokosit nga paketimi. Poashtu, në klasë duhet të sillen përbërësit e ëmbëlsirës që do të përgatitet, e që janë: një paketim qumësht, një paketim gjalp i zbutur në temperaturë dhome, dy lugë kakao, një paketim sheqer dhe një qese miell kokosi. Gjatë matjes së vëllimeve të duhura të përbërësve, gjatë gatitjes së ëmbëlsirave dhe gjatë ngrënjes së tyre, në nivel klase mund të diskutohet dallimi në mes të vëllimit që zë gota, luga,</p>	



ena dhe pjata. Procedura e gatitjes është e dhënë në libër fq. 101, të cilën nxënësit e ndjekin duke diskutuar për veprimtarinë që zhvillohet.

Hapi III – Diskutim i përbashkët


Nxënësit tani vazhdojnë të diskutojnë rezultatet e fituara duke shijuar ëmbëlsirën e përgatitur nga vetë ata.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit si dhe gjatë diskutimeve.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Paratë	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2 - Zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësime; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Blerje, para, mbledhje, zbritje	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbledh dhe zbret paratë (euro).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon paratë euro;</li> <li>Mbledhin dhe zbresin me para;</li> <li>Krijon barazime për vlera të ndryshme të parave.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifiko paratë euro;</li> <li>Mbledh dhe zbrit paratë;</li> <li>Krijoj barazime për vlera të ndryshme të parave.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektor, hamer, fletore, laps, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Diskutim</p> <p>Mësimdhënësi/ja fillon diskutimin me nxënësit rreth blerjeve të shumta që bëjnë ata. Pyet nxënësit për lodrën e tyre të preferuar dhe sa kushton ajo. Pastaj, nxënësit tregojnë për paratë e ndryshme që njohin. Diskutimi mund të ndërlidhet edhe me fushat tjera duke treguar për llojet e monedhave të ndryshme që përdoren në botë. Identifikohet paraja që përdoret në vendin tonë (euro, €) dhe pastaj mësimdhënësi/ja paraqet me anë të projektorit apo hamerit paratë me vlerë 1€, 2€, 5€, 10€, 50€ dhe 100€.</p> <p>Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të ndërtojnë një barazim të mbledhjes për paratë 10€. Barazimet shkruhen në tabelë dhe diskutimi vazhdon edhe për vlerat e ndryshme të parave euro.</p> <p>Hapi II- Puna në libër</p> <p>Nxënësit vazhdojnë punën në libër. Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që ashtu si janë të ulur në banka, dy nga dy, të diskutojnë për paraqitjen në faqen 102 dhe për pyetjet e dhëna në detyrën 1 faqe 103. Më pas diskutimi zgjerohet në nivel klase. Në detyrën 2 kërkohet që duke shikuar ilustrimet e kuletave me para të gjejnë sa para ka në kuletë.</p> <p>Hapi III – Punë në fletore</p> <p>Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore të cilët krijojnë detyra lidhur me paratë. Fillimisht nxënësit do të paraqesin një tabelë në fletore e më pas në anën e majtë të saj do të paraqesin</p>	

produkte të ndryshme me çmime të ndryshme ndërsa në anën e majtë do të paraqesin shumën (paratë që ju nevojiten për të blerë të gjitha produktet).

Detyra	Sa para nevojiten?
 <div style="display: flex; justify-content: space-around; margin-top: 10px;"> <div style="border: 1px solid green; padding: 5px; width: 40px; text-align: center;">5 €</div> <div style="border: 1px solid green; padding: 5px; width: 40px; text-align: center;">2 €</div> <div style="border: 1px solid green; padding: 5px; width: 40px; text-align: center;">1 €</div> </div>	
<p><b>DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:</b> Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.</p>	
<p><b>VLERËSIMI:</b> Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër dhe fletore.</p>	


TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Euro	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2 - Zbaton shprehjet të arsyetimit për të bërë hamendësime; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Euro, blerje, para, mbledhje, zbritje	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbledh dhe zbret paratë (euro).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon paratë euro;</li> <li>Mbledhin dhe zbresin me euro;</li> <li>Krijon barazime për vlera të ndryshme të parave.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifiko paratë euro;</li> <li>Mbledh dhe zbrit me euro;</li> <li>Krijoj barazime për vlera të ndryshme të parave.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, para të printuara, fletore, lapsi, ngjyrat	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Aktivitet në grupe</p> <p>Mësimdhënësi/ja ndanë në grupe nxënësit dhe më pas secilit grup u jep disa kartëmonedha eurosh të printuara. Më pas në një kuti vendosë kartëmonedha dhe monedha të tjera të printuara të cilat grupet duhet t'i marrin për të fituar vlerën e njëjtë me kartëmonedhat e dhëna në fillim.</p> <p>Kur të kenë përfunduar punën nxënësit fillojnë të prezantojnë se si i kanë kombinuar vlerat për të fituar barazinë me vlerën e kartëmonedhës së dhënë në fillim.</p> <p>Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të diskutojnë dhe analizojnë veprimtarinë e secilit grup duke argumentuar nëse kanë bërë zgjidhje të saktë ose jo.</p> <p>Hapi II- Puna në libër</p> <p>Nxënësit hapin libri, fq. 104. Në detyrën 1 nxënësit duhet të ngjyrosin monedhat në atë mënyrë që të fitojnë vlerën e parave të paraqitura në anën e majtë të tekstit. Në detyrën 2, 3 dhe 4 kërkohet të njehsojnë me euro që të gjejnë shumën apo ndryshimin duke përdorur eurot.</p> <p>Hapi III – Punë në fletore</p> <p>Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore të cilët krijojnë detyra lidhur me paratë. Në mes të faqes vendosin një vlerë prej disa eurosh (shembull: 10€) e më pas paraqesin monedha e kartëmonedha duke bërë kombinime të ndryshme të cilat së bashku paraqesin vlerën prej 10 euro.</p>	



DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

VLERËSIMI: Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër dhe fletore.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Centët	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2 - Zbaton shprehjet të arsyetimit për të bërë hamendësime; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Cent, euro, para, mbledhje, zbritje	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbledh dhe zbret paratë (euro).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen shumën e parave;</li> <li>Mbledh dhe zbresin me euro dhe cent;</li> <li>Ndërton barazime për paratë.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjej shumën e parave;</li> <li>Mbledh dhe zbret me euro;</li> <li>Ndërto barazime për paratë.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektori ose hamer, fletore, laps, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Diskutim</p> <p>Mësimdhënësi/ja në fillim të orës mësimore, bën ndërlidhjen me orën paraprake. Pra, nxënësit së bashku me mësuesen rikujtojnë eurot dhe njohuritë e shumta që kanë për to. Ndër të tjera, mësuesja rikujton nxënësit rreth barazimeve të shumta që kanë ndërtuar për vlerat e ndryshme të parave, psh: <math>10\text{€} = 2\text{€} + 5\text{€} + 2\text{€} + 1\text{€}</math>.</p> <p>Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit nëse ka monedha që kanë vlerë më të vogël se 1€. Në këtë mënyrë nxënësit fillojnë diskutimin rreth centëve. Mësimdhënësi/ja me anë të projektorit apo hamerit shfaqë para nxënësve monedhat e ndryshme që kanë vlerë më të vogël se 1€. Ato janë: 50 cent, 20 cent, 10 cent, 5 cent, 2cent dhe 1 cent. Kërkohej nga nxënësit që të ndërtojnë barazime të mbledhjes për monedhën 1€.</p>	



### Hapi II- Puna në libër

Nxënësit hapin librin, fq. 105. Në detyrën 1 nxënësit duhet të dallojnë monedhat centëshe. Në detyrën 2 kërkohet të ngjyrosin monedhat në atë mënyrë që të fitojnë vlerën e parave të paraqitura në anën e majtë të tekstit. Në detyrën 3, kërkohet të njehsojnë që të gjejnë shumën apo ndryshimin duke përdorur centët.

### Hapi III – Ushtrime në libër

Nxënësit tani vazhdojnë punën e pavarur në libër fq. 106. Në detyrën 1 nxënësit do të mbledhin dhe zbresin centë ndërsa në detyrën 2 do të gjejnë shumën e eurove dhe centëve duke analizuar paratë e vendosura në kuleta.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 2.2 - Zbaton shprehjet të arsyetimit për të bërë hamendësime; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.	
FJALËT KYÇE: Cent, euro, para, mbledhje, zbritje	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbledh dhe zbrit paratë (euro);</li> <li>• Demonstron shkathtësi dhe shprehje për zgjidhje të problemave.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Blen duke përdorur paratë euro;</li> <li>• Mbledhin dhe zbresin me euro dhe cent;</li> <li>• Ndërton barazime për paratë.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Blej duke përdorur vlera të ndryshme të parave;</li> <li>• Mbledh dhe zbrit me euro;</li> <li>• Ndërto barazime për paratë.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektori ose hamer, para të printuara, fletore, laps, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Loja ‘Në dyqan’</p> <p>Mësimdhënësi/ja në fillim të orës mësimore njofton nxënësit që sot do të shndërrojmë klasën në një librari e cila shet mjete shkollore. Kërkon nga nxënësit që të nxjerrin nga çantat mjetet e punës që posedojnë dhe ju kërkon që për secilin mjet të vendosin nga një letër që përcakton çmimin. Më pas ju shpërndanë para të printuara ku ata do të blejnë dhe shesin gjërat me paratë e fotokopjuara. Gjatë aktivitetit nxënësit duhet të jenë të gatshëm që të këmbëjnë paratë varësisht nga vlera e çmimit dhe të kthejnë paratë e tepërta për blerësin.</p> <p>Hapi II- Puna në libër</p> <p>Nxënësit hapin librin fq. 107. Në detyrën 1 lidhin dy nga dy objektet në mënyrë që të fitohet vlera 1€, ndërsa në detyrën 2, nxënësit duhet të lidhin dy nga dy objektet në mënyrë që të fitohet vlera 100€.</p> <p>Hapi III – Ushtrime në libër</p> <p>Nxënësit tani vazhdojnë punën e pavarur në libër fq.108. Në detyrat e dhëna, kërkohet të ngjyrosin aq monedha sa duhet për t`u plotësuar çmimi në etiketë.</p>	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.	
VLERËSIMI: Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.	



TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Krahasojmë shumën e parave	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.8 - Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3 -5 minuta;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;</p> <p>III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>2.2 - Zbaton shprehjet të arsyetimit për të bërë hamendësime;</p> <p>4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Cent, euro, para, mbledhje, zbritje	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbledh dhe zbrit paratë (euro).</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Krahason shumën e parave dhe vendos shenjat <math>&gt; = &lt;</math>;</li> <li>Mbledhin dhe zbresin me euro dhe cent;</li> <li>Ndërton barazime për paratë duke i krahasuar ato.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Krahaso shumën e parave dhe vendos shenjat <math>&gt; = &lt;</math>;</li> <li>Mbledh dhe zbrit me euro dhe cent;</li> <li>Ndërto barazime për paratë duke i krahasuar ato.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektori ose hamer, fletore, laps, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Diskutim Mësimdhënësi/ja në fillim të orës mësimore paraqet përmes projektorit shumën të ndryshme parash dhe kërkon nga nxënësit të krahasojnë shumën e parave të paraqitura.</p> <p>Hapi II- Puna në libër Nxënësit hapin librin bazë, f. 109. Në detyrat e dhëna kërkohet të analizojnë e të krahasojnë shumën e parave duke vendosur shenjat <math>&gt; = &lt;</math>.</p> <p>Hapi III – Ushtrime në fletore Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Duke shkëmbyer fletoret ndërtojnë detyra me mbledhje dhe zbritje të eurove duke kërkuar që të krahasojnë rezultatet e parave. Në çifte diskutojnë për rezultatet e detyrave duke argumentuar zgjidhjet.</p>	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.	
VLERËSIMI: Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënësi gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër dhe në fletore.	

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme me fjalë	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;</p> <p>1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;</p> <p>3.6 - Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë.</p>	
FJALËT KYÇE: Cent, euro, para, probleme, strategji, zgjidhje	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbledh dhe zbret paratë (euro);</li> <li>• Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon kërkesat e problemeve me fjalë që kanë të bëjnë me paratë;</li> <li>• Përdorë strategji për zgjidhjen e problemeve me fjalë;</li> <li>• Argumenton strategjinë e përdorur dhe zgjidhjen e problemit.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikoj kërkesat e probleme me fjalë që kanë të bëjnë me paratë;</li> <li>• Përdor strategji për zgjidhjen e problemeve me fjalë;</li> <li>• Argumento strategjinë e përdorur dhe zgjidhjen e problemit.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, projektori ose hamer, fletore, laps, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Detyrë problemore</p> <p>Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore duke u parashtruar nxënësve një detyrë problemore në lidhje me paranë, psh: <i>Miri ka blerë një lodër 65 euro, ndërsa motra e tij ka blerë një lodër 6 euro. Sa euro kanë shpenzuar Miri dhe motra e tij? Për sa ishte më e shtrenjtë lodra e Miri se ajo e motrës?</i></p> <p>Nxënësit shkruajnë detyrën në fletore dhe pasi të gjejnë rezultatin, mësimdhënësi/ja diskuton me ta rreth strategjive të ndryshme që kanë përdorur në zgjidhjen e këtij problemi me fjalë. Secili nxënës tregon mënyrën se si ka arritur deri te rezultati në mënyrë që të ketë laramani të strategjive.</p> <p>Hapi II- Puna në libër/Shqyrtim i përbashkët</p> <p>Nxënësit hapin librin, fq. 110. Detyrat e dhëna në formë problemash analizohen dhe zgjidhen sipas strategjisë më të përshtatshme. Pas çdo detyre diskutohen në mënyrë të përbashkët për të mundësuar vlerësimin e veprimtarive në zgjidhjen e problemeve me fjalë.</p>	

### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Duke shkëmbyer fletoret ndërtojnë ndërtojnë probleme me fjalë dhe në çifte i zgjidhin ato duke argumentuar zgjidhjet dhe strategjitë që kanë përdorur.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër dhe në fletore.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Tërësia, gjysma dhe çereku	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.4 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇË: Tërësia, gjysma, çereku	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë.</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon tërësinë, gjysmën dhe çerekun e figurave të ndryshme;</li> <li>• Veçon gjysmën, dhe çerekun përmes shembujve praktik nga jeta.</li> <li>• Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifiko tërësinë, gjysmën dhe çerekun e figurave të ndryshme;</li> <li>• Veço gjysmën, dhe çerekun përmes shembujve praktik nga jeta.</li> <li>• Përcakto gjysmën dhe çerekun e tërësisë.</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, pjata nga kartoni, gërshërët, fletorja, lapsi, goma	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Zhvillimi i njësisë aktuale duhet të fillojë me një aktivitet konkret. Mësimdhënësi/ja sjell disa pjata kartoni në formë të rrethit. Fillimisht diskutohet me nxënësit për pjatën që realisht paraqet një tërësi. Nga nxënësit kërkohet që secili në mënyrë individuale të gjejë një bosht të asaj pjate (e vizatojnë me laps meqë pjata është nga kartoni) e pastaj e përgjysojnë duke e prerë me gërshërë pikërisht nëpërmjet atij boshti. Diskutohet me nxënësit në lidhje me atë se çfarë u formua tani. Diskutimi vazhdon derisa nxënësit arrijnë të tregojnë se janë formuar dy gjysma nga pjata që ishte në fillim, d.m.th nga tërësia. Pra, nxënësit identifikojnë që 1 tërësi = 2 gjysma.</p> <p>Mësimdhënësi/ja udhëheqë nxënësit që të përgjysojnë edhe gjysmat e formuara. Diskutohet sërish me nxënësit rreth pjesëve të formuara. Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Sa pjesë u formuan tani?</li> <li>➤ Si e kemi emërtuar një pjesë të tillë?</li> <li>➤ Sa pjesë të tilla paska një tërësi?</li> <li>➤ Po gjysma, sa pjesë të tilla ka? etj.</li> </ul>	

Në këtë mënyrë nxënësit identifikojnë edhe çerekun si dhe ndërlidhjet në mes tërësisë, gjysmës dhe çerekut duke treguar që 1 tërësi = 2 gjysma, 1 tërësi = 4 çerekë, 1 gjysmë = 2 çerekë.

#### Hapi II- Puna në libër/Shqyrtim i përbashkët


Nxënësit hapin librin, faqe 113. Fillimisht analizohen dhe diskutohen paraqitjet në detyrat 1, 2 dhe 3. Në detyrën e 4 kërkohet që të plotësohen vendet boshe me fjalët tërësia, gjysma dhe çereku duke u bazuar në ilustrimet e dhëna.

#### Hapi III – Ushtrime në libër

Nxënësit tani vazhdojnë punën në faqe 114 në të cilën janë dhënë ilustrimet dhe hapësirat në të cilën kërkohet të shënohen fjalët, tërësia, gjysma dhe çereku varësisht çfarë paraqesin ilustrimet në fjalë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër dhe në fletore.

TEMA: Numrat natyrorë	
NJËSIA MËSIMORE: Probleme	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.4 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.4 - Përdor fjalorin fletstar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Tërësia, gjysma, çereku.	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë;</li> <li>• Tregon shembuj nga jeta për gjysmën dhe çerekun dhe bën lidhjen me pjesëtimin.</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon tërësinë, gjysmën dhe çerekun e figurave të ndryshme;</li> <li>• Identifikon tërësinë, gjysmën dhe çerekun e numrave të ndryshëm;</li> <li>• Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë;</li> <li>• Përdor pjesëtimin për të veçuar gjysmën dhe çerekun.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikoj tërësinë, gjysmën dhe çerekun e figurave të ndryshme;</li> <li>• Identifikoj tërësinë, gjysmën dhe çerekun e numrave të ndryshëm;</li> <li>• Përcaktoj gjysmën dhe çerekun e tërësisë;</li> <li>• Përdor pjesëtimin për të veçuar gjysmën dhe çerekun.</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, projektori ose hamer, fletorja, lapsi, goma, ngjyra	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Jeta dhe puna	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Zhvillimi i njësisë aktuale duhet të fillojë me një aktivitet konkret. Fillimisht, mësimdhënësi/ja paraqet me anë të projektorit apo hamerit një shembull për tërësinë, gjysmën dhe çerekun.</p> <p>Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të tregojnë çfarë paraqet rrethi dhe pasi nxënësit të arrijnë në përfundim që bëhet fjalë për tërësinë, mësimdhënësi/ja kërkon nga ta që të numërojnë sa pika ndodhen gjithsej në këtë rreth. Nxënësit numërojnë pikat dhe tregojnë se në rreth ndodhen 12 pika. Më tutje, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të identifikojnë gjysmën e rrethit e pastaj të gjejnë sa pika ndodhën në atë gjysmë. Kështu nxënësit tregojnë që në gjysmë të rrethit ndodhen 6 pika.</p>	
	

Në këtë mënyrë mësimitdhënësi/ja u tregon nxënësve që meqë rrethi paraqet tërësinë dhe në tërësi kemi 12 pika, ndërsa në gjysmë të rrethit vetëm 6 pika, kjo do të thotë që gjysma e numrit 12 është numri 6. Ose me pjesëtim mund ta gjejmë duke e shënuar  $12 : 2 = 6$ .

Më tutje, mësimitdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të identifikojnë çerekun dhe të numërojnë sa pika ndodhen brenda atij çereku. Nxënësit tregojnë që në çerek të rrethit ndodhen 3 pika dhe në këtë mënyrë arrijnë në përfundim që çerekun e numrit 12 qenka numri 3. Ose me pjesëtim mund ta gjejmë duke shënuar  $12 : 4 = 3$ .

Mësimitdhënësi/ja merr edhe shembuj të tjerë të numrave dhe nxënësit tregojnë gjysmën dhe çerekun e numrave të ndryshëm. Më pas, mësimitdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që gjysmën dhe çerekun e një tërësie ta ndërlidhin me veprimin e pjesëtimit. Pra duke rikujtuar se kur dëshirojmë të gjejmë gjysmën e një numri pjesëtojmë me 2 ndërsa kur duam ta gjejmë çerekun pjesëtojmë me 4.

#### Hapi II- Puna në libër/Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit hapin librin, faqe 115. Detyrat e dhëna në formë ilustrimesh analizohen dhe më pas diskutohen në mënyrë të përbashkët dhe argumentohen zgjidhjet. Nxënësit vazhdojnë punën edhe në faqen 116. Detyrat e dhëna në formë ilustrimesh analizohen dhe zgjidhen sipas strategjisë më të përshtatshme. Pas çdo detyre diskutohen në mënyrë të përbashkët për të mundësuar vlerësimin e veprimtarive në zgjidhjen e problemeve me fjalë.

#### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Ata duhet të gjejnë gjysmën dhe çerekun e numrave 16, 24, 44. Pasi të kenë përfunduar detyrat në fletore, rezultatet diskutohen në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër dhe në fletore.

TEMA: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare	
NJËSIA MËSIMORE: Barazimet e mbledhjes	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 – Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;</p> <p>III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;</p> <p>1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;</p> <p>3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Barazim, mbledhje, pjesë, tërësi	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra deri në 100);</li> <li>• Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri 100.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton mbledhorin e panjohur;</li> <li>• Plotëson lidhjet pjesë-pjesë-tërësi për të krijuar barazime të sakta;</li> <li>• Gjen zgjidhjen e barazimeve në detyra të ndryshme.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakto mbledhorin e panjohur;</li> <li>• Plotëso lidhjet pjesë-pjesë-tërësi për të krijuar barazime të sakta;</li> <li>• Gjej zgjidhjen e barazimeve në detyra të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, biskota, pjata, faculeta, laps, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret/Shqyrtim i përbashkët</p> <p>Mësimdhënësi/ja fillon orën me një aktivitet konkret ku ka përgatitur dy pjata. Në njërin pjatë ka vendosur 3 biskota, ndërsa në pjatën tjetër janë të vendosura disa biskota të cilat janë të mbuluara me faculetë. Më pas mësimdhënësi/ja njofton nxënësit se gjithsej biskota janë 10. Tani pyetja për nxënësit është se sa biskota ka në pjatën e mbuluar?</p> <p>Nxënësit përgjigjen duke ofruar përgjigje të ndryshme dhe mësimdhënësi/ja në fund zbulon numrin e biskotave në pjatën e mbuluar.</p> <p>Pasi nxënësit t'i kenë konceptuar simbolet e mbledhjes, zbritjes dhe shenjën e barazimit, duhet të kalohet në ushtrimin e shkruarjes dhe leximit të barazive të mbledhjes dhe zbritjes me ç'rast mësimdhënësi/ja gjithnjë duhet ta diskutojë së bashku me nxënësit mundësinë e shkruarjes së dy e më shumë barazive për të njejtin model (barazinë e mbledhjes dhe atë të zbritjes, ndërrimin e vendeve të mbledhorëve etj). Kjo gjithashtu do të ndihmojë shumë që nxënësit ta ndërtojnë lidhjen në mes të mbledhjes dhe zbritjes.</p>	



Te barazimet e bashkimit (mbledhjes) kemi ndërlidhjen e tri sasive. Kemi sasinë apo pjesën fillestare, sasinë apo pjesën që shtohet dhe sasinë apo shumën totale që paraqet rezultatin pas bashkimit të dy pjesëve. Tek barazimet e bashkimit kemi tri situata të mundshme, ku ciladoqoftë prej këtyre tri pjesëve mund të jetë e panjohur në barazim.

Psh:  $\underline{\quad} + 7 = 10$  (mungon pjesa fillestare)

$3 + \underline{\quad} = 10$  (mungon pjesa që shtohet)

$3 + 7 = \underline{\quad}$  (mungon tërësia, shuma totale)

Mësimdhënësi/ja merr shembuj të ndryshëm të barazimeve dhe të gjitha i ndërlidhë me strategjinë pjesë-pjesë-tërësi.

Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit hapin librin bazë, faqe 119. Detyrat e dhëna me kërkesa dhe në formë ilustrimesh analizohen dhe zgjidhen sipas strategjisë më të përshtatshme. Pas çdo detyre diskutohen në mënyrë të përbashkët për të mundësuar vlerësimin e veprimtarive në zgjidhjen e detyrave.

Hapi III – Ushtrime në libër

Nxënësit tani vazhdojnë punën në libër faqe 120. Nxënësit ndërlidhin zgjidhjen e barazimeve me strategjinë pjesë-pjesë-tërësi. Duke ditur që mbledhja dhe zbritja janë të lidhura, në kontekstin pjesë-pjesë-tërësi, mbledhja do të ishte tërësia që mungon kur dihen pjesët, ndërsa zbritja do të ishte pjesa që mungon kur dihet tërësia dhe njëra pjesë. Prandaj, nxënësit mësojnë mënyra të ndryshme për të gjetur pjesën që mungon në mënyrë që të krijojë barazime të sakta.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

NJËSIA MËSIMORE: Gjejmë mbledhorin duke përdorur boshtin numerik

KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:

I.3 – Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;

II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;

II.2 - Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;

III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:

1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;

1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;

3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.

FJALËT KYÇE: Barazim, mbledhje, mbledhor, pjesë, tërësi

REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:

- Përcakton mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra deri në 100);
- Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri 100.

REZULTATET E ORËS:

- Përcakton mbledhorin që mungon;
- Përcakton mbledhorin përmes boshtit numerik;
- Gjen zgjidhjen e barazimeve në detyra të ndryshme.

KRITERET E SUKSESIT:

- Përcakto mbledhorin që mungon;
- Përcakto mbledhorin përmes boshtit numerik;
- Gjej zgjidhjen e barazimeve në detyra të ndryshme.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, boshti numerik, laps, ngjyra etj.


LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:

Hapi I – Aktivitet konkret/Shqyrtim i përbashkët

Mësimdhënësi/ja fillon orën me një aktivitet konkret ku ka përgatitur një bosht numerik të shtrirë në dysheme (mund të vizatohet edhe me shkumës).

Në tabelë paraqet detyrën  $11 + \square = 45$ . Pyetën nxënësit: Si do ta gjenim mbledhorin që mungon me ndihmën e boshtit numerik? Pas përgjigjeve të nxënësve, mësimdhënësi/ja sqaron: Nisemi nga numri që përfaqëson mbledhorin e parë të cilin e kemi të njohur, më pas duke shikuar shumën në e dimë që duhet të shtojmë 3 dhjetëshe për të arritur te numri 41. Pra bëjmë tre kërcime dhe në fund na mbetet të bëjmë 4 hapa për të arritur te numri 45.



Pra, mbledhori që mungon është  $10 + 10 + 10 + 1 + 1 + 1 + 1 = 34$

Vazhdohet edhe me disa shembuj të cilët diskutohen me nxënësit.

### Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët


Nxënësit hapin librin, faqe 121. Detyra 1 është ajo që u diskutua në aktivitetin hyrës. Në detyrën 2 kërkohet nga nxënësit që të gjejnë mbledhorin që mungon duke përdorur boshtin numerik. Pas çdo detyre, rezultatet diskutohen në mënyrë të përbashkët për të mundësuar vlerësimin e veprimtarive në zgjidhjen e detyrave.

### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Nxënësit ndërlidhin zgjidhjen e barazimeve me bosht numerik dhe strategjinë pjesë-pjesë-tërësi. Duke ditur që mbledhja dhe zbritja janë të lidhura, në kontekstin pjesë-pjesë-tërësi, mbledhja do të ishte tërësia që mungon kur dihen pjesët, ndërsa zbritja do të ishte pjesa që mungon kur dihet tërësia dhe njëra pjesë. Prandaj, nxënësit mësojnë mënyra të ndryshme për të gjetur pjesën që mungon në mënyrë që të krijojnë barazime të sakta. Nxënësit krijojnë detyra duke përdorur dy mënyrat.

P.sh:

Gjejmë mbledhorin që mungon



DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

VLERËSIMI: Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare	
NJËSIA MËSIMORE: Barazimet e zbritjes	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 – Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;</p> <p>1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;</p> <p>3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Barazim, zbritje, pjesë, tërësi	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra deri në 100);</li> <li>• Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri 100.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton numrin që mungon në barazimet e zbritjes;</li> <li>• Plotëson lidhjet pjesë-pjesë-tërësi për të krijuar barazime të sakta;</li> <li>• Gjen zgjidhjen e barazimeve në detyra të ndryshme.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakto numrin që mungon në barazimet e zbritjes;</li> <li>• Plotëso lidhjet pjesë-pjesë-tërësi për të krijuar barazime të sakta;</li> <li>• Gjej zgjidhjen e barazimeve në detyra të ndryshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, kapse rrobash, fletore, laps, ngjyra etj.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret/Shqyrtim i përbashkët</p> <p>Mësimdhënësi/ja fillon orën me një aktivitet konkret. Në tavolinë ka vendosur 15 kapse rrobash. Pas pak minutash mësimdhënësi/ja tërheq disa kapse duke pamundësuar nxënësit të shohin se sa ka hequr nga tavolina. Tani në tavolinë janë 8 kapse. Pyetja është: Sa kapse ka hequr nga tavolina mësimdhënësi/ja?</p> <p>Nxënësit përgjigjen duke ofruar përgjigje të ndryshme dhe mësimdhënësi/ja në fund zbulon numrin e kapeve të hequr.</p> <p>Pasi nxënësit t'i kenë konceptuar simbolet e mbledhjes, zbritjes dhe shenjën e barazimit, duhet të kalohet në ushtrimin e shkruarjes dhe leximit të barazive të mbledhjes dhe zbritjes me ç'rast mësimdhënësi/ja gjithnjë duhet ta diskutojë së bashku me nxënësit mundësinë e shkruarjes së dy e më shumë barazive për të njëjtin model (barazinë e mbledhjes dhe atë të zbritjes, ndërrimin e vendeve të mbledhorëve etj). Kjo gjithashtu do të ndihmojë shumë që nxënësit ta ndërtojnë lidhjen në mes të mbledhjes dhe zbritjes.</p> <p>Te ky lloj i barazimeve (të zbritjes), përsëri kemi ndërlidhjen e tri sasive, sasia fillestare apo tërësia, sasia apo pjesa që duhet larguar dhe sasia që mbetet pas largimit apo rezultati.</p>	

Mirëpo, për dallim nga barazimet e bashkimit, pjesa fillestare është tërësia apo sasia më e madhe, përderisa tek barazimet e bashkimit vlen situata e kundërt.

Psh:  $19 - \underline{\quad} = 7$  (mungon pjesa që duhet larguar)

$23 - 14 = \underline{\quad}$  (mungon pjesa që mbetet pas largimit apo rezultati)

$\underline{\quad} - 8 = 24$  (mungon tërësia apo sasia fillestare)

Mësimdhënësi/ja merr shembuj të ndryshëm të barazimeve dhe të gjitha i ndërlidhë me strategjinë pjesë-pjesë-tërësi.

Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit hapin librin bazë, faqe 122. Detyrat e dhëna me kërkesa dhe në formë ilustrimesh analizohen dhe zgjidhen sipas strategjisë më të përshtatshme. Pas çdo detyre diskutohen në mënyrë të përbashkët për të mundësuar vlerësimin e veprimtarive në zgjidhjen e detyrave.

Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Nxënësit ndërlidhin zgjidhjen e barazimeve me strategjitë e përmendura më lart. Duke ditur që mbledhja dhe zbritja janë të lidhura, në kontekst të ngushtë me njëra-tjetrën, nxënësit ndërtojnë barazime të ndryshme të zbritjes duke përdorur mënyra të ndryshme për të gjetur numrin që mungon.

P.sh

Detyra

$18 - \underline{\quad} = 4$

$25 - \underline{\quad} = 16$

Zgjidhja

$18 - 4 = 14$

$25 - 16 = 9$

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.





TEMA: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare	
NJËSIA MËSIMORE: Barazimet e shumëzimit	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> I.3 – Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.2 - Sqaron me anë të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore; III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; 1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave; 3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.	
FJALËT KYÇË: Barazim, shumëzim, pjesë, tërësi	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton faktorin e panjohur (numra deri në 100);</li> <li>• Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri 100.</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton faktorin që mungon;</li> <li>• Plotëson lidhjet pjesë-pjesë-tërësi për të krijuar barazime të sakta;</li> <li>• Gjen zgjidhjen e barazimeve në detyra të ndryshme.</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakto faktorin që mungon;</li> <li>• Plotëso lidhjet pjesë-pjesë-tërësi për të krijuar barazime të sakta;</li> <li>• Gjej zgjidhjen e barazimeve në detyra të ndryshme.</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, laps, gomë, ngjyra	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b> <p>Hapi I – Shqyrtim i përbashkët</p> <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi janë të lidhur. Ky fakt është i njohur edhe për nxënësit. Në kontekstin faktor-faktor-prodhim, pjesëtimi tregon faktorin që mungon kur dihet prodhimi dhe njëri faktor.</p> <p>Te barazimet e shumëzimit kemi sërish ndërlidhjen e tri sasive. Kemi numrin e grupeve, madhësinë e grupeve dhe tërësinë. Te barazimet e shumëzimit kemi tri situata të mundshme, ku ciladoqoftë prej këtyre tri pjesëve mund të jetë e panjohur në barazim.</p> <p>Psh: <math>\_ \cdot 4 = 20</math> (mungon numri i grupeve)  <math>7 \cdot \_ = 42</math> (mungon madhësia e grupeve)  <math>9 \cdot 3 = \_</math> (mungon tërësia)</p> <p>Mësimdhënësi/ja merr shembuj të ndryshëm të barazimeve të shumëzimit, ku mungon cilado nga tri sasitë.</p> <p>Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët</p> <p>Nxënësit hapin librin, faqe 126. Detyrat e dhëna me kërkesa dhe në formë ilustrimesh analizohen dhe zgjidhen sipas strategjisë së paraqitur në fillim të mësimin. Pas çdo detyre</p>	



diskutohen në mënyrë të përbashkët për të mundësuar vlerësimin e veprimtarive në zgjidhjen e detyrave.

### Hapi III – Ushtrime në libër

Nxënësit tani vazhdojnë punën në faqe 127. Në detyrën 1 nxënësit ndërlidhin zgjidhjen e barazimeve të shumëzimit duke e ndërlidhur shumëzimin me pjesëtimin. Te barazimet e shumëzimit, prodhimi paraqet tërësinë. Faktori që e kemi tregon në sa grupe të barabarta duhet të ndahet tërësia. Numri i elementeve në grupe na jep faktorin që mungon.

P.sh

Detyra

$$4 \cdot \underline{\quad} = 32$$

$$\underline{\quad} \cdot 5 = 25$$

Zgjidhja

$$32 : 4 = 8$$

$$25 : 5 = 5$$

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Shprehjet shkronjore			
NJËSIA MËSIMORE: Shkronja x			
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash; II.7 - Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.			
FJALËT KYÇE: Numër, e panjohur, shkronjë			
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryen veprimet themelore me shprehje shkronjore.</li> <li>• Gjen vlerën (numerike) të shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të ndryshoreve.</li> </ul>			
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Veçon numrin e panjohur.</li> <li>• Kryen veprimet themelore me shprehje shkronjore;</li> <li>• Gjen vlerën (numerike) të shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të ndryshoreve;</li> </ul>		KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Veço numrin e panjohur.</li> <li>• Kryej veprimet themelore me shprehje shkronjore;</li> <li>• Gjej vlerën (numerike) të shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të ndryshoreve;</li> </ul>	
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletorja, laps, ngjyra			
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Shqyrtim i përbashkët</p> <p>Meqë nxënësit kanë njohuri mbi barazimet si dhe për lidhjet pjesë-pjesë-tërësi, atëherë mësimdhënësi/ja u tregon që pjesën që mungon mund ta shkruajmë si x. Gjithashtu, nxënësit kanë njohuri edhe për ndërlidhjen e mbledhjes dhe zbritjes, andaj kjo orë mësimore fokusohet në zgjidhjen e barazimeve ku numri i panjohur paraqitet me shkronjën x.</p> <p>Mësimdhënësi/ja diskuton me nxënësit rreth barazimeve të ndryshme ku pozita e shkronjës x (numrit të panjohur) është në vend të mbledhorit të parë, pastaj në vend të mbledhorit të dytë dhe të zbritshmit, zbritësit. Diskutohet për mënyrën e zgjidhjes së secilit lloj të këtyre barazimeve.</p>			
Barazimet e mbledhjes		Barazimet e zbritjes	
Kur mungon mbledhori i parë	Kur mungon mbledhori i dytë	Kur mungon i zbritshmi	Kur mungon zbritësi
$X + 12 = 22$ $X = 22 - 12$ $X = 10$	$24 + X = 32$ $X = 32 - 24$ $X = 8$	$X - 35 = 11$ $X = 11 + 35$ $X = 46$	$64 - X = 20$ $X = 64 - 20$ $X = 44$

Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit hapin librin, faqe 128. Në detyrën 1 janë detyra në të cilat numri i panjohur është mbledhori i parë dhe mbledhori i dytë. Në detyrën e dytë janë detyra ku numri i panjohur është i zbritshmi dhe zbritësi. Pasi nxënësit t'i zgjidhin këto detyra, rezultatet diskutohen në nivel klase.

Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Në fletore kërkohet të ndërtojnë barazime ku e panjohura x është mbledhori i parë, i dytë, i zbritshmi, zbritësi.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Shprehjet shkronjore			
NJËSIA MËSIMORE: Probleme me fjalë			
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II. 1 - Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; III.4 - Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave; 2.2 - Zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësime; 4.2 - Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.			
FJALËT KYÇE: Numër, e panjohur, shkronjë			
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shndërron shprehjet me fjalë në shprehje me simbole dhe anasjelltas;</li> <li>• Zgjidh problema nga jeta e përditshme duke përdorur shprehjet shkronjore.</li> </ul>			
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shndërron shprehjet me fjalë në shprehje me simbole dhe anasjelltas;</li> <li>• Kryen veprimet themelore me shprehje shkronjore;</li> <li>• Gjen vlerën (numerike) e shprehjes shkronjore në probleme me fjalë.</li> </ul>		KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shndërro shprehjet me fjalë në shprehje me simbole dhe anasjelltas;</li> <li>• Kryej veprimet themelore me shprehje shkronjore;</li> <li>• Gjej vlerën (numerike) e shprehjes shkronjore në probleme me fjalë.</li> </ul>	
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, laps, ngjyra			
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Detyrë problemore Mësimdhënësi/ja ndanë nxënësit në 4 grupe dhe secilit grup ju parashtron një problemë me fjalë.			
Barazimet e mbledhjes		Barazimet e zbritjes	
Gr.1	Gr. 2	Gr. 3	Gr. 4
Nita kishte blerë disa libra, babai ja solli edhe 10 libra të rinj. Ajo tani kishte 22 libra. Sa libra bleu Nita?	Peshkatari në mëngjes zuri 17 peshq. Në mesditë zuri edhe disa të tjerë. Ai tani kishte 24 peshq. Sa peshq zuri peshkatari në mesditë?	Blendi kishte shumë balona në dekorin e ditëlindjes. Gjatë festës 12 prej tyre pëlçitën. Tani në dekorin e ditëlindjes kishin mbetur vetëm 6 balona. Sa balona kishte në dekorin e ditëlindjes në fillim të festës?	Gjyshja kishte gatuar 45 biskota me arra. Disa prej tyre ua dhuroj fëmijëve të lagjes. Tani i mbetën 21 biskota? Sa biskota ua dhuroj fëmijëve të lagjës?

Pas përfundimit të detyrave në grupet përkatëse nxënësit prezantojnë dhe të gjithë së bashku analizojnë zgjidhjen e detyrave.

#### Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit hapin librin, faqe 129. Këto detyra janë dhënë në formë tekstuale dhe nxënësit duhet t'i analizojnë me kujdes, të ndërtojnë barazimet duke përdorur x në vend të të panjohurës dhe më pas të zgjidhin këto detyra. Rezultatet e detyrave diskutohen në nivel klase.

#### Hapi III – Ushtrime në libër

Nxënësit tani vazhdojnë punën në faqe 130, ku duhet të zgjidhin detyra të ndryshme të shprehura me fjalë. Barazimet i paraqesin me të panjohurën x. Detyrat vlerësohen dhe analizohen në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare	
NJËSIA MËSIMORE: Jobarazimet	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>I.3 – Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;</p> <p>II.2 - Sqaron me anë të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore;</p> <p>III.7 - Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.3 - Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;</p> <p>1.4 - Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;</p> <p>3.3 - Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.</p>	
FJALËT KYÇE: Jobarazim, zgjidhje, bashkësi zgjidhjesh	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjen bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacioneve (numra deri në 100);</li> <li>• Përdor algoritmet për zgjidhjen e problemave me fjalë duke përdorur ekuacione \inekuacione me numra deri 100.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon jobarazimet nga barazimet;</li> <li>• Gjen bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacioneve;</li> <li>• Përdor algoritme për zgjidhjen e problemeve duke përdorur ekuacionet dhe inekuacionet.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallo jobarazimet nga barazimet;</li> <li>• Gjej bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacioneve;</li> <li>• Përdor algoritme për zgjidhjen e problemeve duke përdorur ekuacionet dhe inekuacionet.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, laps, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Copza të përziera</p> <p>Mësimdhënësi/ja vendosë në tabelë disa copa letre ku janë shkruar disa barazime dhe disa jobarazime. Kërkohej nga nxënësit që t'i sistemojnë detyrat e njërit lloj në një anë dhe në anën tjetër detyrat e llojit tjetër. Tani do parashatrojmë pyetje se çfarë po i dallon këto detyra? Duke pasur parasysh njohuritë nga mësimet e mëparshme nxënësit do të njohin barazimet. Diskutohet se çfarë i dallon barazimet nga jobarazimet. Do të vërejmë se te jobarazimet në vend të shenjës” =” kemi shenjat” &gt;” dhe” &lt;”. Pra te jobarazimet nuk kemi vlerë të barabartë të shprehjeve në të dy anët por do të kemi në njërin anë më shumë apo më pak se në anën tjetër.</p> <p>Për të gjetur bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimeve provojmë numrat me radhë. Tani merren disa shembuj të jobarazimeve dhe në këtë mënyrë shpjegohet se si zgjidhen jobarazimet dhe cilët numra ofrojnë bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimit.</p>	

Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit hapin librin, faqe 131. Detyrat e dhëna me kërkesa dhe ilustrime analizohen dhe së bashku me mësimdhënësin/en zgjidhen duke ritheksuar dallimin e barazimeve me jobarazimet.

Hapi III – Ushtrime në libër

Nxënësit tani vazhdojnë punën në faqe 132 duke zgjidhur detyra të ndryshme me jobarazime. Zgjidhjet diskutohen në nivel klase.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Puna me të dhëna	
NJËSIA MËSIMORE: Grafiku	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyre, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;</p> <p>II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyre që kërkohet prej tij/saj.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>3.2 - Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.</p>	
FJALËT KYÇE: Grafiku, të dhënat, lexim i të dhënave	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Analizon të dhënat e grumbulluara nga tabela dhe i paraqet në grafik.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Lexon të dhënat e paraqitura në grafik;</li> <li>Krahason të dhënat e paraqitura në grafik;</li> <li>Analizon të dhënat dhe i paraqet me grafik.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Lexo të dhënat e paraqitura në grafik;</li> <li>Analizo të dhënat dhe i paraqet me grafik;</li> <li>Krahaso të dhënat e paraqitura në grafik;</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, laps, ngjyra etj.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Gjatë kësaj ore mësimore tentohet që nxënësit të rifreskojnë njohuritë që kanë në lidhje me konceptin e grafikut. Më konkretisht duhet të punohet në plotësim të grafikut dhe lexim të grafikut.</p> <p>Mësimdhënësi/ja shënon në tabelë disa kolona dhe emërton ato në bazë të ngjyrave të syve e pastaj ndan nxënësit në bazë të ngjyrave të syve që kanë. Pasi të plotësohet ky grafik, lexohen të dhënat.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Cila ngjyrë e syve qenka më shprehur në klasën tonë?</li> <li>➤ Cila ngjyrë e syve qenka më pak e shprehur në klasën tonë?</li> <li>➤ Sa nxënës paskan sy me ngjyrë të kaltër?</li> <li>➤ Sa nxënës paskan sy me ngjyrë kafeje? etj.</li> </ul> <p>Shtrohen pyetje për nxënësit, në lidhje me cka mund të bëjmë grafik?</p>	



Nxënësit shprehin idetë e tyre dhe këto ide mund t'i realizojnë si detyrë shtëpie.

**Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët**

Nxënësit hapin librin, faqe 135. Në detyrën 1 kërkohet të analizohet ilustrimi në faqen paraprake dhe të përgjigjen pyetjeve duke shikuar ilustrimin. Në detyrën 2 është dhënë grafiku i një dyqani të kafshëve dhe kërkohet nga nxënësit që duke lexuar grafikun të plotësohen përgjigjet për pyetjet e parashtruara.

**Hapi III – Ushtrime në libër**

Nxënësit tani vazhdojnë punën në faqe 136 ku janë paraqitur dy detyra përmes të cilave kërkohet nga nxënësit të analizojnë grafikët dhe të përgjigjen në kërkesat e dhëna.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Puna me të dhëna				
NJËSIA MËSIMORE: Tabela				
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;</p> <p>II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p>				
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>3.2 - Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.</p>				
FJALËT KYÇE: Tabela, të dhënat, grumbullim, lexim				
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Grumbullon të dhënat në klasë apo diku tjetër dhe paraqet në tabelë.</li> </ul>				
<p>REZULTATET E ORËS</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Grumbullon të dhënat në klasë apo diku tjetër dhe paraqet në tabelë;</li> <li>• Analizon të dhënat e grumbulluara nga tabela;</li> <li>• Interpreton të dhënat e grumbulluara dhe i krahason ato.</li> </ul>		<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Grumbullon të dhënat në klasë apo diku tjetër dhe paraqet në tabelë;</li> <li>• Analizo të dhënat e grumbulluara nga tabela;</li> <li>• Interpreton të dhënat e grumbulluara dhe i krahason ato.</li> </ul>		
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletore, laps, ngjyra				
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet				
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Gjatë kësaj ore mësimore tentohet që nxënësit të rifreskojnë njohuritë që kanë në lidhje me konceptin e tabelës së të dhënave. Më konkretisht duhet të punohet në plotësim të tabelës dhe lexim të të dhënave nga tabela.</p> <p>Mësimdhënësi/ja vizaton një tabelë me 5 kolona dhe 2 rreshta. Në rreshtin e parë mësimdhënësi/ja plotëson copëzat e tabelës me emrat e disa frutave, psh: molla, dardha, portokalli, pjeshka, ndërsa në copëzën e parë të rreshtit të dytë ajo shkruan “numri i nxënësve” ku më pas plotësohet nga të dhënat që nxirren nga nxënësit e klasës.</p>				
Fruti	Molla	Dardha	Portokalli	Pjeshka
Nr. i nxënësve				

Kështu, mësuesi/ja pyet me radhë nxënësit e klasës se cili është fruti më i pëlqyer për ta nga 4 frutat e paraqitur në tabelë. Mësuesja plotëson tabelën me të dhënat e nxjerrura nga nxënësit dhe pastaj bashkarisht lexojnë ato të dhëna duke bërë pyetje të ndryshme si psh:

- Cili qenka fruti më i pëlqyer nga nxënësit e klasës sonë?
- Cila qenka fruti më pak i pëlqyer nga nxënësit e klasës sonë?
- Sa nxënës të klasës sonë e pëlqejnë mollën?
- Sa nxënës të klasës sonë e pëlqejnë dardhën? etj.

#### Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit hapin librin, faqe 137. Në detyrën 1 kërkohet të analizohet ilustrimi dhe të vendosen të dhënat në tabelë me vija dhe me numra. Në detyrën 2 janë paraqitur të dhënat lidhur me leximin e librave që kanë bërë nxënësit e një klase përgjatë pushimeve pranverore. Këto të dhëna i sistemojnë në tabelë.





#### Hapi III – Ushtrime në libër

Nxënësit tani vazhdojnë punën në faqe 138 ku është paraqitur grafiku me të dhënat e aktiviteteve të preferuara të një klase të dytë. Kërkohet nxënësit të analizojnë grafikun, të përgjigjen në pyetjet dhe kërkesat e dhëna dhe të paraqesin të dhënat në tabelë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Puna me të dhëna	
NJËSIA MËSIMORE: Piktogrami	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</p> <p>II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;</p> <p>II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre;</p> <p>III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p>	
<p>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</p> <p>1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;</p> <p>3.2 - Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor;</p> <p>3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.</p>	
FJALËT KYÇE: Piktogram, vlerë, lexim, të dhëna	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor piktogramet.</li> </ul>	
<p>REZULTATET E ORËS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexon të dhënat e paraqitura në piktogram;</li> <li>• Krahason të dhënat e nxjerrura nga piktogrami;</li> <li>• Interpreton të dhënat nga piktogrami.</li> </ul>	<p>KRITERET E SUKSESIT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexon të dhënat e paraqitura në piktogram;</li> <li>• Krahason të dhënat e nxjerrura nga piktogrami;</li> <li>• Interpreton të dhënat nga piktogrami.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletore, laps, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
<p>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</p> <p>Hapi I – Aktivitet konkret</p> <p>Piktogrami është një nga instrumentet më të cilat grumbullohen dhe analizohen të dhënat në statistike. Është në formë të grafikut por dallon nga grafiku sepse secili objekt i paraqitur në piktogram ka një vlerë të caktuar. Mësuesja mund të marrë një shembull nga klasa në lidhje me leximin e të dhënave nga piktogrami.</p> <p>Sa konsumojnë fruta nxënësit e klasës së dytë?</p> <p>■ Me katror paraqesim dy nxënës. Gjysma e katrorit paraqet një nxënës. ■</p>	

			
Molla	Dardha	Portokalli	Pjeshka

Kështu, mësimitdhënësi/ja mbledh të dhënat dhe i paraqet në piktogram duke i analizuar ato.

#### Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit hapin librin, faqe 139. Në detyrën 1 kërkohet nga nxënësit që të analizohet piktogrami dhe të përgjigjen në pyetjet e parashtuara. Në detyrën 2 është dhënë piktogrami me të dhënat e vendeve të preferuara për të vizituar fëmijët. Nxënësit analizojnë piktogramin dhe u përgjigjen kërkesave të dhëna me fjalë.


#### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore duke paraqitur një piktogram dhe me shokun/shoqen e bankës analizojnë dhe diskutojnë për piktogramin që kanë ndërtuar.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

<b>TEMA:</b> Puna me të dhëna	
<b>NJËSIA MËSIMORE:</b> Piktogrami dhe tabela	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1:</b> II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
<b>KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1:</b> 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.2 - Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor; 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.	
<b>FJALËT KYÇE:</b> Piktogram, vlerë, lexim, të dhëna	
<b>REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpreton të dhënat e grumbulluara dhe i krahason ato.</li> </ul>	
<b>REZULTATET E ORËS</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexon dhe paraqet të dhënat nga piktogrami në tabelë;</li> <li>• Krahason të dhënat e nxjerrura nga piktogrami dhe tabela;</li> <li>• Interpreton të dhënat nga piktogrami dhe tabela</li> </ul>	<b>KRITERET E SUKSESIT:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexo dhe paraqit të dhënat nga piktogrami në tabelë;</li> <li>• Krahaso të dhënat e nxjerrura nga piktogrami dhe tabela;</li> <li>• Interpreto të dhënat nga piktogrami dhe tabela</li> </ul>
<b>BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:</b> Libri Matematika 2B, projektori, fletore, laps, ngjyra	
<b>LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:</b>  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënëni/ja përmes projektorit paraqet një piktogram i cili ka të bëjë me instrumentin muzikor është më të pëlqyer në klasën e Jonit.	



Me yll paraqesim 2 nxënës. Tani kërkohet që këto të dhëna nga piktogrami t'i paraqesin me tabelë. Pas përfundimit të detyrës nxënësit prezantojnë tabelën që e kanë hartuar.

#### Hapi II- Puna në libër /Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit hapin librin, faqe 140. Detyrat e dhëna kanë të bëjnë me leximin e të dhënave nga piktogrami dhe paraqitjen e tyre në tabelë.

#### Hapi III – Ushtrime në fletore

Nxënësit tani vazhdojnë punën në fletore. Duke shkëmbyer fletoret me njëri-tjetrin, vizatojnë një piktogram nga i cili duhet të lexohen të dhënat dhe të paraqiten në tabelë. Kontrollimin e detyrave e bëjnë në çift.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Puna me të dhëna	
NJËSIA MËSIMORE: Sporti i preferuar	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: II.1 - Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; II.4 - Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.5 - Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 3.2 - Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor; 3.5 - Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.	
FJALËT KYÇË: Tabelë, grafik, vlerë, lexim, të dhëna	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpreton të dhënat e grumbulluara dhe i krahason ato.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbledh të dhënat përmes aktiviteteve konkrete;</li> <li>• Lexon dhe paraqet të dhënat në grafik;</li> <li>• Krahason të dhënat e nxjerrura;</li> <li>• Interpreton të dhënat.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbledh të dhënat përmes aktiviteteve konkrete;</li> <li>• Lexon dhe paraqet të dhënat në grafik;</li> <li>• Krahason të dhënat e nxjerrura;</li> <li>• Interpreton të dhënat.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, fletore, laps, ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shkencat e Natyrës	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  <p>Hapi I – Aktivitet konkret – Mbledhja e të dhënave Mësimdhënëni/ja njofton nxënësit që sot do të punojnë një projekt. Nxënësit duhet të mbledhin të dhënat për shoqet dhe shokët e klasës për sportin e pëlqyer. Nxënësit ndahen në 5 grupe ku secili grup merret me hulumtimin e një sporti të caktuar. Mbledhin të dhënat në fletore duke i paraqitur ato në tabelë qoftë me vija apo me numra. Më pas i grumbullojnë ato duke i shënuar në tabelën e klasës.</p> <p>Hapi II- Puna në libër-Paraqitja në grafik Nxënësit hapin librin, faqe 141. Plotësohet detyrat e dhënë për paraqitjen e të dhënave me grafik duke ngjyrosur fushat për numrin e nxënësve për secilin sport që kanë pëlqyer.</p> <p>Hapi III – Interpretimi i të dhënave</p>	



Nxënësit tani interpretojnë të dhënat duke analizuar përmes pyetjeve se cili sport ishte më i pëlqyeri e cili ishte më pak i pëlqyer se tjetri.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësuesi/mësuesja.

**VLERËSIMI:** Mësuesi/mësuesja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Probabiliteti	
NJËSIA MËSIMORE: Mundësia	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5minutash; II.7 - Ndërton tekste,objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Mundësia, ngjarje, e mundur, e pamundur	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Parashikon mundësinë (me dallime të mëdha).</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon ngjarjen e mundur nga ngjarja e pamundur;</li> <li>Arsyeton ngjarjet e mundura dhe të pamundura;</li> <li>Përdor shembuj nga jeta e përditshme.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallo ngjarjen e mundur nga ngjarja e pamundur;</li> <li>Arsyeto ngjarjet e mundura dhe të pamundura;</li> <li>Përdor shembuj nga jeta e përditshme.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, goma, kavanozi, tophat me ngjyra	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Mësimdhënësi/ja përdor tophat me dy ngjyra të ndryshme dhe kavanozin e gjerë e të tejdukshëm plastik për të organizuar aktivitete konkrete të nxjerrjes së tophave me sy mbyllur. Së pari në kavanoz fut vetëm tophat me ngjyrë të njëjtë dhe thërret një prej nxënësve që me sy mbyllur të tërheqë një toph. Para se nxënësi (që ka dorën në kavanoz) të nxjerrë jashtë tophin, mësimdhënësi/ja shtron pyetjen para klasës se çfarë ngjyre do të ketë tophi që do të nxirret. Pason pyetja mbi mundësinë e nxjerrjes së tophit me ngjyrën tjetër. Duke drejtuar pyetje të njëpasnjëshme, mësimdhënësi/ja drejton procesin drejt përgjigjeve që nxjerrja e tophit me ngjyrën në fjalë është një ngjarje që do të ndodhë sigurisht, pra është ngjarje e sigurtë, sepse nuk ka mundësi që të nxjerret një toph i ngjyrës tjetër. Ngjashëm, bëhet prova me tophat vetëm të ngjyrës tjetër, dhe në fund bëhet prova me tophat të dy ngjyrave, por mësuesja duhet të kujdeset që tophat të njëjës ngjyrë të ketë më shumë, ndërsa të ngjyrës tjetër të ketë fare pak. Psh 5 tophat të njëjës ngjyrë dhe një toph i ngjyrës tjetër. Te kjo situatë, mësimdhënësi/ja thërret me rradhë disa nxënës që të provojnë me sy mbyllur të nxjerrin një toph. Secilën herë mësimdhënësi e kthen tophin prapa në kavanoz. Nxënësit do të binden se shumë më shpesh	

nxirren toptha me ngjyrë më të shumtë në numër, sesa topthin që është vetëm një, apo më të paktë me numër.

**Hapi II- Puna në libër**

Nxënësit hapin librin, faqe 143. Plotësohen detyrat e dhëna të ngjashme me aktivitetin e realizuar në pjesën hyrëse.

**Hapi III – Luajnë lojën me fjali**

Nxënësit tani luajnë lojën me fjali si p.sh “ Fluturon, fluturon gjarpri.” Nxënësi duhet të tregojë nëse mundësia për të ndodhur kjo është e sigurtë, shumë e mundur, pak e mundur apo e pamundur.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimitdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimitdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.

TEMA: Probabiliteti	
NJËSIA MËSIMORE: E mundur apo e pamundur	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E KOMPETENCAVE KRYESORE PËR SHKALLËN 1: I.3 - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5minutash; II.7 - Ndërton tekste,objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna; III.2 - Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.	
KONTRIBUTI NË REZULTATET E FUSHËS SË KURRIKULËS PËR SHKALLËN 1: 1.1 - Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; 3.4 - Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.	
FJALËT KYÇE: Mundësia, ngjarje, e mundur, e pamundur	
REZULTATET E TË NXËNIT TË LËNDËS: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën provën, e mundur, e pamundur;</li> <li>• Përdorë probabilitetin në jetën e përditshme.</li> </ul>	
REZULTATET E ORËS <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon ngjarjen e mundur nga ngjarja e pamundur;</li> <li>• Arsyeton ngjarjet e mundura dhe të pamundura;</li> <li>• Argumenton ngjarjet e ndryshme dhe vlerëson mundësinë që të ndodhë vërtet.</li> </ul>	KRITERET E SUKSESIT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallo ngjarjen e mundur nga ngjarja e pamundur;</li> <li>• Arsyeto ngjarjet e mundura dhe të pamundura;</li> <li>• Argumento ngjarjet e ndryshme dhe vlerëson mundësinë që të ndodhë vërtet.</li> </ul>
BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: Libri Matematika 2B, lapsi, goma, ngjyra etj.	
LIDHJA ME FUSHAT TJERA ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE DHE SITUATA JETËSORE: Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE:  Hapi I – Aktivitet konkret Ora si zakonisht duhet të ketë një hyrje konkrete të ndërlidhur fuqishëm me përvojat e përditshme reale të fëmijëve. Në këtë frymë, mësimdhënësi/ja fillon të ndërtojë ngjarje në lidhje me ardhjen e përditshme të nxënësve në shkollë, siç është ardhja në shkollë me veturë dhe nga ana tjetër ardhja në shkollë me aeroplan. Prej nxënësve kërkohet të përfundojnë nëse këto ngjarje janë të mundura apo të pamundura, gjë që do të jetë shumë e kapshme dhe e qartë për nxënësin, dhe do t'i ndihmojë të zhvillojë të kuptuarit e koncepteve ‘ngjarje e mundur’ dhe ‘ngjarje e pamundur’.  Hapi II- Puna në libër Nxënësit hapin librin, faqe 144. Plotësohen detyrat e dhëna të ngjashme me aktivitetin e realizuar në pjesën hyrëse. Ata duke analizuar diskutojnë me njëri-tjetrin për mundësinë e një ngjarjeje që të ndodhë në të vërtetë apo jo.	

Hapi III – Puna në fletore

Nxënësit tani krijojnë në fletore ngjarje të cilat ua lexojnë shokëve/shoqeve dhe pyesin ata nëse kjo ngjarje është e mundur apo e pamundur.

Ora vazhdon me ndërtimin e ngjarjeve të ndryshme të mundura dhe të pamundura nga ana e nxënësve, diskutimin e ideve të hedhura dhe arsyetimin e tyre.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** Material nga faqja e internetit e shtëpisë botuese apo i dizajnuar nga mësimdhënësi/ja.

**VLERËSIMI:** Mësimdhënësi/ja përcjell pjesëmarrjen e secilit nxënës gjatë aktivitetit, gjatë diskutimeve si dhe veprimtarisë në libër.